



**INSTITUCIONI I OMBUDSPERSONIT në KOSOVË**

**RAPORTI I GJASHTË VJETOR**

**2005 – 2006**

**drejtuar**

**Kuvendit të Kosovës**

**11 korrik 2006**

**Telefoni: ++381 38 545 303**

**Telefaksi: ++381 38 545 302**

**e-mail: [ombudspersonkosovo@ombudspersonkosovo.org](mailto:ombudspersonkosovo@ombudspersonkosovo.org)**

**web faqja: [www.ombudspersonkosovo.org](http://www.ombudspersonkosovo.org)**

# PËRMBAJTJA

<b>PARATHËNIE</b>	<b>4</b>
<b>HYRJE</b>	<b>6</b>
PREZANTIM I INSTITUCIONIT TË OMBUDSPERSONIT	6
MANDATI I INSTITUCIONIT TË OMBUDSPERSONIT	7
OMBUDSPERSONI I MËPARSHËM	7
USHTRUESI I DETYRËS SË OMBUDSPERSONIT	8
ZËVENDËSI I OMBUDSPERSONIT	9
QASJA NË INSTITUCIONIN E OMBUDSPERSONIT	9
INFORMIMI PUBLIK DHE AKTIVITETET TJERA PROMOVUESE	11
<b>PËRZGJEDHJE E ÇËSHTJEVE TË TË DREJTAVE TË NJËRITU NË KOSOVË</b>	<b>11</b>
ASPEKTE TË PËRGGJITHSHME	11
ZHVILLIMET NË SEKTORIN LIGJOR	12
GJYQËSORI NË KOSOVË	19
PAPËRSHTATSHMËRIA E MEKANIZMAVE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJËRIUT NË KOSOVË DHE ROLI I OMBUDSPERSONIT	23
KOMUNITETET MINORITARE NË KOSOVË	28
SITUATA E PERSONAVE TË ZHVENDOSUR BRENDIA DHE JASHTË KOSOVËS DHE KUSHTET PËR KTHIMIN E TYRE	35
MBROJTJA E TË DREJTAVE PRONËSORE NË KOSOVË DHE ÇËSHTJE TË PËRAFËRTA	41
TË DREJTAT E FËMIJËVE NË KOSOVË	45
FORMAT E NDRYSHME TË DISKRIMINIMIT NË KOSOVË	50
TË DREJTAT E NJËRIUT DHE BISEDIMET MBI STATUSIN	55
<b>AKTIVITETET E INSTITUCIONIT TË OMBUDSPERSONIT</b>	<b>57</b>
HETIMET, AVOKIMI DHE NDËRMJETËSIMI	57
SHQYRTIMI I LEGJISLACIONIT	58
AKTIVITETET E GRUPEVE TË POSAÇME TË INSTITUCIONIT TË OMBUDSPERSONIT	59
<i>Aktivitetet e Grupit për Mos-diskriminim</i>	60
<i>Aktivitetet e Njësisë për barazi gjinore</i>	61
<i>Aktivitetet e grupit për të drejtat e fëmijëve (GDF)</i>	62
BASHKËPUNIMI ME BASHKËSINË NDËRKOMBËTARE	64
BASHKËPUNIMI ME AUTORITETET TJERA	65
BASHKËPUNIMI ME AUTORITETET VENDORE	65
MËSIMI PRAKTIK	66
VETËDIJESIMI DHE MARRËDHËNIET ME MEDIA	66
BASHKËPUNIMI ME OMBUDS INSTITUCIONET DHE ORGANET TJERA TË NGJASHME TË ANKIMIT	67
KONFERENCAT DHE TRAJNIMET E PUNONJËSVE	68
<b>PËRKRAHJA FINANCIARE</b>	<b>72</b>
E ARDHMJIA FINANCIARE E INSTITUCIONIT TË OMBUDSPERSONIT	72
PËRKRAHJA FINANCIARE DHE NË TË MIRA GJATË VITIT 2005-2006	73
<b>PËRMBLEDHJE STATISTIKORE E RASTEVE</b>	<b>76</b>
PËRMBLEDHJE E RASTEVE	76

MASAT E PËRKOZHME DHE RAPORTET -----	77
PËRMBLEDHJE STATISTIKORE E RASTEVE -----	77
<b>ANEKSI I: PËRMBLEDHJET E RAPORTEVE -----</b>	<b>80</b>
<b>ANEKSI II: MASAT E PËRKOZHME-----</b>	<b>96</b>
<b>ANEKSI III: PËRMBLEDHJE E LETRAVE TË PËRZGJEDHURA -----</b>	<b>100</b>
<b>ANEKSI IV: SKEMAT ORGANIZATIVE TË INSTITUCIONIT TË OMBUDSPERSONIT -----</b>	<b>131</b>
<b>ANEKSI V: LISTA E PUNONJËSVE -----</b>	<b>133</b>
<b>ANEKSI VI: LISTA E SHKURTESAVE-----</b>	<b>136</b>

## PARATHËNIE

Ky vit ka qenë vit i ndryshimeve, duke filluar me bartjen e udhëheqjes së Institucionit të Ombudspersonit nga një Ombudsperson ndërkombëtar në atë vendor, ndryshimin e mandatit të Institucionit me Rregulloren e UNMIK-ut të shpallur në shkurt 2006, fillimin e procesit të përpilimit të procedurave për zgjedhjen dhe emërimin e Ombudspersonit të ardhshëm nga Kuvendi i Kosovës, dhe së fundi përpilimin e Ligjit mbi Institucionin e Ombudspersonit që pritet të miratohet nga Kuvendi në fund të këtij viti. Këto ndryshime kanë krijuar disa vështirësi të caktuara për punonjësit e institucionit, veçanërisht duke pasur parasysh që faza aktuale e bartjes së kompetencave ishte filluar pa një bazë të duhur ligjore.

Me largimin e pararendësit tim në dhjetor 2005, z. Søren Jessen-Petersen, PSSP, nxorri një Vendim Ekzekutiv me të cilin më emëroi Ushtrues të detyrës së Ombudspersonit në Kosovë, duke më dhënë përgjegjësinë për të siguruar vazhdimin e punës së Institucionit të Ombudspersonit deri në emërimin e një Ombudspersoni të ri nga Kuvendi i Kosovës. Meqë kjo periudhë për të cilën raportohet mbulon periudhën kur Institucioni ka qenë nën udhëheqjen ndërkombëtare si dhe atë pas bartjes së saj në duart e vendorëve, dëshiroj që me këtë rast t'ia shpreh falënderimin tim z. Nowicki për kontributin e tij në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Si Ombudsperson ndërkombëtar, ai mbrojti në mënyrë të palodhur të drejtat e popullit në Kosovë gjatë pesë viteve të fundit. Dëshiroj që gjithashtu ta falënderoj atë për rekomandimet dhe këshillat e tij gjatë përgatitjes së këtij raporti.

Për mua, është një nder dhe privilegj i veçantë që më është dhënë mundësia që Raportin Vjetor të Institucionit të Ombudspersonit t'ia paraqes për herë të parë Kuvendit të Kosovës, si organ që e përfaqëson popullin.

Derisa Kosova është duke kaluar në një periudhë mjaft të rëndësishme në të cilën është duke u përcaktuar e ardhmja e popullit të saj, proces që udhëhiqet nën patronazhin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, mbrojtja e të drejtave të njeriut, në veçanti ato të minoriteteve, duket se është sfida më e madhe për Institucionet e Përkohshme të Vetqeverisjes, e cilat do të vazhdojnë edhe pas përcaktimit të statusit final të Kosovës. Niveli i mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe sundimi i ligjit janë treguesit kryesor të nivelit të arritur të demokracisë dhe ato përfaqësojnë shtyllat kryesore të integritetit të mundshëm të Kosovës në Evropë.

Në këtë drejtim, roli i Ombudspersonit ka një rëndësi të veçantë. Duke punuar si një organ i pavarur me mandat për t'i hetuar shkeljet e të drejtave të njeriut dhe për të bërë rekomandime në rast të shkeljes së këtyre të drejtave nga autoritetet publike, Ombudspersoni do ta përmbushë mandatin e tij duke u ndihmuar njerëzve si dhe duke promovuar përmes autoritetit të tij një qeverisje më të mirë.

Përmbajtja e këtij raporti shpreh brengat tona lidhur me problemet e përditshme me të cilat ballafaqohen njerëzit dhe vështirësitë që hasen në realizimin e të drejtave të garantuara me sistemin ligjor në Kosovë. Mungesa e përgjegjësisë së administratës publike, mbrojtja e pamjaftueshme e të drejtave të minoriteteve, mungesa e një sistemi të duhur të sigurisë sociale, korrupsioni, nepotizmi dhe krimi i organizuar janë faktorët kryesor që kanë ndihmuar në krijimin e një sistemi të pasigurisë ligjore për banorët e Kosovës dhe kanë parandaluar funksionimin e drejtë të sistemit ligjor.

Dëshiroj të besoj se shumë nga çështjet e ngritura në këtë raport, do të tërheqin vëmendjen e merituar të autoriteteve dhe që në një të ardhme të afërt këto çështje do të zgjidhen dhe tejkalojnë. Dëshiroj të besoj në përkushtimin e vendimmarrësve, udhëheqësve qeveritar dhe zyrtarëve publik që mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut ta shndërrojnë në realitet për shoqërinë Kosovare.

Hilmi Jashari  
Ushtrues i detyrës së Ombudspersonit  
Korrik 2006

## **HYRJE**

Ky Raport vjetor është publikuar në pajtim me Nenin 16.1 të Rregullores Nr. 2006/6 të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë, dhe Rregullën 16 të Rregullave procedurale të Institucionit të Ombudspersonit.

Raporti i gjashtë vjetor mbulon vitin e pestë të plotë të veprimeve të Institucionit, nga 1 korriku 2005 deri më 30 qershor 2006. Ai ka tri pjesë kryesore. Pjesa e parë është një prezantim i Institucionit të Ombudspersonit, punonjësve të tij dhe punës së tij. Pjesa e dytë përbën një analizë të shkurtë të aspekteve të caktuara të situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë nga këndvështrimi i Ombudspersonit, kurse e treta ofron informacione rreth aktiviteteve dhe veprimeve të Institucionit të Ombudspersonit gjatë periudhës për të cilën raportohet.

### **Prezantim i Institucionit të Ombudspersonit**

Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë (IOK) është një institucion i pavarur, i cili ka mandat të shqyrtojë çështjet që kanë të bëjnë me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut apo keqpërdorim të autorizimeve nga autoritetet publike në Kosovë. Në fillim, Institucioni ishte themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/38, që i jepte mandat për të hetuar ankesa kundër UNMIK-ut dhe administratës lokale publike. Në shkurt 2006, u shpall Rregullorja e UNMIK-ut 2006/6 duke zëvendësuar Rregulloren 2000/38. Sipas Rregullores 2006/6, Institucioni i Ombudspersonit ka mandat që të hetojë ankesa kundër autoriteteve lokale apo organeve tjera të Institucioneve të Përkohshme të Vetqeverisjes në Kosovë (IPVQ), por nuk ka më mandat që të hetojë ankesa kundër organeve administrative ndërkombëtare në Kosovë.

Institucioni i Ombudspersonit është hapur zyrtarisht më 21 nëntor 2000 në Prishtinë, me 18 punonjës. Në atë kohë, të gjithë punonjësit e lartë ishin ndërkombëtar. Me zgjerimin e institucionit dhe me hapjen e zyreve të terrenit, numri i punonjësve u rrit në 50 dhe gradualisht punonjësit ndërkombëtar u zëvendësuan nga punonjës vendor. Nga mesi i vitit 2003 deri në dhjetor 2005, Institucioni përbëhej nga Ombudspersoni ndërkombëtar, dy zëvendësit e tij vendor, juristët për të drejtat e njeriut dhe punonjësit përkrahës administrativ. Në dhjetor 2005, Ombudspersoni ndërkombëtar u largua dhe një nga zëvendësit e tij u emërua Ushtrues i detyrës së Ombudspersonit. Rregullorja 2006/6 parasheh një strukturë të re organizative: një Ombudsperson vendor, një zëvendës kryesor dhe tre zëvendësa të tjerë të Ombudspersonit, ku të gjithë duhet të emërohen nga Kuvendi i Kosovës. Në kohën kur ky raport po përgatitej për publikim, Kuvendi kishte miratuar dhe kishte filluar zbatimin e një procedure formale për zgjedhjen e Ombudspersonit të ri.

Që nga themelimi i institucionit, struktura e punonjësve të Institucionit të Ombudspersonit ka qenë shumetnike – shumica e punonjësve është e përkatësisë etnike shqiptare, kurse pjesa tjetër janë të përkatësisë serbe, turke dhe rome. Në pajtim me Rregulloren 2006/6, gjuhët zyrtare në Institucion janë gjuha shqipe dhe ajo serbe.

## **Mandati i Institucionit të Ombudspersonit**

Institucioni i Ombudspersonit pranon dhe heton ankesa nga çdo person në Kosovë që beson se të drejtat e saj/tij i janë shkelur nga ndonjë autoritet publik lokal në Kosovë. Institucioni zhvillon hetime, publikon raporte dhe ofron shërbime juridike dhe avokim publik. Të gjitha shërbimet kryhen falas. Nëse hetuesit e institucionit gjejnë se ka shkelje të të drejtave të njeriut, përfqësuesit udhëheqës të institucionit mund të kërkojnë zgjidhje përmes kanaleve të ndryshme. Ata mund të kërkojnë informacione plotësuese nga autoritetet publike, rekomandojnë veprime për autoritetet lokale, publikojnë raporte, apo të ngritin brengat e tyre pranë mediave. Në rastet që kanë të bëjnë me ankesat e kosovarëve drejtuar autoriteteve publike jashtë Kosovës, institucioni i Ombudspersonit mund të ofrojë shërbimet e tij të mira ose mund t'i përcjellë ato raste te Ombudsmani kompetent vendor ose ndonjë institucion tjetër i natyrës së njëjtë në shtetin përkatës.

Institucioni i Ombudspersonit ka kompetencë që të veprojë në mënyrë të pavarur kur pranon informata dhe mund të hapë hetime në mungesë të ankesës individuale (të ashtuquajturat "hetime *ex officio* apo hetimet sipas detyrës zyrtare). Institucioni ka mandat për të monitoruar veprimet dhe ligjet e aprovuara nga ana e autoriteteve për të siguruar që ato i respektojnë standardet e të drejtave të njeriut dhe kërkesat e qeverisjes së mirë. Në rastet kur Institucioni i Ombudspersonit konsideron që një praktikë ose situatë e përgjithshme ndikon jo vetëm në një individ ose një grup të tyre por në tërë qytetarët si tërësi dhe në të njëjtën kohë nuk është në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ai do të nxjerrë një Raport Special, i cili do të përfshijë rekomandimet drejtuar Kuvendit të Kosovës.

Në mënyrë që të përqendrohet në çështjet e veçanta të disa grupeve të cënueshme të njerëzve, në veçanti fëmijëve, grave dhe minoriteteve, Institucioni i Ombudspersonit ka formuar tri grupe të posaçme juristësh: Grupin për të Drejtat e Fëmijëve (GDF), Njësinë për Barazi Gjinore (NjBGj) dhe Grupin për Mos-diskriminim (GMD).

Ndonëse monitoron pajtueshmërinë e gjyqësorit me standardet e të drejtave të njeriut, Institucioni i Ombudspersonit nuk zëvendëson gjykatën dhe nuk mundet që në mënyrë të drejtpërdrejtë të hetojë krimet, ndryshojë aktvendimet e gjykatës apo të lëshojë vendime detyruese. Institucioni i Ombudspersonit nuk merret me kontestet mes personave privat dhe nuk ka juridiksion mbi administratën ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) e as mbi KFOR-in, forcën ushtarake përgjegjëse për siguri në territorin e Kosovës.

## **Ombudspersoni i mëparshëm**

Z. Marek Antoni Nowicki, mbajti postin e Ombudspersonit që nga 11 korriku 2000 deri më 31 dhjetor 2005. Ai fillimisht u emërua Ombudsperson në Kosovë më 11 korrik 2000, nga z. Bernard Kouchner, PSSP në atë kohë, në pajtim me rekomandimin e Kryesuesit të radhës të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Më 11 korrik 2002, z. Michael Steiner, PSSP në atë kohë, e vazhdoi mandatin e z. Nowicki si Ombudsperson në Kosovë edhe për dy vite tjera deri më 10 korrik 2004. Më 26 maj

2004, z. Harri Holkeri, PSSP në atë kohë, e vazhdoi mandatin e Ombudspersonit edhe për një vit, deri më 10 korrik 2005. Më 15 qershor 2005, z. Søren Jessen-Petersen, PSSP, vendosi ta vazhdojë për herë të fundit mandatin e z. Nowicki deri më 31 dhjetor 2005, kur udhëheqja e Institucionit kaloi tërësisht në duart e vendorëve.

Z. Nowicki ka lindur në vitin 1953 dhe është i nacionalitetit polak. Prej vitit 1987, është anëtar i Odës së Avokatëve të Polonisë. Ai ka një histori të gjatë të aktiviteteve për të drejtat e njeriut që filloi në vitin 1982, kur, gjatë periudhës së qeverisjes ushtarake në Poloni, veprimi si kolumnist i shtypit të rezistencës dhe bashkëpunëtor i lëvizjes “Solidarnosc”. Gjithashtu, në këtë kohë, z. Nowicki bashkë-themloi Komitetin e Helsinkit në Poloni. Gjatë periudhës mes 1990 – 1993, ai ishte anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (IHF) në Vjenë, kurse gjatë 1992 – 1993 ishte ushtrues i detyrës së kryetarit të këtij Fondacioni.

Gjatë periudhës mes viteve 1993 – 1999, z. Nowicki ishte anëtar i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në Strasburg. Ai është kryetar i Fondacionit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Varshavë dhe anëtar i Rrjetit të Bashkimit Evropian të Ekspertëve të Pavarur për të Drejtat Themelore.

Detyra e z. Nowicki si Ombudsperson përfundoi më 31 dhjetor 2005, ku më pas Zëvendësi i Ombudspersonit, z. Hilmi Jashari, u emërua Ushtrues i detyrës së Ombudspersonit.

### **Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit**

Pas largimit të Ombudspersonit, z. Marek Antoni Nowicki, z. Søren Jessen-Petersen, PSSP, emëroi z. Jashari si Ushtrues të detyrës së Ombudspersonit për një periudhë kohore nga 1 janari 2006 deri në kohën kur Kuvendi i Kosovës të emërojë një Ombudsperson të ri. Në ndërkohë, ai vazhdon të mbajë këtë pozitë dhe njëkohësisht të kryejë detyrat e Zëvendës Ombudspersonit.

Z. Hilmi Jashari është lindur në vitin 1969 në Mazgit, në Kosovën qendrore. Z. Jashari diplomoi në Fakultetin Juridik në Prishtinë më 1993 dhe filloi të punojë si sekretar i Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut në Obiliq. Pas vitit 1994, ishte i përfshirë në aktivitetet e shoqatave të ndryshme shqiptare jashtë vendit. Mes viteve 1996 – 1998, z. Jashari punoi si asistent ligjor në zyrën e një avokati në Prishtinë.

Ai është duke punuar në Institucionin e Ombudspersonit prej fillimit të punës së tij në tetor të vitit 2000, ku kishte filluar jurist dhe në korrik 2001 është caktuar Drejtor i Hetimeve. Më 14 mars 2004, ai emërohet si Zëvendës Ombudsperson nga z. Harri Holkeri, PSSP në atë kohë. Mandati i tij është zgjatur nga z. Søren Jessen-Petersen, PSSP, më 15 korrik 2005.



## **Zëvendësi i Ombudspersonit**

Zëvendës Ombudspersoni i ndihmon Ushtruesit të detyrës së Ombudspersonit në drejtimin e suksesshëm të punës së Institucionit të Ombudspersonit dhe e zëvendëson në mungesë të tij.

Z. Ljubinko Todorović, zëvendës Ombudsperson, është lindur në vitin 1951 në Graçanicë. Ai është emëruar zëvendës i Ombudspersonit më 15 shtator 2000 nga z. Berndard Kouchner, PSSP në atë kohë. Posti i tij si zëvendës i Ombudspersonit është zgjatur disa herë, kurse herën e fundit më 11 janar 2006 nga z. Harri Holkeri, PSSP në atë kohë.

Z. Todorović diplomoi në Fakultetin Juridik në Prishtinë më 1981. Më 1991, ai dha provimin e jurisprudencës. Ai tashmë ka punuar në profesione të ndryshme. Mes tjerash, z. Todorović ka qenë përfaqësues ligjor i një korporate, inspektor pune dhe avokat publik i vetëqeverisjes për komunën e Prishtinës. Ai gjithashtu ka qenë sekretar i Bordit Ekzekutiv të Kuvendit Komunal të Prishtinës, si dhe sekretar i Kuvendit Komunal të Prishtinës.

Para vendosjes së Administratës Ndërkombëtare të UNMIK-ut në Kosovë, z. Todorović ka punuar si drejtor në Qendrën Gjermatike në Prishtinë.

## **Qasja në Institucionin e Ombudspersonit**

Qasja në Institucionin e Ombudspersonit ofrohet përmes zyrës së tij qendrore në Prishtinë dhe zyrave në terren në Gjilan, Pejë, Mitrovicë, Prizren dhe Graçanicë. Zyrat në terren janë zakonisht të përbëra nga një ose dy juristë dhe një asistent ligjor/përkthyes. Zyra e terrenit në Mitrovicë gjithashtu ka nën-zyrën e saj në pjesën veriore të qytetit dhe Zyra e terrenit në Pejë ka nën-zyrën e saj në fshatin Vidanjë afër Klinës. Në të dy nën-zyrat punon nga një jurist.

Zyra qendrore në Prishtinë është e hapur për palët katër ditë në javë, respektivisht prej të hënës deri të enjten mes orës 10:00 dhe 14:00. Zyrat në terren pranojnë ankues dy herë në javë mes orës 10:00 dhe 14:00, respektivisht të hënën dhe të enjtën në Gjilan, Pejë, Mitrovicë dhe Graçanicë. Zyra e terrenit në Prizren pranon ankues të hënën dhe të mërkurën. Natyrisht, ankuesit janë të mirëseardhur që në rastet urgjente të vijnë edhe jashtë orarit të pranimit.

Në vitin 2005, institucioni hapi një nën-zyre në Vidanjë në mënyrë që t'u ofrojë qasje më të lehtësuara në Institucionin e Ombudspersonit personave të bashkësive minoritare të Kosovës përëndimore, sidomos komunitetit serb. Kjo zyrë filloi punën në shtator 2005.

Juristët e zyrës qendrore dhe ata që punojnë në zyrat e terrenit rregullisht vizitojnë komunat, enklavat dhe zonat në të cilat gjenden bashkësi të konsiderueshme etnike joshqiptare. Të vetëdijshëm se të burgosurit dhe paraburgosurit kudo në Kosovë kanë qasje të kufizuar ndaj institucioneve dhe se janë të cenueshëm ndaj shkeljeve të të

drejtave të njeriut, përfaqëuesit e Institucionit të Ombudspersonit gjithashtu bëjnë vizita të rregullta dhe të shpeshta në burgje dhe qendra paraburgimi kudo në Kosovë.

Institucioni i Ombudspersonit, në bashkëpunim me autoritetet kompetente të burgjeve, ka vazhduar procesin e komunikimit të drejtpërdrejt me të burgosurit dhe të paraburgosurit përmes kutive postare speciale të vendosura në të gjitha burgjet dhe qendrat e paraburgimit në Kosovë. Vetëm punonjësit e Institucionit të Ombudspersonit kanë qasje në këto kuti postare. Shpesh herë ndodh që përmes këtyre kutive postare të burgosurit dhe të paraburgosurit ta bëjnë kontaktin e parë me Institucionin e Ombudspersonit. Institucioni i Ombudspersonit gjithashtu i shpërndanë formularë administratave të qendrave të paraburgimit dhe burgjeve, që mund të shfrytëzohen nga të burgosurit apo paraburgosurit për të bërë ankesa apo kërkesa, të cilat më pas përcjellën te Institucioni nga administrata kompetente.

Një herë në muaj, një jurist i Institucionit të Ombudspersoni gjithashtu e viziton edhe Entin për Kujdesin Social në Shtime, ku është vendosur një kuti e posaçme postare për ta lehtësuar qasjen në Institucion.

Institucioni mbanë rregullisht Ditët e Hapura, gjatë të cilave ankuesit mund të takohen personalisht me Ombudspersonin apo ndonjë zëvendës të Ombudspersonit. Në zyrën qendrore në Prishtinë, Dita e Hapur organizohet dy herë në muaj, ndërsa në Zyrat e terrenit ajo organizohet një herë më muaj në rajonet e tyre përkatëse dhe në Gjakovë. Gjithashtu, Institucioni mbanë shënime për ankues nga Lipjani të interesuar që të takohen me Ombudspersonin. Kur kjo listë plotësohet, atëherë edhe atje mbahet një Ditë e Hapur. Në rajonet që mbulohen nga ana e Zyrave të terrenit, banorët informohen rreth datave të këtyre ditëve të hapura përmes listave që publikohen në ndërtesat e komunave të ndryshme, lajmërimeve në mediat lokale si dhe përmes datave që publikohen në prezantimin e Institucionit të Ombudspersonit në internet.

Linja telefonike për raste urgjente në zyrën qendrore të Institucionit të Ombudspersonit është e lidhur drejtpërdrejt me zyrën kryesore të juristëve pa kaluar nëpër centralin telefonik të Institucionit të Ombudspersonit. Gjatë vitit të kaluar, përdorimi i linjës ka shënuar rritje të përhershme, duke lehtësuar qasjen në institucion për ata që kanë nevojë urgjente. Institucioni i Ombudspersonit gjithashtu është duke pranuar gjithnjë e më shumë ankesa përmes postës elektronike nga banorët e Kosovës dhe kosovarët që jetojnë jashtë vendit.

Komunikimi mes Ombudspersonit dhe kosovarëve që janë duke qëndruar përkohësisht në Serbi dhe në masë më të vogël në Mal të Zi vazhdon të përmirësohet përmes bashkëpunimit me Komisionarin e Serbisë për Refugjatë dhe përmes marrëveshjes së nënshkruar mes Ombudspersonit dhe Organizatës humanitare spanjolle “Movimiento por la Paz, el Desarme y la Libertad (Lëvizja për Paqe, Çarmatosje dhe Liri – MPDL). Institucioni dhe MPDL rishtas vazhduan marrëveshjen e nënshkruar gjatë periudhës së kaluar për të cilën është raportuar, sipas të cilës MPDL u pajtua që të ndihmojë ankuesit në plotësimin e formularëve të ankesës dhe kontaktimin me Institucionin e Ombudspersonit.

## **Informimi publik dhe aktivitetet tjera promovuese**

Në mënyrë që të informohet publiku për ngjarjet dhe rastet më të rëndësishme pranë Institucionit të Ombudspersonit, "Informatori Periodik" vazhdon të publikohet çdo tre muaj në gjuhën shqipe, serbe, angleze si dhe në gjuhën turke. Informatori ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme për një njohuri më të gjerë publike në Kosovë dhe posaçërisht jashtë saj për punën e Institucionit të Ombudspersonit.

Gjithashtu, prezantimi i Institucionit të Ombudspersonit në internet është burim thelbësor për informim mbi aktivitetet e institucionit dhe përmban versionet elektronike të të gjitha raporteve, letrave të rëndësishme dhe komunikatave për shtyp.

Për të siguruar një informim sa më të gjerë për Ditët e Hapura, institucioni bënë lajmërimi përmes radiostacioneve. Dy javë para mbajtjes së çdo Dite të Hapur, radiostacione të njohura brenda komuniteteve fillojnë të emetojnë një program lajmëruar që sqaron natyrën e punës së Institucionit të Ombudspersonit dhe qëllimin e Ditëve të Hapura.

Veç kësaj, Grupi për të Drejtat e Fëmijëve ka fushatën e tij për ngritjen e vetëdijësimit. Kjo fushatë është e drejtuar kryesisht në shkolla, duke vizituar klasat apo duke i ftuar për ta vizituar Institucionin për t'i informuar fëmijët lidhur me të drejtat e tyre dhe se si institucioni mund t'i mbrojë ato.

## **PËRZGJEDHJE E ÇËSHTJEVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË KOSOVË**

### **Aspekte të përgjithshme**

Kjo periudhë raportuese ka të bëjë me një kohë të veçantë të historisë së shkurtër të Kosovës si protektorat i UNMIK-ut, përkatësisht me situatën e bisedimeve mbi statusin e ardhshëm të Kosovës. Tensionet brenda partive politike ashtu dhe brenda grupeve etnike, kryesisht shqipëtarëve dhe serbëve, janë mjaft të larta dhe debati publik në çdo fazë të bisedimeve për status lë pak hapsirë për çështje tjera.

Në këtë situatë, efikasiteti dhe gjendja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut konsiderohet si çështje margjinale, zakonisht vetëm në kontekstin e përmbushjes së standardeve të caktuara nga UNMIK-u. Derisa gjatë periudhës për të cilën raportohet ka pasur përpjekje të mira për të ngritur vetëdijen mbi çështjen e të drejtave të njeriut, puna e administratës publike vendore në Kosovë ende karakterizohet me një mungesë përgjegjësie ndaj njerëzve nën juridiksionin e saj. Ky është qëndrim i përgjithshëm i zyrtarëve publik që ndihet pak a shumë në të gjitha fushat ku IPVQ-të janë kompetente.

Si dega e ekzekutivit ashtu dhe e gjyqësorit të IPVQ-ve ende perceptohen si të dobëta dhe të korruptuara. Shumica e banorëve të Kosovës kanë pak besim në të dyjat. Shërbimi Policor i Kosovës, ndonëse konsiderohet të jetë një nga forcat më të trajnuara policore në

Evropë, ende vuan nga mungesa e përvojës dhe nuk është në gjendje të luftojë kundër shkallës së gjërë të kriminalitetit dhe mosrespektimit të ligjeve ekzistuese në Kosovë. Sistemi ligjor është konfuz dhe i mungon transparenca. Shumë ligje zbatohen në mënyrë të zgjedhur dhe arbitrare, posaçërisht në fushën e të drejtës pronësore.

Një zbatim i tillë arbitrar i ligjeve lejon një diskriminim të gjërë në Kosovë. Individët që kanë të bëjnë me administratën publike nuk mund të jenë kurrë të sigurtë nëse zyra me të cilën ata kanë të bëjnë do të zbatojë ligjin në rastin e tyre. Grupet e cënueshme, posaçërisht anëtarët e minoriteteve etnike, pësojnë më së shumti nga ky dallim në trajtim.

Marrëdhënia në mes autoriteteve dhe popullit të Kosovës duhet të përmirësohet dhe të dy palët duhet t'i kushtojnë më tepër konsideratë dhe respekt të drejtave të minoriteteve. Shumica e fuqive të rezervuara deri tani për UNMIK-un tani janë transferuar te organet vendore dhe është koha që këto struktura të marrin përgjegjësinë për fushat e tyre përkatëse të punës. Banorët e Kosovës duhet të fitojnë besim në administrimin e IPVQ-ve, përkatësisht në aftësinë apo vullnetin e tyre për të respektuar sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Pa këtë besim, i cili është element thelbësor i demokracisë, çdo diskutim për zbatimin e standardeve të UNMIK-ut apo të vlerave tjera Evropiane në Kosovë është i kotë.

### **Zhvillimet në sektorin ligjor**

Asnjë shtet demokratik nuk mund të funksionojë si duhet pa një zbatim efikas të sundimit të ligjit. Në shumë shtete evropiane, sistemet e duhura të sundimit të ligjit janë vendosur shumë kohë më parë, kështu që funksionimi i tyre tashmë është akceptuar. Sidoqoftë, shembulli i Kosovës dëshmon se çfarë pasoja ligjore dhe praktike mund të shfaqen në qoftë se një sistem ligjor nuk është koherent dhe në të cilin ekziston një konfuzion lidhur me përmbajtjen dhe zbatueshmërinë e ligjeve. Përderisa është e qartë se Kosova tani për tani është një vend në tranzicion, asnjë tranzicion politik e as ligjor nuk mund të zbatohet në mënyrë të duhur në mungesë të funksionimit të rregullt të sundimit të ligjit. Sigurimi i një sistemi funksional të tillë nuk mund të lihet në fund të një tranzicioni – kjo është një çështje që duhet të vendoset në fillim të një faze të tillë, si jashtëzakonisht e nevojshme (sine qua non) për të kryer një tranzicion.

Shtatë vjet prej kur UNMIK-u mori përgjegjësitë në Kosovë, ende ekzistojnë mjaft paqartësi ligjore rreth asaj se cilat ligje jugosllave janë ende të zbatueshme dhe cilat prej tyre nuk janë, si dhe ende nuk ekziston ndonjë organ kompetent ligjor, tek i cili organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit do të mund të drejtoheshin për çështje të tilla. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/24 mbi Ligjet e Zbatueshme në Kosovë, e përmirësuar më vonë me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/59, thotë se ligjet e zbatueshme në Kosovë janë: Rregulloret e UNMIK-ut, ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës, si dhe ligjet e Jugosllavisë të miratuara para 22 marsit të vitit 1989. Përderisa kjo duket e thjeshtë në teori, e njëjta nuk vlen edhe në praktikë, kryesisht për shkak se të gjitha Rregulloret e aprovuara të UNMIK-ut cekin në mënyrë të thjeshtë se ato zëvendësojnë të gjitha ligjet ose dispozitat tjera që nuk janë në pajtim me to, duke mos specifikuar saktësisht se cilin ligj ose cilat ligje ato i zëvendësojnë. Kjo çështje është ngritur nga Ombudspersoni i mëparshëm në disa Raporte të mëhershme Vjetore, por asgjë nuk ka ndryshuar për të

mirë. Fatkeqësisht, edhe ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës e kanë përvetësuar këtë praktikë.

Neni 1.2 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/24 thotë se përjashtimisht, ndonjë gjykatë kompetente, organ ose person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, mund gjithashtu të zbatojë ligjet jo diskriminuese jugosllave të periudhës pas 22 marsit 1989, nëse një çështje ose një situatë nuk mbulohet nga ligjet e tjera të lartpërmendura. Mirëpo, nuk ekziston ndonjë organ më i lartë i veçantë i cili është kompetent për të përcaktuar se cilat ligje janë diskriminuese e cilat jo.

Organi i cili do të ishte kompetent për të shqyrtuar çështjet e tilla si dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, mund të ishte Kolegji i Veçantë i Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet e Kornizës Kushtetuese, i paraparë me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme të vitit 2001. Megjithatë, edhe pse kanë kaluar pesë vite që nga shpallja e Kornizës Kushtetuese përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001, ky Kolegj i Veçantë ende nuk është themeluar. Mungesa e një organi të tillë shpie në një situatë kur një organ gjatë zbatimit të ligjeve Jugosllave të periudhës pas 22 marsit 1989 është i lirë të vendosë vetë se cilit ligj do t'i referohet. Kjo formë e interpretimit arbitrar të ligjit krijon pasiguri të gjerë ligjore.

Në të njëjtën kohë, ligjet që momentalisht janë të zbatueshme në Serbi vazhdojnë të aplikohen në ato zona të mbuluara nga sistemi paralel i gjyqësisë i administruar nga Ministria e Drejtësisë e Serbisë, që nuk njihet nga UNMIK-u. Ky zbatim paralel i një sistemi të ndryshëm ligjor vetëm sa e shton konfuzionin e përgjithshëm.

Për shumë vite, konfuzioni i përgjithshëm dhe pasiguria ligjore janë shtuar për shkak të vështirësive me të cilat është përballur një pjesë e madhe e opinionit për të pasur qasje në Rregulloret e UNMIK-ut dhe në ligjet e Kuvendit të Kosovës. Informimi i publikut për aktet ligjore të cilat janë detyruese për ta është një parim themelor i sundimit të ligjit i cili për një kohë të gjatë nuk është zbatuar në mënyrë të duhur në Kosovë. Në disa raste, Rregulloret e UNMIK-ut janë nxjerrë por nuk janë publikuar në web faqen e UNMIK-ut deri në tri ose më shumë javë më vonë. Publikimi i teksteve të përkthyer nga gjuha angleze origjinale në atë shqipe dhe serbe në web faqe zakonisht është vonuar edhe më shumë për shkak të përkthimeve.

Qasja në ndonjërin prej ligjeve të vjetra jugosllave që ende janë të zbatueshme në Kosovë është e vështirë, nëse jo e pamundur. Përderisa gjykatat në Kosovë, Biblioteka Kombëtare në Prishtinë dhe biblioteka e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës kanë kopje të shumicës së këtyre ligjeve, shumë ministri, komuna dhe institucione nuk i kanë në dispozicion dhe shpesh nuk janë në dijeni për ekzistencën e tyre. Kjo në veçanti është befasuese duke pasur parasysh se Qendra Juridike e Kosovës i ka koleksionuar këto ligje dhe posedon kopje të të gjitha ligjeve jugosllave nga viti 1945. Qendra Juridike e Kosovës më parë ka ofruar qasje në këto ligje në një bibliotekë të themeluar posaçërisht për këtë qëllim, por që fatkeqësisht u detyrua ta mbyllë kah mesi i vitit 2005 për shkak të mungesës së hapësirës dhe fondeve.

Gjatë vitit 2004, filloi puna në një bazë të të dhënave të themeluar nga Zyra e Kryeministrit, por më vonë stagnoi për shkak të vështirësive në mirëmbajtjen e programit të kësaj baze të të dhënave. Sipas informacioneve të marra nga personat kompetent nga Zyra e Kryeministrit, janë duke u bërë përpjekje për vënien në funksion të bazës së të dhënave në një të ardhme të afërt. Funksionimi i një baze të tillë të të dhënave, e cila do të përmbante një numër të madh të ligjeve të zbatueshme në Kosovë në versionet e gjuhëve angleze, shqipe dhe serbe, do të përmirësonte në masë të madhe njohurinë e një pjese të caktuar të opinionit në lidhje me ligjet e zbatueshme në Kosovë, si dhe me të drejtat dhe obligimet që ato përmbajnë. Pritet që baza e të dhënave mund të vihet në funksion në gjysmën e dytë të vitit 2006. Sidoqoftë, nga një bazë e tillë e të dhënave do të përfitojnë vetëm ata persona të cilët kanë mundësi të qasjes në internet. Sa i përket popullatës në përgjithësi, fillimi i zbatimit të Ligjit mbi Gazetën Zyrtare, të miratuar më 12 maj 2005, do të zvogëlojë problemet e qasjes së popullatës dhe institucioneve relevante në aktet ligjore dhe ato nënligjore.

Më 26 prill 2006, Qeveria themeloi Zyrën për Menaxhimin dhe Administrimin e Gazetës Zyrtare të Kosovës, ndërsa numri i parë i gazetës është botuar rreth një muaj më vonë. Ajo përfshinte dy ligje, dhe u botua në gjuhët angleze, shqipe, serbe, turke dhe atë boshnjake. Sipas Ligjit mbi Gazetën Zyrtare, botimi dhe shpërndarja e gazetës tek të gjitha institucionet dhe zyrat postare në nivel komunal do të bëhet çdo muaj, gjë që do të zvogëlonte vështirësitë momentale me të cilat përballen individët në qasjen në aktet ligjore dhe ato nënligjore të nxjerra nga Qeveria dhe ministritë. Aktualisht aktet nënligjore shpesh herë nuk janë në dispozicion në internet, kështu që në përgjithësi publiku përballlet me vështirësi në qasjen ose thjeshtë njohjen e tyre. Edhe aktet ligjore por edhe ato nënligjore hyjnë në fuqi menjëherë pasi të jenë publikuar.

Kjo vë në pah një problem tjetër në lidhje me miratimin e ligjeve, posaçërisht mungesën e vazhdueshme të *vacatio legis* në shumicën e ligjeve të Kuvendit të Kosovës ose Rregulloreve të UNMIK-ut. *Vacatio legis* është vonesa e caktuar kohore në mes të shpalljes së ligjit dhe zbatimit të tij, që ka për qëllim t'i jap publikut dhe institucioneve kompetente për zbatimin e ligjit mundësinë për t'u përshtatur dhe përgatitur për situatat e reja ligjore, gjë që është edhe njëri prej parimeve kyçe të një shteti të qëndrueshëm ligjor. Momentalisht, dështimi i ligjeve për të ofruar një *vacatio legis* ngadalëson zbatimin e një ligji të ri, pasi që përgatitjet e duhura nuk mund të bëhen paraprakisht. Efektet e kësaj mund të shihen në shumicën e ligjeve dhe rregulloreve të miratuara, të cilat zakonisht kanë filluar zbatimin pas disa muajsh apo edhe vitesh pas hyrjes së tyre në fuqi. Edhe pse kjo çështje është ngritur nga Ombudspersoni i mëparshëm në dy Raportet e fundit Vjetore, gjërat nuk janë përmirësuar.

Për shkak të paqartësive ligjore të lartpërmendura, disa ligje të caktuara jugosllave janë injoruar plotësisht, edhe pse në mungesë të ligjeve të reja ose Rregulloreve të UNMIK-ut të miratuara ndërkohë, ato vazhdojnë të jenë të zbatueshme. Njëri prej shembujve të tillë është edhe ligji që u garanton pensionin invalidor invalidëve të Luftës së Dytë Botërore. Edhe pse ky ligj është ende në fuqi, invalidët e Luftës së Dytë Botërore ankohen se që nga viti 1999 nuk kanë marrë pensione. Kjo çështje është ngritur nga Ombudspersoni i mëparshëm tek ish Kryeministri gjatë periudhës së fundit raportuese. Pasi që nuk kishte asnjë përgjigje, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit e ka adresuar këtë çështje tek

Kryeministri përmes një letre të dërguar në maj të vitit 2006, në të cilën letër ende nuk ka marrë ndonjë përgjigje.

Një shembull tjetër i një dështimi të tillë në zbatimin e legjislacionit ekzistues është “Ligji mbi Ekspropriimin i Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës i vitit 1978”. Procedurat e ekspropriimit të parapara në këtë ligj, në shumicën e rasteve nuk zbatohen si duhet në praktikë.

Ligjet e tjera të zbatueshme nuk injorohen aq shumë sa zbatohen në mënyrë selektive. Një shembull i tillë është Ligji i Kuvendit të Kosovës Nr. 2004/15 mbi Ndërtimin, i shpallur më 14 tetor 2004 me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/37. Qëllimi i këtij Ligji është të përcaktojë të gjitha aspektet që lidhen me ndërtimin, materialet, mbikëqyrjen dhe procedurat ligjore që kanë të bëjnë me ndërtimin. Bazuar në këtë ligj, Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor deri më tani ka nxjerrë 11 Udhëzime Administrative, duke përmbushur në këtë mënyrë obligimet e saj për të nxjerrë akte nënligjore të nevojshme për zbatimin e plotë të këtij ligji. Në anën tjetër, shpërthimi i përgjithshëm i ndërtimeve në tërë Kosovën vazhdon të bëhet në mënyrë tërësisht të paligjshme, duke nxjerrë në pah një indiferencë ndaj ligjeve ekzistuese. Komunitet dhe gjykatat shumë shpesh duket se mbështesin këtë fenomen, duke mos i ndëshkuar shumë ndërtues të ndërtimeve të paligjshme. Vendimi për të larguar kiosqet e vendosura në mënyrë të paligjshme nëpër të gjitha komunitet, i zbatuar në masë mjaft të madhe nëpër tërë Kosovën gjatë vitit 2005, kishte të bëjë vetëm me një aspekt të vogël dhe jo aq të rëndësishëm të ndërtimeve të paligjshme në Kosovë dhe thjeshtë bëri përpjekje gjysmë për të zgjidhur këtë problem mjaft të përhapur. Disa prej rasteve më serioze të hetuara nga Institucioni i Ombudspersonit vunë në pah faktin se komunitet kanë lëshuar leje ndërtimi në kundërshtim me ligjin. Në rastet tjera, puna ndërtimore nuk është kryer në përputhje me lejen e ndërtimit të lëshuar nga komuna përkatëse, e cila në anën tjetër zakonisht dështon në marrjen e masave të nevojshme për t’iu dhënë fund veprimeve të tilla të paligjshme.

Ligji i Kuvendit të Kosovës Nr. 2005/26 Kundër Korrupsionit i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/33 më 12 maj 2005 ende nuk është zbatuar në praktikë. Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë se një organ i pavarur, i quajtur Agjensioni Kosovar Kundër Korrupsionit, do të themelohet me qëllim të ushtrimit të përgjegjësive të përcaktuara me këtë ligj. Funksionimi i këtij organi është i lidhur me emërimin e drejtorit të tij nga Kuvendi i Kosovës, gjë që ende nuk ka ndodhur edhe pse deri tani kanë kaluar më shumë se një vit e gjysmë që nga shpallja e ligjit. Në bazë të informatave të siguruar nga zyrtarët kompetent të Kuvendit të Kosovës në fund të periudhës raportuese, procedura për emërimin e drejtorit të Agjensionit është në vijim e sipër dhe pritet që të përfundojë në një të ardhme të afërt. Duke marrë parasysh faktin që funksionimi i duhur i sundimit të ligjit në Kosovë mbetet i pamundur përballë korrupsionit mjaft të përhapur, dhe faktin që lufta kundër korrupsionit është njëra prej standardeve të kërkuara nga bashkësia ndërkombëtare për shtetet që dëshirojnë t’u bashkohen strukturave të Bashkimit Evropian, zbatimi i menjëhershëm i Ligjit Kundër Korrupsionit duhet të jetë njëra prej prioritetëve të të gjitha organeve kompetente në përgjithësi dhe Kuvendit të Kosovës në veçanti.

Duke pasur parasysh rastet individuale, por edhe *ex officio*, Institucioni i Ombudspersonit ka hetuar çështjen e zbatimit të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27 mbi Ligjin Themelor të Punës, i cili në mënyrë të përgjithshme rregullon punësimin në Kosovë. Hetime të ngjashme janë kryer edhe në lidhje me zbatimin e Ligjit të Kuvendit të Kosovës Nr. 2003/19 për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të të Punësuarve dhe Ambientit të Punës të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/33, që ka për qëllim parandalimin e lëndimeve dhe sëmundjeve në vendin e punës dhe mbrojtjen e ambientit të punës, si dhe Ligjit të Kuvendit të Kosovës Nr. 2002/09 mbi Inspektoratin e Punës të Kosovës të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/4. Ky ligj është miratuar duke pasur parasysh nevojën e formimit të Inspektoratit të Punës si një mekanizëm i rëndësishëm që mbikëqyrë zbatimin e Ligjit Themelor të Punës dhe rregullave tjera të mbrojtjes në punë.

Hetimet e Institucionit të Ombudspersonit kanë vënë re shumë mangësi sa i përket zbatimit të ligjeve të lartpërmendura. Këto mangësi janë më evidente në sektorin privat, ku shumë punëdhënës rekrutojnë fuqi punëtore nga tregu i zi, duke mos u ofruar të punësuarve kontrata pune dhe më pas duke mos përmbushur asnjë nga kushtet e përcaktuara me ligjet e lartpërmendura. Në të njëjtën kohë, gjatë inspektimeve të kryera nga inspektorët përkatës, punëdhënësve nuk u sigurohen kopjet e akteve normative dhe atyre plotësuese që rregullojnë këtë fushë, siç është paraparë me Ligjin mbi Inspektoratin e Punës. Marrja e informacioneve të tilla do të ishte padyshim thelbësore për të shtuar njohuritë rreth të drejtave dhe obligimeve të punëdhënësve dhe të punësuarve.

Gjatë periudhës së kaluar raportuese, përmes një letre të dërguar më 18 maj 2005 Ministrin të Shëndetësisë, Ombudspersoni i mëparshëm ngriti çështjen e zbatimit të Ligjit për Produktet Medicinale dhe Pajisjet Medicinale lidhur me praktikën e shitjes së ilaçeve dhe prodhimeve të importuara medicinale nëpër barnatore pa përkthimin e udhëzimeve, dozimit dhe/ose etiketës së paketimit në ndonjërin prej gjuhëve zyrtare të Kosovës. Kjo çështje ishte e një rëndësie të veçantë sepse blerësit e ilaçeve të lartpërmendura zakonisht nuk kanë kuptuar gjuhën në të cilën janë shkruar udhëzimet, dhe atyre u ishte dashur t'u besojnë udhëzimeve gojore të farmacistëve, ose edhe më keq, punonjësve të farmacive. Pas marrjes së informacioneve se kjo situatë nuk është përmirësuar deri më tani, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit së fundi e ngriti përsëri këtë çështje me Ministrinë e Shëndetësisë më 15 qershor 2006.

Në një çështje të ngjashme, Ligji Nr. 2004/17 për Mbrojtjen e Konsumatorit, i shpallur më 19 tetor 2004 me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/42, përcakton, rregullon dhe mbron të drejtat e konsumatorëve gjatë blerjes së mallrave, shërbimeve dhe formave të tjera në tregun e lire. Ligji siguron mbrojtjen e shëndetit, mjedisit, dhe interesave ekonomike të konsumatorit. Sipas këtij ligji, Qeveria është e obliguar që të emëroj një Këshill për hartimin e "Programit të Kosovës për Mbrojtjen e Konsumatorëve". Sipas informatave të marra nga Ministria për Tregti dhe Industri, si përgjegjëse kryesore për zbatimin e këtij ligji, Këshilli do të krijohet në tetor të vitit 2006 dhe menjëherë do të fillojë me hartimin e Programit të Kosovës për Mbrojtjen e Konsumatorëve, i cili do t'i dorëzohet Kuvendit në fillim të vitit 2007. Duhet nënvizuar se shqyrtimi i këtyre çështjeve në këtë fazë mund të thuhet se është në kundërshtim me ligjin, i cili parasheh aprovimin nga Qeveria dhe dorëzimin e Programit të Kosovës për Mbrojtjen e Konsumatorëve Kuvendit jo më vonë se gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit të lartpërmendur. Veprimet e koordinuara për



përmirësimin e mbrojtjes së konsumatorëve të cilat është dashur të ndërmerren shumë më herët nuk janë ndërmarrë deri më tash.

Në bazë të Ligjit për Inspeksionin e Tregut Nr. 02/L-1, të shpallur më 31 maj 2005 me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/29, Inspektorati i Tregut që funksionon në kuadër të Ministrisë për Tregti dhe Industri, si një mekanizëm i rëndësishëm që mbikëqyrë zbatimin e ligjeve të tregtisë, ka filluar punën afërsisht dy muaj para përfundimit të kësaj periudhe të raportimit, dhe mbetet të shihet se si do të funksionojë në praktikë. Detyrat dhe autorizimet e autoriteteve të Inspektoratit të Tregut përfshijnë mbikëqyrjen e zbatimit të akteve normative dhe të dispozitave të veçanta të akteve të tilla, përfshirë edhe Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorëve.

Sipas dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorëve, Ministria për Tregti dhe Industri në bashkëpunim me ministrinë e tjera kompetente, do të duhej nxjerrë akte të brendshme normative në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Megjithatë, zbatimi i këtij ligji nuk do të japë asnjë rezultat praktik, përderisa ministrinë e tjera kompetente për t'u marrë me konsumatorë nuk nxjerrin akte nënligjore në mënyrë që të përpilojnë procedurat e brendshme për zbatimin e ligjit.

Lidhur me Ligjin e Kuvendit të Kosovës për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar në Kosovë (Ligji Nr. 2003/23, i shpallur më 17 dhjetor 2003 me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/40), Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale ka nxjerrë disa akte nënligjore që përcaktojnë një bazë të mjaftueshme për zbatimin e këtij ligji. Megjithatë, ende u mbetet ministrive përkatëse që t'u përmbahen obligimeve të tyre për nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e Nenit 13 të këtij ligji, që ka të bëjë me beneficionet për personat me aftësi të kufizuara të përhershme. Dështimi i ministrive kompetente për nxjerrjen e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e plotë të këtij ligji pasqyron një mospërfillje që cenon parimet e qeverisjes së mirë dhe respektimit të të drejtave të njeriut, të cilat secila qeveri është e obliguar t'i respektojë. Meqenëse ministrinë nuk u janë përmbajtur obligimeve të tyre, kategorisë së lartpërmendur të njerëzve, të cilët për shkak të aftësive të tyre të kufizuara do të duhej të ishin të privilegjuar ose së paku të trajtoheshin ndryshe, deri më tani u janë mohuar të drejtat e garantuara me këtë ligj. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit e ka ngritur këtë çështje fillimisht me Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale e më pas edhe me Kryeministrin si dhe me të gjitha ministrinë kompetente për nxjerrjen e akteve të nevojshme nënligjore.

Lidhur me çështjen e mësipërme, nga shumë ankesa të pranuar nga Institucioni i Ombudspersonit konstatohet se, sipas vendimeve të lëshuara nga Administrata Pensionale, kërkesat e tyre janë refuzuar me arsyetimin e thjeshtë se kërkuarit nuk kanë përmbushur kriteret e përshkruara në Nenin 3 të Ligjit për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë. Megjithatë, disa kritere nuk janë mjaft të qarta, siç është kriteri për aftësinë e plotë dhe të kufizuar i paraparë me nenin 3.2 (d), i cili nuk është i shpjeguar në ligj. Në letrën e datës 30 qershor 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një rekomandim Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, duke i kërkuar atij që t'i propozojë Kuvendit të Kosovës ndryshimin dhe plotësimin e nenit 3 të këtij Ligji.

Ligji i Kuvendit të Kosovës për Qasje në Dokumente Zyrtare, (Ligji Nr. 2003/12 i shpallur më 6 nëntor 2003 me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/32), është i një rëndësie të veçantë për funksionimin e mirë të një shoqërie demokratike. Qëllimi i këtij ligji është që t'u mundësohet qytetarëve që më për së afërmi të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes së institucioneve publike dhe të garantohet që këto të fundit të gëzojnë legjitimitet dhe transparencë më të madhe, të jenë më efikase dhe t'u japin më shumë llogari atyre. Qeveria dhe "institucionet përkatëse" të përmendura në ligj nuk kanë përmbushur obligimet e tyre për zbatimin e ligjit brenda afateve të caktuara, edhe pse ai është shpallur para më shumë se dy vite e gjysmë. Duket se hapat drejt përmbushjes së obligimeve të tyre janë duke u ndërmarrë tani, meqenëse Ministria për Shërbime Publike nxori një Udhëzim Administrativ, i cili u aprovua nga Kryeministri më 28 mars 2006. Ministria e Shërbimeve Publike po ashtu ka përgatitur planin e implementimit të këtij Udhëzimi Administrativ, i cili u është shpërndarë të gjitha institucioneve publike. Sipas informatave të marra, është themeluar "Komisioni ndërinstitucional për Vlerësimin e Praktikave Administrative në Fushën e Dokumenteve Zyrtare" dhe Ministria për Shërbime Publike ka përgatitur projekt rregulloren për punën e këtij Komisioni. Pritet që Qeveria dhe "institucionet përkatëse" do të ndërmarrin më shumë veprime drejt zbatimit të plotë të këtij ligji në një të ardhme të afërt.

Lidhur me komentet për zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore, Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, si dhe Ligjin për Familjen, shiko pjesët e këtij raporti që kanë të bëjnë me Barazinë Gjinore, respektivisht të Drejtat e Fëmijëve.

Në disa fusha, nuk ka kurrfarë ligji që rregullon situata të caktuara. . Një shembull i tillë i mungesës së ligjeve është fakti se ende nuk ka ndonjë ligj që ofron ndonjë mjet juridik për procedurat e stërzgjatura gjyqësore. Kjo çështje u ngrit në të gjitha raportet në të cilat Institucioni i Ombudspersonit erdhi në përfundim se procedura të caktuara gjyqësore kishin zgjatur aq shumë sa për ta shkelur të drejtën e një personi që çështja i tij të zgjidhet brenda një kohe të arsyeshme. Edhe pse ato raporte janë lëshuar nga Insitucioni i Ombudspersonit gjatë katër viteve të fundit, duket që deri më tani nuk janë ndërmarrë kurrfarë veprimesh për ta përgatitur një ligj të tillë.

Edhe pse hartimi dhe implementimi i një Ligji për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, historike dhe natyrore të Kosovës është njëri nga standardet e përcaktuara nga bashkësia ndërkombëtare, ky ligj nuk është miratuar ende. Përgjigja nga personat përgjegjës të Kuvendit të Kosovës lidhur me këtë çështje ishte se një projektligj i tillë është në shqyrtim dhe se së shpejti do të miratohet nga Kuvendi. Duket se e njëjta përgjigje vlen edhe për Projekt Ligjin mbi Religjionin dhe Projekt Ligjin mbi Gjuhët.

Siç shihet, situata e sistemit ligjor në Kosovë në shumë aspekte mbetet konfuzë dhe në mospajtim me parimet themelore të sundimit të ligjit. Për të përmirësuar këtë gjendje, do të ishte e nevojshme që një organ i pavarur ligjor të bënte një vështrim të përgjithshëm të gjendjes dhe të rekomandonte thjeshtimin dhe harmonizimin e legjislacionit, për të siguruar zbatimin e drejtë dhe qasjen e tij në publik. Në të njëjtën kohë, autoritetet përgjegjëse në Kosovë gjithashtu duhet të jenë më vigjilentë për obligimet e tyre lidhur me zbatimin e sundimit të ligjit, si dhe të tregojnë një angazhim më të madh lidhur me garantimin e zbatimit të ligjeve ekzistuese. Kjo është e nevojshme për të ndihmuar sistemin ligjor të Kosovës që të zhvillohet në përputhje me standardet Evropiane.

## Gjyqësori në Kosovë

Ashtu si edhe në Raportet e mëparshme vjetore, kjo pjesë ofron një studim të hollësishëm të funksionimit të sistemit gjyqësor në Kosovë, e në veçanti përputhshmërinë e tij me dispozitat e përcaktuara me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Përderisa është arritur përparim drejt realizimit të standardeve të tilla në ligj dhe në praktikë, sistemi ende përballet me të meta të konsiderueshme.

Në Kosovë, rekrutimi dhe emërimi i gjykatësve dhe i gjykatësve porotë bëhet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, i cili momentalisht përbëhet nga gjykatës lokal dhe ndërkombëtarë, si dhe nga një numër i jo-gjykatësve, përfshirë këtu Ministrin e Drejtësisë, kryetarin e Komisionit parlamentar për çështje legjislative të Kuvendit të Kosovës, kryetarin e Odës së Avokatëve të Kosovës dhe një profesor të drejtësisë. Pas shpalljes së konkursit publik, ky këshill shqyrton kërkesat për t'u punësuar dhe e rekomandon PSSP-në rreth personave që duhet emëruar. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/52 të datës 20 dhjetor 2005, duke zëvendësuar Këshillin e mëparshëm Gjyqësor dhe të Prokurorisë së Kosovës, i cili ishte përgjegjës për rekrutimin dhe emërimin e gjykatësve, gjykatësve porotë dhe prokurorëve, deri në miratimin e emërimeve nga Kuvendi i Kosovës.

Një aspekt i veçantë i sistemit gjyqësor të Kosovës janë gjykatësit ndërkombëtarë, të cilët emërohen dhe caktohen në gjykatat e Kosovës vetëm nga PSSP-ja pa ndonjë procedurë të veçantë të rekrutimit ose emërimit.

Ministria e Drejtësisë është organ kompetent përgjegjës për të gjitha çështjet ligjore, teknike, financiare dhe administrative të lidhura me gjykatat dhe gjyqësorin. Kjo ministri është themeluar gjashtë muaj më parë me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/53 të datës 20 dhjetor 2005, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/19 mbi Degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë. Mes tjerash, kjo ministri mban edhe përgjegjësinë për zhvillimin e politikave në administrimin e drejtësisë, veçanërisht në prokurorinë publike dhe qasjen e minoriteteve në sistemin e drejtësisë, u ofron ndihmë viktimave të krimit dhe mbikëqyrë zyrën e koordinatorit për ndihmë të viktimave. Për momentin, ministria po përgatitet për marrjen graduale të shumicës së kompetencave të lidhura me drejtësinë, që më parë ishin të rezervuara për Shtyllën e mëparshme të UNMIK-ut për Polici dhe Drejtësi.

Më 27 prill 2006, PSSP-ja nxjerri Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/25 mbi Kornizën rregullative për sistemin e drejtësisë në Kosovë, ku u përcaktua autoriteti i PSSP-së mbi Ministrinë e Drejtësisë dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Rregullorja e autorizon PSSP-në që të ushtrojë funksionet e tij të përkatëse në lidhje me emërimin e gjykatësve ose prokurorëve, e veçanërisht atyre të bashkësive etnike të papërfaqësuar sa duhet, themelimin e gjykatave komunale shtesë, departamenteve të gjykatave të tilla dhe gjykatave komunale për kundërvajtje, themelimin e zyrave ndërlidhëse të gjykatave dhe përcaktimin e gjykatësve nëpër panelet që merren me ankesat për diskriminim në gjykata.

Veç kësaj, sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/25, PSSP-ja mban të drejtën për të ndërhyrë në procedurën e rekrutimit të pjesëtarëve të bashkësive të pakicave, për të siguruar përfaqësim të duhur etnik nëpër gjykata, ku kandidatët i përmbushin vetëm disa

prej kërkesave të nevojshme, me kusht që kërkesat e mospërfshira të përmbushen sa më parë, por jo më vonë se një vit nga data e emërimit.

Siç është cekur më lart, Kosovës ende i mungon një procedurë e pavarur për emërimin e gjykatësve, meqenëse vendimi përfundimtar për një çështje të tillë prapë se prapë merret nga PSSP-ja, autoriteti më i lartë ekzekutiv në Kosovë. Edhe pse i përbërë nga një spektër i gjerë i faktorëve të ndryshëm nga legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori, Këshilli Gjyqësor vetëm i propozon gjykatësit për emërim, por nuk e merr vendimin për emërimin e tyre, dhe për këtë arsye i mungon fuqia e vërtetë në këtë fushë.

Sa u përket gjykatësve ndërkombëtar, procedura e emërimit ende nuk është transparente, pasi që përveç kriterëve që gjykatësit duhet të plotësojnë, nuk ekzistojnë dispozita të tjera të zgjedhjes së tyre në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2000/06, të datës 15 shkurt 2000 mbi emërimin dhe shkarkimin nga detyra të gjykatësve ndërkombëtarë dhe prokurorëve ndërkombëtarë (të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/34 të datës 27 maj 2000 dhe Rregulloren e UNMIK-ut 2001/2 të datës 12 janar 2001). Për më tepër Rregullorja e sipërpërmendur nuk e përcakton kohëzgjatjen e mandatit të gjykatësve ndërkombëtar, gjë që vazhdon të paraqesë kërcënim serioz për pavarësinë e gjyqësorit. Në praktikë, mandati zakonisht zgjat gjashtë muaj, që nuk mjafton për ta garantuar pavarësinë e këtyre gjykatësve dhe sjellë rrezikun e ndikimit negativ në administratën drejtësisë për shkak të ndërrimeve të vazhdueshme në këtë drejtim. Për më tepër, dështimi i vazhdueshëm për të themeluar një mekanizëm ligjor për t'i adresuar ankesat kundër gjykatësve ndërkombëtar ngrit shqetësime serioze lidhur me përgjegjësinë e sistemit në tërësi.

Sa i përket punës momentale të gjykatave, një nga problemet me të cilin përballet sistemi gjyqësor në Kosovë vazhdojnë të jenë pohimet për korrupsionin e përhapur. Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit ka vazhduar të pranojë një numër të konsiderueshëm të ankesave lidhur me pohimet për korrupsion të gjykatësve. Këto ankesa e pasqyrojnë dobësinë e gjyqësorit në Kosovë dhe mungesën e besimit të banorëve të Kosovës ndaj tij. Mekanizmat ekzistues për parandalimin e korrupsionit nuk duket ta kenë rritur besimin e publikut në gjykatat vendore.

Në anën tjetër, korrupsioni nuk duket të jetë arsyeja e vetme për mungesë të cilësisë në punën e gjykatës. Krahas trajnimeve të organizuara nga Instituti gjyqësor i Kosovës, duhet të zhvillohen strategji të mëtejshme për ta përmirësuar standardin e përgjithshëm të administrimit të drejtësisë në Kosovë.

Në të njëjtën kohë, forcimi i gjyqësorit dhe rritja e besimit në punën e tij do të jetë e vështirë, nëse jo edhe e pamundshme që të arrihet nëse pagat e gjykatësve vendorë mbesin në nivel të ulët ashtu siç janë tani. Në këtë kontekst, duhet të theksohet se pagesa e duhur është thelbësore për ruajtjen e pavarësisë së gjyqësorit. Ajo ndihmon të garantohet cilësia e administrimit të drejtësisë dhe len më pak hapësirë për korrupsion apo mitosje të gjykatësve.

Një çështje tjetër e pazgjidhur dhe mjaft shqetësuese është edhe kohëzgjatja e proceseve gjyqësore civile. Është e vërtetë se në masë të madhe kjo shkaktohet nga mungesa e numrit të mjaftueshëm të gjykatësve dhe personelit mbështetës për t'u marrë me numrin e madh të lëndëve të pazgjidhura, si dhe për shkak të faktit se gjykatësit nuk janë të caktuar

nëpër gjykata sipas nevojave ekzistuese – disa gjykata në Kosovë kanë numër të vogël të lëndëve dhe shumë më tepër gjykatës për t'u marrë me to, përderisa gjykatat tjera kanë numër mjaft të madh të lëndëve dhe shumë pak gjykatës.

Një arsye tjetër për vonesat e proceseve gjyqësore janë edhe mangësitë në menaxhimin e rasteve nga administrata e gjykatës, veçanërisht lidhur me rastet urgjente të cilave shumë shpesh nuk u jepet trajtimi prioritar të cilin e meritojnë. Në raportin e tij të titulluar “Kosova: Shqyrtimi i parë i sistemit të drejtësisë civile” të publikuar në qershor të vitit 2006, Misioni i OSBE-së në Kosovë erdhi në një përfundim të ngjashëm.

Për këtë arsye, rekrutimi i më shumë gjykatësve për ato gjykata që kanë numër të madh të rasteve të pazgjidhura, si dhe trajnimi i duhur mbi menaxhimin e gjykatave për administratorët e gjykatave janë çështje të cilat duhet të adresohen nga autoritetet kompetente lokale dhe ndërkombëtare pa ndonjë vonesë të mëtejshme.

Një e metë tjetër e identifikuar në gjykatat e Kosovës, e cila duket të shkaktojë shumë vonesa në proceset gjyqësore është edhe mungesa e numrit të mjaftueshëm të sallave gjyqësore. Shpeshherë gjykatësit janë të obliguar që të mbajnë seanca dëgjimore në zyrat e tyre, gjë që parandalon pjesëmarrjen e publikut në këto seanca, duke reduktuar në të njëjtën kohë edhe transparencën e sistemit.

Në raportin e kaluar vjetor, Ombudspersoni i mëparshëm e ka theksuar çështjen e gjykatave paralele të vendosura në enklavat serbe në Kosovë, ose nëpër qytetet e Serbisë, të cilat kohëve të fundit merren kryesisht me çështjet e pronave. Këto gjykata paralele janë të administruara dhe financuara nga Ministria e Drejtësisë e Serbisë, duke shpërfillur autoritetin e UNMIK-ut. Në anën tjetër, UNMIK-u nuk i njeh këto gjykata. Shtatë vite pas marrjes së kontrollit mbi Kosovën, UNMIK-u ende nuk ka arritur të vendosë kontrollin e plotë mbi sistemin gjyqësor në Kosovë.

Veç kësaj, mungesa e ekspertëve si dhe mungesa e pajisjeve të nevojshme për përgatitjen e ekspertizave përkatëse për gjykatat në Kosovë, si dhe mungesa e fondeve të duhura për t'i financuar ato, vazhdon të shkaktojë procese të stërzgjatura gjyqësore. Për momentin, Zyra e mjekësisë ligjore e UNMIK-ut është e kufizuar në kryerjen e autopsive dhe kontrollimeve fizike të viktimave, si dhe në dhënien e ekspertizës për gjykatat lidhur me këtë çështje. Gjatë mbledhjeve mes përfaqësuesve të Institucionit të Ombudspersonit dhe gjykatave, së fundi u konstatua se themelimi i një instituti të veçantë përgjegjës për përgatitjen e ekspertizave të llojeve të ndryshme gjatë proceseve gjyqësore, në veçanti për gjykatat penale dhe prokurorët, do të ndihmonte në zgjidhjen e këtyre problemeve. Ekspertizat e tilla do të përfshinin ekspertizën dhe hulumtimin në fushën e shkencës së mjekësisë ligjore dhe psikiatrisë. Institucionet e ngjashme në shumë vende kanë demonstruar efikasitetin në zbatimin e detyrave të tyre dhe kanë ndihmuar përsheptimin e proceseve gjyqësore. Megjithatë, duke pasur parasysh problemet buxhetore të institucioneve publike në Kosovë, themelimi i një instituti të tillë do të kërkonte mbështetjen financiare të donatorëve ndërkombëtarë.

Gjatë shtatë viteve të kaluara, kanë ekzistuar edhe probleme substanciale lidhur me përkthimin e dokumenteve dhe përkthimeve gojore gjatë proceseve gjyqësore. Burimi i këtij problemi qëndron në faktin se për momentin, gjykatat nuk janë duke përcjellë

ndonjë procedurë të veçantë për përcaktimin e cilësisë së përkthyesve. Ligji i zbatueshëm jugosllav mbi përkthyesit dhe interpretët e gjykatës i vitit 1969 parasheh një procedurë të tillë, por ajo nuk po zbatohet. Për të zgjidhur këtë situatë konfuze, autoritetet kompetente dhe gjykatat e larta duhet të garantojnë që ky ligj do përfillet.

Në shumë situata kur proceset gjyqësore kalojnë në fazën e ankimit, gjykatat e shkallës së dytë kthejnë mbrapa vendimet e gjykatës së shkallës së parë disa herë për shkak të gabimeve procedurale, ose edhe më keq, për shkak të gabimeve në qasjen e dëshmive ose në zbatimin e ligjit. Përsëri, kjo dëshmon cilësinë e ulët të punës në gjykata dhe demonstroi një mungesë serioze të profesionalizmit dhe motivimit në gjykatat e shkallës së parë dhe rritë numrin edhe ashtu të madh të rasteve të pazgjidhura që presin të shqyrtohen nga gjykatat e shkallës së dytë.

Një arsye për gabimet e tilla të përsëritshme është fakti kur rastet kthehen mbrapa për rigjykim tek gjykatat e instancës së parë, panelet të cilat e kryejnë një rigjykim të tillë përbëhen nga gjykatësit e njëjtë të cilat kanë vendosur mbi çështjen në instancën e parë. Fakti se procedura e dytë kryhet nga gjykatësit e njëjtë gjithashtu ngrit çështjen e paanësisë së tyre lidhur me rastin, duke pasur parasysh që ato nuk paraqesin “një palë sy të ri”, çfarë do të duhej të ishte rasti me një panel të paanshëm shqyrtues. Përfshirja e mëhershme në rastin bart me vete edhe rrezikun që gjykatësi i përfshirë tashmë mund ta ketë krijuar mendimin e tij mbi rastin, çfarë mund të ketë ndikim negativ në administrimin e drejtësisë.

Një problem tjetër i lidhur me punën e gjykatës është dështimi për të fuqizuar vendimet e gjykatës, gjë që duket të jetë shndërruar në një praktikë mjaft të përhapur në sistemin gjyqësor të Kosovës, edhe pse gjykatat nuk janë gjithmonë fajtoresh për këtë. Zakonisht problemi qëndron në faktin se vendimet e gjykatës nuk respektohen nga pala e paditur, në veçanti nga komunat.

Një problem i veçantë në këtë kontekst është i lidhur me rastet kur palët e paditura janë ndërmarrjet e dikurshme shoqërore që tani administrohen nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM), e cila gjithashtu është përgjegjëse për procesin e privatizimit. Një numër i madh i këtyre rasteve përfshin punëtorët e mëparshëm të cilët ankohen nëpër gjykata për mospagesën e pagave të tyre. Përderisa gjykatat kanë nxjerrë vendime në favor të paditësve, ato nuk kanë qenë në gjendje të ekzekutojnë këto vendime në llogaritë bankare të ndërmarrjeve të dikurshme shoqërore për shkak se llogaritë ose kanë qenë të zbrazëta, ose bankat kanë marrë udhëzime nga AKM-ja për të mos ekzekutuar vendimet e tilla të gjykatës. Problemi kryesor qëndron në faktin që edhe pse Oda e veçantë pranë Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit i ka informuar gjykatat në lidhje me kompetencat e tyre në rastet e tilla, ajo nuk ka lëshuar ndonjë informatë rreth asaj se si të bëhet ekzekutimi i vendimeve në praktikë. Veç kësaj, AKM-ja nuk ka qenë mjaft e gatshme për të bashkëpunuar me gjykatat në çështjet e tilla. Për këtë arsye, të gjitha gjykatat që merren me aspektet ligjore të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore duhet ta diskutojnë zgjidhjen e kësaj çështjeje me gjykatat lokale. Lidhur me këtë çështje, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një raport Kuvendit të Kosovës në prill të vitit 2006, ku thuhej se moszbatimi i këtyre vendimeve përbën shkelje të së drejtës së ankuesit për një proces të rregullt

gjyqësor, duke pasur parasysh që qasja e tyre në gjykatë kishte rezultuar si joefektive si pasojë e paafësisë së Gjykatës përkatëse Komunale për të ekzekutuar vendimin e saj.

Një problem tjetër më praktik i lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore është mungesa e numrit të mjaftueshëm të referentëve ekzekutiv, që është një problem mjaft i përhapur, derisa ka edhe gjykata që nuk kanë asnjë referent ekzekutiv.

Lidhur me rastet penale, një çështje që nuk ka ndryshuar aq shumë prej raportit të fundit vjetor është mungesa e masave për mbrojtjen e dëshmitarëve. Gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit ka marrë përsëri informacione se dëshmitarët ende frikësohen për t'i ndihmuar gjykatësit dhe prokurorët në zgjidhjen e rasteve pasi që kanë shumë pak shpresë se organet për zbatimin e ligjit do të jenë në gjendje t'i mbrojnë ata. Kjo shkakton vonesa të konsiderueshme në hetimin e rasteve të rënda penale. Një program i duhur i mbrojtjes së dëshmitarëve në Kosovë ekziston vetëm në letër, dhe për momentin duket se nuk ka fonde të mjaftueshme ose kapacitete të tjera për të zbatuar këtë plan program në praktikë. Derisa nuk zbatohet ky program, shumë raste penale do të mbesin të pazgjidhura për shkak të mungesës së dëshmitarëve ose dëshmive. Megjithatë, në të njëjtën kohë, mbetet për t'u dyshuar nëse zbatimi i një programi të tillë të kufizuar do të mund ta thyente rrethin momental të frikësimit, korrupsionit dhe mungesës së përgjithshme të bashkëpunimit nga dëshmitarët në Kosovë.

Një problem tjetër i cili është specifik për rastet penale është mungesa e vazhdueshme e hapësirës së burgjeve për personat e dënuar. Në rastet kur përfshihen dënime më të lehta penale, kundërvajtësit duhet të presin për periudha të gjata të paarsyeshme për ta filluar vuajtjen e dënimit. Ky problem i mungesës së hapësirës së nevojshme prek edhe të paraburgosurit, procedura e të cilëve është kthyer për rigjykim, të cilët shumë shpesh nuk vendosen në qendra të paraburgimit afër gjykatave kompetente, por shpërndahen në qendra paraburgimi nëpër tërë Kosovën.

Pa marrë parasysh disa iniciativa të caktuara për përmirësimin e funksionimit të sistemit të gjykatave në Kosovë, gjyqësori mbetet i dobësuar nga pohimet për korrupsion të përhapur dhe mungesa e besimit, si dhe mungesa e vazhdueshme e fondeve. Duke marrë parasysh faktin që Kosova nuk ka ndonjë traditë të gjatë të gjyqësorit të fortë dhe të pavarur dhe që shumica e gjykatësve në Kosovë filluan të ushtrjnë funksione gjyqësore vetëm pas vitit 1999, duhet të ketë më shumë angazhim për t'i eliminuar këto mangësi në mënyrë që të garantohet një administrim i pavarur dhe efikas i drejtësisë. Ende mbetet mjaft për t'u bërë në këtë fushë dhe Ministria e sapokrijuar e Drejtësisë do të duhet të luajë një rol të rëndësishëm në arritjen e synimeve të sipërpërmendura.

## **Papërshtatshmëria e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe roli i Ombudspersonit**

Në periudhën për të cilën raportohet janë parë disa përmirësime në lidhje me implementimin e instrumenteve të caktuara ligjore ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.

UNMIK-u dhe IPVQ-të i kanë bërë hapat e parë drejt implementimit të Kornizës së Konventës të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare. Në Raportin e kaluar vjetor tashmë është diskutuar marrëveshja e nënshkruar në vitin 2004 mes UNMIK-ut dhe Këshillit të Evropës mbi aranzhimet teknike në lidhje me këtë Kornizë të Konventës. Në qershor të vitit 2005, në pajtim me këtë marrëveshje, UNMIK-u ia paraqiti një raport Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, duke e informuar Komitetin rreth masave legjislative dhe të tjera që IPVQ-të i kishin ndërmarrë për ta zbatuar Kornizën e Konventës. Si përgjigje në këtë, duke u bazuar gjithashtu në një “raport hije” të nxjerrë nga një grup punues i përbërë nga përfaqësuesit komuniteteve minoritare në Kosovë si dhe në një vizitë Kosovës, Komisioni këshillues i Këshillit të Evropës për Kornizën e Konventës e miratoi një mendim lidhur me zbatimin e Kornizës së Konventës në Kosovë. Mendimi i Komisionit këshillues u publikua në mars të vitit 2006 dhe përmbante rekomandime si të përmirësohet zbatimi i Kornizës së Konventës.

Pas përgjigjes së UNMIK-ut në mendimin e Komisionit Këshillues, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës e nxjerri një rezolutë më 21 qershor 2006, duke i përsëritur në një masë të madhe konkluzionet e Komisionit Këshillues dhe duke rekomanduar që UNMIK-u, mes tjerash, ta përmirësojë procesin e bartjes së kompetencave dhe funksioneve të gjyqësorit, si dhe forcimin e besimit në gjykata. Në fund, Komiteti i Ministrave gjithashtu paralajmëroi që UNMIK-u do të duhej të garantojë që bartja e Institucionit të Ombudspersonit në duart e udhëheqjes vendore nuk do ta dëmtojë efikasitetin e Institucionit apo zvogëlojë besimin që ai e kishte ndërtuar deri atëherë në mesin e komuniteteve minoritare.

Në korrik të vitit 2004, Komisioni i KB-ve për të Drejtat e Njeriut kërkoi nga UNMIK-u që ta përgatisë një raport mbi situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë prej vitit 1999, që iu dërgua Komisionit në qershor të vitit 2006. UNMIK-u kërkoi nga Institucioni i Ombudspersonit që, si institucion vendor për të drejtat e njeriut, ta japë vlerësimin e tij lidhur me këto çështje, gjë që Institucioni e bëri. Megjithatë, duket që ky vlerësim nuk ishte përfshirë në versionin përfundimtar të raportit që i ishte dërguar Komisionit. Ky është një zhvillim fatkeq për shkak se rregullat procedurale të Komisionit lënë hapësirë për vlerësimet e institucioneve vendore për të drejtat e njeriut dhe Institucioni i Ombudspersonit duket të jetë në pozitën më të mirë për të ofruar informata mbi çështjet që ndërlidhen drejtpërdrejt me Institucionin dhe punën e tij. Në ndërkohë, Komisioni ka kërkuar për sqarime të mëtejshme që në mënyrë specifike përfshijnë edhe çështjen e bashkëpunimit mes Institucionit të Ombudspersonit dhe UNMIK-ut dhe pasojat që kosovarizimi i Institucionit të Ombudspersonit do t'i ketë në punën e Institucionit. UNMIK-u ia dërgoi Komisionit përgjigjet në këto pyetje në fund të qershorit të vitit 2006.

Nga UNMIK-u, përsëri në bashkëpunim me IPVQ-të, është kërkuar nga Komisioni i KB-ve për të drejtat ekonomike dhe sociale që ta përgatisë një raport mbi gëzimin e të drejtave ekonomike dhe sociale në Kosovë prej vitit 1999. Ky raport është duke u përgatitur dhe pritet që t'i dërgohet Komisionit në mars të vitit 2007.

Edhe pse këto raporte dhe aktivitetet shoqëruese demonstronjë që ende mbetet të bëhet shumë për ta ngritur vetëdijen për të drejtat e njeriut në Kosovë, ato gjithashtu



demonstrojnë edhe një progres sepse UNMIK-u, për herë të parë, është i obliguar që për veprimet e tij t'u japë llogari organeve ndërkombëtare monitoruese për të drejtat e njeriut.

Një hap prapa në lidhje me zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ka të bëjë me Konventën evropiane për parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës apo degradues ose ndëshkues, e cila ia jep Komisionit të Këshillit të Evropës për parandalimin e torturës të drejtën të ketë qasje në të gjitha vendet ku personat janë të privuar lirie. Në pajtim me një marrëveshje në mes të UNMIK-ut dhe KFOR-it, kjo Konventë është tani e zbatueshme edhe në territorin e Kosovës. Duket që për shkak të refuzimit të KFOR-it për t'ia mundësuar Komisionit qasjen në objektet e tij të paraburgimit, Komisioni ka vendosur që deri më tani të mos e vizitojë asnjë nga qendrat tjera të paraburgimit apo burgjet në Kosovë, kështu që Konventa e lartpërmendur ende nuk është duke u zbatuar në territorin e Kosovës.

Një zhvillim tjetër pozitiv në lidhje me monitorimin e brendshëm të të drejtave të njeriut është themelimi i njësave për të drejtat e njeriut në shumë Ministri, të cilat janë duke marrë përkrahje të konsiderueshme nga OSBE-ja dhe Njësitë e saj këshilluese për të drejtat e njeriut. Ky është një hap i madh drejt garantimit që strukturat qeveritare vendore në Kosovë të bëhen të vetëdijshme për standardet evropiane për të drejtat e njeriut dhe si të mirëmbahen ato dhe mbetet vetëm të shpresohet që fondet dhe përkrahja e mjaftueshme nga ministritë e ndryshme do të garantojnë që ato të mund t'i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të duhur dhe efikase.

Zyra këshilluese për qeverisje të mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit deri më tani është ngarkuar me këshillimin e qeverisë, si dhe me shqyrtimin dhe zhvillimin e politikës lidhur me të drejtat e njeriut. Derisa ka shumë vullnet të mirë nga ana e kësaj zyre për ta ngritur nivelin e vetëdijes së IPVQ-ve për të drejtat e njeriut, ajo mbetet e varur në masë të madhe nga donacionet ndërkombëtare. Kjo paraqet brengë serioze lidhur me qëndrueshmërinë e kësaj zyre shumë të rëndësishme.

Përkundër këtyre zhvillimeve në monitorimin vendor të të drejtave të njeriut dhe zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ka pasur pak përparim në forcimin e mekanizmave vendorë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Me përfundimin e mandatit të Ombudspersonit ndërkombëtar në dhjetor të vitit 2005, Institucioni i Ombudspersonit u kosovarizua në tërësi. Pasi që Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/6 mbi Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë, parasheh një Avokat vendor të popullit, nuk u shpall deri në shkurt të vitit 2006, Institucionin e Ombudspersonit është duke e udhëhequr Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit prej janarit të vitit 2006. Seleksionimi i Ombudspersonit të ri tashmë ka filluar dhe pritet që kjo pozitë të plotësohet deri në fund të vitit 2006. Përkundër vonesave për ta shpallur Rregulloren e lartpërmendur, Institucioni i Ombudspersoni vazhdoi të bashkëpunojë si më parë dhe vazhdoi ta gëzojë besimin e të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Megjithatë, aktivitetet e përditshme të Institucionit janë vështirësuar deri në një masë me Rregulloren e re të UNMIK-ut nr. 2006/06, që ka shkaktuar një konfuzion duke ofruar një numër të formulimeve të paqarta. Për shembull, derisa ajo ia mundëson Ombudspersonit

qasjen e papenguar në çdo vend ku personat janë të privuar lirie, neni 4.9 përcakton që ndërmjet institucionit të Avokatit të Popullit dhe autoriteteve kompetente përkatëse do të zhvillohen “procedura të veçanta” për të lehtësuar këtë qasje. Kjo kundërthënie e qartë sjell dyshimin nëse Institucioni i Ombudspersonit do të lejohet edhe më tej të ketë qasje të pakufizuar në burgje në mungesë të këtyre marrëveshjeve apo procedurave të veçanta.

Megjithatë, problemet kryesore të shkaktuara me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/06 janë se ajo heq UNMIK-un nga juridiksioni i Institucionit të Ombudspersonit dhe e kufizon mandatin e Institucionit vetëm mbi IPVQ-të dhe që Rregullorja dështon ta përcaktojë mënyrën se si Institucioni do të duhej të procedojë rastet në pritje për t’u zgjidhur kundër UNMIK-ut. Kërkesat drejtuar UNMIK-ut lidhur me këto çështje dhe brengat tjera lidhur me Rregulloren deri më tani nuk kanë rezultuar me kurrfarë sqarimesh të mëtejshme në këtë drejtim.

Nuk do të kishte ndonjë problem po qe se strukturat përkatëse të UNMIK-ut, siç është policia, të ishin bartur në duart e vendorëve për afërsisht në kohë të njëjtë sikur edhe Institucioni i Ombudspersonit. Ashtu si është situata tani, derisa pritet që UNMIK-u në të ardhmen do ta përfundojë procesin e bartjes së pushtetit të tij të rezervuar në strukturat vendore, është ende shumë vështirë të vlerësohet kur dhe si do të ndodhë kjo.

Një problem i veçantë në këtë drejtim mund të shihet në pjesën veriore të Kosovës, ku komunat e banuara kryesisht me popullsi serbe kanë vendosur rishtas që ta ndërpresin në tërësi bashkëpunimin me IPVQ-ve. Nëse IPVQ-të nuk kanë ndikim në këto rajone, atëherë i vetmi organ që mbetet t’i mbikëqyrë komunat vendore është UNMIK-u. Pasi që UNMIK-u, në anën tjetër, më nuk është nën juridiksionin e Institucionit të Ombudspersonit, atëherë edhe komunat në pjesën veriore të Kosovës, si rrjedhim, gjithashtu gjenden jashtë juridiksionit të Institucionit të Ombudspersonit.

Sa i përket bashkëpunimit mes Institucionit të Ombudspersonit dhe UNMIK-ut, Rregullorja nr. 2006/06 e shpallur rishtas vendos që UNMIK-u do të bashkëpunojë me Institucionin, por natyrisht nuk ekziston obligimi për ndonjë bashkëpunim të tillë dhe ai mund të pranohet ose të refuzohet, duke mos pasur nevojë të jepet ndonjë arsytim nëse ndodh kjo e fundit. Tani, më shumë se kurrë më parë, mbetet mbi departamentet e UNMIK-ut që të bashkëpunojnë ose jo me Institucionin dhe në raste të caktuara, posaçërisht në rastin e Zyrës së UNMIK-ut për komunitete, kthime dhe çështje të pakicave, bashkëpunimi ka mbetur në nivel të lartë.

Në mënyrë që të shqyrtohen ankesat kundër UNMIK-ut, u themelua Paneli këshillëdhënës mbi të drejtat e njeriut pranë UNMIK-ut, përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit këshillëdhënës mbi të drejtat e njeriut. Anëtarët e Panelit këshillëdhënës do të emërohen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm pas propozimit të bërë nga Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli ka mandat që të pranojë dhe shqyrtojë ankesat lidhur me të drejtat e njeriut kundër UNMIK-ut.

Kjo Rregullore ka shumë mangësi. Derisa ajo e obligon PSSP-në që të bashkëpunojë me Panelin duke i ofruar qasje në të gjitha dokumentet në lidhje me ankesën, PSSP në të njëjtën kohë mund t’i refuzojë kërkesat e Panelit për të intervistuar punonjës të caktuar të

UNMIK-ut apo për qasje në dokumentet e UNMIK-ut. Edhe pse Paneli mund t'i bëjë rekomandime publike PSSP-së, ai do ta ketë pushtetin dhe diskrecionin ekskluziv për të vendosur nëse do të vepron sipas këtyre rekomandimeve apo jo.

Derisa ekzistimi i një Paneli këshillëdhënës mbi të drejtat e njeriut është më mirë se asgjë, ky Panel nuk mund ta zëvendësojë Ombudspersonin. Ai nuk është një organ i pavarur, por më shumë një panel këshillëdhënës brenda sistemit të UNMIK-ut. Mbetet plotësisht mbi PSSP-në që të pranojë këto këshilla apo jo. Për më tepër, një Panel i përbërë nga tre anëtarë që takohen rregullisht për t'i shqyrtuar parashtrirat me shkrim nuk është e njëjtë me Ombudspersonin, që takohet me ankuesit tërë kohën dhe veprimet e të cilit nuk janë të kufizuara me një procedurë të tillë formale.

Për momentin, ende nuk është e qartë nëse Paneli do ta fillojë punën dhe nuk dihet se sa dhe cilat raste kundër UNMIK-ut në pritje për t'u zgjidhur pranë Institucionit të Ombudspersonit do të mund t'i transferohen këtij Paneli. Institucionit dhe punonjësve të tij u mbetet t'ua sqarojnë ankuesve që më nuk mund të procedojnë rastet e tyre kundër UNMIK-ut.

Anash këtyre zhvillimeve më të vonshme, kërkesat e caktuara për ta forcuar Institucionin që Ombudspersoni i mëparshëm dhe Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës i kanë paraqitur në disa raste kanë mbetur pa u shqyrtuar më Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/06. Ombudspersoni ende nuk është i lejuar që të fillojë ose marrë pjesë në një procedurë gjyqësore, siç është rasti me një numër të Ombudsmanëve tjerë në botë. Ende nuk është caktuar ndonjë afat specifik kohor brenda të cilit autoritetet publike janë të obliguara të përgjigjen në intervenimet e Ombudspersonit, kurse të njëjtat autoritete gjithashtu nuk janë të obliguara që të arsyetojnë kurrfarë vonese për t'u përgjigjur në letrat apo raportet e Ombudspersonit. Shpresohet që kjo situatë do të përmirësohet kur Kuvendi i Kosovës ta miratojë ligjin e tij mbi Institucionin e Avokatit të Popullit.

Në mungesë të forcimit të pozitës së Ombudspersonit, bashkëpunimi me pjesë të ndryshme të IPVQ-ve ende dallon dhe varet në masë të madhe nga secila ministri apo komunë e veçantë. Derisa disa nga këto organe janë përgjigjur rregullisht në kërkesat dhe rekomandimet e Ombudspersonit të mëparshëm dhe Ushtruesit të detyrës së Ombudspersonit më vonë, ka organe tjera që qartas nuk e shohin këtë si të nevojshme dhe e konsiderojnë Institucionin më shumë si një armik dhe thumb në këmbë se sa një mekanizëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që synon ruajtjen e baraspeshës mes autoriteteve publike dhe njerëzve nën juridiksionin e tyre. Bashkëpunimi me disa autoritete lokale është i mirë. Një shembull i kësaj është Shërbimi Policor i Kosovës, që tani e ka caktuar një zyrtar policor për t'u marrë vetëm me të drejtat e njeriut. Pas një takimi të punonjësve të lartë të Institucionit të Ombudspersonit, u vendos që të mbahen takime të rregullta një herë në muaj mes punonjësve të Institucionit dhe këtij përfaqësuesi të SHPK-së.

Megjithatë, mungesa e përgjithshme e njohurisë rreth standardeve për të drejtat e njeriut dhe nevojës për t'i zbatuar ato në Kosovë nuk është vetëm problem i IPVQ-ve. Shumë nga njerëzit, të drejtat e të cilëve është e paraparë të mbrohen, nuk janë të vetëdijshëm që i kanë këto të drejta. Edhe pse të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë prej vitit 2001, tekstet e dokumenteve të rëndësishme për të drejtat e njeriut, siç janë Deklarata

Universale e të Drejtave të Njeriut Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ) dhe Protokollet e saj, Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj, Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, sa për t'i përmendur disa, ende nuk janë të njohura për publikun e gjerë. Kështu, derisa shumë pjesë të administratës publike nuk i njohin apo nuk donë t'i njohin obligimet që i kanë për t'ju përmbajtur standardeve të caktuara për të drejtat e njeriut, në të njëjtën kohë edhe shumë pjesë të popullsisë nuk i shtyjnë ato që ta bëjnë këtë nga mosdija për një spektër të gjerë të ligjeve për të drejtat e njeriut që janë të zbatueshme në Kosovë. Kjo çështje është ngritur disa herë në Raportet e kaluara vjetore, mirëpo ende nuk është bërë ndonjë hap drejt përmirësimit të kësaj situatë.

Në fillim të bisedimeve rreth statusit të Kosovës, nuk duhet të harrohet çështja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Është zhvillim fatkeq që në një kohë të tillë të rëndësishme, Institucioni i Ombudspersonit është dobësuar nga një periudhë e pasigurisë ligjore dhe kufizimet e mandatit të tij. Prandaj, është e rëndësishme më të madhe që Institucioni të forcohet në të ardhmen dhe që të vazhdohet përkrahja e plotë që ia kanë premtuar udhëheqësit e Kosovës, përkatësisht Kryetari i Kosovës, Kryeministri dhe Kryetari i Kuvendit të Kosovës.

Megjithatë, mbrojtja e mirëfilltë e të drejtave të njeriut nuk mund t'i lehet vetëm një Institucioni që për nga natyra e tij nuk mund të nxjerrë vendime obliguese. Është gjithashtu e nevojshme që të themelohen gjykatat ose odat, funksioni kryesor i të cilave do të ishte të shqyrtojnë aspektet e të drejtave të njeriut. Në këtë drejtim, nuk është bërë aq sa duhet. Derisa Korniza kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme, e shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/19 e kishte paraparë themelimin e një Kolegji të Veçantë të Gjykatës Supreme mbi çështjet e kornizës kushtetuese, një kolegji i tillë ende nuk është themeluar.

Në të njëjtën kohë, banorët e Kosovës ende nuk përfitojnë nga mbrojtja që u ofrohet shumicës së banorëve tjerë të Evropës nga ana e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg. Kjo ka ndodhur për shkak të statusit ende të pazgjidhur të Kosovës, derisa UNMIK-u, duke qenë mision i një organizate ndërkombëtare, nuk mund ta nënshkruajë një konventë që në thelb paraqet marrëveshje multilaterale mes shteteve.

Për arsytet e lartpërmendura, kurrë nuk është mjaft të theksohet që krijimi i një gjykate për të drejtat e njeriut në anën vendore dhe vendosja e banorëve të Kosovës nën mbrojtjen e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut do të duhej të jenë prioritetet më të larta në bisedimet momentale rreth të ardhmes së Kosovës.

## **Komunitetet minoritare në Kosovë**

Në Kosovën e sotme, kur shikohet popullsia si tërësi, shqiptarët etnik konsiderohet të përbëjnë shumicën me përafërsisht 90% të popullsisë. Komunitetet minoritare që përbëjnë dhjetë për qind të mbetura janë komuniteti ashkali, boshnjak, kroat, egjiptian, rom, serb dhe turk. Derisa në shumicën e rajoneve shqiptarët janë shumicë kurse grupet tjera pakicë, kjo situatë është e kundërta në Kosovën veriore, ku pjesa veriore e

Mitrovicës dhe komunat siç janë Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi banohej kryesisht me serbë. Kjo vlen gjithashtu edhe për komunën e Shtërpçës në jug.

Çështja e mbrojtjes së komuniteteve minoritare është shumë e rëndësishme dhe duhet të shqyrtohet në mënyrë që Kosova të bëhet një shoqëri moderne demokratike me aspirata reale që t'i bashkohet Bashkimit Evropian. Duke marrë parasysh tensionet mes komuniteteve të ndryshme etnike në Kosovë, mbrojtja e të drejtave të minoriteteve apo thjeshtë definimi i një minoriteti është dhe ka qenë gjithmonë një temë politike – tani më shumë se kurdoherë më parë, kur të merret parasysh dhuna etnike në vitet e fundit.

Në fazën momentale të bisedimeve rreth statusit, situata politike është vazhdimisht duke u tensionuar dhe kjo dukuri pritet të vazhdojë derisa të vazhdojnë edhe bisedimet, pasi që komunitetet e ndryshme në Kosovë shpresojnë për rezultate të ndryshme të këtyre bisedimeve. Derisa shumica shqiptare shpreson për një pavarësi të plotë dhe të pakushtëzuar nga Serbia, pjesa më e madhe e komunitetit serb ende shpreson që qeveria e Serbisë do t'ia arrijë të fitojë një lloj të autonomisë ekstensive për Kosovën ashtu që ajo të mos ndahet nga Serbia. Në veçanti, serbët e përkrahin planin e Beogradit për decentralizim që përfshin një numër të madh të komunave të reja dhe përkrahjen e vazhduar për sistemet paralele të arsimit dhe përkujdesjes shëndetësore që Beogradi ende ia ofron komunitetit serb dhe disa komuniteteve tjera minoritare. Sa i përket komuniteteve më të vogla minoritare, ato e ndiejnë nevojën që pak a shumë të zgjedhin mes këtyre dy palëve, varësisht nga vendi ku jetojnë dhe ku qëndrojnë ngjashmëritë dhe afrimet e tyre. Në disa raste, pjesëtarë të ndryshëm të komunitetit të njëjtë i zgjedhin anët e ndryshme, siç është rasti me komunitetin goran, që është i ndarë në dy pjesë të barabarta në këtë drejtim.

Ngritja e tensioneve për shkak të bisedimeve për statusin ka sjellë deri te incidentet e mëtejshme, në veçanti gjatë muajve të fundit, kur ishin hedhur me gurë disa herë autobusët e UNHCR-së që po transportonin serbët e kthyer të fshatrave në Pejë në Mitrovicën veriore. Gjithashtu, në maj dhe në fillim të qershorit, sulmet e armatosura janë shtuar, posaçërisht në pjesën veriore të Kosovës të banuar kryesisht me serbë, ku një person është vrarë kurse shumë të tjerë janë lënduar. Derisa pjesëtarët e komunitetit serb dyshojnë që këto sulme të armatosura kishin motive etnike, Policia e UNMIK-ut nuk ka mundur ta konfirmojë këtë deri më tani, si dhe nuk ka ofruar shumë informata rreth përfundimeve të arritura gjatë zhvillimit të hetimeve, që prapë jep hapësirë për spekulime si në mesin e shqiptarëve, ashtu edhe atë të serbëve.

Një urë që lidh dy fshatra të të kthyerve, Grapcin dhe Binçën, u dëmtua nga një mjet eksploziv, derisa një person i përkatësisë etnike serbe që ishte kthyer në Klinë u vra rishtas në shtëpinë e tij me armë automatike. Përveç kësaj, u shkatërruan 30 gurë varresh në varrezat serbe në fshatin Starograckë të komunës së Lypjanit. Policia e UNMIK-ut ka filluar hetimet në këto raste, mirëpo në kohën kur ky Raport është publikuar, publiku nuk kishte qenë i informuar deri atëherë për ndonjë rezultat konkret të këtyre hetimeve. E vetmja përgjigje konkrete ndaj këtyre ngjarjeve nga ana e Policisë së UNMIK-ut ka qenë prania e shtuar e policisë ndërkombëtare në rajonet e banuara me serbë dhe romë.

Përveç ngritjes së numrit të krimeve, motivet e disa prej të cilave mbesin të kontestueshme, në Kosovë ka rajone ku ekziston një skemë e rregullt e keqtrajtimit dhe

frikësimit të romëve dhe serbëve, posaçërisht në fshatrat e të kthyerve. Udhëheqësit ndërkombëtarë dhe vendore i kanë dënuar këto krime publikisht dhe, sipas vlerësimit teknik të PSSP-së të progresit në implementimin e standardeve për Kosovën që i është dorëzuar Këshillit të Sigurimit në prill të vitit 2006, në njëzet e tetë komuna janë themeluar Këshillat lokale për parandalimin e krimit, të cilët, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/24 mbi kornizën dhe parimet drejtuese të Shërbimit Policor të Kosovës, tani po transformohen në Këshilla komunal për sigurinë e bashkësive.

Duhet të përmendet që ka pasur përmirësime në lidhje me lirinë e lëvizjes dhe sigurisë së individëve të përkatësisë etnike joshqiptare, por kjo varet nga rajoni dhe nga komuniteti përkatës minoritar. Liria e lëvizjes për serbët dhe romët, grupet të cilat deri më tani janë shënjuar më së shumti, është përmirësuar deri diku në rajonin e Prishtinës, Gjilanit dhe Prizrenit, mirëpo është ende problematike në rajonin e Pejës dhe Mitrovicës. Sipas një ankete të Shërbimit policor të Kosovës në prill të vitit 2006, 99% të të anketuarve theksuan që lëvizin edhe jashtë rajonit ku jetojnë, 80% thanë që ndiheshin të sigurt derisa e bënin këtë dhe asnjë nuk raportoi t'i ketë sulmuar dikush gjatë kësaj lëvizje.

Megjithatë, mbetet frika nga incidentet e mundshme, në veçanti në mesin e atyre grupeve minoritare ku shumica nuk e flet gjuhën shqipe. Në atmosferën e nxehtë momentale të kontestit politik rreth statusit të ardhshëm të Kosovës, kjo vetëm sa përkeqësohet me incidentet e hedhjes së gurëve në autobusë apo një incident tjetër që ndodhi në rajoni e Pejës, ku ishte shtënë me armë zjarri në një automjet me targa të Beogradit, në të cilin ndodheshin dy anglezë.

Lidhur me transportin publik, situata është e njëjtë sikur edhe gjatë periudhës së kaluar për të cilën është raportuar – autobusët kalojnë nëpër enklava serbe dhe rome mirëpo nuk ndalojnë aty. I vetmi mjet transporti për njerëzit nga këto komunitete mbeten automjetet private dhe autobusët specialë që qarkullojnë dy herë në javë prej fshatrave të vogla në ato të mëdha dhe në Mitrovicën veriore ku pjesëtarët e bashkësive minoritare nga pjesë tjera të Kosovës mund të blejnë gjësendet e nevojshme dhe të vizitojnë qendrat shëndetësore. Zakonisht, këta autobusë qarkullojnë pa përcjellje policore, mirëpo pas incidenteve të hedhjes së gurëve, atyre u është ofruar përkohësisht përcjellja e tillë në disa rajone, së paku derisa autoritetet kompetente të mos konsiderojnë që situata është qetësuar. Sipas vlerësimit të PSSP-së që i është dorëzuar Këshillit të Sigurimit në prill të vitit 2006, disa autobusë të caktuar që ishin financuar për t'u shërbyer komuniteteve minoritare sipas nevojës ishin ndërprerë për shkak të kufizimeve buxhetore, mirëpo Ministria e transportit dhe telekomunikimeve ishte angazhuar në një strategji të re për ta përmirësuar transportin e tillë në bashkëpunim me Ministrinë për kthime dhe komunitete.

Sa i përket situatës së vendosjes dhe banimit të atyre personave që janë zhvendosur gjatë trazirave të marsit të vitit 2004, kur ishin shkatërruar apo dëmtuar përafërsisht 730 shtëpi që ishin pronë e serbëve dhe pjesëtarëve të komuniteteve tjera minoritare, kryesisht romë dhe ashkali, shumë shtëpi janë rindërtuar përmes fondeve publike. Megjithatë, Institucioni i Ombudspersonit është ende duke pranuar një numër të konsiderueshëm të ankesave nga personat e zhvendosur të këtyre komuniteteve, pronat e të cilëve ende nuk janë rindërtuar. Shumica e personave të zhvendosur nuk janë kthyer në shtëpitë e tyre, kryesisht për shkak të arsyeve të sigurisë. Shumë nga ta i kanë shitur pronat e tyre dhe janë shpërngulur.

Sa i përket 36 kishave serbe ortodokse që ishin shkatërruar gjatë ngjarjeve të marsit të vitit 2004, asnjë nga to nuk është rindërtuar. Një Memorandum i mirëkuptimit është nënshkruar mes Kishës serbe ortodokse, IPVQ-ve dhe UNMIK-ut në fund të vitit 2005. Fondet janë ndarë për t'i rindërtuar vendet fetare, gjysma e tyre prej IPVQ-ve, kurse gjysma tjetër prej donatorëve ndërkombëtarë. Momentalisht, nuk mund të gjendet kurrfarë marrëveshje lidhur me atë se kush do t'i menaxhojë fondet e pranuar nga donatorët ndërkombëtarë dhe kush to ta monitorojë rindërtimin dhe mbetet të shihet se si do të zgjidhet kjo në të ardhmen, në pritje të zhvillimeve të mëtejshme politike në lidhje me statusin.

Shumë pjesëtarë të komunitetit rom, shtëpitë e të cilëve u shkatërruan kah fundi i luftimeve të vitit 1999, tani jetojnë në kushte shumë të mjera. Një numër i madh i tyre ishin duke jetuar në kampet e kontaminuar me plumb në Kosovën veriore gjatë shtatë viteve të fundit, duke pritur që vendbanimet e tyre të mëparshme të rindërtohen, mirëpo këtë vit shumë nga këta persona janë rivendosur në vendbanim më të mirë në kampin e dikurshëm të KFOR-it në Mitrovicën veriore. Një grup tjetër i madh i romëve që më parë kishin jetuar në kampin e Plemetinit tani janë vendosur në banesat e rindërtuara rishtas nëpër komuna të ndryshme. Autoritetet kompetente parashohin që deri në fund të vitit 2006, të gjithë banorët e kampit, kryesisht romë por edhe serbë, do të vendosen në vendbanime më të mira ashtu që kampi i Plemetinit të mund të mbyllet.

Shumica e minoriteteve, siç janë serbët, boshnjakët, romët, goranët dhe ashkalitë jetojnë në fshatra dhe e sigurojnë jetesën përmes bujqësisë, pasi që nuk ka mundësi tjera të punësimit për ta.

Në të njëjtën kohë, serbët në rajonet rurale ende përballen me probleme gjatë përpjekjeve për ta punuar tokën e tyre nëse ajo nuk është në afërsi të shtëpive të tyre, qoftë për shkak të sigurisë apo për shkak se tokën e tyre e kanë uzurpuar dhe e punojnë shqiptarët. Ky është një problem i madh, posaçërisht për serbët dhe romët që jetojnë në fshatrat e të kthyerve në rajonin e Pejës, Gjilanit ose në fshatrat serbe dhe rome në Kosovën qendrore, ku toka e kontestuar gjendet në fshatrat shqiptare apo në afërsi të tyre apo në rajonet siç janë Lypjani, Priluzha ose Millosheva në Kosovën qendrore dhe veriore. Këto komunitete gjithashtu ankohen rreth vjedhjeve të shpeshta të gjedhëve apo makinave bujqësore. Policia deri më tani nuk ka qenë në gjendje ta zgjidhë shumicën e këtyre kontesteve dhe krimeve të pohuara.

Frika e përmendur më lart nga keqtrajtimi gjithashtu ndikon në qasjen e grupeve të caktuara minoritare, respektivisht serbëve dhe romëve, ndaj formave të ndryshme të përkujdesjes shëndetësore. Derisa shumica e fshatrave të banuara kryesisht me pjesëtarë të këtyre komuniteteve i kanë qendrat e tyre për trajtim themelor mjekësor, ata ende duhet t'u drejtohet spitaleve në Graçanicë, Llapllasellë dhe Mitrovicë veriore për problemet më serioze shëndetësore dhe rrallë herë vizitojnë spitalet dhe qendrat shëndetësore në rajonet shqiptare edhe nëse këto qendra janë më afër, që gjithashtu tregon që ende ekziston një mungesë e besimit mes komuniteteve të caktuara minoritare dhe komunitetit shumicë.

Sa i përket qasjes në gjykatë, sipas informatave të pranuar nga UNMIK-u, në rajonet e minoriteteve funksionojnë nëntë zyra të ndërlidhjes të gjykatave dhe organizimi i ditëve të gjykatës ka filluar në gjashtë vende. Hapja e një gjykatë për kundërvajtje në Graçanicë është duke u diskutuar në mënyrë aktive mes UNMIK-ut dhe udhëheqësve të bashkësisë. Sipas vlerësimit të PSSP-së që i është dorëzuar Këshillit të Sigurimit në prill të vitit 2006, 9.44% të gjykatësve dhe 9% të prokurorëve në Kosovë u takojnë komuniteteve minoritare.

Situata e përshkruar në Raportin e kaluar vjetor lidhur me shërbimet postare dhe telefonike dhe fakti që ekzistojnë sisteme të ndryshme për komunitete të ndryshme nuk është përmirësuar. Kryesisht, komuniteti shqiptar, ashkali, turk dhe boshnjak shfrytëzojnë shërbimet që i ofron Postë Telekomit të Kosovës (PTK), i vetmi shërbim postar dhe telefonik i pranuar nga UNMIK-u dhe IPVQ-të, kurse pjesëtarët e komunitetit serb dhe rom që jetojnë në enklava në Kosovën qendrore, veriore dhe juglindore shpesh herë shfrytëzojnë shërbimet postare, kodin postar dhe telefoninë e Serbisë që shfrytëzohej para ardhjes së UNMIK-ut në vitin 1999. PTK nuk funksionon në këto rajone dhe gjithashtu nuk ka bërë përpjekje për të ofruar shërbimet atje. Si zakonisht, ajo se cili sistem shfrytëzohet gjithashtu varet nga rajoni në të cilin jetojnë grupet minoritare.

Situata ekonomike në Kosovë është ende e vështirë për të gjithë banorët, por posaçërisht për grupe të caktuara të cenueshme që përfshijnë minoritetet, edhe pse ka pasur një rritje të vogël të pjesëtarëve të komuniteteve minoritare në SHPK. Shumica e komuniteteve minoritare ende nuk bëjnë pjesë në tregun normal të punës, posaçërisht serbët dhe romët. Niveli i papunësisë në mesin e komunitetit serb në disa rajone është më shumë se 80%, kurse në fshatrat e të kthyerve ai arrin deri në 100%. Për pjesëtarët e komunitetit rom, niveli i papunësisë është 98%. Edhe pse në vitin 2005, Qeveria e Kosovës hapi më shumë se 90 vende të punës për pjesëtarët e grupeve minoritare në nivelin qendror dhe komunal të Shërbimit civil të Kosovës, deri më tani askush nuk është punësuar në këto vende pune. Sipas informatave nga zyrat e bashkësive lokale, në disa enklava, ministritë e caktuara i kishin hequr këto pozita me arsyetimin që ato nuk ishin paraparë me buxhet.

Në skenën politike, përfaqësimi i grupit minoritar serb nuk është adekuat për shkak se politikanët serbë filluan t'i bojkotojnë IPVQ-të para zgjedhjeve të tetorit të vitit 2004. Sa i përket atyre rasteve ku pjesëtarët e grupeve minoritare punojnë në IPVQ, raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e KB-ve në Kosovë i 5 qershorit 2006 theksoi që funksionet e tyre kryesisht kanë të bëjnë me çështjet që kanë rëndësi vetëm për minoritetet, siç është kthimi ose, në rastin e serbëve që punojnë në shëndetësi dhe arsim, fakti që ata deri vonë kanë marrë paga edhe nga IPVQ-të edhe nga Beogradi.

Sistemi i pagave të dyfishta u ndërpre në mars të vitit 2006, kur Qendra koordinuese serbe për Kosovë dhe Metohi kërkoi nga të gjithë individët që merrnin paga nga IPVQ-të edhe nga Serbia që ta zgjedhin dhe mbajnë vetëm një nga këto paga. Për shkak të pasojave negative që fshirja nga lista e pagave të Serbisë mund ta ketë në pensionet e tyre, shumica e serbëve të punësuar në shëndetësi dhe arsim, sipas vlerësimeve të UNMIK-ut përafërsisht 70%, vendosën të refuzojnë pagat e IPVQ-ve dhe tani marrin vetëm pagat nga ministritë përkatëse të Serbisë, duke mbetur në listat e pagave të IPVQ-ve.



Sistemi paralel i arsimit i përkrahur dhe financuar nga qeveria e Serbisë shfrytëzohet nga serbët, romët dhe një pjesë e komuniteti goran, derisa sistemi i arsimit i Kosovës shfrytëzohet nga pjesëtarët e komuniteteve tjera minoritare dhe komuniteti shumicë i shqiptarëve.

Për më tepër, ende ekziston problemi lidhur me arsimin e lartë për shumicën e komuniteteve të caktuara minoritare të cilat nuk e flasin gjuhën shqipe. Përkundër qëllimit të UNMIK-ut që ta rihapë Universitetin e Prishtinës si institucion shumetnik, kjo ende nuk ka ndodhur. Në përgjithësi, si UNMIK-u ashtu edhe IVPQ-të kryesisht nuk ia kanë arritur të ofrojnë shkollimin adekuat dhe të lartë në gjuhët e minoriteteve apo qasjen e barabartë në arsimin e lartë. Për këtë arsye, por edhe për shkaqe politike, komuniteti serb në Kosovë dhe pjesëtarët e caktuar të komuniteteve tjera që flasin gjuhët sllave mbështetet kryesisht në universitetin paralel në Mitrovicën veriore, ku pjesa më e madhe e punonjësve përbëhet nga profesorët e mëparshëm dhe rektori i mëparshëm i Universitetit të Prishtinës para ardhjes së UNMIK-ut në vitin 1999. Ky universitet vepron nën autoritetin e Ministrisë së Arsimit të Serbisë dhe përdor programin mësimor të Serbisë.

Ka vetëm dy përjashtime ku arsimit i lartë ofrohet në gjuhën e minoriteteve: Fakulteti i Arsimit në Prizren dhe Shkolla e biznesit në Pejë, ku ka dy nën-klasa në të cilat studentët boshnjakë mund ta vijnë mësimin në gjuhën boshnjake. Të dy këto fakultete veprojnë si degë të Universitetit të Prishtinës, mirëpo klasat ende nuk funksionojnë aq mirë sa do të duhej për shkak se ligjëruesit nga Sanxhaku i Serbisë, ku flitet gjuha boshnjake, nuk vijnë rregullisht kurse Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ende nuk i ka ofruar mjetet e nevojshme për të siguruar pagat e tyre. Së paku për momentin, ligjëruesit vazhdojnë të punojnë pa pagesë dhe mbetet të shpresohet që së shpejti do të fillojnë të paguhet. Gjithashtu duhet të theksohet që ende ka probleme lidhur me tekstet mësimore për nxënësit boshnjakë në gjuhën e tyre, dhe që MASHT ende nuk ka botuar tekste të tilla, siç pohohet, për shkak të mungesës së fondeve.

Komuniteti turk ankohet për çështje të ngjashme, duke theksuar që vetëm disa tekste mësimore ishin botuar në gjuhën turke prej themelimit të administratës së UNMIK-ut në Kosovë. Për këtë arsye, nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme zakonisht përdorin tekstet mësimore nga Turqia, edhe pse ato nuk janë në pajtim me programin mësimor të Kosovës. Duhet të theksohet që të gjitha shkollat publike që ofrojnë klasë në gjuhën turke nuk kanë punonjës profesional dhe që në disa raste, siç është rasti i fshatit Mamushë afër Prizrenit, mësuesit që kanë udhëtuar nga Prizreni gjatë tri viteve të fundit nuk kanë marrë kurrfarë pagash dhe i kanë paguar vetë shpenzimet e udhëtimit. Megjithatë, si zhvillim pozitiv, Universiteti i Prishtinës ofron mësim dhe literaturë në gjuhën turke tani për më shumë se dy vite.

Kur flitet për arsimin në lidhje me komunitetin rom, duhet të theksohet që fëmijët e tyre vijnë mësimin ose në sistemin e arsimit të Kosovës ose atë të strukturave paralele serbe. Niveli i lartë i varfërisë në këtë komunitet paraqet vështirësi të rënda për arsimimin e rinisë së tij, pasi që shumë familje thjeshtë nuk mund t'i sigurojnë tekstet mësimore për fëmijët e tyre. Lidhur me shkollimin në gjuhën romë, ka pasur disa nisma në këtë drejtim nga OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare mirëpo deri më tani ato kanë mbetur vetëm në

letër. Çështje kryesore këtu mbetet standardizimi i gjuhës rome sepse vetëm në Kosovë ekzistojnë 15 dialekte të ndryshme të kësaj gjuhe.

Në përgjithësi, shkollimi nuk duket të jetë prioritet i familjeve rome, për të cilat brengat lidhur me përmbushjen e nevojave të përditshme janë më të rëndësishme se nevoja për shkollimin themelor të fëmijëve. Ky problem gjithashtu vlen deri në një masë edhe për komunitetet ashkali dhe egjiptian, të cilat gjithashtu nuk kanë mjetet financiare për të blerë tekstet mësimore. Komunitetet ashkali dhe egjiptian gjithashtu ankohen që në tekstet mësimore që përdoren në shkolla, ata nuk përmenden si grupe minoritare në Kosovë.

Sa i përket përdorimit të gjuhës së minoriteteve në përgjithësi në Kosovë, duhet të theksohet që, edhe pse gjuha serbe është një gjuhë zyrtare në Kosovë, kjo nuk merret parasysh gjithmonë në praktikë. Niveli i përdorimit të gjuhëve tjera, që përfshin edhe përdorimin e gjuhës shqipe në rajonet ku shumica është joshqiptare, gjithashtu nuk është i kënaqshëm. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës arriti konkluzionin e njëjtë në rezolutën e tij të nxjerrë më 12 qershor 2006 lidhur me situatën e minoriteteve në Kosovë, mirëpo pranoi që kishte disa shembuj pozitiv të përdorimit të rregullt të gjuhëve të minoriteteve në organet zyrtare. Gjithashtu, Komiteti i Ministrave pohoi që në një numër të vendeve kishte mungese të vullnetit politik dhe kapacitetit që kufizonte mundësinë e personave që u takojnë komuniteteve minoritare që ta përdorin gjuhën e tyre për të komunikuar me administratën publike. Kjo gjithashtu vlente edhe për përdorimin privat të disa gjuhëve, posaçërisht përdorimin e gjuhës serbe, që përsëri është e lidhur me situatën e tendosur momentale politike.

Niveli i përkthimit mes gjuhëve dallon, varësisht nga komunat e ndryshme, edhe pse standardi i kualitetit të përkthimit është gjithmonë joadekuat. Sipas vlerësimit teknik të PSSP-së që i është dorëzuar Këshillit të Sigurimit në prill të vitit 2006, përkthimi ofrohet në të gjitha takimet e Kuvendit të Kosovës, kuvendeve komunale ose komisioneve kurdoherë që janë të pranishëm pjesëtarët e minoriteteve. Njëzet e dy nga tridhjetë komunat kanë njësi të dedikuara për gjuhët, derisa tjerat – përveç Zveqanit – kanë së paku një përkthyes. Si duket, në përgjithësi, shërbimet e përkthimit në tri komunat veriore – Zveqan, Leposaviq dhe Zubin Potok – nuk janë adekuate. Ministria e shërbimeve publike dhe Ministria e administrimit të pushtetit lokal kanë njësi për ta monitoruar pajtueshmërinë e gjuhës nëpër ministri dhe komuna, por në shumë raste ndarja e fondeve për këtë qëllim nuk ka qenë e mjaftueshme.

Njëllonj, Korniza kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme kërkon që të gjitha shenjat publike duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe serbe. Në krahasim me vitet tjera, duket që shenjat po vandalizohen më rrallë, që gjithashtu mund të jetë edhe rezultat i përpjekjeve të intensifikuara të autoriteteve kompetente për t'i riparuar ose zëvendësuar shenjat e tilla. Në rajonin e Prizrenit, disa shenja janë në të tri gjuhët – shqipe, serbe dhe turke. Megjithatë, siç u theksua në vlerësimin e PSSP-së drejtuar Këshillit të Sigurimit, ka shumë raste kur zyrat publike përdorin emra jozyrtarë për vendet të ndryshme, posaçërisht në nivel komunal.

Sa i përket mediave, vlerësimi i PSSP-drejtuar Këshillit të Sigurimit theksoi që nga 118 emetuesit e licencuar, 72 veprojnë vetëm në gjuhën shqipe, 35 vetëm në gjuhën serbe,

kurse 11 janë shumetnik dhe/ose shume gjuhësor. Më 13 prill 2006, filloi punën stacioni i parë televiziv në gjuhën turke, i cili gjithashtu do të emetojë lajme në gjuhën shqipe, serbe, boshnjake dhe rome.

Nga tri stacionet televizive që emetohen në tërë Kosovën dhe nga katër radio stacionet që emetohen në tërë Kosovën, vetëm emetuesi publik Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ofron program televiziv dhe të radios në gjuhët minoritare, por edhe kjo është vetëm një pjesë e vogël e programit të përgjithshëm. Një ndryshim i nenit 20 të Ligjit për radiotelevizionin e Kosovës të Kuvendit të Kosovës, i shtuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/14 të 11 prillit 2006 për shpalljen e këtij ligji, parasheh që pesë (5) për qind e fondeve të arkëtuara nga parapagimi për transmetuesin publik ndahen për Fondin e krijuar në kuadër të Zyres së Kryeministrit për përkrahjen e “mediave të pakicave, atyre shumetnike dhe të disfavorizuara”.

Derisa situata e mediave të emetuara për pakicat duket të japë shpresë, situata e mediave të shtypura nuk është aq pozitive. Në Kosovë pothuajse nuk ka kurrfarë media të shtypur në gjuhën serbe – shumica e banorëve serbë lexojnë gazetën që publikohen në Serbi. Të vetmet përjashtime janë e përdyjavshmja *Gradjanski Glasnik*, e themeluar rishtas dhe që ka një botues shqiptar dhe një redaktor serb dhe e përjavshmja *M Magazine*, që botohet në gjuhën serbe dhe shqipe. E vetmja gazetë javore e botuar në gjuhën turke në Kosovë me emrin *Yeni Donem*, edhe pse e themeluar me ndihmën e donatorëve ndërkombëtarë, është pronë private.

Për ta përmbledhur çështjen e komuniteteve minoritare në Kosovë, është e rëndësishme që theksohet që hapa të caktuar janë ndërmarrë në këtë drejtim mirëpo në praktikë edhe nuk ka pasur njohje të të drejtave të minoriteteve si të tilla.

Në përgjithësi, në shoqëritë e shumëllojshme etnike, ekzistojnë formula të ndryshme të ruajtjes së bashkëjetesës paqësore. Ato supozojnë që strukturat qeveritare njohin, përkrahin dhe ndihmojnë ushtrimin e të drejtave të posaçme të minoriteteve, derisa komunitetet minoritare nga ana e tyre i pranojnë dhe njohin si autoritetet, ashtu edhe pushtetin e tyre. Momentalisht, në Kosovë, strukturat qeveritare ende e rezistojnë njohjen dhe përkrahjen e të drejtave të komuniteteve minoritare, posaçërisht të komunitetit serb dhe rom, derisa grupe të caktuara minoritare, në veçanti komuniteti serb, refuzojnë t'i njohin institucionet e Kosovës. Ky dështim i komuniteteve pakicë dhe shumicë për ta njohur legjitimitetin dhe të drejtat e ndërsjella është çështje politike dhe duhet të zgjidhet në nivel politik.

### **Situata e personave të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës dhe kushtet për kthimin e tyre**

Shumë njerëz në Kosovë janë duke vuajtur nga valë të shumëfishta të zhvendosjes që kanë ndodhur gjatë dekadës së fundit. Përderisa gjatë periudhës para mesit të vitit 1999, një numër i madh i shqiptarëve të Kosovës dhe pjesëtarëve të caktuar të grupeve të

pakicave shqipfolëse u zhvendosën brenda vendit ose shkuan në Evropën Perëndimore, shumë serbë dhe grupe të tjera të pakicave, kryesisht romë i lëshuan shtëpitë e tyre gjatë apo pas fushatës së bombardimeve të NATO-s dhe gjetën strehim të përkohshëm në Serbi, enklavat dhe fshatrat serbe në territorin e Kosovës, Mitrovicën veriore apo në qendrat kolektive (strehimore kolektive për PZHBV). Duke filluar nga viti 2000, një numër i shqiptarëve etnik që më parë kanë jetuar në pjesën veriore të Mitrovicës u larguan në pjesën jugore të këtij qyteti si dhe në zonat e tjera kryesisht të banuara me shqiptarë. Vala e fundit e zhvendosjeve ndodhi në mars të vitit 2004, kur gjatë protestave të dhunshme edhe 4 100 serbë dhe pakica të tjera, kryesisht romë dhe ashkali, u bënë të pastrehë (shumë prej tyre për të dytën herë) duke pasur nevojë për strehim. E njëjta ndodhi edhe me disa familje shqiptare të pjesës veriore të Mitrovicës.

Sa u përket shtëpive të shkatërruara gjatë periudhës para mesit të vitit 1999, shumica prej tyre janë ndërtuar pas marrjes së përgjegjësive nga UNMIK-u në fushën e administrimit publik në Kosovë, duke ju falënderuar ndihmës së organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-ve, ndihmë kjo e cila është shpërndarë nëpër komuna të ndryshme.

Sidoqoftë, ka pasur mjaft ankesa gjatë pesë vitet e kaluara nga personat shtëpitë e të cilëve nuk janë rindërtuar. Që nga viti 2002, duket se fondet për rindërtimin e shtëpive janë harxhuar dhe ka pasur shumë pak mbështetje nga komunat, ashtu që personat e zhvendosur nga të gjitha komunitetet është dashur që t'ia dalin vetë. Një numër i këtyre personave të zhvendosur, kryesisht shqiptarë për shkak të mungesës së strehimit, kanë uzurpuar në mënyrë joligjore banesat që ishin braktisur gjatë dhe pas vitit 1999.

Shumica e këtyre njerëzve përsëri kanë nevojë për strehim meqenëse DÇB vazhdon të dëbojë uzurpuesit e mbetur nga shtëpitë ose banesat. Në të njëjtën kohë, shtetet e Evropës Perëndimore kanë nisur procesin e kthimit të detyrueshëm të shqiptarëve, ashkalive dhe egjiptianëve të Kosovës. Shtëpitë e atyre që janë dëbuar nga banesat ose që janë kthyer me forcë është dashur të rindërtohen shumë më herët. Meqë kjo nuk ka ndodhur ende, këta njerëz tani janë të pastrehë ose shumë shpejtë do të bëhen të tillë, me shumë pak burime ose përkrahje për ata. Shumë prej serbëve dhe romëve të zhvendosur janë gjithashtu duke pritur për rindërtimin e shtëpive të tyre të shkatërruara gjatë periudhës pas mesit të vitit 1999, por për momentin, atyre u është siguruar vetëm strehim i përkohshëm, në shumë raste i cilësisë së dobët.

Lidhur me rindërtimin e ish Mëhallës së Romëve në Mitrovicën jugore, PSSP-ja dhe Kryeministri i Kosovës zyrtarisht kanë vendosur gurthemelin për një vendbanim të ri rom në zonën e Mëhallës së Romëve në Mitrovicën jugore në maj të vitit 2006. Plani përfshinë ndërtimin e dy ndërtesave me 24 apartamente dhe 54 shtëpi deri në fund të vitit 2006, por që nga vendosja e gurthemelit duket se është arritur pak përparim në ndërtimin e këtyre ndërtesave.

Situata me kampin e PZHBV-ve rom në fshatin e Plemetinit është duke u përmirësuar. Në fund të majit 2006, UNHCR-ja dhe IPVQ-të kanë ndërtuar dhe u kanë dorëzuar banesat në këtë fshat rreth 40 familjeve që kanë jetuar në kampin e Plemetinit në kushte të mjerueshme.

Në fshatin Magurë të komunës së Lipjanit, Qeveria e Kosovës ka ndërtuar një ndërtesë banimi për romët e zhvendosur nga Lipjani të cilët kanë jetuar në kampin e Plemetinit. Ndërtesa e banimit mund të strehojë 18 familje të zhvendosura rome.

Aktualisht, kanë mbetur edhe rreth 40 familje në kampin e Plemetinit, duke përfshirë 5 familje të refugjatëve serb nga Kroacia të cilët janë zhvendosur që nga vitet e 90-ta. Sipas UNHCR-it, ky grup i fundit do të vendoset në një ndërtesë tjetër sociale, ndërtimi i të cilës pritet të fillojë në qershor 2006. Pasi që edhe këtyre familjeve të mbetura do t'u sigurohet strehimi i ri, UNHCR-i planifikon që deri në fund të vitit 2006 të mbyllë kampin e Plemetinit.

Lidhur me rindërtimin e shtëpive pas ngjarjeve të dhunshme të marsit të vitit 2004, gjatë kësaj periudhe raportuese janë rindërtuar më shumë shtëpi se gjatë periudhës së kaluar, mirëpo situata e përgjithshme ende nuk është e kënaqshme. Më tepër se dy vite më pas, shumica e këtyre personave janë edhe të zhvendosur.

Kriteret për rindërtimin e shtëpive jo gjithmonë janë transparente. Ombudspersoni ka kontaktuar me Komisionin Ndërministror për Rindërtim në disa raste kur janë plotësuar kriteret objektive, por personat e prekur megjithatë nuk ishin përfshirë në listën e përfitueseve.

Shumica e apartamenteve në ndërtesën e YU programit në Prishtinë nuk janë riparuar dhe nuk u është paguar kompensimi për dëmtimin e pronave të lëvizshme të gjitha familjeve, por vetëm atyre banesat e të cilave janë djegur – këto janë vetëm 2 nga gjithsejtë 89 familje në ndërtesat e lartpërmendura në Prishtinë, duke pasur parasysh që shumica e dëmtimeve u shkaktuan nga uji i përdorur për shuarjen e zjarrit. Në Obiliq janë rindërtuar vetëm 14 nga 44 shtëpitë e dëmtuara dhe shkatërruara. Në rajonin e Pejës, më saktë në fshatrat e të kthyerve në Bellopojë dhe Biqë janë rindërtuar të gjitha shtëpitë e shkatërruara gjatë ngjarjeve të marsit 2004.

Veç kësaj, asnjë lokal afarist nuk është rindërtuar ende. Arsyeja e dhënë nga Komisioni Qendror Ndërministror për Rindërtim rreth vonesave në rindërtimin e shtëpive private dhe lokaleve afariste është mungesa e pohuar e mjeteve financiare për rindërtim edhe pse Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve ka marrë fonde për këtë qëllim nga UNMIK-u.

Rindërtimi nuk është i vetmi problem me të cilin ballafaqohen personat e zhvendosur në Kosovë: kushtet jetësore gjithashtu paraqesin brengë të madhe. Mbi dyqindmijë serb nga Kosova janë të zhvendosur që nga viti 1999 dhe ende strehohen në qendra kolektive, ose në shtëpi dhe banesa private të marra me qira në Serbi. Gjendja e tyre tashmë është përmendur në raportin e kaluar vjetor dhe nuk ka ndryshuar: në bazë të ligjit ndërkombëtar Kosova nuk është shtet i pavarur, kështu që këta persona nuk janë refugjatë meqë nuk kanë ikur në ndonjë shtet tjetër. Sidoqoftë, si persona të zhvendosur brenda vendit ata nuk i gëzojnë të drejtat dhe mbështetjen e njëjtë si refugjatët nga shtetet e ish Jugosllavisë. Në të njëjtën kohë, personat e zhvendosur nuk i gëzojnë të drejtat e njëjta si banorët e tjerë të Serbisë, ose nëse po atëherë kanë problem në ushtrimin e këtyre të drejtave.

Lidhur me rreth 18.000 PZhBV-të nga Kosova që ende qëndrojnë në Malin e Zi, mund të shpresojmë se autoritetet e shtetit të ri të pavarur të Malit të Zi do t'i njohin tani këta persona si refugjatë dhe do t'u japin atyre përfitimet shtesë që vijnë me statusin e refugjatit.

Shumë pjestarë të komunitetit rom janë zhvendosur brenda vendit që nga viti 1999 dhe jetojnë në qendra të ndryshme kolektive në Kosovë dhe në Serbi. Raporti i fundit vjetor theksonte gjendjen e vështirë të romëve që jetojnë në kampet për PZHBV në Çeshmin Llug, Kabllare dhe Zhitkovc të pjesës veriore të Kosovës. Prej vitit 1999, kur u shkatërrua Mëhalla e Romëve në Mitrovicën jugore (e ashtuquajtura Mëhalla e Romëve) shumë ish banorë të kësaj zone janë vendosur në kampet e sipërpërmendura pa marrë parasysh vërejtjet se ata janë vendosur në një terren të kontaminuar nga deponitë e afërta të sasive të mëdha mbeturinave të plumbit, të cilat kanë helmuar disa fëmijë që jetonin në kampe, gjë që ka shkaktuar shtrimin e tyre në spital. Pasi që tema e helmimit me plumb u bë temë e një diskutimi të gjerë në vitin 2004 dhe 2005 pas intervenimit të mediave dhe një numri faktorësh duke përfshirë edhe Ombudspersonin e mëparshëm, UNMIK-u filloi rindërtimin e ish kampit të KFOR-it, Osterode në Mitrovicën veriore për vendosjen e këtyre PZHBV-ve romë. Fillimisht, udhëheqësit e romëve që jetonin nëpër kampe refuzuan idenë e vendosjes në Osterode, duke u frikësuar se vendosja në një kamp me kushte më të mira do të vështirësonte kërkesën e tyre për rindërtimin e shtëpive të tyre në Mëhallë. Përfundimisht, kushtet jashtëzakonisht të këqija nëpër kampet e ndotura ndikuan që gjysma e kampit të Çeshmin Llugut, kampit të Kabllares dhe një të tretës së kampit të Zhitkovcit të vendosen në Osterode, i cili edhe pse është afër kampeve fillestare nuk paraqet rreziqe të theksuara shëndetësore, meqenëse toka e kontaminuar në të cilin ai është ndërtuar është shtruar me beton. Kjo është konfirmuar nga ekspertë të pavarur, përfshirë OBSH-në.

Në përfundim të periudhës raportuese, Institucioni i Ombudspersonit pranoi informata nga përfaqësuesit e romëve në kampet e lartpërmendura se më shumë se 60 familje tashmë janë vendosur në kampin e ri dhe se kontejnerët e rinj po përgatiteshin për strehimin e banorëve të mbetur të kampeve Çeshmin Llug dhe Zhitkovc. Gjatë një vizite të shkurtër nga ana e Institucionit të Ombudspersonit në Osterode, banorët e rinj të këtij kampi u ankuan se sistemi i furnizimit me ujë në kampin e ri nuk ishte i mirë. Po ashtu, ata thanë se aty kishte vetëm disa tualete dhe banjo për më tepër se 60 familje të vendosura në kamp. Përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit nuk ishin në gjendje t'i hetonin këto ankesa sepse menjëherë pas ardhjes në kamp atyre ju kërkua nga rojet e sigurimit që të largoheshin nga kampi, nën arsyetimin se ata po zbatonin urdhrat e menaxhmentit të kampit. Çdo përpjekje për të caktuar një vizitë tjetër ishte e pa suksesshme, për shkak të pamundësisë së kontaktimit me menaxhuesit e kampit.

Kthimi eventual i personave të zhvendosur nga grupet e pakicave etnike brenda dhe jashtë Kosovës, kryesisht atyre serbë dhe romë në shtëpitë e tyre ose në strehimore të përshtatshme varet nga shumë faktorë, por kryesisht nga ajo nëse ata do ta ndiejnë vetën të jetojnë të sigurt në Kosovë përsëri apo jo. Ata do të duhej të jenë në gjendje të zgjedhin nëse dëshirojnë të kthehen në banimin e tyre të mëparshëm apo në ndonjë vendbanim tjetër.

Duke pasur parasysh paqartësitë rreth negociatave pasuese lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës, personat e zhvendosur të komuniteteve të sipërpërmendura që momentalisht jetojnë jashtë Kosovës ballafaqohen me dilemën se a të kthehen apo jo. Përderisa në përgjithësi, mund të thuhet se situata e sigurisë për të kthyerit e grupeve të pakicave etnike – kryesisht serbëve – ka shënuar përparim, shumë prej tyre ende frikohen të lëvizin lirshëm. Frika e këtyre të kthyerve për të lëvizur lirshëm nëpër Kosovë është ushqyer nga incidentet e fundit të hedhjes së gurëve në autobusë dhe dëmitmit të gurrëve të varreve, siç është paraqitur më gjerësisht në pjesën mbi të drejtat e pakicave. Faktorët tjerë që ndikojnë në vendimin e personave të sipërpërmendur për t'u kthyer janë shqetësimet rreth kujdesit mjekësor, sistemit të edukimit, diskriminimit të mundshëm dhe ekonomisë së dobët në Kosovë.

Për momentin, serbët dhe pakicat e tjera dalëngadalë po kthehen në zonat rurale, përderisa nuk ka fare kthim në zonat urbane, fillimisht për shkak të frikës së mungesës së sigurisë e gjithashtu edhe për shkak të faktit se shumë apartamente kanë qenë të uzurpuara ilegalisht deri vonë. Megjithatë, edhe pse DÇBP-ja i ka larguar shumicën e uzurpuesve ilegal, frika e lartpërmendur rreth sigurisë dhe mosdija lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës i pengon shumicën e pjesëtarëve të këtyre bashkësive të pakicave që të kthehen.

Ata serbë që janë kthyer përballen me vështirësi, siç ndodhë në disa raste kur për shkak të frikës së sigurisë së tyre ata nuk mund ta punojnë tokën që gjeografikisht nuk është afër vendbanimit ku ata janë kthyer. Po ashtu, ekzistojnë raste kur uzurpuesit ilegal e kultivojnë tokën që me të drejtë u takon personave të kthyer dhe deri më tani ka pasur shumë pak përpjekje nga ana e autoriteteve kompetente për zgjidhjen ose shqyrtimin e këtyre çështjeve.

Personat e kthyer e kanë vështirë që të fillojnë ndonjë biznes të ri për shkak të vështirësive për t'iu qasur një tregu edhe ashtu të kufizuar të punësimit. Frika për të lëvizur nëpër Kosovë dhe vështirësitë në blerjen e makinerive të duhura gjithashtu e bënë të vështirë që ata që të ndërtojnë një jetesë të qëndrueshme. Po ashtu ekzistojnë probleme edhe lidhur me vjedhjen e makinerisë dhe bagëtisë, përderisa Ministria për Kthim dhe Komunitete është përgjegjëse për kthimet dhe përmirësimin e kushteve të tyre jetësore, deri më tani ajo nuk ka bërë aq sa duhet për të krijuar një strategji të duhur për përmirësimin e qëndrueshmërisë jetësore të personave në fjalë.

Megjithatë, një Ministri nuk mund ta bëjë vet këtë punë – duhet të angazhohet e gjithë udhëheqësia e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare në një përpjekje të përbashkët për të përmirësuar fatin e të kthyerve.

Shumë njerëz të zhvendosur si pasojë e ngjarjeve të marsit nuk janë kthyer ende, pasi që nuk kanë besim se situata e sigurisë është përmirësuar në atë mënyrë që do t'u mundësonte atyre të jetojnë një jetë paqësore. Të gjithë ish banorët e kthyer të fshatrave nga Bellopoja dhe Biqa, të zhvendosur për të dytën herë si pasojë ngjarjeve të lartpërmendura tashmë janë kthyer në shtëpitë e tyre. Në zonën e Gjilanit dhe në një fshat afër jugut të Mitrovicës, shumë njerëz ende nuk kanë guxuar të kthehen, por vijnë për çdo ditë që t'i shohin pronat e tyre. Një numër i konsiderueshëm i tyre kanë vendosur që t'i shesin pronat e tyre dhe të vendosën në vende të tjera. Në ato raste kur njerëzit janë

kthyer, doli se një numër i caktuar i shtëpive të rindërtuara ishin ndërtuar me një cilësi të dobët. Në raste të caktuara, vjedhja e dyerve, bojlerëve, pajisjeve të qeramikës dhe thyerja e xhamave paraqesin probleme shtesë. Shembuj të rasteve të lartpërmendura kanë ndodhur në komunën e Prishtinës, Fushë Kosovës dhe asaj të Obiliqit.

Sa i përket çështjes së kthimeve me forcë, UNHCR-ja në qershor 2006 ka lëshuar një dokument të ri mbi Nevojat e Vazhdueshme të Mbrojtjes Ndërkombëtare të Individëve nga Kosova. Një ndryshim i rëndësishëm prej dokumentit të kaluar të lëshuar në prill 2005, është se pjesëtarët e komuniteteve ashkali dhe egjiptiane nuk konsiderohen më si të rrezikuar, për shkak të zhvillimeve pozitive ndëretnike. Megjithatë, për arsye të kapacitetit të kufizuar të pranimi në Kosovë, kthimi i personave nga këto grupe duhet të bëhet në faza të ndryshme. Mirëpo, UNHCR-ja mbeti e shqetësuar për serbët, romët dhe shqiptarët e Kosovës, në ato raste kur këto grupe përbëjnë pakicën. Njerëzit e këtyre bashkësive duhet edhe më tutje të konsiderohen si të rrezikuar nga përndjekja dhe duhet të vazhdojnë të përfitojnë nga mbrojtja ndërkombëtare në vendet ku kanë kërkuar azil. Ombudspersoni i mëparshëm kishte ngritur këtë çështje në mënyrë të vazhdueshme pranë UNMIK-ut dhe një numër të qeverive perendimore gjatë vitit 2005.

Sidoqoftë, marrëveshjet e bëra me disa shtete të Evropës Perëndimore si Gjermania lejon kthimin e detyrueshëm të një numri të kufizuar të romëve – kryesisht kundërvajtsve që janë dënuar me burgim në vendet ku kanë kërkuar strehim. Megjithatë, autoritetet e vendeve nikoqire janë të obliguara që fillimisht të kontaktojnë UNMIK-un i cili duhet të kryejë një vlerësim të rrezikshmërisë në baza individuale. Në qoftë se ndonjë rast individual nuk e merr miratimin paraprak të UNMIK-ut, vendi nikoqir mund të mos e kthejë këtë person në Kosovë.

Duke marrë parasysh numrin e madh të njerëzve që tashmë janë kthyer në mënyrë të detyrueshme në Kosovë gjatë viteve të fundit, ndihma e pakët që u është dhënë këtyre njerëzve është e mjerueshme. Ende nuk ka zyre të specializuara apo qendra informative për këta njerëz, as në nivelin qendror as në atë komunal, apo trajtim të veçantë mjekësor ose psikologjik ose kurse të gjuhës për fëmijët, që shpesh e flasin vetëm gjuhën e vendit ku kanë qenë të strehuar.

Në disa shtete vazhdon praktika e kthimit të personave që u janë nënshtruar trajtimeve mjekësore ose psikologjike, në bazë të informatave që ata marrin nga zyrat e tyre ndërlidhëse në Kosovë, që thonë se i njëjti trajtim mund të bëhet edhe në Kosovë.

Megjithatë, në disa raste ky lloj informacioni është sfiduar me sukses nga avokatët para gjykatave të vendeve nikoqire. Zyra e UNMIK-ut për Bashkësi, Kthime dhe Çështje të Pakicave ende mban qëndrimin e paraqitur në një shkresë të përgatitur së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë në janar të vitit 2005, që ndër të tjera thotë se ka mungesë të përgjithshme të profesionistëve të shëndetit mental në Kosovë, e në veçanti të profesionistëve që mund të merren me njerëzit me nevoja të veçanta, pastaj burime të pamjaftueshme financiare dhe mungesë e shërbimeve për ata që jetojnë në zonat rurale, ashtu që personat që vuajnë nga stresi post-traumatik të mund të trajtohen në vendet nikoqire para se të kthehen në Kosovë, në mënyrë që të shmangët përkeqësimi i gjendjes së tyre.



Në përgjithësi, Kosova përballet me mundësi të kufizuara që të mirëpresë dhe pranojë një numër të madh të refugjatëve dhe PZHBV-ve të cilët ende nuk kanë vendosur nëse dëshirojnë të kthehen ose jo. Duhet bërë më shumë për përgatitjen e terrenit, ashtu që persona tashmë të kthyer të mund të gjejnë vendin e tyre në shoqërinë kosovare.

## **Mbrojtja e të drejtave pronësore në Kosovë dhe çështje të përafërta**

Pacenueshmëria e të drejtës në pronë është parakusht për funksionimin e sistemit ligjor dhe demokratik. Pasi që Kosova, nën administrimin e UNMIK-ut, është ende në proces ndërtimit të institucioneve të mirëfillta demokratike, kjo duhet të jetë një nga shtyllat kryesore të këtyre institucioneve, e garantuar përmes legjislacionit dhe administratës demokratike, si dhe përmes gjyqësorit të pavarur. Megjithatë, sa i përket zbatimit të këtyre parimeve në praktikë, realiteti në Kosovë është i tillë që niveli i pamjaftueshëm i mbrojtjes së pronës së njerëzve është alarmues dhe pasqyron funksionimin e pamjaftueshëm të sistemit ligjor në Kosovë dhe papërgjegjësinë e shumicës së organeve administrative.

Mungesa e përgjegjësisë është më e dukshme në fushën e ndërtimeve të paligjshme, që në mënyrë të përhapur dhe këmbëngulëse ende nuk e përfillin sistemin e lejeve të ndërtimit dhe planeve urbanistike. Të shumtën në Prishtinë, por edhe në qytetet dhe qytezat tjera më të vogla në tërë Kosovën, ndërtesa të larta ngritën si kërpudha dhe komunat në shumicën e rasteve dështojnë ta zbatojnë ligjin për të penguar ndërtimet e tilla të pakontrolluara. Komunat shumë rrallë shqyrtojnë si duhet problemet e personave, pronat e të cilëve janë dëmtuar apo shfrytëzimi i tyre është penguar përmes punëve ndërtimore në ndërtesa të larta. Deri më tani, përkundër ankesave të shumta të këtyre personave, vetëm në disa raste ka ndodhur që inspekcionet komunale të rrënojnë ndërtesat e ngritura në mënyrë të paligjshme.

Kur përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit e ngritën këtë çështje pranë zyrtarëve kompetent të inspekcioneve komunale, ata shpesh herë pohuan që, derisa e kishin të njohur që ndërtimet e caktuara i kishin tejkaluar kufijtë e dhënë me lejen e ndërtimit apo ishin duke u ndërtuar pa një leje të tillë, ata nuk do të intervenonin për t'i rrënuar këto ndërtime derisa Kuvendi i Kosovës të mos e shpallë Ligjin mbi Ndërtimet. Pas shpalljes së këtij Ligji, do të përpiloheshin plane të reja urbanistike dhe do të shqyrtohej në baza individuale pajtueshmëria e secilës nga këto ndërtime me planet e reja urbanistike.

Gjatë bisedës me përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit, zyrtarët e inspekcioneve komunale gjithashtu u ankuan që ndërtuesit e paligjshëm vazhdojnë punët e tyre ndërtimore përkundër urdhrave të Komunës. Në të njëjtën kohë, ata pohojnë që është vështirë që të garantojnë përfilljen e këtyre urdhrave në mungesë të policisë së inspekcionit.

Problemi i përshkruar më lart është vetëm një nga të tillët në Kosovë që paraqesin një dështim për ta zbatuar sundimin e ligjit. Mirëpo, ai mund të merret si shembull për t'i treguar vështirësitë e përgjithshme në zbatimin e sundimit të ligjit – në vend të ndaljes së punëve ndërtimore që nuk janë në pajtim me ligjin në fuqi, ato lejohen të vazhdojnë derisa të mos shpallet një ligj i ri në këtë drejtim. Edhe në rastet kur ekziston vullneti për

t'u dhënë fund këtyre praktikave të paligjshme, nuk ekzistojnë mekanizmat përkatës për ta garantuar zbatimin efikas të sundimit të ligjit.

Një shembull tjetër ku komunat dështojnë ta zbatojnë sundimin e ligjit është çështja e eksproprijimit të pronave private, që zakonisht bëhet për të ndërtuar rrugët, ndërtesat publike apo monumentet. Sipas Ligjit mbi Eksproprijimin të ish-KSA të Kosovës, të vitit 1978, Komunat së pari duhet ta informojnë pronarin e ligjshëm rreth qëllimit të tyre për eksproprijim dhe t'i sqarojnë arsyet pse kjo është në interes publik. Më vonë, pasi të jetë kryer eksproprijimi, Komunat janë të obliguara që ta kompensojnë pronarin e tokës, qoftë përmes dhënies së tokës me përmasa të njëjta apo përmes dhënies së mjeteve financiare. Fatkeqësisht, ky Ligj respektohet vetëm në raste të rralla – zakonisht, Komunat vendosin të bëjnë eksproprijimin pa i informuar paraprakisht pronarët e ligjshëm dhe nuk sqarojnë përse apo nëse ky eksproprijim është në interes publik. Nganjëherë, por jo gjithmonë, këto sqarime jepen më vonë. Derisa ka pasur raste që personave privatë u janë dhënë pjesë të tokës si kompensim për pronën e eksproprijuar, këto raste janë më shumë përjashtime nga praktika e përgjithshme. Për shkak të mungesës së pohuar të fondeve publike, deri më tani asnjë person të cilit i është eksproprijuar prona nuk ka marrë ndonjë kompensim në formë të mjeteve financiare.

Kjo situatë është më e rënda në raste të caktuara ku KFOR-i, pas hyrjes në Kosovë në vitin 1999, faktikisht i eksproprijoi pronat e caktuara duke ndërtuar rrugë në një numër të komunave në Kosovë. Një nga rastet më të theksuara të kësaj natyre ndodhi në Prizren, ku autoritetet kompetente komunale e udhëzuan ankuesin që të ankohet pranë KFOR-it, pasi që ata e kishin ndërtuar rrugën. KFOR-i, në anën tjetër, e udhëzoi ankuesin që të ankohet pranë Komunës, pasi që rruga ishte ndërtuar për Komunën dhe po shfrytëzohej nga ajo. Derisa KFOR dhe Komuna refuzojnë të marrin përgjegjësinë për këtë eksproprijim, pronari i ligjshëm në fjalë ende nuk ka marrë kurrfarë kompensimi për pronën që e ka humbur.

Një kategori tjetër e rasteve me të cilat është marrë Institucioni i Ombudspersonit gjatë periudhës për të cilën raportohet ka të bëjë përsëri, sikur edhe në Raportet tjera Vjetore, me punën e Drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore (DÇPB). DÇPB u themelua në vitin 1999 me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/23 për të punuar me kërkesat e personave fizikë, pronësia, posedimi ose e drejta e banimit në pronën e patundshme banesore të të cilëve u është revokuar para datës 24 mars 1999 si rezultat i diskriminimit. Drejtoria tashmë ka nxjerrë vendimet mbi pothuajse të gjitha kërkesat dhe ta përfundojnë punën e saj sapo të përfundohet edhe kërkesat e fundit në pritje për t'u zgjidhur.

Mbledhja e fundit e rregullt e Komisionit për kërkesa të DÇPB-së do të mbahet në korrik të vitit 2006, mirëpo për shkak të pamundësisë që në një mbledhje të vetme të shqyrtohen të gjitha kërkesat pranë DÇPB-së, pritjet që Komisioni i kërkesave ta mbajë edhe një mbledhje të jashtëzakonshme në shtator të vitit 2006. DÇPB do ta vazhdojë punën e saj derisa të ekzekutohen të gjitha vendimet e Komisionit të kërkesave.

Një kategori e rasteve që është dëshmuar të jetë tejte e ndërlikuar ka të bëjë me rastet që përfshijnë punonjësit e dikurshëm të ndërmarrjeve shoqërore, të cilëve punëdhënësit e tyre u kishin ndarë banesa në vitet e tetëdhjeta, mirëpo të cilët së pari u dëbuan nga puna dhe më vonë edhe nga banesat në vitet e nëntëdhjeta nën regjimin e Millosheviqit. Këto

banesa pastaj iu ndanë punëtorëve tjerë, të cilët i morën ato në posedim. Në raste të tilla, si personat që i kishin pasur fillimisht në posedim këto banesa, ashtu edhe personat që dikur i morën të njëjtat në posedim, paraqitën kërkesa pranë DÇPB-së.

DÇPB vendosi mbi këto raste duke i dhënë posedimin njëres palë, kurse kompensimin palës tjetër. Megjithatë, ekzekutimi i vendimeve për kompensim ende paraqet problem sepse DÇPB nuk mund të vendoste kujt t'i japë kompensim dhe, nëse ky është rasti, sa do të jetë ky kompensim. Sipas informatave të pranuara nga DÇPB, është kërkuar shumë herë nga PSSP që të vendosë lidhur me këtë çështje, mirëpo kjo nuk ka ndodhur deri më tani.

Lidhur me rastet e ngjashme kur mbajtësit e të drejtës së banimit ishin larguar nga vendet e tyre të punës para se të marrin në posedim banesat që u ishin ndarë, DÇPB e zgjidhi këtë çështje duke vendosur që ankuesit do të duhej të paraqesin kërkesat për kompensim pranë Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), një organ që është përgjegjës për administrimin dhe privatizimin e ndërmarrjeve të dikurshme shoqërore, apo pranë Gjykatës supreme të Kosovës, që punon në mënyrë specifike me çështjet që kanë të bëjnë me AKM-në. Megjithatë, duket që deri më tani asnjë nga personat në fjalë nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë të tillë për kompensim pranë AKM-së.

Pasi që shumica e personave që kishin jetuar në banesat e ndara në vitet e nëntëdhjeta u larguan nga Kosova nga mesi i vitit 1999, mbajtësit e dikurshëm të të drejtës së banimit u kthyen në banesat që i konsideronin të jenë të tyre dhe kanë jetuar në to këto shtatë vitet e fundit. Mirëpo tani ata janë dëbuar një nga një nga këto banesa nga ana e DÇPB-së, e cila përgjegjësinë për të gjetur ndonjë lloj strehimi për këta njerëz ia barti komunave të ndryshme të Kosovës. Fatkeqësisht, vetëm disa komuna ishin në gjendje që ta ofrojnë këtë strehim deri më tani – ku pohohet që kjo është për shkak të mundësive të kufizuara financiare, por më shpesh për shkak se ata thjeshtë nuk e konsiderojnë që kjo është pjesë e përgjegjësisë të tyre.

Mungesa e përgjegjësisë për të ofruar strehim apo ndonjë formë tjetër të banimit ka pasoja edhe më të rënda për personat e dëbuar nga ana e DÇPB-së dhe të cilët nuk kanë ku të shkojnë për shkak se shtëpitë e tyre, të rrënuara gjatë luftimeve të viteve 1998-99, ende nuk janë rindërtuar. Menjëherë pasi që UNMIK-u morri përsipër administratën publike në vitin 1999, organizatat dhe OJQ-të ndërkombëtare ofruan ndihma për të rindërtuar pronat e tilla të shkatërruara, mirëpo kjo ndihmë tani është shfrytëzuar pothuajse në tërësi, duke paraqitur kështu një problem serioz për ata persona që prej vitit 1999 kanë qenë duke shfrytëzuar në mënyrë të paligjshme prona të ndryshme për qëllim të strehimit. Përkundër kërkesave të përsëritura drejtuar komunave për të rindërtuar këto prona, këtyre personave nuk u ishte ofruar kurrfarë ndihme për rindërtim apo ndonjë strehim tjetër pasi që zyrtarët komunalë konsideronin që ata ishin duke jetuar diku dhe çështja e tyre e strehimit, së paku përkohësisht, ishte e rregulluar. Derisa disa nga komunat janë marrë me këtë çështje, në shumicën e rasteve ekziston një mungesë e qartë e vullnetit politik në nivelin lokal dhe qendror që të ballafaqohen me këtë problem.

Gjatë viteve të fundit, Institucioni i Ombudspersonit ka pranuar shumë kërkesa në lidhje me këtë çështje dhe ajo është një nga brengat kryesore të Institucionit. Momentalisht, Institucioni i Ombudspersonit është duke përgatitur një raport special mbi pajtueshmërinë

e këtij mosveprimi të autoriteteve kompetente me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Qeveria dhe komunat e Kosovës, në bashkëpunim me donatorët ndërkombëtarë, duhet të veprojnë shpejtë për ta përpiluar një strategji të strehimit për një numër të personave që përnjëherë kanë mbetur pa strehim për shkak të arsyeve të lartpërmendura. Në të njëjtën kohë, rindërtimi i shtëpive dhe pronave të shkatërruara gjatë luftimeve të vitit 1999 duhet që përsëri të bëhet prioritet për faktorët vendorë dhe ndërkombëtarë, edhe pse ata nuk janë të obliguar me ligj që ta bëjnë këtë.

Në anën tjetër, autoritetet kosovare janë të obliguara qartas me ligj për t'i rindërtuar shtëpitë e shkatërruara gjatë trazirave të marsit të vitit 2004 në Kosovë. Megjithatë, ende nuk janë rindërtuar të gjitha shtëpitë. Në disa raste ku shtëpitë janë rindërtuar, ka pasur ankesa që kjo nuk është bërë në mënyrë plotësisht të kënaqshme. Hollësi të mëtejshme lidhur me këtë janë paraqitur në pjesën e këtij Raporti Vjetor që ka të bëjë me personat e zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës dhe kushtet për kthim.

Përveç këtyre rasteve dramatike, mbrojtja e të drejtave pronësore të minoriteteve etnike, posaçërisht të serbëve dhe romëve, është e shënjuar me probleme të vazhdueshme prej vitit 1999, të shumtën në lidhje me pamundësinë e këtyre personave që të kenë qasje në tokën e tyre. Për një diskutim më të hollësishëm të kësaj çështjeje, shikoni pjesën e këtij Raporti që ka të bëjë me të drejtat e komuniteteve minoritare.

Pas mbylljes së DÇPB-së, kërkesat lidhur me pronën e patundshme private, bujqësore dhe komerciale si rrjedhojë e ngjarjeve të vitit 1998-1999 në Kosovë do të shqyrtohen nga ana e Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP), e themeluar si agjenci administrative e cila do të funksionojë si organ i pavarur në pajtim me Kapitullin 11.2 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme dhe në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/10 mbi Agjencinë Kosovare të Pronës, të datës 4 mars 2006. AKP do të ndihmojë gjykatat në zgjidhjen e asaj kategorie të kërkesave lidhur me pronën e patundshme private, bujqësore dhe komerciale si pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Vendimet mbi konstatimet dhe konkludimet e Agjencisë Kosovare mbi Pronën do të merren sipas autorizimit të gjykatave të Kosovës. Supozohet që AKP do të merret me një numër të madh të kërkesave, njëllon sikur DÇPB para saj.

Në shumë raste në pritje për t'u zgjidhur pranë AKP-së, DÇPB-së apo çfarëdo organi tjetër që merret me kërkesat në lidhje me pronësinë, dështimi i palëve përkatëse për t'i informuar autoritetet e kadastrave lidhur me bartjen e pronësisë e vështirëson në masë të madhe zgjidhjen e kërkesave të tilla. Kjo sjell deri te vështirësitë e pakalueshme në kontestet pronësore dhe zhvlerëson regjistrat e kadastrave si dëshmi të pronësisë.

Një problem tjetër në këtë drejtim është fakti që zyra e kadastrave shpesh herë u mungon dokumentacioni nga periudha e kohës së Jugosllavisë. Në disa raste ky dokumentacion është shkatërruar apo humbur, kurse në rastet tjera atë e kanë marrë me vete punonjësit e mëparshëm të këtyre zyrave me rastin e largimit të tyre nga Kosova vitin 1999. Kontakti me personat kompetent në Serbi është i vështirësuar për shkak të situatës së tendosur politike momentalisht, prandaj zyrtarët e kadastrave në Kosovë i

këshillojnë individët që këto çështje t'i drejtojnë pranë gjykatave kompetente, që paraqet një problem shtesë duke marrë parasysh vonesat e zakonshme në procedurat gjyqësore. Për më tepër, numri i madh i dokumenteve të falsifikuara që qarkullojnë nëpër Kosovë ka shkaktuar konfuzion të konsiderueshëm lidhur me pronësinë. Nganjëherë ndodh që tri apo katër palë ose individë pohojnë të jenë pronarë të pronës së njëjtë.

Siç mund të shihet, ka shumë vështirësi në lidhje me mbrojtjen e duhur dhe të drejtë të pronës, që shpesh herë ka të bëjë me mungesën e llogaridhënies dhe përgjegjësisë së autoriteteve komunale, zakonisht krahas edhe me gjyqësorin e brishtë. Është e nevojshme që qeveria qendrore të ndërmarrë hapa më efikas dhe më të vendosur për të zgjidhur këto çështje.

## **Të drejtat e fëmijëve në Kosovë**

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve nuk është çështje e re për legjislacionin kosovar. Edhe pse Kosova, apo më mirë thënë UNMIK-u, nuk është në gjendje ta nënshkruajë Konventën për të Drejtat e Fëmijëve (KDF) pasi që vetëm shtetet e mbajnë këtë të drejtë, Korniza kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme i obligon institucionet me mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe zbatimin e kësaj konvente edhe në territorin e Kosovës, duke i vënë kështu bazat e standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në shoqërinë kosovare. KDF kërkon ndërmarrjen e të gjitha masave që të kujdeset dhe garantohet mbrojtja, respektimi dhe promovimi i të gjitha të drejtave të fëmijëve përmes nxjerrjes së ligjeve përkatëse si dhe krijimit të mekanizmave kontrollues. Për implementimin e kësaj Konvente në Kosovë, autoritetet kompetente duhet kenë parasysh parime kryesore në vijim: parimin e mos-diskriminimit të fëmijëve, parimin me të cilin secili fëmijë ka të drejtën e jetës dhe zhvillimit, parimin e interesit më të lartë të fëmijëve dhe parimin që secili fëmijë ka të drejtën e shprehjes së lirë të mendimit dhe të jetë i dëgjuar. Sipas nenin 1 të KDF-së, fëmijë është secili person më i ri se 18 vjet.

Sikur në çdo shoqëri tjetër që kalon nëpër fazën e tranzicionit, edhe në shoqërinë Kosovare ekzistojnë disa faktorë që e vështirësojnë tej mase mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në praktikë. Shembuj për këtë janë gjendja e varfër ekonomike e vendit, numri i madh i të papunëve dhe standardi i ulët jetësor. Ajo që është më e rëndësishmja, një numër i madh i personave dhe entiteteve që merren me fëmijët, duke filluar nga prindërit, kujdestarët e fëmijëve, mësimmësuesit, dhe mbi të gjitha institucionet publike, nuk kanë nivel të mjaftueshëm të informimit lidhur me ruajtjen e të drejtave të fëmijëve.

Duke marrë parasysh nevojën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve për shkak të statusit të tyre të posaçëm të cenueshëm, Institucioni i Ombudspersonit themeloi Grupin për të Drejtat e Fëmijëve në vitin 2004, për të punuar në rastet individuale dhe dukuritë e përgjithshme në lidhje me të drejtat e fëmijëve, si dhe për të ndikuar në ngritjen e vetëdijesimit në fushën e të drejtave të fëmijëve.

Kur flitet për legjislacion më të përgjithshëm lidhur me fëmijët, është e rëndësishme të përmendet Ligji i Kosovës për familjen Nr. 2004/32, që hyri në fuqi më 20 janar 2006 dhe e zëvendësoi Ligjin e RSFJ-së mbi martesën dhe marrëdhëniet familjare nr. 10-84 të vitit 1984. Megjithatë, momentalisht, të ty ligjet vazhdojnë të zbatohen në praktikë.

Qendrat për punë sociale nëpër Kosovë vazhdojnë ta zbatojnë ligjin e vjetër duke vendosur në çështjet që kanë të bëjnë me besimin e fëmijëve dhe adoptimin, edhe pse këto çështje, sipas ligjit të ri, janë nën juridiksionin ekskluziv të gjykatave në Kosovë. Sidoqoftë, në praktikë, shumë nga vendimet e Qendrave për punë sociale nuk janë ekzekutuar pasi që prej vitit 1999 nuk ekziston ndonjë organ ekzekutiv i cili do të merrej me ekzekutimin e këtyre urdhrave administrativ.

Derisa konsiderohet pozitiv fakti që në legjislacion, në përgjithësi, fëmijët kanë një rol më të rëndësishëm se më parë, ende mbetet të bëhet shumë në kuptim të mbrojtjes dhe zbatimit të këtyre ligjeve.

Gjithashtu, duhet të themelohen më shume institucione që do të jenë përgjegjëse për mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve dhe duhet të përmirësohet puna e institucioneve ekzistuese që merren me fëmijët, respektivisht Qendrat për punë sociale. Në Kosovë, nocioni i mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në praktikë përmes institucioneve të posaçme u paraqit në vitin 2004 dhe prej atëherë është zhvilluar dhe përmirësuar vazhdimisht. Një zhvillim pozitiv gjithashtu është krijimi i Zyrtarëve për të drejtat e fëmijëve në ministri të ndryshme brenda IPVQ-ve, që shpresohet të ndihmojë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në të ardhmen.

Kjo është posaçërisht e rëndësishme për Kosovën, duke marrë parasysh faktin që fëmijët këtu përballen me një numër të problemeve gjatë zhvillimit të tyre, kur për çdo ditë raportohet për numër të madh të fëmijëve që janë të detyruar që të punojnë edhe punët më të rënda, të lypin apo ta braktisin shkollimin. Shumë fëmijë shpesh herë mbeten edhe pa kurrfarë kujdesi prindëror.

Sa i përket fëmijëve që punojnë, Neni 32 i KDF-së thekson që secili fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rreziqe ose që cenon edukimin e tij ose dëmton shëndetin apo zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror. Sipas nenit 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27 mbi Ligjit themelor të punës në Kosovë, mosha minimale për punësim është tetëmbëdhjetë vjet, përveç punëve të lehta të cilat mund t'i kryejnë edhe fëmijët 15 vjeçar ose më të vjetër, me kusht që punët e tilla nuk e dëmtojnë shëndetin ose zhvillimin e tij a të saj dhe nuk e pengon atë për ndjekjen e mësimit në shkollë.

Edhe pse raporti i fundit i Organizatës ndërkombëtare të punës i vitit 2004 thekson që numri i fëmijëve që punojnë në botë është në rënie, një raport i nxjerrë nga UNICEF-i në të njëjtin vit thekson që ky numër është në rritje në shoqërinë kosovare. Në fakt, nuk ka nevojë të bëhet ndonjë hetim i veçantë për të vërtetuar se fëmijët kosovarë punojnë pothuajse të gjitha punët të cilat janë të dëmshme për ta, siç janë shitja e cigareve dhe produkteve të tjera në rrugë dhe lokale nate, kafene dhe restorante, kryerja e punëve të rënda fizike dhe të amvisërisë, puna nëpër miniera dhe mihje sipërfaqësore, puna e rëndë në sektorin e bujqësisë apo pylltarisë apo kërkimi i lëmoshës. Në këto punë përfshihen edhe fëmijët e moshave deri në 5-6 vjet, të cilët punojnë deri në orët e vona të natës.

Arsyeja kryesore për rritjen e numrit të fëmijëve që punojnë qëndron në situatën e lartpërmendur të mjerë ekonomike. Faktorë tjerë që kontribuojnë në këtë drejtim janë

niveli i ulët i arsimit dhe vetëdijes për efektet negative që puna e rëndë apo e rrezikshme mund t'i ketë në zhvillimin e fëmijëve.

Gjatë periudhës së kaluar për të cilën është raportuar, Ombudspersoni i mëparshëm ia drejtoi Kryeministrit në atë kohë vëmendjen ndaj çështjes së fëmijëve që punojnë, mirëpo kurrë nuk pranoi ndonjë përgjigje lidhur me këtë. Gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit punoi në një rast tepër serioz ku një fëmijë dhjetë vjeçar nga Mitrovica detyrohej të punojë për t'u përkujdesur për familjen e tij prej dhjetë anëtarësh. Institucioni i Ombudspersonit, përmes ofrimit të shërbimeve të mira, i ka ndihmuar prindërve të tij në realizimin e ndihmës sociale dhe pensionit invalidor. Përveç kësaj, falë ndihmës së një OJQ-je suedeze, ka filluar edhe ndërtimi shtëpisë së familjes, që ishte shkatërruar gjatë luftimeve të viteve 1998-99.

Megjithatë, ka pasur zhvillime të caktuara gjatë viteve të fundit drejt përmirësimit të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Në mars të vitit 2005, Ministria e Punës dhe Mirëqenies sociale, me përkrahjen e Zyrës së IPEC-së (Programi ndërkombëtar mbi eliminimin e punës së rëndë të fëmijëve) në Prishtinë, mbajtën bisedimet preliminare me institucionet dhe OJQ-të për të drejtat e fëmijëve lidhur me themelimin dhe përcaktimin e rregullave të punës së “Komitetit të Kosovës për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve”. Ky Komitet u bë zyrtar me Vendimin nr. 5/166 të datës 13 shtator 2005 nga Kryeministri i Kosovës. Anëtarë të këtij Komiteti do të jenë një apo dy përfaqësues nga të gjitha ministratë, krahas me përfaqësuesit e Policisë së UNMIK-ut, Shërbimit Policor të Kosovës, si dhe nga OJQ- të dhe IPEC-u. Mandati i Komitetit është që ta shqyrtojë dhe aprovojë planin strategjik dhe operative të IPEC-ut, të vendos politikën dhe prioritetet programore, përfshirë fushat dhe sektorët në të cilat duhet të zhvillohen programet e veprimit si dhe të sigurojë përkrahjen qeveritare dhe materiale për këto programe. Edhe pse nenit 10 i Vendimit nr. 5/166, thekson që Komiteti do të duhet që brenda 45 ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi ta përgatisë një Plan veprimi mbi eliminimin e punës së fëmijëve në Kosovë, që do të duhej të aprovohej përmes një urdhri të Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Komiteti ka dështuar që ta bëjë këtë brenda afatit të paraparë. Një plan i tillë strategjik i organizuar dhe i udhëhequr nga institucionet publike me siguri se do të zbuste problemin e fëmijëve që punojnë në Kosovë dhe mbi të gjitha do të mund t'i përcillte dhe luftonte në rend të parë shkaqet që sjellin deri te një numër i tillë i madh. Në të njëjtën kohë, ai gjithashtu do t'i obligonte autoritetet qendrore administrative që t'i mbrojnë dhe respektojnë të drejtat e fëmijëve, duke garantuar që do të ekzistojnë mjete të mjaftueshme financiare për të realizuar këtë plan.

Sa i përket çështjes më të përgjithshme të arsimit, u përmend më herët që legjislacioni kosovar ofron mbrojtje të mjaftueshme për fëmijët, mirëpo zbatimi i tij deri më tani nuk është bërë në masë të mjaftueshme. Shembuj për këtë janë Ligji mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë nr. 2002/02, që e miratoi Kuvendi i Kosovës më 26 shtator 2002 (i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/19 më 31 tetor 2002), Ligjin për Inspektionin e Arsimit në Kosovë nr. 2004/37 i 8 shtatorit 2004 (i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/55 më 17 dhjetorit 2004) dhe 68 Udhëzimet Administrative të nxjerra nga MASHT për zbatimin e këtyre ligjeve. Megjithatë, për mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijëve sipas standardeve ndërkombëtare nuk është e mjaftueshme vetëm mbrojtja ligjore, por edhe mbrojtja efektive institucionale dhe zbatimi i bazës përkatëse ligjore në praktikë.

Një obligim të veçantë që KDF vendos mbi autoritetet kompetente është që ato duhet të sigurojnë kushte të mjaftueshme për një arsimin efektiv. Kjo deri më tani nuk është arritur në Kosovë, ku shumë shkolla vuajnë nga lokale të papërshtatshme kështu që janë të detyruara ta zhvillojnë mësimin me orë të shkurtuara nga një orë në gjysmë orë, si dhe që mësimin ta mbajnë në shumë ndërrime, shpesh herë në tri ose katër. Nuk janë të rralla rastet kur fëmijët detyrohen ta mbajnë mësimin nëpër kontejnerë që nuk kanë as kushtet elementare për këtë qëllim. Pasojë e një gjendje të tillë është edhe mungesa e mbikëqyrjes së tensionimit ndërmjet nxënësve, por edhe mes nxënësve dhe mësimitdhënësve. Kur kjo çështje i drejtohet MASHT-së, ajo i referohet buxhetit të vogël që e ka në dispozicion.

Një problem shumë shqetësues në lidhje me shkollat, respektivisht mungesa e ujit të pijshëm që është përmendur në raportin e kaluar vjetor, ende vazhdon të ekzistojë. Sipas një raporti të Njësisë Sanitare të Ujit të Institutit për Shëndetin Publik (ISHP) në Prishtinë, në vitin 2002, në 82,5 % të shkollave të vizituara uji ka qenë i kontaminuar dhe/ose i papijshëm, duke lënë kështu vetëm në 17,5 % të shkollave me ujë të pijshëm. Në qershor të vitit 2004, Ministria e Arsimit, shkencës dhe teknologjisë, së bashku me Ministrinë e shëndetësisë dhe Ministrinë e ambientit dhe planifikimit hapësinor (MAPH) nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit për “Programin Shkollor mbi Promovimin e Shëndetit”. Sipas memorandumit, ministritë e lartpërmendura morën përsipër përmirësimin e kushteve në ato shkolla të Kosovës ku nuk ka ujë të pijshëm.

Ombudspersoni i mëparshëm e ngriti këtë çështje gjatë periudhës së kaluar për të cilën është raportuar. Më 28 shtator 2005, Ombudspersoni përsëri e ngriti këtë çështje me Kryeministrin e Kosovës që u përgjigj me një letër më 8 tetor 2005, ku ishte theksuar që Zyra e Kryeministrit, në bashkëpunim me MASHT, kishin ndërmarrë masat për ta krijuar një ekip pune sa më shpejt që të jetë e mundur për t’u përgjigjur në këtë çështje me të gjitha masat e mundshme. Megjithatë, sipas informatave të kohës së fundit, situata mbetet e pandryshuar, përveç asaj që çdo tre muaj janë shpërndarë sasi të klorit në pikat më kritike. Zyrtarët e ISHP theksojnë që mungesa e ujit të pijshëm dhe/ose kontaminimi i ujit nëpër disa shkolla të Kosovës paraqet rrezik nga epidemitë

Gjatë kontaktimit të drejtpërdrejt me fëmijët nëpër shkolla, një nga ankesat kryesore të fëmijëve ka qenë se shumë nga bashkëmoshatarët e tyre kanë qenë të detyruar të braktisin shkollat për shkak të kushteve të rënda ekonomike që ua kishin pamundësuar atyre që të sigurojnë tekstet mësimore. Kjo situatë është jo vetëm alarmuese por edhe shkel nenin 3.2 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë nr. 2002/02, sipas të cilit tekstet mësimore për nxënësit që vijojnë shkollën fillore përkatësisht nxënësit deri në nivelin e katërt jepen falas nga Ministria e Arsimit. Ombudspersoni i mëparshëm reagoi në këtë situatë në periudhën e fundit për cilën është raportuar kurse Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit përsëri ngriti këtë çështje në janar të vitit 2006, duke kërkuar nga MASHT dhe Kryeministri që të merren hapa konkret në mënyrë që këto dispozita ligjore të zbatohen dhe që të gjithë fëmijët të trajtohen në mënyrë të barabartë. Derisa Zyra e Kryeministrit vetëm sa e informoi Ushtruesin e detyrës së Ombudspersonit që çështje të tilla do të duhej t’i drejtoheshin MASHT-së, kjo Ministri u përgjigj në shkurt të vitit 2006, duke theksuar që nga qeveria për këtë qëllim kishte kërkuar të sigurohen 3.500000 Euro, por që Ministria kishte pranuar vetëm 2.00000 Euro për shkak të mungesës të



fondeve dhe shpresonin që kjo shumë do të ishte e mjaftueshme që të siguronin tekste mësimore për skamnorët dhe jetimët. Institucioni i Ombudspersonit vazhdon ta përcjellë këtë situatë.

Një problem tjetër që nuk ta bëjë aq shumë me shkollat sa ka të bëjë me rrethinën e tyre është fakti që shumë shkolla janë të vendosura afër rrugëve kryesore, që shpesh herë nuk kanë trotuare apo shenja trafiku që kërkojnë nga vozitësit që të ngasin automjetet e tyre më ngadalë në afërsi të shkollës. Për shkak të këtij problemi, shumë nxënës tashmë janë lënduar apo kanë humbur jetën duke shkuar apo duke u kthyer nga shkolla. Ombudspersoni i mëparshëm e ngriti këtë çështje me MASHT dhe Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit (MTT), si gjatë periudhës së kaluar për të cilën është raportuar, ashtu edhe në shtator të vitit 2005. MTT u përgjigj duke ia ofruar Ombudspersonit një raport mbi përmirësimet dhe veprimet e ndërmarra në lidhje me këto “pika të zeza” në trafik. MASHT u përgjigj duke theksuar që Ministria kishte përcaktuar disa prioritete në lidhje me sigurinë e fëmijëve në trafik, respektivisht për të kërkuar nga komunat që këtë çështje ta kenë prioritet gjatë menaxhimit të fondeve, t’i obligojë Zyrat Rajonale të arsimit dhe Departamentet Komunale të Arsimit që të kenë prioritet këtë çështje në agjendën e promovimit dhe kërkimit të donatorëve dhe të kërkojë nga MTT që të hartojë projektet dhe sigurojë bazën ligjore për këto ndërtime. Megjithatë, hetimet e kohëve të fundit të Institucionit të Ombudspersonit tregojnë që edhe shumë pika të tjera të rrezikshme të rëndësisë së madhe në trafik në Kosovë janë lënë anash dhe se akoma ka nevojë për t’u punuar konkretisht në këto pika të trafikut për të garantuar siguri më të madhe për fëmijët.

Shkollimi që u ofrohet fëmijëve në Qendrën korrektuese në Lypjan gjithashtu nuk është i nivelit adekuat – sipas informatave që i ka pranuar Institucioni i Ombudspersonit në vitin 2005, në Qendër kishte vetëm tre mësues për të gjitha moshat. Në tetor dhe dhjetor të vitit 2005, Ombudspersoni i mëparshëm ia ngriti këtë çështje Ministrisë të arsimit, shkencës dhe teknologjisë, i cili ende nuk është përgjigjur. Duke marrë parasysh nevojën e posaçme për arsimim, posaçërisht të kësaj kategorie të fëmijëve, është e rëndësishme që autoritetet kompetente t’ia kushtojnë kësaj çështje vëmendjen që i takon.

Sa i përket mbrojtjes juridike të fëmijëve, rastet që kanë të bëjnë me besimin e fëmijëve në pritje për t’u zgjidhur pranë gjykatave përkatëse gjithashtu pësojnë nga ngarkesa e tepruar e zakonshme me raste që shkakton vonesa të mëdha në gjykatat e Kosovës. Natyra urgjente e këtyre rasteve merret parasysh shumë pak, krahas me faktin që me kalimin e kohës mund të ndodhë edhe deri te largimi i konsiderueshëm i prindërve dhe fëmijëve nga njëri tjetri. Duket që gjykatat nuk e kuptojnë nevojën për të vendosur shpejtë në këto çështje dhe i grumbullojnë ato me raste tjera, që përbën shkelje të të drejtës së fëmijëve për ta gëzuar shoqërinë e të dy prindërve e që mbrohet me të drejtën për respektimin e jetë familjare sipas nenit 8 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut.

Një kategori speciale e fëmijëve përfshin fëmijët me probleme psikike, të cilët kanë nevojë për kujdes të specializuar shëndetësor që institucionet ekzistuese publike në Kosovë shpesh herë nuk mund ta ofrojnë. Derisa fëmijët me sëmundje apo që kanë nevojë për t’u operuar kanë mundësinë që të paraqesin kërkesë për trajtim mjekësor jashtë vendit pranë Ministrisë së shëndetësisë, kjo e fundit nuk pranon rastet që kanë të bëjnë me trajtimin psikik ose psikiatrik pasi që konsideron që trajtimi special në ato raste

mund të zgjasë dhe të kushtojë tepër shumë. Sipas informatave që i ka pranuar Institucioni i Ombudspersonit, ekzistojnë plane për një klinikë të tillë në të ardhmen në Kosovë për këto raste, mirëpo ende nuk është bërë asgjë konkrete në atë drejtim.

Në veçanti, sa i përket fëmijëve, të cilët janë më të cenueshëm për shkak të asaj se nuk mund ta mbrojnë veten, të gjitha institucionet në Kosovë duhet që të përkrahin parimet e përcaktuara në KDF. Deri më tani, kjo nuk është bërë në mënyrë të kënaqshme, mirëpo zhvillimet e kohës së fundit japin shpresë që niveli i vetëdijesimit për të drejtat e fëmijëve, i ngritur viteve të fundit, do të vazhdojë të tregojë ngritje të mëtejshme. Duhet që më shumë prioritet t'i jepet arsimimit të fëmijëve, posaçërisht në fushën e të drejtave të njeriut dhe nën kushtet që janë në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, gjithnjë duke pasur parasysh atë që është më e mira për fëmijët. Derisa gjithkush është i vetëdijshëm për mungesën e fondeve të mjaftueshme brenda IPVQ-ve, qeveria e Kosovës dhe organet tjera vendimmarrëse do të duhej të garantojnë që kjo mungesë e fondeve nuk do të jetë në dëm të fëmijëve dhe zhvillimit të tyre të mëtejshëm.

### **Format e ndryshme të diskriminimit në Kosovë**

E drejta për të qenë të lirë nga diskriminimi është parim themelor i ligjit për të drejtat e njeriut. Përmes instrumenteve të ndryshme të së drejtës ndërkombëtare, shtetet obligohen të luftojnë të gjitha format e diskriminimit. Ato kanë përgjegjësi për të siguruar që ligjet dhe institucionet e tyre të merren me shkaqet dhe pasojat e diskriminimit dhe të sigurojnë mjete të duhura ligjore për personat, të cilëve u janë shkelur të drejtat e tyre themelore për trajtim të barabartë. Shembuj se ku mund të gjinden formulime të parimeve të mosdiskriminimit janë Deklarata e KB-ve për të Drejtat e Njeriut, Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në Kosovë, akt ligjor i cilësisë së njejtë është Ligji kundër diskriminimit, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 shkurt 2004 dhe i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/32 më 20 gusht 2004. Parimet e mosdiskriminimit mund të gjinden gjithashtu në Kornizën Kushtetuese për Vetqeverisje të Përkohshme të vitit 2001, e cila thekson se instrumentet e lartpërmendura ndërkombëtare janë drejtëpërdrejtë të zbatueshme në Kosovë ashtu si edhe në shumë ligje të ndryshme të Kosovës, për shembull në ligjet lidhur me punësimin apo shërbimin civil.

Termi diskriminim shpesh përdoret në diskutimet politike, por vlenë të përkujtohet se cili është kuptimi i vërtetë i këtij termi - trajtimi ndryshe i një personi apo një grupi të cilët përfundojnë në një situatë vërtetë të ngjashme, të krahasueshme apo analoge. Në anën tjetër, diskriminimi mund të ndodh edhe në rastin e kundërt – kur njerëzit që përfundojnë në situata plotësisht të ndryshme dhe trajtohen njejtë. Masat e ndërmarra në mënyrë që të parandalohet apo të kompensohet vendosja e personave të cenueshëm apo personave në një pozitë të pafavorshme, i ashtuquajtur "diskriminimi pozitiv" nuk konsiderohen të jenë diskriminim në kuptimin e mësipërm.

Në mënyrë që të përmirësohet puna e Institucionit të Ombudspersonit në fushën e mosdiskriminimit, në mars 2004 Institucioni themeloi një Grup për mosdiskriminim në kuadër të Departamentit të Hetimeve.

Në Kosovë, çështja e diskriminimit është një temë mjaft e diskutuar dhe deri më tani, veç Ligjit kundër diskriminimit, janë bërë shumë përpjekje publike për të luftuar format e ndryshme të diskriminimit dhe për të gjetur zgjidhje për këtë problem. Megjithatë, në praktikë, këto përpjekje nuk ishin aq të sukseshme. Në një shoqëri, e cila ende vuan nga pasojat e luftimeve ndëretnike para shtatë vitesh, si dhe nga papunësia e lartë dhe brengat e vazhdueshme për të ardhmën, idea për t'iu dhënë të drejta të veçanta grupeve të cenueshme në mënyrë që të rritet ndikimi i tyre në proceset vendimmarrëse nuk është prioritet.

Megjithatë, IPVQ-të ishin angazhuar në një numër aktivitete për ngritjen e vetëdijes në këtë drejtim. Gjatë vitit 2005, dhe në fillim të vitit 2006, Zyra Këshilluese për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit filloi me zbatimin e një projekti për promovimin e Ligjit të lartëpërmendur kundër diskriminimit, që përfshinte trajnime dhe seminare për punonjësit e autoriteteve në nivelin qendror dhe lokal, në veçanti në komunat me popullatë të përzier etnike. Trajnime u organizuan gjithashtu edhe për policë të Shërbimit Policor të Kosovës dhe për pjestarë të Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Në maj të vitit 2006, Zyra Këshilluese për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës nxorri një Udhëzim Administrativ për të lehtësuar zbatimin e Ligjit kundër diskriminimit dhe për të promovuar parimet e tij. Para nxerrjes së tij, Grupi për Mosdiskriminim i Institucionit të Ombudspersonit, me iniciativë të Zyrës së lartëpërmendur, dha rekomandime mbi formulimin e pjesëve të caktuara të draftit të Udhëzimit Administrativ.

Megjithatë, përkundër këtyre përpjekjeve, parimet e të drejtave të njeriut të garantuara në ligjin e lartëpërmendur rrallë herë merren parasysh. Forma më e diskutuar e diskriminimit aktualisht është diskriminimi etnik, i cili, veçanërisht pas luftimeve, merr një karakter politik të llojit të vet që shpesh i qet në hije problemet e vërteta ekzistuese në këtë kontekst. Në të njëjtën kohë, çështja është politizuar shumë me ngritjen e tensioneve gjatë procesit të bisedimeve mbi statusin e ardhshëm të Kosovës. Në një situatë të tillë, përkujtimi i idesë origjinale të diskriminimit dhe problemeve reale që ai i shkakton individëve bëhet edhe më i rëndësishëm.

Derisa ka dallime varësisht nga çdo minoritetet etnik në Kosovë, përkatësisht serb, turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian dhe goran, anëtarët e të gjitha komuniteteve minoritare ankohen për diskriminim gjatë procesit të punësimit si dhe përdorimit dhe përfilljes së kufizuar të gjuhëve të tyre përkatëse nga autoritetet publike. Mungesa e arsimimit të duhur të fëmijëve të tyre në gjuhën e tyre amtare dhe e përkrahjes financiare për këtë qëllim, gjithashtu është temë që shpesh diskutohet nga persona të përkatësisë etnike turke, boshnjake, rome dhe gorane.

Minoriteti serb ankohet se Policia nuk i ka zhvilluar si duhet hetimet mbi sulmet ndaj tyre. Derisa është vështirë të vlerësohet se qëndrojnë arsytet e vërteta për këtë pamundësi për t'i zgjidhur rastet e tilla, është fakt i vërtetë që numri i pazgjidhur i rasteve ku viktimat janë të përkatësive etnike minoritare është më i lartë se në kategoritë e tjera të rasteve.

Një çështje speciale për sa i përket diskriminimit ka të bëjë me pamundësinë e pohuar të personave të disa minoriteteve, kryesisht serb, për të marrë pjesë në privatizimin e ndërmarrjeve të mëparshme shoqërore ku kishin punuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme shoqërore, punëtorët e mëparshëm të ndërmarrjeve të tilla kishin të drejtë të përfitojnë të ardhura nga privatizimi i ndërmarrjeve nëse kanë qenë të regjistruar si punonjës të ndërmarrjeve në kohën e privatizimit të tyre dhe nëse mund të dëshmojnë se kanë punuar për ndërmarrjen së paku tri vite. Meqë shumica e ankuesve serb ishin larguar nga Kosova në kohën kur kishin filluar procedurat e privatizimit, ata nuk mund të regjistroheshin në mënyrën e lartpërmendur.

Derisa gjithnjë ekziston mundësia për personat që pohoet të jenë përjashtuar nga procesi i privatizimit të parashtrajnë ankesa pranë Odës së Veçantë për Çështje që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit pranë Gjykatës supreme të Kosovës, çfarëdo ankese mund të jetë e suksesshme vetëm nëse diskriminimi i pohuar mund të dëshmohet. Ky parim i vendosjes së barrës së dëshmisë mbi ankuesit, megjithatë, është në kundërshtim me standardet relevante Evropiane, të cilat kanë ndryshuar për sa i përket bartjes së barrës së dëshmisë nga pala ankuese te pala përgjegjëse, kurdo që mund të perceptohet barra e dëshmisë në shikim të parë. Kjo bartje e barrës së dëshmisë është gjithashtu e përfshirë edhe në nenin 8 të Ligjit kundër diskriminimit. Si Ombudspersoni i mëparshëm ashtu edhe Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit kanë ngritur këtë çështje pranë PSSP-së, duke rekomanduar ndryshimin e procedurave pranë Odës së Veçantë në pajtim me standardet Evropiane në raste e diskriminimeve, por që deri më tani kanë qenë pak të suksesshme.

Diskriminimi kundër romëve mund të mos jetë gjithmonë kaq i debatuar në publik sa problemet me të cilat ballafohen serbët, por anëtarët e këtij komuniteti shpesh i nënshtrohen modeleve të rregullta të talljeve dhe ofendimeve. Derisa ky diskriminim i përgjithshëm prek gjithashtu ashkallitë dhe egjiptianët, situata është më e vështirë për romët, të cilët rrallë herë e njohin gjuhën ashtu si duhet. Atyre rregullisht ju mohohen të drejtat më themelore siç janë, e drejta për vendbanim të duhur, qasja në shërbime mjeksore, situata ekonomike apo apo e drejta për arsimim. Në veçanti, Institucioni i Ombudspersonit ka monitoruar nga afër, gjatë kësaj dhe periudhave tjera raportuese, situatën e romëve që jetonin në kampe për persona të zhvendosur brenda vendit në pjesën veriore të Kosovës, të cilat ishin ndërtuar në tokë të kontaminuar nga mbeturinat e një miniere të plumbit në afërsi. Grupet egjiptiane dhe ashkali shpesh vuajnë nga probleme të ngjashme për sa i përket kushteve jetësore, por jo deri në këtë masë. Pjesa e mësipërme mbi të drejtat e minoriteteve flet më hollësisht për këtë çështje.

Por, diskriminimi etnik nuk është forma e vetme e diskriminimit në Kosovë. Derisa shpesh trajtohet si një organ i veçantë i ligjit, trajtimi i ndryshëm i burrave dhe grave dhe forma tjera të diskriminimit gjinor nuk duhet parë si i tillë por si një formë e veçantë e diskriminimit. Barazia gjinore vazhdon të jetë një çështje e rëndësishme, kryesisht për arsye të modeleve tradicionale hierarkike të rrënjësura thellë që mbizotërojnë në shumë komunitete etnike në Kosovë, të cilat në parim ua privojnë grave shumë të drejta të cilat i gëzojnë burrat. Derisa në shumë raste gratë vazhdojnë të konsiderohen si inferiore ndaj burrave, vetëdijësimi për këtë çështje është përmirësuar deri diku, në veçanti pas miratimit të Ligjit të Kuvendit të Kosovës 2004/2 mbi Barzinë Gjinore më 19 shkurt

2004. Ky ligj, i shpallur nga PSSP me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/18 më 7 qershor 2004, synon vendosjen e barazisë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë Kosovare duke siguruar mundësi të barabarta për pjesëmarrje në jetën politike, ekonomike, sociale kulturore dhe fusha tjera sociale si për burrat ashtu edhe për gratë.

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë ndërmarrë hapa të shumta për të promovuar barazinë gjinore dhe për të ngritur vetëdijen për disa lloje të caktuara të diskriminimit gjinor. Një nga këto ishte edhe krijimi i një programi i kohës së fundit nga qeveria për barazi gjinore dhe themelimi i një zyre për barazi gjinore në kuadër të Zyres së Kryeministrit. Drejtoria për legjislacion brenda zyres për barazi gjinore ka shqyrtuar deri më tani disa ligje nga këndvështrimi i barazisë gjinore.

Mbetet e paqartë se sa mund të arrihet me aktivitete të tilla dhe ligje nëse problem i vërtetë qëndron në vlerat tradicionale dhe mungesës të arsimit. Si rregull e përgjithshme, ka dallime të konsiderueshme në mes zonave rurale dhe urbane në perceptimin e gruas dhe të drejtave të saj. Në zonat rurale, ligjet dhe zakonet tradicionale qëndrojnë, pozita sociale e gruas është shpesh më inferiore ndaj asaj të burrit dhe gati sa nuk ka kurrfarë njohurie apo kuptimi të parimit të barazisë gjinore. Në zonat më urbane ka më shumë barazi gjinore, ndonëse një numër i konsiderueshëm i familjeve që jetojnë në zona urbane vazhdojnë t'i përmbahen vlerave dhe zakoneve tradicionale. Dallimi gjithashtu pasqyrohet në nivelin e arsimit: në zonat rurale, më tepër se dhjetë për qind e grave janë të pashkolluara, derisa niveli i shkollimit është shumë më i lartë në zonat urbane.

Pabarazia gjinore gjithashtu pasqyrohet në shkallën e punësimit. Papunësia është më e lartë në mesin e grave se të burrave dhe Institucioni i Ombudspersonit ka pranuar një numër ankesash ku gratë ankoreshin se janë larguar nga puna vetëm për shkak të gjinisë së tyre.

Kudo në Kosovë, fëmijët dhe gratë janë gjithashtu viktimat e para të dhunës familjare, një problem që shpesh nuk ngritet nga viktimat për frikë nga pasojat negative, në veçanti në zonat rurale. Dhuna familjare është një problem i përhapur gjërësisht, por i cili vetëm kohëve të fundit është sjell në vëmendje të publikut përmes fushatave mediale dhe aktiviteteve tjera të ngritjes së vetëdijes nga UNMIK-u dhe faktorët lokal.

Në shumë shtëpi rurale apo tradicionale, idea që gruaja të trashëgojë pronë gjithashtu nuk është në pajtim me vlerat tradicionale. Ombudspersoni ka pranuar mjaft ankesa nga raste të tilla dhe ka ndihmuar në zgjidhjen e disa prej tyre.

Një aspekt i veçantë i trajtimit inferior të grave ndërlidhet me besimin e fëmijëve apo qasjen tek ata pas shkurorëzimit apo vdekjes së babait të fëmijëve. Sipas traditës shqiptare të Kosovës, fëmijët e lindur në një familje janë pjesë e familjes së gjërë të babait, kështu që pas shkurorëzimit apo vdekjes së bashkëshortit, një grua mund të vazhdojë t'i shoh fëmijët e saj vetëm nëse vazhdon të jetojë në shtëpinë e familjes së burrit të saj. Një praktikë e tillë vazhdon shpesh edhe raste kur ka një aktgjykim të gjykatës që i jep nënës të drejtën në besim të plotë dhe në qajse të fëmijëve. Gjykatat, në veçanti në zonat më rurale, kanë vështirësi në ekzekutimin e aktgjyqimeve të tilla. Pas publikimit të një raporti nga Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit në dhjetor 2005 mbi

një rast të tillë, u arrit që përfundimisht të ekzekutohet një aktgjykim dhe tani e ëma ka qasje tek fëmijët e saj.

Ndonëse ka ndikim të më pak njerëz, diskriminimi kundër personave me aftësi të kufizuara është gjithashtu një çështje mjaft serioze në Kosovë. Shumë persona me aftësi të kufizuara nuk janë në gjendje t'i marrin disa beneficione të caktuara në të cilat kanë të drejtë sipas Ligjit të Kuvendit të Kosovës mbi Pensionet e Aftësisë së Kufizuar. Shembuj për këtë janë, mes tjerash, qasja e veçantë në ndërtesat publike, mjete më të mira të transportit, çmim të reduktuar të energjisë elektrike dhe shërbimeve tjera publike, përjashtime nga pagesa e disa taksave si dhe qasja më e mirë në ngjarjet kulturore, sportive dhe të tjera. Një çështje tjetër që është ngritur shpesh pranë Institucionit të Ombudspersonit kishte të bëjë me pamundësinë e personave me aftësi të kufizuara për të marrë leje të vozitjes, meqë nuk ka ndonjë ligj të veçantë apo vende të përshtatshme për ta testuar aftësinë e tyre të ngasjes.

Në Kosovë në përgjithësi, vëmendja e mediave dhe ajo publike si dhe dialogu kryesisht përqendrohen në format më të qarta apo të dukshme të diskriminimit siç janë ato në fushat e diskriminimit gjinorë dhe minoriteteve etnike. Por këto dhe problemet e personave me aftësi të kufizuara të përmendura më lartë nuk janë format e vetme të diskriminimit në shoqërinë Kosovare.

Siç ndodh shpesh në një mjedis të dalë nga konflikti, ku ka papunësi të lartë, korrupsion serioz, autoritete të dobëta të qeverisjes dhe të përforcimit të ligjit, ekziston një dallim i përgjithshëm në trajtimin e individëve nga autoritetet publike. Beneficionet dhe format tjera të ndihmave nuk shpërndahen në mënyrë të barabartë, ndërsa brenda zyreve dhe organeve administrative publike nuk ka procedurë të shkruar për të parandaluar sjelljen arbitrare apo diskriminuese. Në përgjithësi, ligji nuk zbatohet njëjtë për të gjithë njerëzit nga organet ekzekutive dhe gjyqësori. Përparësi u jepet individëve bazuar në gjendjen e tyre financiare, lidhjeve familjare apo opinionet politike. Kryeministri ka paralajmëruar një luftë kundër korrupsionit, shkakut kryesor për këtë sjellje diskriminuese, por deri më tani është arritur shumë pak në këtë drejtim.

Si në shumë fusha tjera të të drejtave të njeriut në Kosovë, problemet e vërteta qëndrojnë jo aq në ligje sa në zbatimin e tyre – apo thënë më mirë, mungesën nga kjo. Që nga viti 1999, parimi i mosdiskriminimit është përfshirë në shumë ligje në Kosovë, posaçërisht në Ligjin kundër diskriminimit të vitit 2004. Por pavarësisht nga dispozitat ligjore dhe përpjekjet e shumta të faktorëve ndërkombëtar dhe lokal për promovimin dhe zbatimin e tyre, banorët e Kosovës në përgjithësi dhe administrata publike në veçanti ende nuk e kanë kuptuar apo nuk janë të interesuar për të zbatuar parimin themelor të barazisë të të gjithë personave para ligjit. Më tepër duhet bërë për të promovuar edukimin dhe vetëdijen publike e këtij parimi themelor dhe mekanizmeve ligjore ekzistuese për mbrojtjen e tij. Ashtu siç është, mosdija e përgjithshme për të drejtat për trajtim të barabartë para ligjit shpie në një situatë ku si kryesi ashtu dhe viktima e diskriminimit mund të jenë mësuar me praktika të padrejta dhe paligjshme nga administrata publike aq sa t'i konsiderojnë këto praktika si normale apo të besojnë që asgjë nuk mund të bëhet për t'i ndryshuar ato.

Si autoritetet ashtu dhe njerëzit në Kosovë duhet të kuptojnë se parimi i mosdiskriminimit nuk është çështje politike apo sociale, por një e drejtë themelore e njeriut e mbrojtur me ligjet vendore dhe ndërkombëtare.

## **Të drejtat e njeriut dhe bisedimet mbi statusin**

Vite me radhë prej se UNMIK morri administrimin e Kosovës në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 të 10 Qershorit 1999, statusi i pazgjidhur i Kosovës ka krijuar vështirësi praktike për popullatën e Kosovës. Një numër vështirësish të tilla që janë hasur gjatë periudhës së fundit të raportimit janë ngritur në Raportet e kaluara Vjetor dhe kanë vazhduar të shkaktojnë telashe në këtë periudhë raportimi.

Në fazën e tanishme të bisedimeve për statusin në mes të IPVQ-ve, Qeverisë së Serbisë dhe komunitetit ndërkombëtar, politikanët, organizatat ndërkombëtare, OJQ-të dhe ekspertët vendor e ndërkombëtar, vazhdimisht kanë bërë dallimin në mes të aspekteve politike dhe atyre të politikave të këtyre bisedimeve. Çështjet të cilat ende duhet të zgjidhen janë të shumëfishta, shembuj janë mungesa e bashkëpunimit në ndjekjen e personave të cilët kanë kryer krime në Kosovë dhe supozohet se jetojnë në Serbi, çështja e kompenzimit të dëmeve të shkaktuara gjatë luftimeve në vitet 1998-99, privatizimi dhe trashëgimia kulturore.

Një nga çështjet më të mëdha dhe më emocionale të pazgjidhura në këtë kontekst është çështja e njerëzve të pagjetur, kryesisht shqiptarë, por gjithashtu edhe serbë dhe nga etnicitetet e tjera. Procesi i kthimit i të gjithë trupave të gjetur në Petrovo Selo, Batajnica dhe Bajna Bashta të Serbisë për në Kosovë tashmë ka përfunduar, dhe sipas informacioneve nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq të Majit 2006, janë gjetur 700 persona të zhdukur që nga fillimi i vitit 2005. Megjithatë, janë mbi 2200 persona ende të pagjetur. Është me rëndësi mjaft të madhe që të vazhdoen diskutimet në mes të IPVQ-ve, liderëve të Kosovës, Serbisë dhe komunitetit ndërkombëtar në drejtim të gjetjes së metodave të reja të bashkëpunimit në mënyrë që të sigurohen informata mbi këta njerëz të pagjetur.

Si një institucion i pavarur i cili merret me ankesat për të drejtat e njeriut, Institucioni i Ombudspersomit ka një perspektivë të vetme të çështjeve ligjore dhe pasojave të çështjeve të diskutuara gjatë bisedimeve lidhur me statusin dhe lidhur me atë se si ndikojnë këto në jetën e njerëzve. Gjatë kohës së periudhës së raportimit, Institucioni i Ombudspersonit ka pranuar një numër të madh ankesash në lidhje me çështjet e tilla.

Ekziston pothuajse një mungesë e plotë e bashkëpunimit në mes të autoriteteve në Serbi dhe UNMIK-ut apo IPVQ-ve. Kjo krijon pengesa të përditshme, siç është pamundësia e banorëve të Kosovës që të qasen në dokumentet nga kohërat e Jugosllavisë, të cilat mbahen ende nga autoritetet në Serbi. Personat e zhvendosur të përkatësisë serbe që jetojnë jashtë Kosovës gjithashtu kanë probleme t'i qasen dokumenteve pranë IPVQ-ve. Derisa juristët individual dhe organizatat si OJQ-ja spanjolle MPDL [(Movimiento por la Paz, el Desarme y la Libertad (Lëvizja për paqë, çarmatim dhe liri)] janë në gjendje të marrin dokumente të tilla përmes kanaleve dhe sistemeve të tyre, për individët është gati

e pamundur që të bëjnë të njejtën gjë. E njejtja gjë është e vërtetë për një numër të regjistrave kadastral prej para vitit 1999, të cilët gjithashtu janë arhivuar në Serbi.

Kjo mungesë e bashkëpunimit dhe komunikimit gjithashtu parandalon individët nga marrja e pensioneve të fituara gjatë kohës së Jugosllavisë, pasi që fondet e pensionve relevante administrohen në Beograd. Me probleme të ngjashme balafaqohen edhe personat të cilët dikur kanë pasur llogari të kursimeve në Jugobanka, bankën shtetërorë të Jugosllavisë së dikurshme. Kjo çështje është diskutuar në Raportin e kaluar vjetor, dhe akoma nuk është zgjidhur.

Marëdhëniet në mes gjykatave në Kosovë dhe gjykatave në Serbi, kanë ende nevojë për një përmirësim të madh sa i përket njohjes reciproke të legjitimitetit dhe këmbimit të informacioneve. Nëse një gjykatë civile në Kosovë dëshiron të dërgojë një dokument apo shkresë tek një palë e cila jeton në Serbi, kjo duhet të shkojë përmes Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut, i cili pastaj do të provojë t'i qaset gjykatën në Serbisë. Gjykatat e Serbisë duhet të ndjekin të njejtat procedura përmes UNMIK-ut për të siguruar dokumente nga gjykatat në Kosovë. Ky proces i bashkëpunimit nuk është vetëm i komplikuar, por ai rrallë është i sukseshëm.

Në mënyrë të ngjashme, edhe UNMIK-u edhe autoritetet në Serbi nuk e njohin legjitimitetin e njëri-tjetrit për të regjistruar automjetet e banorëve të Kosovës. Në vitet e hershme të administrimit të vet, UNMIK-u ka nxjerrë sistemin e vet të regjistrimit të automjeteve, i cili nuk i pranon më si të vlefshme tabelat e regjistrimit nga Kosova, të lëshuara nga rexhimi i dikurshëm Jugosllav. Në anën tjetër sistemi i UNMIK-ut nuk është pranuar nga autoritetet e Serbisë, të cilat vazhdojnë të regjistrojnë automjetet e blera në Serbi nga banorët e Kosovës, dhe u caktojnë atyre tabela të regjistrimit sipas sistemit të vjetër. Pronarët e automjeteve me automjete të regjistruara në Serbi pastaj ballafaqohen me vështirësi të shumta kur sjellin automjetet e tyre mbrapa në Kosovë. SHPK-ja shpesh konfiskon këto automjete dhe obligimet e tyre nën regjimin e taksës së akcizës janë të paqarta apo të keq-interpretuara nga zyrtarët e caktuar.

Përfundimisht, çështja e suksesionit duhet të zgjidhet një herë e përgjithmonë. Duhet të bëhet e qartë nëse IPVQ-të ekzistuese, kryesisht në nivelin komunal, mund të mbahen përgjegjëse për veprimet apo vendimet administrative të ndërmarrura nga komunat para vitit 1999. Kjo çështje tanimë është ngritur me UNMIK-un nga komunat e caktuara, deri tani me pak sukses.

Këto kundërthënie administrative dhe ligjore pasqyrojnë problemet praktike të udhëheqjes së administratës publike përmes një misioni të përkohshëm të KB-ve. Këto probleme praktike shpesh nuk merren parasysh gjatë diskutimeve politike në mes partnerëve bisedues, megjithëse kanë ndikim të rëndësishëm në situatën në terren, që në anën tjetër ndikon në rrjedhën e bisedimeve. Institucioni i Ombudspersonit shpreson se zgjidhja e pritur e statusit politik dhe ligjor të Kosovës, çfarëdo që të jetë ajo, gjithashtu do të lehtësojë e këtyre të pazgjidhura deri para kësaj kohe.



## **AKTIVITETET E INSTITUCIONIT TË OMBUDSPERSONIT**

Përveç aktiviteteve të rregullta të Institucionit, si Ombudspersoni i mëparshëm ashtu edhe Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit kanë kaluar një pjesë të konsiderueshme të kohës duke i drejtuar tranzicionet si rezultat i kosovarizimit të Institucionit. Derisa Ombudspersoni i mëparshëm i kaloi javët e fundit të mandatit të tij duke ua bërë vizitat e fundit kryesuesve të institucioneve ndërkombëtare dhe vendore, duke avokuar për përkrahjen e tyre për Institucionin pas largimit të tij, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit pati takime të shumta në gjysmën e parë të vitit 2006 me kryesuesit e organizatave ndërkombëtare dhe vendore për të krijuar marrëdhënie pozitive pune me ta.

Puna thelbësore e Institucionit mbasin hetimet dhe avokimi lidhur me çështjet e të drejtave të njeriut, siç është theksuar edhe në hyrjen e këtij Raporti. Megjithatë, Institucioni i Ombudspersonit angazhohet në një numër të aktiviteteve tjera, përfshirë këtu komentimin e aspekteve të të drejtave të njeriut në ligjet dhe politikat e qeverisë, aktivitetet lidhur me marrëdhënie me mediat dhe ngritjen e vetëdijes dhe bashkëpunimin me programet e bashkësisë ndërkombëtare dhe të autoriteteve vendore. Institucioni i Ombudspersonit është i angazhuar në mënyrë aktive me organizatat vendore, rajonale dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, për t'i informuar ato rreth situatës në Kosovë, për t'i identifikuar fushat e bashkëpunimit të mundshëm dhe për të shkëmbyer përvojat e dobishme. Kjo pjesë e Raportit paraqet një përshkrim të aktiviteteve të Institucionit të Ombudspersonit gjatë periudhës për të cilën raportohet, si dhe çështjet operative siç janë financimi dhe mësimi praktik.

### **Hetimet, avokimi dhe ndërmjetësimi**

Një nga funksionet kryesore të Ombudspersonit është avokimi në interes të banorëve të Kosovës. Kjo më së shumti bëhet përmes letrave të intervenimit drejtuar autoriteteve të ndryshme publike por gjithashtu përmes takimeve personale mes punonjësve të tyre dhe përfaqësuesve të Institucionit të Ombudspersonit. Në raste të veçanta, Ombudspersoni mund ta ngritë ndonjë çështje me mediat apo të tërheqë vëmendjen më të gjerë të publikut ndaj saj. Një detyrë tjetër kyçe e Ombudspersonit është ndërmjetësimi dhe ofrimi i shërbimeve të mira. Në fakt, shumica e rasteve pranë Institucionit të Ombudspersonit kanë ndonjë aspekt të ndërmjetësimit.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, një shembull i shërbimeve të ndërmjetësimit ndodhi në maj të vitit 2006, kur zëvendës Ombudspersoni dhe përfaqësues tjerë të Institucionit të Ombudspersonit u takuan me një grup të të burgosurve të një qendër të paraburgimit në pjesën veriore të Mitrovicës, që kishin hyrë në grevë urie për të protestuar kundër mënyrës se si sistemi gjyqësor i kishte trajtuar rastet e tyre. Përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit arritën ta ndërmjetësojnë ndërprerjen e grevës me kusht që do ta shqyrtonin këtë çështje me Departamentin e drejtësisë të UNMIK-ut dhe që të burgosurit do t'ia shkruanin një letër këtij Departamenti ku do të kërkonin pajtimin e tij që rastet e tyre të rishqyrtohen nga një gjykatës ndërkombëtar

brenda 15 ditëve. Departamenti i Drejtësisë pranë UNMIK-ut i kontaktoi të burgosurit në mes të qershorit dhe i informoi ata që kishte kërkuar nga Gjykata e qarkut në Prishtinë që dosjet e tyre t'ua përcjellë ndonjë gjykatësi ndërkombëtar në Kosovë. Në kohën kur ky Raport është publikuar, të burgosurit ende nuk kishin pranuar ndonjë lajmërim të mëtejshëm dhe ishin kthyer në grevën e tyre. Institucioni i Ombudspersonit vazhdon ta mbikëqyrë këtë situatë.

## Shqyrtimi i legjislacionit

Institucioni i Ombudspersoni gjithashtu ka mandatin zyrtar që të japë komente lidhur me ligjet në Kosovë<sup>1</sup> dhe mund të rekomandojë miratimin apo ndryshimin e ligjeve ose përmirësimin e zbatimit të ligjeve në fuqi. Nganjëherë Institucioni konsultohet nga Kuvendi i Kosovës në lidhje me planifikimin dhe përpilimin e ligjeve të ndryshme ose nga autoritetet tjera në lidhje me zbatimin e ligjeve. Në raste të tilla, Institucioni mund të japë komente mbi aspekte të ndryshme të drejtave të njeriut në këto ligje apo lidhur me atë se cili do të ishte roli më i përshtatshëm i Institucionit të Ombudspersonit në një ligj të veçantë ose zbatimin e tij. Ky mandat ligjor dhe aktivitetet shoqëruese në lidhje me të e pasqyrojnë vlerën e perspektivës së veçantë të Institucionit të Ombudspersoni mbi çështjet legjislative, duke marrë parasysh kontaktin e tij të afër dhe të shpeshtë me të gjitha komunitetet në Kosovë.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersoni dha komente lidhur me ligjet në vijim:

- Drafti i Udhëzimit Administrativ të IPVQ-ve për zbatimin e Ligjit kundër diskriminimit (të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/32), në mars të vitit 2006 dhe me ftesë të Zyrës së Kryeministrit (Udhëzimi administrativ më vonë u nënshkrua nga Kryeministri më 6 maj 2006)
- Projektligji i Kuvendit të Kosovës për shpifje dhe fyerje, në prill të vitit 2006 dhe me ftesë të Komisionit të Kuvendit të Kosovës për çështje juridike, legjislative dhe të kornizës kushtetuese.
- Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuar, në qershor të vitit 2006 dhe me iniciativë të Institucionit.
- Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 2004/32 për familjen (të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/7), në qershor të vitit 2006 dhe me iniciativë të Institucionit;
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/6 për Institucionin e avokatit të popullit në Kosovë, në shkurt të vitit 2006 dhe me iniciativë të Institucionit.

---

<sup>1</sup> Sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/38, Institucioni i Ombudspersonit ka mandat që të japë komente lidhur me Rregulloret e UNMIK-ut. Sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/06, Institucioni ka mandat të japë komente vetëm lidhur me ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës.

Përveç kësaj, Institucioni i Ombudspersonit u bëri thirrje autoriteteve vendore dhe ndërkombëtare për ta përpiluar dhe shpallur një ligj mbi nevojën për ta ofruar ndonjë mjet juridik në dispozicion për procedurat e stërzgjatura gjyqësore.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit ishte ftuar të marrë pjesë në takimet në vijim lidhur me legjislacionin e mundshëm:

- Grupin punues për Rregulloren e re të UNMIK-ut për Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë<sup>2</sup>, të kryesuar nga OSBE-ja. Anëtarët tjerë të Grupit përfshinin Kuvendin e Kosovës, Zyrën e Komisionarit të lartë të KB-ve për drejtat e njeriut dhe Zyrën e UNMIK-ut për kthime dhe komunitete.
- Tryezën e rrumbullakët rreth procedurës së emërimit të Ombudspersonit dhe zëvendësve të tij me Komisionin legjislativ të Kuvendit të Kosovës, me iniciativë të OSBE-së, ku morën pjesë përfaqësuesit e Këshillit të Evropës dhe Komisionarit të lartë të KB-ve për drejtat e njeriut.
- Grupin punues të Kuvendit për projektligjin për Institucionin e avokatit të popullit në Kosovë përmes Komisionit legjislativ të Kuvendit të Kosovës.

### **Aktivitetet e grupeve të posaçme të Institucionit të Ombudspersonit**

IOK gjithashtu ka grupe të posaçme të juristëve për të hetuar rastet dhe ngritur vetëdijen rreth çështjeve në disa fusha të caktuara të ndjeshme, posaçërisht rreth çështjeve që kanë të bëjnë me grupet më të cenueshme. Grupi për të drejtat e fëmijëve (GDF) përqendrohet në çështjet që kanë të bëjnë me shkollat, dhunën në familje, përkujdesjen dhe besimin e fëmijëve; Njësia për barazi gjinore (NjBGj) përqendrohet në çështjet që kanë të bëjnë me diskriminim në bazë të gjinisë dhe dhunën në familje. Grupi për mosdiskriminim (GMD) përqendrohet në fushat tjera të diskriminimit, në veçanti në diskriminimin në bazë të paaftësisë dhe përkatësisë etnike, fetare apo kombëtare.

Secili nga grupet e posaçme bashkëpunon me OJQ-të dhe organizatat tjera që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe barazisë gjinore. Tri organizata që kanë bashkëpunuar më ngushtë me këto grupe dhe kanë dhënë përkrahje dhe ndihmë shumë të çmuar janë Fondi i Kombeve të Bashkuara për fëmijët (UNICEF), Fondi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara për Gruan (UNIFEM) dhe Save the Children.

---

<sup>2</sup> UNMIK-u e ka ftuar Institucionin të marrë pjesë vetëm në fazën fillestare të punës së këtij Grupi, deri në shtator të vitit 2005, kur një draft i ishte dërguar Zyrës së këshilltarit ligjor të UNMIK-ut dhe IOK më nuk ishte i përfshirë zyrtarisht në këtë proces

## **Aktivitetet e Grupit për Mos-diskriminim**

GMD u themelua më 8 mars 2004 në mënyrë që ta përmirësojë punën e Institucionit të Ombudspersonit në fushën e diskriminimit. GMD zhvillon hetimet mbi të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë por duke mos qenë të kufizuara në diskriminimin në bazë të fesë, origjinës, mendimit politik, lidhjes me pakicat kombëtarë apo moshës.

Ligji kundër diskriminimit, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr 32/2004 më 29 gusht 2004, e autorizon Ombudspersonin që të pranojë dhe hetojë ankesat në lidhje me shkeljen e të drejtave në bazë të diskriminimit. Sipas nenit 4 të Ligjit kundër diskriminimit, Ombudspersoni gjithashtu mund të zhvillojë hetime mbi ankesat lidhur me diskriminimin në sektorin privat.

Hetimet e GMD përfshijnë ankesat e nxënëseve dhe mësimdhënëseve që donë të mbajnë vellon islamike në shkollat publike, moszbatimin e ligjit për pensionet e personave me aftësi të kufizuara, pamundësinë e personave me aftësi të kufizuara që të marrin leje të vizitjes, mungesën e fondeve për qendrat mjekësore shumëetnike, diskriminimin ndaj minoriteteve brenda Ministrisë për kthim dhe komunitete, mungesën e arsimit fillor për nxënësit boshnjak në gjuhën boshnjake, pamundësia për t'u përdorur gjuha boshnjake para gjykatës dhe konfiskimi i diskriminues i automjeteve me targa të Jugosllavisë. Raportet që janë duke u përgatitur nga GMD përfshijnë ankesën lidhur me diskriminimin që i kanë paraqitur punëtorët e dikurshëm të përkatësisë etnike shqiptare në Minierën e Trepçës në pjesën veriore të Mitrovicës dhe përdorimin e gjuhëve të pakicave në zyrat e administratës qendrore dhe lokale.

Një çështje tjetër që ka qenë nën mbikëqyrjen aktive të Ombudspersonit të mëparshëm dhe Ushtresit të detyrës së Ombudspersonit kanë qenë ankesat e punonjësve të dikurshëm të përkatësisë serbe të ndërmarrjeve shoqërore të cilët pohonin që kishin qenë të përjashtuar nga procesi i privatizimit. Në dy letra drejtuar PSSP-së, si Ombudspersoni i mëparshëm ashtu edhe Ushtresi i detyrës së Ombudspersonit rekomanduan që barra e dëshmisë në diskriminimet e tilla të bartet nga punonjësit e dikurshëm në punëdhënësin e dikurshëm, në pajtim me standardet evropiane.

Gjatë muajve të fundit të periudhës për të cilën raportohet, Grupi për mosdiskriminim ka përgatitur një fletushkë për ta ngritur vetëdijen rreth çështjeve të diskriminimit dhe mënyrat si Institucioni i Ombudspersonit mund t'u ndihmojë njerëzve që i janë nënshtruar diskriminimit. Fletushka do të shtypet në muajt që vijojnë.

Më 1 mars 2006, Koordinatorja e GMD-së i dha komentet një Grupi punues mbi draftin e Udhëzimit administrativ të IPVQ-ve për zbatimin e Ligjit kundër diskriminimit (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/32), me ftesë të Zyrës për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit (Udhëzimi administrativ më vonë u nënshkrua nga Kryeministri, më datën 6 qershor 2006). Ajo vërejtje që derisa do të ishte e udhës që Zyra për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të shpërndajë materialet informative mbi Institucionin e Ombudspersonit, këto materiale nuk do të duhej të përgatiten nga ana e

Zyrës për qeverisje të mirë, pasi që Institucioni i Ombudspersonit ishte institucion i pavarur.

### **Aktivitetet e Njesisë për barazi gjinore**

E themeluar më 2 korrik 2004, Njësia për barazi gjinore (NjBGj) përqendrohet në rastet e diskriminimit në bazë të gjinisë dhe angazhohet në ndikimin e proceseve dhe politikave që promovojnë analizat, parandalimin dhe monitorimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut në bazë të gjinisë. Është entiteti i vetëm në Kosovë me mandat për të pranuar dhe hetuar diskriminimin në bazë të gjinisë sipas Nenit 6 të Ligjit për barazi gjinore, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/18, të datës 7 qershor 2004. Sipas nenit 6, çështjet e diskriminimit që lidhen drejtpërdrejt për gjininë “trajtohen nga ana e njesisë për barazi gjinore brenda Institucionit të Ombudspersonit [...] e cila po ashtu ka përgjegjësi të rishikojë projektligjet, të japë komente lidhur me zbatimin e këtij ligji dhe me legjislacionin ekzistues kur ka të bëjë me çështjet gjinore”

NjBGj përbëhet nga një jurist i specializuar, përkrahur nga Zëvendës drejtori i hetimeve të Institucionit. Prej 1 shkurtit 2005, kjo njësi është përkrahur përmes donacioneve zemërgjera nga qeveria e Norvegjisë. Çështjet që i kanë paraqitur ankuesit përfshijnë: dhunën në familje, diskriminimin në bazë të gjinisë gjatë punësimit në sektorin publik, përkrahja financiare dhe materiale për nënat vetushqyese, diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe e drejta e çifteve të martuara për t'u bërë banorë të përhershëm të Kosovës. NjBGj ka mbajtur takime të rregullta me faktorë të shumtë ndërkombëtarë dhe vendorë për të biseduar rreth temave në interes të përbashkët, duke përfshirë takimet me Zyrën e UNMIK-ut për çështje gjinore, Zyrën për barazi gjinore pranë Zyrës së Kryeministrit, përfaqësuesit e ministrive të jashtme të Norvegjisë, Holandës dhe Anglisë, Zyrës së UNMIK-ut për çështje politike dhe të dërguarin e posaçëm të KB-ve për negociatat rreth statusit.

Në janar dhe shkurt, një përfaqësuese e NjBGJ punoi bashkë me përfaqësuesit e Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe dy zyra nga Zyra e Kryeministrit (Zyra për barazi gjinore dhe Zyra për qeverisje të mirë) për ta përgatitur një plan veprimi për ta përmirësuar mbrojtjen e të drejtave të gruas në Kosovë. Ky plan veprimi kërkon angazhimin e institucioneve të lartpërmendura për ta përfshirë mbrojtjen e të drejtave të gruas në planet e tyre vjetore të punës, organizimin dhe zhvillimin e trajnimeve për të drejtat e gruas përmes Institutit Kosovar për Administratë Publike (IKAP), si dhe publikimin e një libri dore për standardet ndërkombëtare për të drejtat e gruas. Përgatitja e një plani të veprimit ishte parakusht për pjesëmarrje në seminarin për të drejtat e gruas në Institutin Raoul Wallenberg (RWI) për të Drejtat e Njeriut dhe të Drejtën Humanitare në Suedi.

Prej 20 shkurtit deri më 17 mars, një përfaqësuese e NjBGj morri pjesë në një program rajonal për të drejtat e gruas në RWI, ku ajo e prezantoi planin e lartpërmendur të veprimit. Ajo iu bashkua 24 aktivistëve tjerë dhe përfaqësuesve zyrtarë të qeverive të jashtme, si dhe OJQ-ve për të drejtat e njeriut nga Evropa qendrore dhe Azia qendrore, në një seri të ligjërimeve, vizitave të studimit dhe debateve mbi rolin e ligjeve dhe institucioneve kyçe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në mbrojtjen e të drejtave të gruas. Prezantimet u dhanë nga ekspertë të programit të RWI-së, Gjykatës Evropiane për

të Drejtat e Njeriut, SIDA (Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar), UNHCR, Amnesty International, si dhe nga disa universitete suedeze dhe organizata tjera për të drejtat e njeriut. Në fund të programit, secili nga 24 pjesëmarrësit prezantoi një plan të veprimit për shtetin e tij apo saj. Zbatimi i këtyre planeve do të diskutohet gjatë ngjarjes së radhës në Kiev të Ukrainës më 21 – 25 gusht 2006. Përfaqësuesja e IOK-së pati mundësinë të marrë pjesë falë përkrahjes zemërgjerë të UNMIFEM-it.

### **Aktivitetet e grupit për të drejtat e fëmijëve (GDF)**

I themeluar më 8 mars 2004, GDF ndjek një qasje të gjerë ndaj të drejtave të fëmijëve në Kosovë. Ai heton ankesat individuale të fëmijëve apo atyre që përfaqësojnë fëmijët, vlerën aspektet e përgjithshme të të drejtave të fëmijëve, kryen aktivitete të ngritjes së vetëdijes në këtë drejtim dhe merr pjesë në seminarët dhe takimet me avokatët tjerë për të drejtat e fëmijëve.

Gjatë kësaj periudhe, GDF zhvilloi hetimet në lidhje me çështje të ndryshme rreth fëmijëve, duke përfshirë raste lidhur me besimin e fëmijëve, qasjen në arsim dhe keqtrajtimin në familje dhe shkolla, si dhe rastet që kishin të bëjnë me kushtet e mjera shëndetësore dhe jetësore. GDF gjithashtu ka qenë i përfshirë në rastet që kishin të bëjnë me mungesën e ujit të pijshëm në shkollat e Kosovës, nevojën për më shumë përkujdesje psikiatrike për fëmijët dhe të ashtuquajturat “Pika të zeza” në trafik, ku fëmijët duhet të kalojnë nëpër zona jashtëzakonisht të rrezikshme të trafikut. GDF u ndihmoi fëmijëve të refugjatëve romë në IRJ të Maqedonisë që të marrin dokumentet e tyre nga shkollat në mënyrë që ta vazhdojnë shkollimin në IRJ të Maqedonisë. GDF gjithashtu nxjerri një raport mbi të drejtë për jetë familjare të një nëne të cilës i ishte mohuar qasja ndaj fëmijës së saj.

Prej themelimit të tij, GDF ka marrë pjesë në Forumin për të drejtat e fëmijëve, të organizuar nga UNICEF-i dhe OJQ-ja Save the Children, ku përfaqësuesit e institucioneve publike dhe shoqërisë civile i shqyrtojnë të drejtat e fëmijëve. Pjesëmarrësit tjerë të rregullt përfshijnë Care International, Catholic Relief Services, World Vision, Handikos-in, Ministrinë e punës dhe mirëqenies sociale, Ministrinë e arsimit, shkencës dhe teknologjisë dhe Zyrat për qeverisje të mire dhe për të drejtat e njeriut pranë Zyrës së Kryeministrit. GDF gjithashtu e ndihmoi trajnimin për të drejtat e fëmijëve të Save the Children për koordinatorët e ri për të drejtat e fëmijëve pranë administratave komunale të IPVQ-ve.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, GDF morri pjesë në trajnime dhe seminare të shumta, siç është sqaruar më lart.

Për ta ngritur vetëdijen rreth GDF-së dhe çështjeve lidhur me fëmijët, GDF e ka bërë praktikë që të shpërndajë pllakate, fletushka dhe materiale tjera promovimi nëpër takime dhe seminare të ndryshme ku merr pjesë, siç janë takimet me Departamentin për mirëqenie sociale pranë Ministrisë së punës dhe mirëqenies sociale në janar të vitit 2006, Zyrës për të drejtat e njeriut pranë Ministrisë së arsimit, shkencës dhe teknologjisë (MASHT) dhe Qendrën për arsim të Kosovës (QAK). QAK u pajtua që t'i shpërndajë ato

në njërin nga trajnimet e saj për trajnues dhe mësimdhënës, kurse MASHT u pajtua që ato t'ua shpërndajë Drejtorive komunale për arsim dhe shkollave nëpër tërë Kosovën.

Prej marsit të vitit 2006, aktivitetet e GDF-së do të reklamohen dhjetë herë deri në fund të vitit në gazetat e përditshme *Koha ditore*, në gjuhën shqipe, *Yeni Donem* në gjuhën turke dhe *Jedinstvo* në gjuhën serbe.

Përveç kësaj, GDF është e angazhuar në fushatat e posaçme të ngritjes së vetëdijes për grupin dhe aktivitetet e tij. Në prill të vitit 2006, GDF nisi një fushatë për të vizituar shkolla, shpërndarë fletushka dhe për t'ua përshkruar nxënësve të drejtat e tyre dhe mekanizmat ligjor në dispozicion të tyre. Si pjesë e kësaj fushate, GDF pati prezantimet përkatëse në Prishtinë, Podujevë, Gjilan, Skenderaj, fshatin Radivojc të komunës së Vitisë, fshatin Barilevë të komunës së Prishtinës, fshatin Llaushë të komunës së Skenderajit dhe fshatin Sushicë afër Graçanicës.

Më 29 shtator 2005, GDF nisi "Fushatën e vetëdijesimit për të drejtat e fëmijëve" nëpër tërë Kosovën, për t'u përshtatur me fillimin e vitit shkollor 2005/2006. Si pjesë e kësaj fushate, GDF organizoi garat në vizatim në shkolla të zgjedhura të Kosovës. Kjo garë, qëllimi i të cilës ishte që ta promovojë GDF-në dhe t'i identifikojë çështjet e fëmijëve nëpër shkollat e Kosovës, titullohej "Çfarë problemesh keni ju dhe si mund të ju ndihmojë Ombudspersoni?". Në fillim të secilit prezantim, GDF ligjëroi rreth të drejtave të fëmijëve dhe punës së GDF-së dhe shpërndau pllakatet dhe fletushkat e saj. Pastaj, kërkoi nga fëmijët që t'i sqarojnë problemet me të cilat përballen ata në jetën e tyre të përditshme dhe që këto probleme t'i paraqesin në mënyrë artistike ashtu që Institucioni i Ombudspersonit t'u ndihmojë për t'i zgjidhur ato. Në këtë garë morën pjesë shkollat e Prishtinës, Pejës, Vushtrisë, Prizrenit, Plemetinit dhe Graçanicës.

Në dhjetor të vitit 2005, përfundoi rrethi i parë i garës. Komisioni i përbërë nga tre përfaqësues të Institucionit të Ombudspersonit i zgjodhi vizatimet më të mira që UNICEF-i do t'i publikonte në formë të kartolinave që promovojnë të drejtat e fëmijëve dhe punën e Institucionit të Ombudspersonit. Fituesit do të shpallen kur të publikohen kartolinat dhe shkollës së secilit nga fituesit do t'i dhurohen libra dhe tekste tjera mësimore. Prej janarit të vitit 2006, GDF është konsultuar me UNICEF-in për përgatitjen dhe publikimin e këtyre kartolinave për ta ngritur vetëdijen e publikut rreth aktiviteteve të GDF-së.

Një ngjarje e veçantë e GDF-së ishte pjesëmarrja e një nga përfaqësuesve të tij në një debat televiziv në TV stacionin *Kohavision* (KTV) lidhur me temën e të drejtave të fëmijëve në Kosovë, me përqendrim në fëmijët e rrugës. Përfaqësuesja e GDF-së theksoi që ekzistonte nevoja urgjente për një plan strategjik për të drejtat e fëmijëve në Kosovë ashtu që autoritetet ta kenë një kuptim më të qartë të përgjegjësive të tyre. Përfaqësuesja gjithashtu e theksoi mungesën e fondeve të dedikuara për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

## **Bashkëpunimi me bashkësinë ndërkombëtare**

Bashkëpunimi me zyra të ndryshme të UNMIK-ut, në veçanti me PSSP-në dhe zëvendësit e tij, ka vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet mirëpo është reduktuar në masë më madhe pas shkurtit të vitit 2006 për shkak të ndryshimit të mandatit që e sjelli Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/6. Institucioni i Ombudspersonit vazhdon të mbajë kontakte të afërta me OSBE-në, OHCHR dhe Zyrën e UNMIK-ut për komunitete, refugjatë dhe çështje të minoriteteve.

Një pjesë e madhe e përkrahjes së OSBE-së për Institucionin e Ombudspersonit përbëhet nga sigurimi i këshilltarëve special në fushën e ligjit, administrimit dhe mediave prej janarit të vitit 2006. Më parë, këshilltarët ndërkombëtare ishin të punësuar drejtpërdrejt nga ana e Institucionit përmes fondeve që i kishte siguruar OSBE-ja.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, në mesin e IPVQ-ve janë themeluar dy institucione të reja të rëndësishme (Ministria e drejtësisë dhe Ministria e punëve të brendshme), të cilave UNMIK-u do të vazhdojë t'ua bartë përgjegjësitë për detyra të rëndësishme që më parë kishin qenë nën pushtetin e tij të rezervuar. Shtylla për administratën civile dhe Shtylla për polici dhe drejtësi pranë UNMIK-ut u shpërbënë dhe detyrat e mbetura në këtë fushë tani janë nën përgjegjësitë e drejtpërdrejta të PSSP-së.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit ka qenë në kontakt të shpeshtë me Komisararin e Policisë së UNMIK-ut dhe Drejtorin ekzekutiv të Drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore (DÇPB), pasi që një numër i madh i rasteve të hapura pranë Institucionit kanë të bëjnë me çështjet nën juridiksionin e tyre përkatës. Komisari i Policisë së UNMIK-ut e kishte caktuar një zyrtar policor që të merret me kërkesat dhe intervenimet e Ombudspersonit dhe bashkëpunimi ishte fillimisht shumë i mirë, mirëpo kohëve të fundit, punonjësit e Institucionit të Ombudspersonit e kanë gjetur shumë të vështirë ta kontaktojnë këtë pikë kryesore brenda Policisë së UNMIK-ut. Në ndërkohë, shumë kompetenca janë bartur te Shërbimi policor i Kosovës. Me DÇPB-në, bashkëpunimi ka qenë tradicionalisht shumë i mirë, edhe pse muajve të fundit është bërë vështirë të caktohet takimet me punonjësit e DÇPB-së për shkak të mungesës së qartë të kohës së tyre për këtë qëllim. DÇPB e mbylli zyrtarisht punën e saj më 30 qershor 2006, duke e bartur përgjegjësinë për raste të reja te Agjencia kosovare e pronës (AKP). Në qershor të vitit 2006, Institucioni filloi të shqyrtojë me DÇPB-në procedurat për punën e ardhme me rastet.

Institucioni i Ombudspersonit gjithashtu vazhdoi bashkëpunimin me Koordinatorin e standardeve të UNMIK-ut, kryesisht duke i tërhequr vëmendjen ndaj intervenimeve, raporteve apo letrave të rëndësishme që i janë drejtuar UNMIK-ut dhe IPVQ-ve. Edhe pse Institucioni i Ombudspersonit nuk ka juridiksion mbi KFOR-in, ai mbajti disa takime me KFOR-in për t'i diskutuar mënyrat e bashkëpunimit në zgjidhjen e ankesave që kishin të bëjnë me KFOR-in.



Sikur edhe në periudhat tjera për të cilat është raportuar, Institucioni i Ombudspersonit mbajti kontakte të rregullta me misionet diplomatike të shteteve të ndryshme në Prishtinë dhe Beograd. Ombudspersoni i mëparshme dhe Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit patën konsultime të rregullta të ndërsjella me organe të shumta të Këshillit të Evropës, sekretariatit të tij dhe zyrës së tij në Prishtinë. Në dhjetor të vitit 2005, Ombudspersoni i mëparshëm mbajti një fjalim para Asamblesë parlamentare të Këshillit të Evropës, në të cilin ai i përmbledhi pesë vitet e punës së tij si Ombudsperson dhe bëri një vlerësim të situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë dhe procesit të kosovarizimit të Institucionit.

Institucioni i Ombudspersonit vazhdoi të bashkëpunojë dhe komunikojë me organizata dhe OJQ tjera ndërkombëtare që janë të angazhuara apo monitorojnë zhvillimet në Kosovë, në veçanti me:

- Qendrën për mbrojtjen e gruas dhe fëmijëve
- Këshillin e Evropës (Zyra në Prishtinë dhe Asambleja Parlamentare në Strasburg)
- Misionin monitorues të KE-së
- HANDIKOS
- Human Rights Watch
- Qendrën për të drejtën humanitare në Beograd dhe zyrën e saj në Prishtinë
- Zyrën e ICRC-së në Prishtinë
- OJQ-në spanjolle “Lëvizja për paqe, liri dhe çarmatim”
- Save the Children
- Komitetin suedez të Helsinkit për të drejtat e njeriut, në Stokholm dhe zyrën e tij në Beograd
- UNHCR
- UNICEF
- UNIFEM

### **Bashkëpunimi me autoritetet tjera**

Institucioni i Ombudspersonit vazhdoi të mbajë kontaktin me Kryesuesin e Qendrës koordinues për Kosovë dhe Metohi, të qeverisë së Serbisë. Ombudspersoni i mëparshëm gjithashtu vazhdoi bashkëpunimin e tij të frytshëm me Zyrat e Komisionarit të lartë për të drejtat e njeriut në Beograd dhe Prishtinë, që kishte filluar në periudhat e kaluara për të cilat është raportuar. Përveç kësaj, në fund të mandatit të tij, ai u takua me Kryetarin, Kryeministrin dhe Ministrin e jashtëm të Serbisë, si dhe me Zëvendës Ombudspersonin e Malit të Zi dhe Ushtruesin e detyrës së drejtorit të Fondit të Beogradit për politikë të shkëlqyer (një pjesë e Rrjetit për programe të demokracisë të Këshillit të Evropës).

### **Bashkëpunimi me autoritetet vendore**

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Ombudspersoni i mëparshëm dhe Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit patën takime me përfaqësuesit e IPVQ-ve në nivel qendror, duke përfshirë Kryetarin e Kosovës, Kryeministrin e Kosovës, Kryetarin e Kuvendit të

Kosovës dhe udhëheqësit e partive kryesore opozitare në Kuvend, për të diskutuar çështje të ndryshme të të drejtave të njeriut dhe të ardhmen e Institucionit të Ombudspersonit.

Ombudspersoni i mëparshëm dhe Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit rregullisht i dërguan letra intervenimi Ministrive të IPVQ-ve, duke ua tërhequr vëmendjen drejt çështjeve të ndryshme të të drejtave të njeriut lidhur me punën e ministrive të tyre. Fatkeqësisht, të gjithë ministrat nuk u përgjigjën në këto intervenime kurse në disa raste ata ishin të gatshëm të japin informata por jo edhe të ndërmarrin veprime konkrete. Autoritetet komunale të Kosovës reagueshan edhe më pak ndaj përpjekjeve të Institucionit të Ombudspersonit për të avokuar ose ndërmjetësuar në lidhje me ankesa të ndryshme nga individët nën juridiksionin e tyre. Përjashtimi më i theksuar nga kjo rregull është padyshim rasti i Komunës së Fushë Kosovës, e cila gjithmonë u përgjigj me kohë në kërkesat dhe rekomandimet e Ombudspersonit. Kurse në rastin e kundërt, Komuna e Prishtinës nuk është përgjigjur në asnjë letër që i ka pranuar nga Institucioni i Ombudspersonit prej marsit të vitit 2004 deri në qershor të vitit 2006.

### **Mësimi praktik**

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit siguroi mësimin njëmuji praktik për 30 studentë nga Fakultetet e drejtësisë dhe Fakulteti i shkencave politike të Universitetit të Prishtinës. Me mësim praktik në Institucionin e Ombudspersonit ishin shpërblyer dy fituesit e Kosova Case Challenge 2006, një simulim i gjyqimit gjatë të cilit nga pjesëmarrësit kërkohet që ta simulojnë procedurën pranë Gjykatës ndërkombëtare të drejtësisë. Gjithashtu, u siguruan dy mësim praktikë pesë-javore për studentët e Programit të studimeve rajonale të magistraturës në Demokraci dhe të drejtat e njeriut në Evropën juglindore, një program i përbashkët i Universitetit të Sarajevës dhe Universitetit të Bolonjës që është financuar nga BE dhe Ministria e Jashtme e Italisë. Një nga mësimet praktikë u mbajt në vjeshtë të vitit 2005 kur tjetri filloi në mes të qershorit të vitit 2006.

### **Vetëdijësimi dhe marrëdhëniet me media**

Institucioni i Ombudspersonit vazhdon ta publikojë Informatorin periodik, në të cilin përfshihen aktivitetet kryesore të Institucionit çdo tre muaj. I publikuar në gjuhën angleze, shqipe, serbe dhe turke, ky Informator periodik shpërndahet në masë të madhe në Kosovë dhe jashtë saj, me 1500 kopje të shtypura vetëm në gjuhën angleze dhe 1500 tjera në gjuhën shqipe, serbe dhe turke.

Raporti vjetor për vitin 2004-2005 u ishte shpërndarë zyrtarëve të lartë të UNMIK-ut dhe IPVQ-ve, duke përfshirë PSSP-në, Kryetarin e Kosovës, kryesuesit e partive kryesore politike, si dhe Sekretarëve të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Evropës.

Përveç kësaj, Institucioni publikoi disa fletushka gjatë periudhës për të cilën raportohet: një mbi programin e tij për të drejta e fëmijëve dhe një tjetër për historinë dhe punën e

Institucionit për Grupin punues të Kuvendit të Kosovës për Ligjin e ri mbi Institucionin e Ombudspersonit/Avokatit të popullit në Kosovë. Gjithashtu, u rishikua dhe u rishtyp një fletushkë e botuar më herët mbi barazinë gjinore. Në fund, është përpiluar edhe një formular i ri i ankesës që përmban edhe informata për Institucionin, që pritet të përpunohen dhe shtypen në muajt që vijojnë.

Institucioni i Ombudspersonit ka ruajtur marrëdhëniet e mira me mediat vendore dhe ndërkombëtare dhe në shtyp i ka ngritur disa herë çështjet në interes të përgjithshëm. Në veçanti, komentet e Institucionit lidhur me procesin e kosovarizimit dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr 2006/6 kanë pasur mbulesë të gjerë nga mediat.

Në shtator të vitit 2004, Ombudspersoni filloi publikimin e rubrikës me emrin “Në besim” në gazetën e përditshme në gjuhën shqipe “*Koha Ditore*”, si dhe në gazetën e përditshme në gjuhën serbe “*Danas*” (rubrika mund të gjendet në <http://www.nowicki-off-the-record.net/archives.html>). Këto shkrime u paraqitën çdo të premte të dytë dhe mbulonin probleme të ndryshme të të drejtave të njeriut në Kosovë. Temat e kësaj rubrike të publikuar gjatë gjysmës së parë të periudhës për të cilën raportohet përfshinin ndihmat sociale, perspektivat e të drejtave të njeriut të intervenimeve ndërkombëtare, problemin e kthimeve të qëndrueshme, Ditët e hapura të Institucionit, problemet e PZhBV-ve romë në Kosovën veriore dhe procesin e kosovarizimit. Prej fillimit, kjo rubrikë u paraqit rregullisht edhe në gjuhën angleze dhe frënge në shumë shërbime të lajmeve në internet lidhur me çështjet e Ballkanit, siç janë *Transitions online* dhe *Le Courier des Balkans*.

Prej 15 qershorit deri më 31 dhjetor 2005, në ato të premte kur nuk publikohej rubrika “Në besim”, Ombudspersoni i mëparshëm publikonte në “Kohën ditore” përmbledhje të hollësishme të rasteve të përzgjedhura pranë Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut që mund të ishin të rëndësishme për Kosovën. Këto përmbledhje ishin të shoqëruara me një analizë të shkurtër nga një nga këshilltarët ndërkombëtarë të Institucionit, përmes të cilës tema e lëndës lidhej me situatën në Kosovë.

Në prill të vitit 2006, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit e vazhdoi praktikën e Ombudspersonit të mëparshëm që të publikojë opinionet në “Kohën ditore” përmes rubrikës që u titullua “Mes tjerash”. Në këtë rubrikë u shqyrtuan çështjet siç janë mungesa e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, korrupsioni dhe vendosja e sundimit të ligjit derisa statusi politik i Kosovës mbetet i pa definuar.

Grupet e posaçme hetuese të Institucionit të Ombudspersonit gjithashtu angazhohen në publikimin e punës së tyre, përfshirë këtu edhe publikimin përmes mediave. Këto aktivitete janë përshkruar më poshtë, në pjesët rreth aktiviteteve të përgjithshme të secilit grup.

## **Bashkëpunimi me Ombuds institucionet dhe organet tjera të ngjashme të ankimit**

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit ka vazhduar bashkëpunimin e tij të afërt me institucionet e ngjashme në shtetet tjera në rastet kur zgjidhja e ankesës së ndonjë personi nga Kosova e kërkuar angazhimin e tyre. Në raste

të tilla u bashkëpunua, për shembull, me Ombudsmanët e Malit të Zi, Shqipërisë, IRJ të Maqedonisë, Kroacisë, Sllovenisë, Spanjës, Zvicrës, Norvegjisë dhe Finlandës, si dhe me Komisionet për Ankesa të Bundestagut të Gjermanisë. Këto raste të shumtën kishin të bëjnë me ankesat e të kthyerve me forcë, përfitimet nga pensionet dhe sjelljen apo veprimet e trupave kombëtare të vendosura në Kosovë në kuadër të KFOR-it.

Në tetor të vitit 2005, një delegacion i Institucionit të Ombudspersonit e vizitoi Zyrën e Ombudsmanit në Shkup të Maqedonisë, për të shkëmbyer përvojat e dobishme, posaçërisht në fushën e teknologjisë informative dhe të komunikimit. Kjo vizitë u financua përmes përkrahjes zemërgjerë të SIDA-së.

Në prill të vitit 2006, një delegacion i Institucionit të Ombudspersonit e vizitoi Zyrën e Avokatit të popullit në Shqipëri, për të shkëmbyer përvojat e dobishme në sektorët ligjor dhe administrativ. Kjo vizitë u financua përmes përkrahjes zemërgjerë të qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Në prill të vitit 2006, Grupi për të drejtat e fëmijëve e vizitoi Ombudsmanin për fëmijë në Oslo të Norvegjisë, për të shkëmbyer përvojat e dobishme në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe çështjeve tjera në lidhje me rininë. Kjo vizitë u financua përmes përkrahjes zemërgjerë të qeverisë Norvegjisë.

Përveç kësaj, Institucioni i Ombudspersonit priti vizitat nga Ombuds institucionet tjera, përfshirë këtu vizitën e Zëvendës Ombudsmanit të Malit të Zi në dhjetor të vitit 2005 dhe Ombudsmanit të Asociacionit të komunave të Valdinievollës (në Toskanë të Italisë) në qershor të vitit 2006. Gjatë këtyre vizitave, u shkëmbyen praktikat përvojat e dobishme në fushën e menaxhimit të zyrës dhe hetimeve. Vizita e Ombudsmanit italian u financua përmes përkrahjes zemërgjerë të qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Gjatë gjysmës së parë të periudhës për të cilën raportohet, Ombudspersoni ndërkombëtar mbajti kontaktin me “Zyrën e popullit” në Beograd që gjendet në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Serbisë. Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Institucioni ia dërgoi “Zyrës së popullit” disa raste që kishin të bëjnë me problemet lidhur me administratën publike në Serbi.

Për më tepër, Institucioni i Ombudspersonit ua shpërndau Informatorin periodik të gjitha Ombuds institucioneve në Evropë për t’i informuar rreth aktiviteteve të kohës së fundit dhe për t’i ndarë përvojat e tij në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

### **Konferencat dhe trajnimet e punonjësve**

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, punonjësit e Institucionit të Ombudspersonit morën pjesë në një numër të madh të vizitave të studimit, konferencave, trajnimeve dhe seminareve me qëllim që punonjësve të Institucionit t’u prezantohen praktikat më të mira të Ombuds institucioneve dhe organizatave tjera për të drejtat e njeriut në shtetet fqinje apo në vendet tjera të Evropës.

## **Iniciativa e Gruas Kosovare**

Më 11 qershor 2005, një përfaqësuese e NjBGj morri pjesë në një tryezë të rrumbullakët të organizuar nga Iniciativa e Gruas Kosovare lidhur me temën e “dhunës seksuale të bazuar në gjini”. Tryeza e rrumbullakët, që u mbajt në Prishtinë, filloi një seri të takimeve që u mbajtën nëpër tërë Kosovën nga ana e Inicativës së Gruas Kosovare, në të cilat përfaqësuesit e organizatave të ndryshme për të drejtat e gruas dhe institucioneve të qeverisë i paraqitën pikëpamjet e tyre lidhur me këto çështje. Përfaqësuesja e NjBGj bëri një prezantim të aktiviteteve të NjBGj-së dhe mënyrat për t’u qasur shërbimeve të saj.

## **Fondacioni i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut**

Dy juristë, në shtator të vitit 2005, dhe një jurist tjetër, në qershor të vitit 2006, morën pjesë në shkollën verore njëjavore për të drejtat e njeriut, të organizuar nga Fondacioni i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Varshavë të Polonisë. Në këtë shkollë verore morën pjesë juristët dhe aktivistët për të drejtat e njeriut nga shtete të Evropës qendrore dhe Azisë qendrore.

## **Konferenca e Rrjetit të Ombudsmanëve Evropian për Fëmijë**

Më 21 – 23 qershor 2005, dy juristë të GDF-së morën pjesë në Konferencën e Rrjetit të Ombudsmanëve Evropian për Fëmijë për vitin 2005, që u mbajt në Varshavë të Polonisë.

## **Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave (ECMI)**

Më 25 – 27 shtator 2005, dy juristë të Institucionit morën pjesë në seminarin “Institucionet e Ombudsmanëve drejt parandalimit të konflikteve ndëretnike dhe lufta kundër diskriminimit”, që u mbajt në Sofje të Bullgarisë.

## **Konferenca e Ombudsmanëve për të Drejtat e Fëmijëve ne Evropën juglindore**

Më 11 – 12 tetor 2005, një juriste e Institucionit morri pjesë në Konferencën e Ombudsmanëve për të Drejtat e Fëmijëve ne Evropën juglindore, që u organizua nga Programi EUNOMIA i Ombudsmanit të Greqisë, që vepron në kuadër të Komisionarit të lartë për të drejtat e njeriut të Këshillit të Evropës dhe ofron përkrahje për Ombuds institucionet e Evropës juglindore. Në ditën e dytë, Koordinatorja e GDF-së e kryesoi një seancë të konferencës të titulluar “Dëgjimi i zërave të fëmijëve në shkolla dhe institucione: përvojat dhe praktikat më të mira”.

## **Ombudsmani i Krahinës autonome të Vojvodinës**

Më 19 – 21 tetor 2005, Zëvendës Ombudspersoni dhe një jurist i Institucionit morën pjesë në një konferencë ndërkombëtare mbi Rolin e Institucionit të Ombudspersonit në shoqëritë shumetnike, të organizuar dhe financuar nga Qendra evropiane për çështje të pakicave, që u mbajt në Novi Sad të Vojvodinës (Serbi).

## **Trajnimet për menaxhmentin**

Më 1 – 2 dhjetor, punonjësit më të lartë drejtues të zyrës qendrore dhe atyre rajonale të IOK-së morën pjesë në trajnimin mbi “Udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e një ekipi”. Trajnimin e financoi dhe organizoi Institucioni i Ombudspersonit.

Më 27 – 28 mars 2006, punonjësit më të lartë drejtues dhe të administratës të zyrës qendrore dhe atyre rajonale të IOK-së morën pjesë në trajnimin mbi “Delegimin” dhe “Menaxhimin e projekteve”. Këto trajnime i kishte organizuar Institucioni i Ombudspersonit dhe ishin financuar përmes një donacioni të SHBA-ve.

## **SIDA**

Më 8 – 10 dhjetor 2005, juristët e Institucionit morën pjesë në trajnimin për keqtrajtimin dhe procesin e rregullt gjyqësor sipas Konventës evropiane për të drejtat e njeriut.

Më 10 – 11 mars 2006, juristët e Institucionit morën pjesë në trajnimin për respektimin e jetës private dhe familjare, të mbrojtur me nenin 8 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut.

Më 2 – 3 qershor 2006, juristët e Institucionit morën pjesë në trajnimin për parimet e mosdiskriminimit dhe të drejtave të pakicave.

## **Konferenca për të drejtat e fëmijëve në Tiranë, Shqipëri**

Më 15 dhjetor 2005, një juriste të GDF-së morri pjesë në konferencën kombëtare “Të gjithë së bashku për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” në Tiranë të Shqipërisë dhe u organizua nga Zyra e Avokatit të Popullit të Shqipërisë.

## **Instituti Raoul Wallenberg, Lund, Suedi**

Më 20 shkurt – 11 mars 2006, një përfaqësuese e NjBGj-së morri pjesë në një program rajonal për statusin e barabartë dhe të drejtat e gruas, të organizuar nga Instituti Raoul Wallenberg i të Drejtave të Njeriut dhe të Drejtës Humanitare në Lund të Suedisë.

## **Save the Children, Kosovë**

Më 11 mars, një përfaqësuese e GDF-së morri pjesë në seminarin “Legjislacioni aktiv për të drejtat e fëmijëve në Kosovë” të organizuar nga Save the Children në Prishtinë. Në seminar gjithashtu morën pjesë Koordinatori për të drejtat e fëmijëve brenda Zyrës për qeverisje të mirë pranë IPVQ-ve si dhe koordinatorët komunal për të drejtat e fëmijëve.

## **Balkan Case Challenge 2006**

Më 28 maj – 1 qershor 2006, një jurist i IOK-së dhe një këshilltare ndërkombëtare e OSBE-së për Institucionin e Ombudspersonit morën pjesë si gjykatës në garat e simulimit të gjykimit që ishin mbajtur në Vjenë të Austrisë si pjesë e Balkan Case Challenge 2006. Këto gara i organizoi World University Service (WUS) i Austrisë.

## **Tryeza e rrumbullakët e IREX-it mbi rolin e mediave dhe shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit**

Më 31 maj 2006, një përfaqësues i Institucionit të Ombudspersonit bëri një prezantim në këtë tryezë të rrumbullakët, duke e përshkruar rolin e Institucionit të Ombudspersonit për ta luftuar korrupsionin. Këtë tryezë të rrumbullakët e organizoi IREX (International Research and Exchanges Board)

## **Programi EUNOMIA**

Më 1 – 3 qershor 2006, një punonjës i IOK-së morri pjesë në seminarin “Mbikëqyrja e Ombudsmanit mbi policinë”, që u mbajt në Syros të Greqisë. Programi EUNOMIA ishte organizator dhe nikoqir i këtij seminari.

## **Rrjeti rajonal i rinisë**

Më 4 – 7 qershor 2006, një juriste i IOK-së morri pjesë në seminarin “Të drejtat dhe e njeriut dhe të pakicave dhe avokimi”, që u mbajt në Budvë të Malit të Zi. Seminarin e organizoi “Lëvizja qytetare për të drejtat e njeriut – Priboj”, një projekt i përkrahur nga “Trusti Ballkanik për Demokraci”.

## **Konferenca “Qytetet për paqe dhe demokraci në Evropë”**

Më 8 – 9 qershor 2006, Zëvendës Ombudspersoni morri pjesë në konferencën “Evropa në udhëkryq: konfliktet e minoriteteve si rrezik për paqen apo si një mundësi?”, që u mbajt në Budapest të Hungarisë. Konferencën e organizoi ALDA me përkrahje të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian.

## **Forumi Evropian për personat me aftësi të kufizuara**

Më 15 qershor 2006, një përfaqësuese e GMD-së morri pjesë në konferencën e Koalicionit të organizatave për personat me aftësi të kufizuara, që ishte përkrahur nga Forumi Evropian për Personat me aftësi të kufizuara. Pjesëmarrësit në këtë konferencë diskutuan rolin e rrjetit të organizatave në avokimin për mundësi të barabarta për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë.

## **Seminari i trajnimit i KB-ve në Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë**

Më 29 qershor – 1 korrik 2006, një asistent ligjor i IOK-së morri pjesë në një program trajnimi për Parandalimin e Konfliktit, të organizuar nga United Nations System Staff College në bashkëpunim me OHCHR në Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë.

## **PËRKRAHJA FINANCIARE**

### **E ardhmja financiare e Institucionit të Ombudspersonit**

Një nga çështjet më të ndjeshme me të cilat është përballur si Ombudspersoni i mëparshëm, ashtu edhe Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit pas tij gjatë periudhës për cilën raportohet, është pavarësia dhe qëndrueshmëria financiare e Institucionit. Në shumë raste, Ombudspersoni ndërkombëtar dhe Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit e kanë theksuar parimin që, në një shoqëri demokratike, një nga elementet kyçe që e garantojnë pavarësinë e ombuds institucioneve është pavarësia e tyre financiare. Përveç kësaj, ata e kanë përsëritur që parimi i pavarësisë gjithashtu nënkupton që procesi buxhetor nuk duhet të ndërhyjë në pavarësinë e Institucioneve të tilla. Kjo do të thotë që çështjet buxhetore lidhur me Institucionin e Ombudspersonit do të duhej të diskutohen mes Kuvendit të Kosovës dhe Institucionit të Ombudspersonit, por jo me Qeverinë, respektivisht Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Parimi i lartpërmendur është ngritur disa herë dhe autoritetet kosovare dhe PSSP janë informuar hollësisht në shumë raste lidhur me nevojat ekonomike të Institucionit. Deri në dhjetor të vitit 2005, Institucioni i Ombudspersonit kishte qenë nën pushtetin e rezervuar të PSSP-së, që do të thotë që deri në atë kohë, PSSP ishte autoriteti i vetëm që e kishte fjalën e fundit në propozimet buxhetore të Institucionit. Megjithatë, procesi buxhetor nuk e respektoi pavarësinë e Institucionit dhe resurset që BKK i ndau për vitin 2006 nuk i kishin marrë parasysh kërkesat financiare që kishin përfshirë shpenzime të caktuara që BKK do të duhej t'i mbulonte në pajtim me ligjin në fuqi në Kosovë.

Ombudspersoni i mëparshëm dhe Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit vazhdimisht kanë kërkuar dhe janë përpjekur që gjejnë fondet e mjaftueshme për të kryer në mënyrë të duhur detyrat e përditshme të Institucionit dhe për të mirëmbajtur resurset e tij njerëzore. Njëlloj si në vitet tjera fiskale, ashtu edhe gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet, qëndrueshmëria financiare e Institucionit ka qenë e mundur të ruhet vetëm falë kontributeve shtesë dhe zemërgjera nga donatorët ndërkombëtarë, të cilat ia mundësuan Institucionit që të mbulojë zbrazëtitat në financimin e tij. Megjithatë, këto donacione ndërkombëtare, të cilat momentalisht mbulojnë shpenzimet e aktiviteteve të caktuara të Institucionit dhe në veçanti shpenzimet lidhur me pagat e punonjësve të caktuar të Institucionit, nuk paraqesin zgjidhje përkatëse afatgjatë në këtë drejtim. Në vend të kësaj, BKK dhe autoritetet kompetente vendore do të duhej ta kuptojnë obligimin e tyre për ta përkrahur këtë institucion të rëndësishëm publik duke ia siguruar atij fondet e nevojshme.

Sipas nenit 17 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/6 mbi Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë, Institucioni i Avokatit të Popullit mund t'ia tërheqë vëmendjen Kuvendit të Kosovës lidhur me propozimet buxhetore të Institucionit; kjo dispozitë e garanton në teori respektimin e pavarësisë themelore financiare të Institucionit. Kështu, zbatimi i drejtë i nenit 17 të lartpërmendur të garantonte që, pas diskutimit me Kuvendin e Kosovës, propozimi buxhetor nuk do ta rrezikonte aftësinë e Institucionit të Avokatit të



Popullit për të kryer funksionet e tij në mënyrë të plotë dhe të pavarur. Në fund të vitit 2003, PSSP në atë kohë aprovoi skemën momentale të pagave në Institucion, që ia ofron punonjësve pagat që janë të nivelit të njëjtë me ato të gjyqësorit. Aprovimi i PSSP-së së mëparshëm i sistemit të posaçëm të pagave të Institucionit e pasqyroi bindjen e tij që juristët dhe punonjësit tjerë të specializuar për të drejtat e njeriut të një institucioni të pavarur të kësaj natyre duhet të paguhet në një nivel përkatës për t'iu ruajtur profesionistët me kualifikime të larta dhe për t'iu shmangur rrezikut nga korrupsioni apo mungesës së rezultateve. Institucioni beson që autoritetet vendore do ta kuptojnë që skema momentale e pagave do të duhet të ruhet edhe në të ardhmen dhe që argumentet e PSSP-së së mëparshëm do të vazhdojnë të vlejnjë për Institucionin e Ombudspersonit.

### **Përkrahja financiare dhe në të mira gjatë vitit 2005-2006**

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit përdori fonde nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, nga Këshilli i Përhershëm i OSBE-së dhe nga shtetet donatore në vijim: Austria, Belgjika, Finlanda, Lihtenshtajni, Norvegjia, Suedia, Turqia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

#### **Lista e projekteve:**

##### **SIDA**

Në shtator të vitit 2005, Institucioni i Ombudspersonit filloi realizimin e projektit trevjeçar të financuar nga SIDA me qëllim që punonjësve të Institucionit t'u ofrohet aftësim i avancuar në fushën e të drejtave të njeriut, qeverisjes së mirë, administratës së përgjithshme dhe ndërmjetësimit. Ky projekt përfshin trajnime për të drejtat e njeriut dhe fushat e ngjashme ligjore, trajnime për administratën dhe menaxhimin e zyrës, kurse të gjuhës angleze, vizita studimi ombuds institucioneve tjera dhe shkollat verore në temat që përkohjnë me projektin. Partneri zbatues i projektit të SIDA-s është Këshilli i Evropës, i cili u ka ofruar juristëve të Institucionit të Ombudspersonit trajnime në çështje të ndryshme lidhur me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në mars, ka pasur bisedimet rreth teknologjisë informative dhe strukturës së një baze elektronike të të dhënave me Ombudspersonin e Maqedonisë, si dhe rreth instalimit të një sistemi të ri të bazës së të dhënave në Institucion përmes konsultimeve me një ekspert të teknologjisë informative të Këshillit të Evropës.

Në pranverë të vitit 2006, u organizua kurse të gjuhës angleze për punonjësit e Departamentit të Hetimeve të Institucionit.

Në qershor të vitit 2006, SIDA financoi pjesëmarrjen e një punonjësi të Institucionit në një kurs veror mbi të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare, të organizuar nga Instituti Ndërkombëtar për të Drejtën Humanitare në San Remo të Italisë dhe në Gjenevë të Zvicrës. Gjatë këtij muaji, me përkrahjen financiare të SIDA-s, Institucioni i Ombudspersonit pranoi nga Këshilli i Evropës një komplet librash dhe publikimesh tjera nga fusha e të drejtave të njeriut, duke përfshirë fjalorë të gjuhës dhe koleksione të

përmbledhjeve të aktgjyqimeve dhe vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Këto libra i janë shtuar bibliotekës së Institucionit të Ombudspersonit.

## **AUSTRIA**

Në pajtim me një marrëveshje me Agjencinë Austriake për Zhvillim pranë Ministrisë së Jashtme të Austrisë, ky donacion i pranuar në dhjetor të vitit 2004 është përdorur për ta themeluar një zyre në terren në Graçanicë, për t'i paguar pagat e punonjësve të kësaj zyre dhe për t'i mbuluar shpenzimet rrjedhëse të saj. Projekti është ende duke vazhduar.

## **BELGJIKA**

Në pajtim me marrëveshjen me donatorin në vitin 2004, fondi i Belgjikës është përdorur për të paguar pagat për dy punonjës dhe për ta publikuar Informatorin Periodik në katër gjuhë. Ky fond gjithashtu është përdorur për ta paguar sigurimin shëndetësor për punonjësit vendorë. Projekti i financuar i qeverisë së Belgjikës përfundoi në dhjetor të vitit 2005.

## **FINLANDA**

Në pajtim me një projekt të financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Finlandës, ky ky grant, i pranuar në fund të vitit 2004, u caktua për t'i paguar pagat për dy përkthyes të lartë me kualifikime të larta në Institucionin e Ombudspersonit. Ky projekt është ende duke vazhduar.

## **LIHTENSHTAJNI**

Institucioni i Ombudspersonit pranoi këtë donacion në vitin 2002 dhe e përdori atë për t'i mbuluar shpenzimet e përgjithshme të Institucionit. Gjatë periudhës për të cilën raportohet, ky grant është përdorur për ta paguar shpenzimet e banimit të praktikantëve ndërkombëtarë në Prishtinë. Në pajtim me një marrëveshje me qeverinë e Lihtenshtajnit, prej janarit të vitit 2006, ky fond u caktua për ta paguar pagën për një oficer të teknologjisë informative në Insitucion.

## **NORVEGJIA**

Në pajtim me një projekt special, donacioni nga Norvegjia i pranuar në fillim të vitit 2005 ishte përdorur për të paguar pagat për dy punonjës dhe për t'i mbuluar shpenzimet e shtypjes së publikimeve të Institucionit. Me një projekt të ri të aprovuar në fund të vitit 2005, IOK pranoi një kontribut të konsiderueshëm financiar për t'i mbuluar pagat e tre punonjësve, shpenzimet rreth disa prej publikimeve të Institucionit dhe shpenzimet rreth aktiviteteve të GDF-së. Ky projekt është ende duke vazhduar.

## **SUEDIA**

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, granti i pranuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Suedisë në vitin 2001 ishte përdorur për të mbuluar shpenzimet e disa nga publikimet e Institucionit. Ky fond u shter në vitin 2005.

## **TURQIA**

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, një fond që Institucioni i Ombudspersonit e pranoi nga Turqia në vitin 2001, u përdor për t'i përkthyer publikimet e Institucionit të Ombudspersonit në gjuhën turke. Në maj të vitit 2006, Institucioni pranoi një kontribut financiar shtesë nga qeveria e Turqisë. Sipas letërzotimit të donatorit, donacioni i ri u caktua për të mbuluar shpenzimet e publikimeve të Institucionit të Ombudspersonit në gjuhën turke.

## **UNICEF**

Si pjesë e projektit specifik të vitit 2005, UNICEF-i e financoi pagën e një juristeje të GDF-së dhe aktivitetet e këtij grupi. Ky projekt përfundoi në dhjetor të vitit 2005.

## **UNIFEM**

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, UNIFEM-i e përkrahu financiarisht publikimin e fletushkave të Njesisë për Barazi Gjinore pranë Institucionit. Ky projekt special përfundoi në vitin 2005.

## **SHBA**

Kontributi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës i ishte ofruar Institucionit të Ombudspersonit në vitin 2001 për t'i përkrahur shpenzimet e përgjithshme të Institucionit dhe për ta paguar pagën e Ombudspersonit të mëparshëm ndërkombëtar. Në dhjetor të vitit 2005, sipas udhëzimeve të qeverisë së SHBA-ve, ky fond u caktua për ndërtimin e kapacitetit të Institucionit të Ombudspersonit. Gjatë periudhës për të cilën raportohet, ky donacion u shfrytëzua për ta financuar vizitën e punonjësve të Institucionit Zyrës së Avokatit të Popullit në Shqipëri, një program të shkëmbimit me Ombudsmanin e Asociacionit të Komunave të Valdnievolës (Toskanë, Itali) dhe një trajnim dyditor mbi "Delegimin" dhe "Menaxhimin e projekteve". Partner zbatues i këtij fondi është Misioni i OSBE-së në Kosovë.

### **Përkrahja në të mira:**

Gjatë tërë periudhës për të cilën raportohet, Këshilli i Evropës siguroi fondet për vizita konsultimi të Ombudspersonit të mëparshëm në Strasburg dhe pjesëmarrjen e Zëvendës Ombudspersonit në Tryezën e 9-të të Rrumbullakët të Ombudsmanëve Evropianë në Kopenhagë të Danimarkës.

Gjatë vitit 2005, OSBE financoi Marrëveshjet për Shërbime Speciale të këshilltarëve ndërkombëtarë të Institucionit të Ombudspersonit.

Organizatata tjera që ishin nikoqire apo sponsorizuan aktivitetet në lidhje me seminare:

- ALDA (“Asociacioni i Agjencive Vendore për Demokraci”)
- EUNOMIA Programi i Ombudsmanit të Greqisë
- Fondacioni i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Varshavë, Poloni
- OSBE
- Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave
- UNICEF
- UNIFEM

## **PËRMBLEDHJE STATISTIKORE E RASTEVE**

### **Përmbledhje e rasteve**

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, përafërsisht 4116 persona kanë kontaktuar Institucionin e Ombudspersonit në Prishtinë dhe në zyret e terrenit për të parqitur ankesa apo për të kërkuar këshilla apo ndihmë. Gjatë 78 Ditëve të Hapura që janë mbajtur gjatë periudhës për të cilën raportohet, përafërsisht 1511 persona janë takuar personalisht me Ombudspersonin apo zëvendësit e tij. Statistikat e mëposhtme janë ndarë në tre kategori të rasteve – rastet CR, aplikacionet dhe ankesat – por statistikat e tyre përkatëse nuk janë gjithmonë të krahasueshme në mënyrë të drejtëpërdrejtë.

Që nga 1 janari 2006, të gjitha rastet e hapura pranë Institucionit të Ombudspersonit janë quajtur “ankesa”, ndërsa gjatë viteve të kaluara Institucioni i ka quajtur ato aplikacione. Gjithashtu, para 1 janarit 2006, rastet për të cilat nuk është hapur hetim formal, sepse nevoja për intervenim të menjëhershëm është konsideruar të jetë më se e nevojshme, janë quajtur “raste për reagim” apo “rastet CR”. Ka ndodhur që, si rezultat nevojës së mëvonshme për hetime të plota, ndonjëherë rastet për reagim të kategorizohen si aplikacione. Meqë prioritet në menaxhimin e rasteve për reagim ka qenë intervenimi sa më i shpejtë i mundur, Institucioni ka mbledhur më pak të dhëna statistikore për këto raste. Ndonëse nuk i kishte ndarë më rastet CR dhe aplikacionet që nga fundi i vitit 2005, Institucioni është ende në proces të hetimit dhe mbylljes të rasteve CR dhe aplikacioneve të hapura para kohës së lartëpërmendur.

Ashtu si edhe në periudhat e mëparshme të raportuara, një numër i madh i rasteve të hetuara nga Institucioni i Ombudspersonit gjatë 12 muajve të fundit kanë të bëjnë me çështje procedurale (siç është zgjatja e procedurave pranë gjykatave dhe DCPB-së), mospërgjigje nga administratat, çështje pronësore, pensionet dhe ndihma sociale, ankesa për keqpërdorim të autoritetit, çështje të gjykimit të drejtë, ankesa lidhur me punësim apo çështje të mosndëshkimit.

## Masat e përkohshme dhe raportet

Kur Ombudspersoni konsideron se ka nevojë për veprim të menjëhershëm të autoriteteve publike, ai mund të kërkojë zyrtarisht nga organi kompetent administrativ që të ndërmarrë apo suspendojë një veprim të caktuar si masë të përkohshme për të parandaluar dëmin e papërmirësueshëm ndaj ankuesve apo pronave të tyre. Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit ka bërë 6 kërkesa të tilla ndaj autoriteteve vendore dhe ndërkombëtare. Shih aneksin 2 për përmbledhje të masave të përkohshme që janë kërkuar gjatë periudhës për të cilën raportohet.

Atëherë kur letrat për intervenim dhe përpjekjet për ndërmjetësim nuk kanë sukses, Ombudspersoni mund të publikojë një raport, duke siguruar një analizë të plotë dhe ekzpozim publik për një shkelje të të drejtave të njeriut apo ligji të aplikueshëm, së bashku me rekomandimet për udhëheqësin përkatës publik apo gjyqësor se si të rregullojë shkeljet. Institucioni shfrytëzon raportet si mjet të fundit të avokimit dhe i dorëzon kopjet e raportit pranë autoritetit publik që ka bërë shkelje dhe pranë Kuvendit të Kosovës (më parë, sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/38, raportet e Institucionit të Ombudspersonit i janë dorëzuar PSSP-së). Shih aneksin 1 për përmbledhje të raporteve të publikuara gjatë periudhës për të cilën raportohet dhe se si janë përgjigjur autoritetet publike në këto raporte.

## Përmbledhje statistikore e rasteve<sup>3</sup>

<b>Rastet për reagim (Rastet C.R)</b>	400
(deri më 31 dhjetor 2005)	
Rastet C.R të mbyllura deri më 30 qershor 2006	
Të shpallura të papranueshme	191
Të zgjidhura pozitivisht	101
Arsye tjera	87
<i>Gjithsejt</i>	379
<b>Aplikacionet</b>	133
(deri më 31 dhjetor 2005)	
Përkatësia etnike e aplikantëve	
Shqiptarë	88
Serbë	34
Të tjerë	12
Palët përgjegjëse	
Gjykatat	74
Komunat	22
DÇPB	15

<sup>3</sup> Për sqarime rreth klasifikimit të rasteve CR, aplikacioneve dhe ankesave, shikoni tekstin në fillim të kësaj pjese të Raportit vjetor

Ministritë e Qeverisë	12
SHPK	10
Të tjerë	8
UNMIK	4
KFOR	2
Rastet e mbyllura deri më 30 qershor 2006	
Të shpallura të papranueshme	157
Arsye tjera	91
Të zgjidhura pozitivisht	79
<i>Gjithsejt</i>	327
<b>Tema e aplikacioneve</b>	
Çështjet procedurale dhe të tjera të gjyqimit të drejtë (procedurë civile)	51
Çështjet lidhur me DÇPB-në	22
Heshtja administrative dhe çështje të ngjashme	20
Qasja në gjykatë (procedurë civile)	14
Çështjet lidhura me pronën (tjera nga ato të DÇPB-së)	13
Keqpërdorim i autoritetit	10
Mosndëshkimi i autoriteteve	8
Dështimi për të hetuar një vepër penale	7
Çështjet për proces të rregullt gjyqësor (procedurë penale)	6
Çështjet lidhur me punësim	4
E drejta për liri	2
Të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore	1
Të drejtat tjera të mbrojtura me KEDNJ	1
<b>Ankesat</b>	428
	(1 janar – 30 qershor)
Përkatësia etnike e ankuesve:	
Shqiptarë	326
Serbë	74
Të tjerë	28
Palët përgjegjëse	
Gjykatat	114
Komunat	75
Të tjera	74
Ministritë e Qeverisë	68
DÇPB	51

SHPK	37
UNMIK	9
KFOR	5
Rastet e mbyllura deri më 30 qershor 2006	
Të shpallura të papranueshme	43
Të zgjidhura pozitivisht	19
Arsye tjera	7
<i>Gjithsejt</i>	69
<b>Tema e ankesës</b>	
Heshtja administrative dhe çështje të ngjashme	112
Çështjet procedurale dhe të tjera të gjykimit të drejtë (procedurë civile)	76
Çështjet lidhur me DÇPB-në	52
Keqpërdorim i autoritetit	50
Të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore	50
Çështjet lidhura me pronën (tjera nga ato të DÇPB-së)	41
Çështjet lidhur me punësim	36
Qasja në gjykatë (procedurë civile)	20
Çështjet për proces të rregullt gjyqësor (procedurë penale)	18
Dështimi për të hetuar një vepër penale	18
Shërbimet e mira	15
Të drejtat tjera të mbrojtura me KEDNJ	14
Mosndëshkimi i autoriteteve	8
E drejta për liri	1
<b>Hetimet dhe Raportet</b>	
(1 korrik 2005 - 30 qershor 2006)	
Hetimet e hapura	18
Raportet e publikuara nga Institucioni i Ombudspersonit	17
Në emër të ankuesve	11
Hetimet ex officio	7
Kërkesat nga Institucioni i Ombudspersonit për masa të përkohshme	5

Hilmi Jashari  
Ushtrues i detyrës së Ombudspersonit

## ANEKSI I: PËRMBLEDHJET E RAPORTEVE

Institucioni i Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4 të Rregullores së aplikueshme më parë të UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, Nenin 4 të Rregullores së mëvonshme të UNMIK-ut Nr. 2006/06 mbi Institucionin e Ombudspersonit si dhe Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportet vijuese gjatë periudhës për të cilën raportohet. Sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/38 (në fuqi deri më 16 shkurt 2006), këto raporte i janë dorëzuar PSSP-së. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/06 (në fuqi që nga 16 shkurti 2006), këto raporte i janë dorëzuar Kuvendit të Kosovës.

### **Nr. i regjistrimit 1112/03**

#### **Lidhur me zvarritjen e procedurës në rastin e Gani Thaçit**

*Më 17 shtator 2004, Ombudspersoni publikoi Raportin Nr. 1112/03 "Lidhur me zvarritjen e procedurës në rastin e Gani Thaçit". Ky rast kishte të bëjë me një nga çështjet e ngritura në një rast të mëparshëm të ankuesit të njëjtë, respektivisht ankesën e ankuesit ndaj asaj që nuk kishte qenë në gjendje të ankohet kundër shkarkimit të tij nga puna në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK). Hetimet në këtë rast rezultuan me publikimin e raportit të Ombudspersonit më 17 prill 2003. Në këtë raport, Ombudspersoni gjeti që të gjitha organet kompetente, respektivisht TMK, organet disiplinore të TMK-së dhe PSSP, në atë kohë, Michael Steiner (në kapacitetin e tij si autoriteti i fundit administrativ në çështjet lidhur me TMK-në), kishin dështuar t'i ofrojnë ankuesit një vendim të arsyetuar me shkrim lidhur me shkarkimin e tij nga TMK ose ta shqyrtojnë ankesën e tij kundër këtij shkarkimi. Gjykata kompetente për të vendosur mbi temën e lëndës së këtyre çështjeve ishte deklaruar që nuk ishte në gjendje ta shqyrtojë rastin derisa ai të mos shfrytëzonte të gjitha rrugët për shqyrtim administrativ deri në vendimin e PSSP-së dhe duke përfshirë edhe atë vendim. Gjykata Supreme e Kosovës, që kishte juridiksion ta urdhërojë PSSP-në të nxjerrë vendimet me shkrim të kërkuara me ligj, gjithashtu kishte dështuar të ndërmarrë këtë veprim. Kjo kishte përbërë shkelje të të drejtës së ankuesit për proces të rregullt gjyqësor, të garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*

*Në rastin në fjalë, Ombudspersoni konkludoi, mes tjerash, që shkelja e të drejtës së ankuesit për gjykatë, e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është ende duke vazhduar për shkak të dështimit të Gjykatës Supreme për të vendosur mbi kërkesën e ankuesit.*

*Ombudspersoni rekomandoi që Gjykata Supreme e Kosovës do të duhej të sigurojë që të nxjerret një vendim mbi rastin e ankuesit pa vonesë të mëtejshme.*

*Më 29 tetor 2004, Ombudspersoni pranoi një shkresë nga Zëvendës PSSP për Polici dhe Drejtësi, duke u përgjigjur që ia kishte përcjellë letrën Njësisë së Inspeksionit Gjyqësor (NjIGj) pranë Departamentit të Drejtësisë, e cila kishte hapur hetimet mbi rastin e lartpërmendur.*



Më **28 korrik 2005**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një përgjigje nga Drejtori i Departamentit të Drejtësisë, në të cilën sqaroi që nuk kishte gjetur ndonjë sjellje të pahijshme gjyqësore në lidhje me rastin. Sipas përgjigjes, zvarritja në procedurën gjyqësore kishte qenë për shkak të vendimit të Kryetarit të Gjykatës Supreme të vitit 2002 që gjykatësve tjerë të mos u caktohet çfarëdo çështje ligjore ekzistuese apo të parashtruar rishtas derisa të bëhet një emërim për ta zëvendësuar gjykatësin e Gjykatës Supreme që fillimisht ishte marrë me lëndën, që kishte vdekur në vitin 2002. Gjykatësi që e kishte zëvendësuar atë nuk e kishte filluar punën deri në janar të vitit 2003, dhe lënda i ishte caktuar atij në shkurt të vitit 2003. Drejtori më tutje sqaroi që vendimi i Kryetarit të Gjykatës Supreme për të pritur dhe për t'ia dhënë lëndën zëvendësimit të gjykatësit të parë kishte qenë i bazuar në nevojën e paramenduar për ta mbajtur ngarkesën me punë të gjykatësve tjerë në një nivel që mund të përballet, dhe që sipas Njesisë së Inspeksionit Gjyqësor, shtatë (7) muaj të mosveprimit në rastin nuk përbënin ndonjë mospërfillje të funksionit gjyqësor. Në kohën kur lënda i ishte caktuar gjykatësit zëvendësues, 495 lëndë ishin në pritje për t'u zgjidhur pranë Gjykatës Supreme të Kosovës. Sipas Drejtorit, 400 lëndë që kishin të bëjnë me ligjin administrativ u ishin caktuar gjykatësve tjerë për t'u përfunduar në vitin 2003 dhe që rasti i z. Thaçi kishte qenë në mesin e atyre lëndëve që i ishin caktuar një gjykatësi tjetër në gusht të vitit 2003. Megjithatë, lënda i ishte caktuar përsëri gjykatësit fillestar zëvendësues në tetor të vitit 2004, derisa NJIGj kishte konkluduar që ende nuk kishte pasur ndonjë sjellje të pahijshme gjyqësore. Vendimi përfundimtar i kolegjit të Gjykatës Supreme lidhur me lëndën ishte marrë më 24 nëntor 2004 dhe Departamenti i Hetimeve tani i konsideronte hetimet të mbyllura.

#### **Nr. i regjistrimit 1063/04 Lidhur me me zvarritjen e procedurës në rastin e Zenë Sahitit**

*Më 28 tetor 2004, Ombudspersoni publikoi Raportin nr. 1063/04 lidhur me "me zvarritjen e procedurës në rastin e Zenë Sahitit." Në këtë rast, mes tjerash, Ombudspersoni gjeti që Gjykata komunale në Prishtinë kishte dështuar të ndërmerr masat e duhura për të siguruar zgjidhjen e rastit të ankuesit ku përfshihej dëbimi i uzurpuesve të paligjshëm nga banesa e tij brenda një afati të arsyeshëm kohor. Sipas Ombudspersonit, kjo kishte përbërë shkelje të të drejtës së ankuesitit për një proces të rregullt gjyqësor, siç është e garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.*

*Më 27 janar 2005, Ombudspersoni pranoi një përgjigje nga një inspektor i Njesisë për Inspeksion të Gjyqësorir (NJIGj) pranë Departamentit të Drejtësisë, përmes së cilës e informoi Ombudspersonin që pas pranimit të raportit të tij, Njësia e Inspeksionit Gjyqësor kishte hapur hetimet mbi këtë çështje për të vlerësuar nëse kishte pasur ndonjë sjellje të pahijshme nga ndonjë anëtar i gjyqësorit.*

Më **28 korrik 2005**, Institucioni i Ombudspersonit e pranoi një përgjigje nga Drejtori i Departamentit të Drejtësisë, në të cilën sqaroi që nuk kishte dëshmi të mjaftueshme për ta vërtetuar sjelljen e pahijshme gjyqësore në këtë rast. Sipas përgjigjes, NJIGj nuk kishte mundur që ta gjejë ndonjë arsye tjetër për t'ia caktuar rastin ndonjë gjykatësi tjetër përveç faktit që kishte 2361 lëndë të pazgjidhura pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë.

Drejtori e kundërshtoi pohimin e Ombudspersonit që Gjykata komunale kishte pritur deri më 23 tetor 2003 për ta shqyrtuar lëndën. Sipas hetimeve të NjIGj-së, një seancë gjyqësore lidhur më këtë rast ishte mbajtur më 8 shtator 2003. Seanca e fundit ishte mbajtur më 2 dhjetor 2003. Në këtë seancë, gjykatësi kryesues e kishte nxjerrë një vendim në favor të kërkesës pronësore të ankuesit dhe i kishte urdhëruar uzurpuesit që t'i lirojnë hapësirat.

Siç theksohej në përgjigjen e NjIGj-së drejtuar Ombudspersonit, pohimi i ankuesit se Kryetari i Gjykatës komunale të Prishtinës e kishte zvarritur rastin e tij në mënyrë aktive ishte i pabazuar. Për më tepër, pala që ankuesi kishte pohuar se ndoshta do të mund të përkrahte pohimet e tij nuk kishte mundur të gjendet, edhe pasi që NjIGj kishte intervistuar të gjithë dëshmitarët potencial të cilëve u përshtatej përshkrimi i dëshmitarit potencial. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë gjithashtu theksoi që ankuesi kishte refuzuar t'i ndihmojë hetimet në përpjekjet e mëtejshme për ta gjetur kush kishte qenë dëshmitari përkrahës. Megjithatë hetimet e NjIGj-së nuk kishin gjetur ndonjë sjellje të pahijshme gjyqësore, Drejtori theksoi që Departamenti i Drejtësisë ishte duke i zhvilluar nismat për të përcaktuar si të zgjidhen më së miri zvarritjet e procedurave civile me të cilat ishin duke u përballuar gjykatat në Kosovë. Ai theksoi që Departamenti i Drejtësisë i konsideronte hetimet të mbyllura.

#### **Nr. i regjistrimit 1082/03**

#### **Lidhur me me zvarritjen e procedurës në rastin e Dobrivoje Micić**

*Më 17 dhjetor 2005, Ombudspersoni publikoi Raportin nr. 10823/03 lidhur me “me zvarritjen e procedurës në rastin e Dobrivoje Micić”. Në këtë rast, Ombudspersoni, mes tjerash, gjeti që dështimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë për ta zgjidhur rastin e ankuesit brenda një kohe të arsyeshme kishte përbërë shkelje të të drejtës së ankuesit për një proces të rregullt gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm kohor, siç është e garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.*

*Në raport, Ombudspersoni iu referua një përgjigjeje të UNMIK-ut në një raport të tij të mëhershëm, përmes të cilës Ombudspersoni u informua që pesëmbëdhjetë pozita gjyqësore të ndara për Gjykatën e qarkut ishin plotësuar dhe që në mes të majit të vitit 2004, një gjykatës shtesë ishte transferuar në Gjykatën e qarkut nga Gjykata komunale në Podujevë për të ndihmuar në lehtësimin e ngarkesës me raste. Derisa vlerësoi përpjekjet e autoriteteve përgjegjëse për ta shtuar numrin e gjykatësve në Gjykatën e qarkut në mënyrë që të zvogëlohet numri i rasteve në pritje për t'u zgjidhur, Ombudspersoni vërejti që këto masa deri më tani nuk kishin arritur ta përshpejtojnë nxjerrjen e një vendimi në rastin e ankuesit.*

*Mes tjerash, Ombudspersoni rekomandoi që PSSP, do të duhej që, jo më vonë se më 2 shkurt 2005, të sigurojë që Gjykata e qarkut të nxjerrë një aktgjykim në rastin e ankuesit pa vonesë të mëtutjeshme. Ombudspersoni më tutje rekomandoi që PSSP do të duhej të emërojë një numër të mjaftueshëm të gjykatësve në Gjykatën e qarkut në Prishtinë ose të ndërmarra masa tjera të domosdoshme për të garantuar shqyrtimin e rasteve dhe dorëzimin e aktgjykimeve brenda një afati të arsyeshëm.*

Më 18 gusht 2005, Ombudspersoni pranoi një përgjigje nga Drejtori i Departamentit të Drejtësisë, i cili tha se, sipas NjIGj-së, lënda e ankuesit ishte pranuar në Gjykatën e qarkut në Prishtinë më 2003 dhe i ishte caktuar një gjykatësi të kësaj Gjykate. Megjithatë, në një datë të mëvonshme, pas publikimit të raportit të Ombudspersonit, rasti i ishte caktuar një gjykatësi tjetër të Gjykatës së qarkut. Në prill të vitit 2005, Gjykata e qarkut filloi punën rreth lëndës në mënyrë më aktive dhe më 27 prill 2005, vendosi ta prishë aktgjykimin e instancës së parë dhe e ktheu rastin për rishqyrtim dhe vendosje.

Sipas Drejtorit të Departamentit të Drejtësisë, vetëm dy muaj nga më shumë se 16 të vonesës mund t'i visheshin gjykatësit të ri të Gjykatës së qarkut, derisa për periudhën tjetër kohore rasti kishte qenë në regjistrin e gjykatës. Drejtori gjithashtu sqaroi që lënda ishte caktuar në bazë të datës kur ishte pranuar dhe që, për fat të keq, prioriteti u ishte dhënë lëndëve më të vjetra. Drejtori më tutje theksoi se meqë hetimet e NjIGj-së nuk kishin mundur të vërtetojnë ndonjë sjellje të pahijshme gjyqësore, për këtë arsye Departamenti i Drejtësisë e konsideronte rastin si të mbyllur.

#### **Nr. i regjistrimit Ex Officio 46/05 Lidhur me ndarjen e banesave në ndërtesën “Gj” të Komunës së Obiliqit**

*Më 30 qershor 2005, Ombudspersoni publikoi Raportin ex officio Nr. 46/05 mbi ligjshmërinë e vendimeve dhe procedurën lidhur me ndarjen e banesave punonjësve të Komunës në ndërtesën “Gj” që i takonte Komunës së Obiliqit. Ky raport ishte rezultat i hetimeve ex officio të nisura me ankesat rreth parregullsive në procedurën e ndarjes që ishin pranuar nga individë të caktuar si dhe nga informata tjera që i ishin dorëzuar Ombudspersonit.*

*Në këtë raport, Ombudspersoni vërejti që komisioni që e kishte emëruar Këshilli Komunal për të zhvilluar procedurën e ndarjes nuk i kishte ndjekur dispozitat e ndarjes nga Ligji i zbatueshëm për Marrëdhënie Banesore të vitit 1983, as ndonjë parim tjetër ligjor, e as kriteret që i kishte përcaktuar vetë. Nga ai gjithashtu nuk është kërkuar t'i raportojë Kuvendit Komunal apo ndonjë organi tjetër, as nuk kishte pasur ndonjë dispozitë që e rregullonte përbërjen e tij apo sa i madh do të ishte kuorumi për t'u lejuar marrë vendime të caktuara. Në këtë mënyrë, ky komision kishte vepruar me një pandëshkueshmëri pothuajse të plotë dhe nuk kishte qenë i obliguar t'i përgjigjet kurrfarë ligjeve, procedurave apo organeve mbikëqyrëse. Prandaj, procedurat e ndarjes së banesave nuk kishin përmbajtur garanci të mjaftueshme për të parandaluar veprimet arbitrare të Komisionit. Ombudspersoni konkludoi që të drejtat e personave që ishin paraqitur për të ju ndarë banesat ishin lënë pa mbrojtjen e nevojshme kundër veprimeve diskriminuese në shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*

*Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej që, në bashkëpunim me Ministrinë e Shërbimeve Publike dhe Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe jo më vonë se më 1 shtator 2005, të garantojë që procedurat e kontestuara të ndarjes së banesave të zhvillohen përsëri, duke marrë në konsideratë standardet ndërkombëtare të përmendura në raport. Ai gjithashtu rekomandoi që PSSP dhe Ministrinë e lartpërmendura të përgjigjen në*

*mënyrë adekuate në pohimet lidhur me parregullsitë në procedurat e ndarjes së banesave në lidhje me ndërtesën “Gj” në Obiliq.*

Më **23 shtator 2005**, Ombudspersoni pranoi një përgjigje lidhur me Raportin *ex officio* nr. 46/05 nga Kryetari i komunës së Obiliqit. Në përgjigjen e tij, Kryetari i komunës theksoi që ankesat që ishin pranuar ishin thjeshtë ato nga aplikuesit e pakënaqur për shkak se këto banesa u ishin dhënë vetëm në bazë të “qirasë”. Kryetari i komunës konfirmoi përsëri qëndrimin e tij që Komisioni i themeluar për t’u marrë me çështjen e banesave, një organ i “pavarur” i emëruar nga Kuvendi Komunal në Obiliq, e kishte bërë ndarjen e banesave sipas kriterëve të caktuara nga vetë ky Komision. Komisioni i kishte ndarë tri banesa për komunitetet minoritare, mirëpo përfundimisht këto banesa u ishin ndarë tre punëtorë të komunitetit boshnjak sepse ata ishin të vetmit konkurrenca nga komunitetet minoritare. Në përgjigje u njoh numri i madh i shqiptarëve të cilëve, për shkak të gjendjes financiare dhe kushteve të banimit u ishin ndarë dy nga tri banesat që kishin qenë të parapara që t’i ndahen komuniteteve minoritare – duke e përsëritur edhe njëherë që këto banesa u ishin dhënë përfituesve vetëm “me qira”. Kryetari i komunës e mbylli përgjigjen e tij duke e theksuar që nuk kishte nevojë të anulohet vendimi i Komisionit për ndarjen e banesave për punëtorët e Administratës komunale pasi që procesi kishte qenë i paanshëm dhe i zhvilluar në mënyrën më të drejtë të mundshme për të gjithë aplikantët.

**Nr i regjistrimit 618/02**  
**F.G. kundër Gjykatës Komunale të Vushtrrisë dhe UNMIK-ut**

Më **25 tetor 2005**, Ombudspersoni publikoi një raport lidhur me ankesën e znj. F.G. në lidhje me mos ekzekutimn e një vendimi të nxjerrë nga Gjykata komunale në Vushtri më 7 maj 2002, që urdhëronte burrin e saj, z. A.G., t’i paguajë ankuesës dhe fëmijëve të saj një alimentacion mujor në vlerë 1300 SFR deri në përfundimin e shkurorëzimit së tyre.

A.G. ishte ankuar kundër vendimit të lartpërmendur pranë Gjykatës së qarkut në Mitrovicë dhe më pas kishte paraqitur kërkesë për shkurorëzim pranë të njejtës gjykatë. Pas një kohe, Gjykata e qarkut nxorri një aktgjykim mbi shkurorëzimin që urdhëronte A.G. t’i paguajë F.G. një alimentacion mujor në vlerë 1200 SFR. Gjykata komunale nuk ishte në gjendje ta ekzekutojë aktgjykimin mbi shkurorëzim sepse A.G. kishte shkuar në Zvicër. Kryetari i Gjykatës komunale, pas kësaj, kërkoi nga Departamenti i UNMIK-ut për Drejtësi që të kontaktojë autoritetet e Zvicrës për të pasur ndihmën e tyre në ekzekutimin e aktgjykimit.

Departamenti i Drejtësisë pranë UNMIK-ut kontaktoi me autoritetet e Zvicrës në dy raste, herën e parë për t’i informuar lidhur me rastin dhe herën tjetër për të kërkuar informata lidhur me mundësinë e A.G. për të paguar alimentacionin, sepse ai pohonte se ishte duke pranuar ndihmë sociale. Pas kërkesës së dytë, Kryetari i gjykatës komunale nuk pranoi informata të mëtejshme nga UNMIK-u lidhur me rastin, përkundër kërkesave të vazhdueshme për azhurnim. Deri në datën e publikimit të këtij raporti, Gjykata komunale nuk ka qenë në gjendje të ekzekutojë aktgjykimin për shkurorëzim dhe ankuesja nuk ka pranuar asnjë pagesë mujore të alimentacionit.

Në raportin e tij, Ombudspersoni shqyrtoi sjelljen e Gjykatës komunale dhe atë të Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut. Ai konkludoi se dështimi i Departamentit të Drejtësisë për të ndjekur çështjen e ankueses në mënyrë të efektshme pranë autoriteteve kompetente në Zvicër kishte parandaluar Gjykatën komunale në ekzekutimin e akgjykimin që urdhëronte pagesën për alimentacion. Ombudspersoni vërejti se sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, e drejta për një proces të rregullt gjyqësor gjithashtu mbronë ekzekutimin e vendimeve të plotëfuqishme dhe obliguese të gjykatave. Prandaj, vonesat e shkaktuara nga dështimi i Departamentit të Drejtësisë për të ndërmarrë veprime të mëtejshme kishte përbërë shkelje të të drejtës së ankueses për proces të rregullt gjyqësor, të garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej që, jo më vonë se 30 nëntor 2005, të ndërmerr veprime për të siguruar që Departamenti i Drejtësisë pranë UNMIK-ut të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të bërë të mundur që Gjykata komunale e Vushtrisë të ekzekutojë aktgjykimin e saj që i jep ankueses të drejtë për alimentacion.

Më **28 dhjetor 2005**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një përgjigje në raport nga Koordinatorja e NjIGj-së në kuadër të Departamentit të UNMIK-ut për Drejtësi, e cila tha se NjIGj kishte vlerësuar se rasti nuk i plotëson për hapjen e hetimeve nga NjIGj sepse nuk kishte dëshmi për sjellje të pahijshme të gjyqësorit.

#### **Nr. i regjistrimit 1533/04** **Lidhur me zvarritjen e procedurës në rastin e Jeton Veselit**

Më **1 nëntor 2005**, Ombudspersoni publikoi një raport mbi rastin e lartpërmendur. Në këtë rast, Ombudspersoni gjeti se dështimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë për ta zgjidhur rastin brenda një kohe të arsyeshme përbënte shkelje të të drejtës së ankuesit për një proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme, siç garantohet me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në rasti aktual, që përfshin kompensimin civil për dëmin e pësuar të ankuesit pasi që kishte blerë një veturë me dokumente të falsifikuara, Ombudspersoni vërejti që, pas përcjelljes së ankesës së ankuesit në Gjykatën e Qarkut më 23 dhjetor 2003, me sa dukej nuk ishin ndërmarrë kurrfarë masa nga kjo gjykatë për sa i përket rastit të ankuesit, deri në datën e publikimit të këtij raporti. Duke pranuar rastin si relativisht jo të ndërlikuar dhe më rëndësi të madhe për ankuesin, i cili kishte humbur një shumë të konsiderueshme të parave me blerjen e veturës me dokumente të falsifikuara, Ombudspersoni vërejti se se Gjykata e Qarkut nuk ishte munduar që të arsyetojë vonesën.

Ombudspersoni gjithashtu vërejti se mungesa e një mjeti ligjor për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm kohor përbënte shkelje të së drejtës për një mjet efektiv ligjorë sipas nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ombudspersoni rekomandoi që Kryetari i Gjykatës së qarkut në Prishtinë duhet që, jo më vonë se më 1 dhjetor 2005, të sigurojë që Gjykata e qarkut në Prishtinë të nxjerrë vendim lidhur me ankesën e të pandehurit pa ndonjë vonesë të më tutjeshme, duke pasur parasysh që rasti është duke u zvarritur pranë kësaj gjykate që gati dy vite.

Ombudspersoni gjithashtu rekomandoi që PSSP, jo më vonë se më 1 dhjetor 2005, të iniciojë një procedurë disiplinore kundër gjykatësve në Gjykatën e qarkut në Prishtinë që kanë qenë të përfshirë në rastin e ankuesit pranë Këshillit gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës. Në fund, Ombudspersoni rekomandoi që PSSP të shpallë një rregullore për sigurimin e një mjeti efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut duke siguruar lehtësim në formë të parandalimit dhe kompensimit lidhur me ankesat për zgjatje të tepruar të procedurës në rastet civile.

Më **8 dhjetor 2005**, IOK pranoi një përgjigje për këtë raport nga administruesi i Gjykatës së qarkut në Prishtinë, i cili theksoi se rasti do të mbyllet brenda një muaji.

Më **14 dhjetor 2005**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një përgjigje nga Koordinatorja e NjIGj-së, e cila tha se NjIGj kishte hapur hetime në rast dhe premtoi se do ta informonte Institucionin e Ombudspersonit për rezultatet e hetimeve.

Më **28 dhjetor 2005**, rasti ishte mbyllur dhe Gjykata e qarkut kishte vendosur në favor të ankuesit. Pas kërkesës së Institucionit të Ombudspersonit për informata të mëtejshme, Gjykata e qarkut sqaroi se vendimi do të përmbahet në korrik 2006.

#### **Nr. i regjistrimit 1370/04 Lidhur me zvarritjen e procedurës në rastin e Enver Pllanës**

Më **29 nëntor 2005**, Ombudspersoni publikoi një raport mbi rastin e lartëpërmendur. Në këtë rast ku përfshihen procedura civile të iniciuara më 2001, Ombudspersoni vërejti se Gjykatës komunale në Prishtinë i është dashur një vit e tre muaj që të përcjellë ankesën e ankuesit në Gjykatën e qarkut në Prishtinë, ndërsa Gjykatës së Qarkut në Prishtinë i është dashur më tepër se dy vite për të vendosur lidhur me ankesën. Rasti kishte të bënte me një kontest nga marrëdhënia e punës dhe nuk ishte aq i ndërlikuar. Për sa i përket vonesës së parë, Ombudspersoni vërejti se dukej që nuk kishte arsyetim për këtë dhe se Gjykata komunale nuk kishte dhënë një arsyetim për këtë. Për sa i përket vonesës së dytë, Ombudspersoni vërejti se çështja pranë Gjykatës së qarkut se a ishte paraqitur padia brenda kohës së paraparë me ligj gjithashtu nuk ishte shumë e ndërlikuar dhe mund të ishte zgjidhur brenda një afati më të shkurtër kohor. Gjykata e Qarkut gjithashtu nuk kishte ofruar asnjë arsyetim lidhur me vonesën.

Duke e pasur parasysh kujdesin e veçantë që kërkohet nga e drejta sipas praktikës së mëparshme të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut në kontestet nga marrëdhënia e punës, Ombudspersoni konkludoi që të dy gjykatat kishin shkelur obligimet e tyre sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila siguron që çdo njeri ka të drejtë në gjykim të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Ombudspersoni gjithashtu vërejti se mungesa e një mjeti ligjor për shkelje të së drejtës për gjykim të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kohor përbënte shkelje të së drejtës për një mjet efektiv ligjorë sipas nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ombudspersoni rekomandoi që Kryetari i Gjykatës komunale në Prishtinë do të duhej që, jo më vonë se më 5 janar 2006, të ndërmerr hapa urgjente për të siguruar që Gjykata

komunale të nxjerrë një vendim të ri në rastin e ankuesit pa vonesë të mëtejshme. Më tutje, ai rekomandoi që PSSP do të duhej që, jo më vonë se më 5 janar 2006, të nisë procedura disiplinore kundër gjykatësve të Gjykatës komunale dhe asaj të qarkut të përfshirë në rastin e ankuesit pranë Këshillit gjyqësor dhe prokurorial. Në fund, Ombudspersoni rekomandoi që PSSP të shpallë një Rregullore që siguron mjete efektive ligjore në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut duke siguruar kështu lehtësim në formë të parandalimit dhe kompensimit lidhur me ankesat për zgjatje të tepruar të procedurës në rastet civile.

### **Nr. i regjistrimit 1420/04 Lidhur me të drejtën për jetë familjare të Ajete Maliqit**

Më **20 dhjetor 2005**, Ombudspersoni publikoi një raport mbi rastin e lartpërmendur. Në këtë rast, ankuesja nuk kishte pasur kontakt me dy fëmijët e saj që nga vdekja e burrit të saj, në pjesë të madhe, nga fakti se familja e të ndjerit ishte përkujdesur për fëmijët që nga vdekja e burrit të saj. Ankuesja kishte fituar të drejta të kufizuara për qasje tek fëmijët e saj në vitin 2000 dhe procedurat për besim të fëmijëve të nisura në vitin 2001 ishin ende në pritje për t'u zgjidhur pranë Gjykatës Supreme në kohën kur është publikuar raporti i Ombudspersonit.

Ombudspersoni vërejti që megjithëse neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk përmban kërkesa të veçanta procedurale, shqyrtimi i çështjeve të nenit 8 duhet gjithashtu të shqyrtojë edhe kohëzgjatjen e procesit të vendimmarrjes të autoriteteve lokale dhe të çfarëdo procedurave të ndërlidhura gjyqësore. Ekzistonte rreziku që çfarëdo vonese procedurale nga gjykata mund të rezultojë de facto në vendosjen e një çështjeje. Rastet që kanë të bëjnë me ribashkimin e prindëve me fëmijët kërkojnë trajtim urgjent, sepse kalimi i kohës mund të ketë pasoja të pakthyeshme për marrëdhëniet në mes fëmijëve dhe prindit që nuk ka jetuar me ta. Duke i zbatuar këto parime në rastin aktual, Ombudspersoni ka konkluduar se fakti që Gjykata e qarkut ka kthyer rastin për rishqyrtim pranë Gjykatës komunale disa herë, zbulon një mungesë serioze të kualitetit dhe punës të gjyqësorit vendor, në veçanti për sa i përket funksionimit të hierarkisë të këtij sistemi. Në përgjithësi, duke mos ndjekur në mënyrë të duhur ligjin e zbatueshëm dhe duke mos vendosur për rastin më shpejtë, gjykatat kompetente kishin dështuar për të vepruar sipas urgjencës që kërkonte situata dhe e kishin parandaluar ankuesen që të takojë dhe të ketë në besim fëmijët e saj. Kjo përbënte shkelje të së drejtave të saj sipas nenit 8.

Ombudspersoni rekomandoi që Kryetari Gjykatës Supreme në Kosovë duhet që, jo më vonë se më 30 janar 2006, të ndërmerr hapa urgjente për të siguruar që Gjykata Supreme të nxjerrë vendim lidhur me një kërkesë për rishqyrtim të një aktgjykimi të Gjykatës komunale për rastin, ashtu siç është vërtetuar nga Gjykata e qarkut dhe pa vonesë të mëtejshme. Gjithashtu, Kryetari i Gjykatës Supreme do të duhej të sigurojë që në të ardhmen raste të tilla të trajtohen si raste me prioritet.

Njëkohësisht, Ombudspersoni rekomandoi që Kryetari i Gjykatës komunale në Gjilan do të duhej që, si masë kalimtare deri sa Gjykata Supreme të vendos për rastin, të sigurojë që ankueses t'i lejohet qasje më e shpeshtë ndaj fëmijëve të saj. Ai më tutje rekomandoi që

Gjykata Komunale të veprojë në këtë mënyrë edhe në raste tjera të ngjashme. Ombudspersoni kërkoi që gjykata të veprojë sipas rekomandimeve të tij jo më vonë se më 30 janar 2006. Në fund, Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej që, jo më vonë se më 30 janar 2006, të sigurojë që Njësia e Inspeksionit Gjyqësor pranë Departamentit të UNMIK-ut për Drejtësi të hetojë sjelljen e gjykatësve të përfshirë në rast.

Më 6 prill 2006, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një përgjigje nga NjIGj ku theksohej se në rast ishin të përfshirë shumë gjyqtarë dhe se raporti i Ombudspersonit nu kishte pohuar për sjellje të pahijshme të ndonjë gjykatësi në veçanti. NjIGj theksoi se për arsye se nuk kishte pohime specifike për sjellje të pahijshme, nuk kishte baza për të hapur hetime lidhur me këtë. NjIGj më tutje theksoi se Gjykata Supreme më në fund kishte nxjerrë një vendim më 17 shkurt 2006 dhe se vendimi ishte ekzekutuar më 22 mars 2006, duke i kthyer kështu fëmijët në besim dhe ruajtje të së ëmës.

### **Nr. i regjistrimit 1800/05 Petko Mikarić kundër Policisë së UNMIK-ut dhe SHPK-së**

Më **20 dhjetor 2005**, Ombudspersoni publikoi një raport mbi rastin e lartpërmendur. Në këtë rast, ankuesi dhe gruaja e tij ankoheshin për keqtrajtim nga persona të tretë që pohojë të ketë ngjarë në vitin 1999. Ombudspersoni vërejti se në atë kohë, Serbia dhe Mali i Zi ende nuk e kishin ratifikuar Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe UNMIK-u ende nuk ishte themeluar. Pavarësisht nëse, de facto, në Kosovë ekzistonte një forcë policore në atë kohë që do të kishte parandaluar sulmin, Ombudspersoni konkludoi se në mungesë të çfarëdo legjislacioni që do t'i kishte obliguar ata që të vepronë ashtu, autoritetet ekzistuese publike në territorin e Kosovës në atë kohë nuk ishin të obliguara ndërkombëtarisht që të vepronë sipas parimeve të nenit 3 (të lirë nga keqtrajtimi) dhe neneve tjera të Konventës.

Sa i përket çështjes nëse autoritetet kompetente kishin kryer hetime të duhura në pohimet e ankuesit për keqtrajtim, Ombudspersoni vërejti që policia në Kosovë ka një përgjegjësi të vazhdueshme për të hetuar raste të tilla dhe se që nga dhjetori 1999, ligjet e zbatueshme në Kosovë i obligonin ata që t'i përmbaheshin parimeve të Konventës. Sidoqoftë, policia nuk kishte kryer hetime të duhura menjëherë pas incidentit dhe e kishte mbyllur rastin. Në vitin 2005, policia vendosi që të rihapë rastin dhe prandaj Ombudspersoni konkludoi se vendimi i mëhershëm për mbylljen e rastit ishte i hershëm dhe ishte bërë pa një vlerësim të duhur të fakteve. Kjo nuk pasqyrore kujdes të duhur nga ana e policisë, e cila kishte shkelur të drejtat e ankuesit dhe të gruas së tij për hetime të duhura në pohimet e tyre sipas nenit 3 të Konventës.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej që, jo më vonë se më 30 janar 2006, të sigurojë që autoritetet kompetente të prokurorisë të kryejnë dhe zhvillojnë hetime në mënyrë aktive në pohimet për lëndime të rënda trupor të ngritura nga ankuesi dhe gruaja e tij, me synim të ndjekjes dhe dënimit të personave përgjegjës për akte të tilla penale. Ai më tutje rekomandoi që PSSP do të duhej të sigurojë që Policia e UNMIK-ut të nisë hetime në sjelljen e atyre policëve të SHPK-së, të cilët kishin përgjegjësinë e parë për hetimin e rastit në fjalë.



Institucioni i Ombudspersonit nuk ka pranuar kurrfarë përgjigje për këtë raport.

**Nr. i Regjistrimit 694/02**  
**Beqir Qerkezi kundër Policisë së UNMIK-ut dhe SHPK-së**

Më **20 dhjetor 2005**, Ombudspersoni publikoi një raport mbi rastin e lartpërmendur. Në këtë rast, Ombudspersoni së pari shqyrtoi nëse pohimet e ankuesit se ishte ratur nga një oficer i policisë së UNMIK-ut dhe disa policë të SHPK-së në vitin 2002, mund të konsideroheshin se përbëjnë shkelje sipas nenit 3 të Konventës. Pas një letërkëmbimi me policinë e UNMIK-ut, gjatë së cilës kohë policia e UNMIK-ut kishte siguruar informata kundërthënëse rreth asaj se a ekzistonte një dosje për incidentin apo jo, Ombudspersoni konkludoi se meqë me sa dukej nuk kishte ndonjë dosje të policisë për rastin, ishte e pamundur që të konkludohet nëse kishte ndodhur një keqtrajtim tre vite më parë. Megjithatë, Ombudspersoni gjeti se dështimi i autoriteteve kompetente të policisë për të filluar ndonjë hetim rreth pohimeve të ankuesit për keqtrajtim, pavarësisht nga fakti se ishin informuar për keqtrajtimit disa herë, mes tjerash, edhe përmes Institucionit të Ombudspersonit, përbënte shkelje të nenit 3. Ky nen kërkon që të bëhen hetime efektive në pohimet për lëndime të rënda trupore, që do të sjellnin deri në identifikimin dhe dënimin e personave përgjegjës për akte të tilla kriminale. Në të njejtën kohë, Ombudspersoni vërejti se çfarëdo veprimesh të ndërmarra nga policia kundër oficerit të policisë së UNMIK-ut, për të cilin pohoet që është i përfshirë në rrahjen e ankuesit, për arsye të imunitetit që gëzojnë punonjësit e UNMIK-ut do të ishin të kufizuara në një hetim të mbrendshëm dicitplinorë të policisë. Kjo nuk do të ishte e njejtë me një procedurë penale, që do të duhej ngritur nga pohime të tilla serioze.

Ombudspersoni gjithashtu vërejti se mungesa e një mjeti ligjor efektiv, për sa i përket pohimit të aplikantit për shkelje të nenit 3 (për arsye të imunitetit që gëzon policia e UNMIK-ut) përbënte një shkelje të së drejtës për mjet ligjor efektiv sipas nenit 13 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut. Në fund, ai gjithashtu theksoi se dështimi i policisë së UNMIK-ut për të bashkëpunuar me Ombudspersonin duke i siguruar atij informata më herët, përbënte shkelje të nenit 4.7 të Regullores së UNMIK-ut 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit, i cili i obligon autoritetet ndërkombëtare në Kosovë që të bashkëpunojnë me Ombudspersonin.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej të sigurojë që në të ardhmen, Policia e UNMIK-ut të kryejë hetime të menjëhershme dhe sipas detyrës zyrtare pas pohimeve për keqtrajtim nga oficerë të policisë. Ombudspersoni më tutje rekomandoi që PSSP do të duhej të shpallte një rregullore apo të sigurojë që të miratohet një akt ligjor i nevojshëm në mënyrë që individët, të cilëve u janë shkelur të drejtat e njeriut apo që besojnë se janë viktima të keqpërdorimit të autoritetit nga ndonjë person me detyrë zyrtare në Kosovë, përfshirë këtu punonjësit e UNMIK-ut, të kenë në dispozicion të tyre një mjet ligjor efektiv. Përfundimisht, Ombudspersoni rekomandoi që PSSP të sigurojë që Policia e UNMIK-ut të vazhdojë bashkpunimin me Institucionin e Ombudspersonit duke i siguruar informata relevante, dokumente dhe dosje bazuar në ligjin e aplikueshëm.

Më 30 maj 2006, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një përgjigje nga Komesari i Policisë së UNMIK-ut, i cili pranonte rekomandimet e Ombudspersonit për të hapur

hetime të menjëhershëm *ex officio*. Ai tha se qëndrimi i tij i vazhdueshëm ka qenë të hetohen jo vetëm pohimet por edhe kuptimi i keqtrajtimit të mundshëm nga policia. Komesari më tutje theksoi se procedurat e qarta për lehtësimin e bashkëpunimit në mes Institucionit të Ombudspersonit dhe Policisë së UNMIK-ut ishin vendosur nga pararendësi i tij dhe Ombudspersoni i mëparshëm. Në përmbyllje, Komesari tha se përfaqësuesve të Institucionit të Ombudspersonit u ishte lejuar qasja në dosjet e Policisë së UNMIK-ut për ankuesin.

### **Raporti Special nr. 10**

#### **Lidhur me dështimin e Kryetarit të komunës së Prishtinës për të bashkëpunuar me Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë**

Më **20 dhjetor 2005**, Ombudspersoni publikoi një raport mbi rastin e lartpërmendur. Në këtë raport, Ombudspersoni shqyrtoi se a përbënte shkelje sipas obligimeve të Kryetarit të komunës së Prishtinës për të reaguar në letrat, masat e përkohshme dhe letërkëmbimet tjera të Ombudspersonit, dështimi i Kryetarit për të bashkëpunuar me Ombudspersonin sipas nenit 3 dhe 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit.

Ombudspersoni vërejti që ligji i lartpërmendur kërkon nga të gjitha autoritetet publike ta ndihmojnë Ombudspersonin në punë e tij dhe t'i përgjigjen kërkesave të tij për informata dhe dokumente brenda një afati të arsyeshëm kohor. Në të njejtën kohë, ai rikujtojë se në mes muajit mars dhe tetor 2005, i kishte dërguar kryetarit të komunës një numër letrash dhe intervenimesh tjera por nuk kishte pranuar kurrë përgjegjje në asnjë nga këto letra. Duke e pasur parasysh se as intervenimi i UNMIK-ut e as ai i Ministrisë të Pushtetit Lokal nuk kishin sjellë ndonjë përmirësim të situatës, Ombudspersoni konkludoi se dështimi i vazhdueshëm për të bashkëpunuar përbënte shkelje të dispozitave të lartpërmendura të Rregullores së UNMIK-ut 2000/38.

Ombudspersoni rekomandoi që Ministri i Pushtetit Lokal, në bashkëpunim me PSSP-në, do të duhej që, jo më vonë se 30 janar 2006, të sigurojnë që kryetari i komunës të përgjigjet pa vonesë të mëtejshme në kërkesat dhe intervenimet e kaluara si dhe ato të ardhme të Ombudspersonit dhe që Ministri i Pushtetit Lokal të shpërndajë kopje të këtij raporti në të gjithë komunat e Kosovës.

Institucioni i Ombudspersonit nuk ka pranuar kurrfarë përgjigje për këtë raport.

### **Nr.i regjistrimit 1133/03**

#### **Shaban Lokaj kundër Gjykatës komunale në Deçan dhe Gjykatës së qarkut në Pejë**

Më **5 janar 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit publikoi një raport lidhur me ankesën e z. Shaban Lokaj, i cili pohoi se një vendim i nxjerrë në tetor 2002 nga Gjykata komunale në Deçan ende nuk ishte ekzekutuar. Gjykata komunale kishte gjetur se z. Lokaj i ishte mohuar pa të drejtë një vend pune nga komuna e Deçanit dhe urdhëroi Komunën që ta caktojë ankuesin në vendin e kontestuar të punës. Komuna refuzoi të vepronte kështu edhe pas refuzimit të ankesës së saj pranë Gjykatës së Qarkut në Pejë.

Komuna vazhdoi me refuzimin e saj për të ekzekutuar vendimin për disa muaj, përkundër urdhërave të vazhdueshme nga Gjykata komunale. Pas një kohe, Gjykata komunale caktoi një gjobë për Komunën, e cila më pas u ankua ndaj këtij vendimi përsëri pranë Gjykatës së qarkut. Pas 18 muajsh, Gjykata e qarkut konkludoi se Gjykata komunale kishte zbatuar ligjin gabimisht dhe prishi vendimin për gjobë. Gjykata e qarkut gjithashtu e udhëzoi Gjykatën komunale që të rishqyrtojë kontestin nga marrëdhënia e punës megjithëse Gjykata e qarkut tashmë e kishte vërtetuar vendimin e plotfuqishëm në këtë rast. Më në fund, në dhjetor 2005, Gjykata komunale nxorri një aktgjykim të ri, duke suspenduar ekzekutimin e vendimit të saj fillestar të tetorit 2002 dhe e udhëzoi komunën që ta kontestojë ekzekutimin e vendimit të Gjykatës komunale.

Në këtë raport, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit gjeti dy shkelje të veçanta të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDN), që garanton të drejtën për një gjykim të rregullt. Shkelja e parë ishte udhëzimi i Gjykatës komunale për komunën që ta kontestojë ekzekutimin e vendimit të vet Gjykatës komunale. Duke udhëzuar një nga palët në procedurat pranë saj, Gjykata komunale kishte shkelur kërkesat nga KEDNj që gjykata duhet të jetë e paanshme ndaj të dy palëve. Shkelja e dytë u shkaktua nga Gjykata e qarkut, të cilës iu nevojitën 18 muaj për të nxjerrë vendimin e saj të dytë. Kjo vonesë e panevojshme përbën shkelje të kërkesave nga KEDNj-së, sipas të cilave procedurat gjyqësore duhet të jenë të shpejta.

Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit përfundoi raportin duke rekomanduar që Gjykata komunale të ekzekutojë vendimin e saj fillestar që urdhëronte punësimin e ankuesit. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit gjithashtu rekomandoi që PSSP të nisë procedurë disiplinore pranë Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë të Kosovës kundër atyre gjykatësve të Gjykatës komunale në Deçan dhe Gjykatës së Qarkut në Pejë që kanë qenë të përfshirë në vendimet e lartpërmendura.

Më **18 prill 2006**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut. Drejtori i Departamentit tha se Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës (KGjPK) ishte duke u zëvendësuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) dhe si rezultat i kësaj nuk pranonte raste të reja. Ai gjithashtu tha se pohimet në raportin e Ushtruesit të detyrës së Ombudspersonit do t'i përcjelleshin NjIGj-së për hetime dhe shqyrtim dhe se Departamenti i Drejtësisë do ta informonte IOK-në për rezultatet e hetimeve.

**Nr. i regjistrimit 1527/04 dhe 1730/05**  
**Sefedin Gashi dhe Osman Hyseni dhe të tjerë kundër**  
**Gjykatës komunale në Vushtrri**

Më **20 prill 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit publikoi një raport mbi dy raste lidhur me 112 individë nga Vushtrria, të cilët ende nuk kishin marrë borxhin nga pagat e papaguara nga dy ndërmarrje shoqërore të administruara nga AKM-ja. Gjykata komunale e Vushtrrisë kishte urdhëruar këto dy ndërmarrje, Ndërmarrja “Kosova” dhe “Vushtex”, që t’ua paguajnë borxhin ankuesve, por konfliktet në politikat ekzistuese të AKM-së kishin parandaluar kryerjen e pagesave.

Ankuesit, njëri prej të cilëve ish-punëtor i ndërmarrjes “Kosova”, dhe 111 ish-punonjës nga ndërmarrja “Vushtex”, pohuan se punëdhënësit e tyre nuk i kishin paguar ata disa muaj apo edhe me vite të tëra gjatë periudhës kohore 2000-2004. Ata e paraqitën rastin e tyre pranë Gjykatës komunale në Vushtri, e cila nxorri vendim në favor të tyre dhe urdhëroi bankat përkatëse që t’u paguajnë ankuesve borxhin nga llogaritë bankare të punëdhënësve të tyre. Meqë ankuesit nuk kishin marrë pagesat e urdhëruara me gjyq, ata plotësuan ankesa pranë Institucionit të Ombudspersonit, që filloi hetime zyrtare pas shqyrtimit paraprak të fakteve.

Në rastin e ndërmarrjes “Kosova”, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit gjeti që problemi buronte nga konflikti i ligjeve. Në njërën anë, nga bankat kërkoheshte me ligj që të veprojnë në pajtim me vendimin e Gjykatës komunale të Vushtrisë, në anën tjetër, bankave u ishte thënë nga AKM-ja që ato nuk mund të ndërmarrin asnjë veprim deri sa të shqyrtoheshin rastet nga Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit. Në rastin e ndërmarrjes “Vushtex”, ndërmarrja nuk kishte më para në xhirollogarinë e vet bankare.

Lidhur me të dy rastet, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit konkludoi që megjithëse Oda e Veçantë kishte qartësuar disa çështje të juridiksionit, ajo nuk kishte siguruar udhëzime të mjaftueshem se si të vazhdohet me përmbarimin e vendimeve të tilla. Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut siguron që e drejta për një proces të drejtë gjyqësor sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut gjithashtu mbron edhe ekzekutimin e aktgjykimeve të gjykatës. Për shkak se Gjykata komunale nuk kishte marrë udhëzimet e mevojshme praktike, ajo nuk kishte ditur se si të bëjë ekzekutimin e vendimeve të lartëpërmendura. Prandaj, ishte mungesa e udhëzimeve nga Oda e Veçantë që solli deri te shkelja e e të drejtës për proces të rregullt gjyqësor.

Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit rekomandoi që Kryetari i Odës së Veçantë do të duhej të sigurojë që Oda e Veçantë urgjentisht ta informojë Gjykatën komunale në Vushtri dhe gjykatat tjera me probleme të ngjashme se si të veprojnë në çështjet praktike të ndërlidhura me ekzekutimin e vendimeve të lartëpërmendura.

Raporti iu dorëzua zyrtarisht Parlamentit të Kosovës. Kopje të raportit gjithashtu iu dërguan edhe PSSP-së, Koordinatorit të Standardeve pranë UNMIK-ut, Kryetarit të Gjykatës komunale në Vushtri dhe Kryetarit të Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit.

Institucioni i Ombudspersonit nuk ka pranuar kurrfarë përgjigje në këtë raport.

**Nr. i regjistrimit 1406/04**  
**Ruzhdi Sefa kundër Komisionit për Emërime të Larta Publike (KELP)**

Më **25 prill 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit publikoi një raport lidhur me ankesën e z. Ruzhdi Sefa, në shërbyes i lartë publik, të cilit i ishte premtuar një post i ri nga Komisioni për Emërime të Larta Publike (KELP) por që nuk ishte caktuar nga Komisioni i lartëpërmendur. (KELP është organ i zyrës së Kryeministrit që emëron shërbyes të lartë civil brenda IPVQ-ve dhe që në konsultim me PSSP-në gjithashtu mund

t'i largojë nga pozita). Në raportin e tij, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit gjeti që për shkak të mospërbushjes së pretendimit legjitim të ankuesit për tu caktuar në një post të ri, kishte pasur shkelje të së drejtës së ankuesit sipas Nenit 1 të Protokollit, që e mbron të drejtën për pasuri.

Ankuesi kishte punuar si Sekretar i Përhershëm në Minsitrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor. Në nëntor 2003, pas disa mosmarrëveshjeve në mes z. Sefa dhe Ministrit, KELP nxorri një vendim me të cilin e dërgonte z. Sefa në pushim me pagesë. Në janar 2004, KELP nxorri një vendim tjetër në të cilin vendosi që ankuesi do të caktohet në një post të nivelit të ngjashëm brenda IPVQ-ve. Pas këtij vendimi, ankuesi më nuk pranoi pagën e tij dhe përkundër kërkesave të vazhdueshme ai nuk u emërua në një post të ri.

Në qershor 2004, z. Sefa plotësoi një ankesë pranë Institucionit të Ombudspersonit, i cili hapi hetime dhe gjeti shkelje të nenit 1 të Protokollit të lartpërmendur, që është interpretuar të mbrojtë jo vetëm pasurinë por edhe pretendimet legjitime në pasuri dhe asete. Duke dështuar në përmbushjen e vendimit të tij, KELP kishte shkelur efektivisht pretendimin ligjorë të ankuesit për asetin nga paga dhe për pozitë të krahasueshme me atë që kishte mbajtur më parë.

Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit rekomandoi që ankuesi të caktohej në pozitën që i ishte premtuar atij nga vendimi i KELP i janarit 2004, ose që t'i jepet dëmshpërblimin adekuat nëse kjo nuk është më e mundur. Raporti iu dorëzua zyrtarisht Parlamentit të Kosovës. Kopje të raportit gjithashtu iu dërguan edhe PSSP-së, Koordinatorit të Standardeve pranë UNMIK-ut si dhe Kryeministrit, njëkohësisht Kryesuesit të KELP-së.

Institucioni i Ombudspersonit nuk ka pranuar kurrfarë përgjigje në këtë raport.

#### **Nr. i regjistrimit Ex Officio 42/2005**

#### **Lidhur me çështjen e diskriminimit të mundshëm në dhënien e materialeve të ndërtimit për riparimin e shtëpive të kategorizuara në kategorinë 4B, pas tërmetit të 24 prillit 2002 në rajonin e Gjilanit**

Më 30 qershor 2006, Ombudspersoni publikoi një raport mbi rastin e lartpërmendur. Në këtë rast, Ombudspersoni hetoi ankesat e pranuar nga individë të caktuar të pakënaqur nga dështimi i komunës së Gjilanit për t'ua ndarë materialet ndërtimore. Komuna kishte marrë fonde nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave për të blerë dhe për t'ua shpërndarë materialin ndërtimorë personave të cilëve u ishin dëmtuar apo shkatërruar shtëpitë si rezultat i tërmetit të 24 prillit 2002. Shumica e ankesave u pranuar nga personat, shtëpitë e të cilëve ishin dëmtuar rëndë apo shkatërruar plotësisht. (kategoria 4B sipas sistemit përzgjedhës të komunës).

Në raportin e tij të publikuar më 30 qershor 2006, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit konkludoi që komisioni i formuar nga komuna për të identifikuar se kush do të fitojë të drejtën për ndihmë nuk kishte përpiluar kurrfarë rregullash procedurale për të rregulluar procesin e tij vendimmarrës. Komisioni gjithashtu nuk duhej t'i raportonte Kuvendit Komunal apo ndonjë organi tjetër, e as që ekzistonin çfarëdo dispozita tjera për të rregulluar përbërjen e tij apo për të specifikuar kushtet për kuorum.

Ky komision kishte vepruar me pandëshkueshmëri të plotë, pa ndonjë mbikëqyrje të rëndësishme apo mbrojtje kundër vendimeve të tij arbitrare. Prandaj, procedurat e komisionit dështuan në mbrojtjen e të drejtave të ankuesve që të jenë të lirë nga çdo formë diskriminimi. Meqë ndihma në materiale që u ishte premtuar viktimave të tërmetit ishte e drejtë materiale, e mbrojtur nga e drejta e pronës sipas nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit konkludoi se kishte pasur shkelje të së drejtës së ankuesit sipas këtij neni në lidhje me nenin 14 të Konventës, e cila thekson se të gjithë personat duhet të jenë të lirë nga çdo formë e diskriminimit.

Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit rekomandoi që Ministri i Pushtetit Lokal do të duhej të sigurojë që ankesat e mëtejshme nga personat shtëpitë e të cilëve janë kategorizuar nën kategorinë 4B dhe të cilët konsiderojnë se është dashur të marrin ndihmë në materiale nga komuna duhet të shqyrtohen dhe trajtohen në mënyrë të duhur nga Komisioni kompetent për ankesa, i krijuar për këtë qëllim nga komuna e Gjilanit.

Më tej, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit rekomandoi që Ministri do të duhej të sigurojë që në të ardhmen, kur në komuna krijohen ad hoc komisione, në veçanti nëse ato përfshijnë shpërndarjen e ndihmës financiare, Kuvendi Komunal përkatës të hartojë dhe miratojë procedurë të duhur për këto komisione si dhe kriteret në bazë të së cilave do të shpërndaheshin ato ndihma

Në fund, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit rekomandoi që Kuvendi i Kosovës të përpilojë një Ligj për Ndihmë Emergjente që do t'i adresonte brengat e theksuara nga Ombudspersoni në këtë raport.

#### **Nr. i përkohshëm i regjistrimit 1599/05 dhe 238/01**

**Feriz Gërvalla dhe të tjerë,  
Zejnullah Piraku dhe të tjerët kundër  
Gjykatës komunale në Gllgovc**

Më **30 qershor 2006**, Ombudspersoni publikoi një raport mbi rastin e lartpërmendur. Ky rast kishte të bëjë me rrënimin e lokalet afariste nga komuna e Gllgovcit përkundër një mase të përkohshme të Gjykatës komunale të Gllgovcit të vitit 2001 që e ndalonte rrënimin. Gjatë viteve 1992-1997, komuna ua kishte dhënë ankuesve lokalet afariste. Pas përfundimit të luftimeve të vitit 1998-99, autoritetet komunale të themeluara nga UNMIK-u konsideronin se lokalet afariste ishin ndërtuar pa leje apo me leje të qeverisë së Serbisë, të cilat autoritetet komunale i konsideronin si forcë okupuse dhe të paligjshme. Komuna nxorri shumë urdhëra për rrënimin e këtyre lokaleve afariste, por PSSP dhe përfqësues të ndryshëm të UNMIK-ut parandaluan zbatimin e tyre. Këto lokale u rrënuan përfundimisht në mars të vitit 2005, përkundër faktit se vendimi i Gjykatës komunale për masë të përkohshme ishte ende në fuqi.

Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit përkujtojë të drejtën precendentale të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila i kishte bërë interpretim nenit 8 të Konventës Evropiane, që mbronë të drejtën për repsektimin e vendbanimit, të përfshijë edhe të drejtën për mbrojtje të hapsirave afariste. Ai konkludoi që rrënimi i lokaleve të ankuesve

përbënte shkelje të këtij neni për shkak se, megjithëse komuna kishte të drejtë të rrënojë objektet të cilat ajo i konsideronte se janë ndërtuar në mënyrë të paligjshme, ajo nuk mund të ushtrojë këtë të drejtë përballë një vendimi të vlefshëm të Gjykatës që urdhëron mos veprojë në atë mënyrë.

Për më tepër, Ushtuesi i detyrës së Ombudspersonit gjeti se rrënimi ishte në kundërshtim me të drejtën për pronë, të mbrojtur me nenin 1 të Protokollit nr.1 të konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ushtuesi i detyrës së Ombudspersonit, më tej, rekomandoi që komuna e Gllogovcit t'i kompensojë ankuesit për lokalet e tyre të shkatërruara.

**Nr. i regjistrimit Ex Officio 43/2005**  
**Lidhur me përdorimin e gjuhës së folur dhe të shkruar boshnjake në Gjykatën komunale në Pejë**

Më **30 qershor 2006**, Ombudspersoni publikoi një raport mbi rastin e lartpërmendur. Në këtë rast, një person me përkatësi etnike boshnjake u ankua që procedurat civile gjyqësore ku përfshihej një kontest pronësor pranë Gjykatës komunale në Pejë, ishin zhvilluar në gjuhën shqipe dhe se ai nuk ishte informuar për të drejtën e tij për t'iu siguruar përkthimi, siç kërkohet me nenin 102. para.2 i Ligjit Jugosllav mbi Procedurën Kontestimore. Ankuesi bëri ankesë ndaj këtij vendi, mes tjerash, në këto baza, pas së cilës rasti u kthye për rishqyrtim në Gjykatën komunale, ku gjatë dy seancave të para gjyqësore morri pjesë edhe përkthyesi për gjuhën boshnjake. Në të dy seancat gjyqësore, ankuesi ishte informuar për të drejtën e tij për të pasur përkthyes por ai hoqi dorë nga kjo e drejtë në seancën e dytë gjyqësore duke deklaruar se e kuptonte gjuhën shqipe.

Në këtë raport, Ushtuesi i detyrës së Ombudspersonit e analizojë rastin si nga këndvështrimi i ligjit ndërkombëtar ashtu edhe i atij vendor. Lidhur me ligjin vendor, Ushtuesi i detyrës së Ombudspersonit vërejtë që dështimi fillestar i gjykatës për ta informuar ankuesin për të drejtën e tij për përkthyes kishte shkelur nenin 102 para. 2 të Ligjit Jugosllav mbi Procedurën Kontestimore. Megjithatë, rasti ishte rigjykuar nga Gjykata e qarkut në Pejë, ku ishte cituar, mes tjerash, dështimi i Gjykatës komunale për të zbatuar nenin 102 para. 2. Gjatë rigjyqimit në Gjykatën komunale, ankuesi ishte informuar për të drejtën e tij për përkthyes dhe një përkthyes i tillë ka qenë prezent në seancë deri kur ankuesi kishte hequr dorë nga kjo e drejtë. Prandaj, Ushtuesi i detyrës së Ombudspersonit gjeti që Gjykata komunale nuk kishte shkelur më dispozitat e lartpërmendura të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Lidhur me të drejtën ndërkombëtare, Ushtuesi i detyrës së Ombudspersonit vërejtë që, pasi që nuk kishte ndonjë të drejtë specifike për ndihmë falas të ofruar nga përkthyes gjatë procedurave civile, çështja në fjalë kishte të bëjë me parimet ndërkombëtare më të përgjithshme të së drejtës për seancë dëgjimore, në këtë rast mjaftonte që ankuesi ishte përfaqësuar nga një Avokat kompetent shqipfolës gjatë procedura gjyqësore. Lidhur me të drejtën për barazi të palëve, Ushtuesi i detyrës së Ombudspersonit gjeti që bazuar në jurisprudencën ndërkombëtare, kërkesa për proces të regullt nuk e obligon Gjykatën që të sigurojë përkthyes për personat që janë në gjendje të kuptojnë dhe të shprehin në mënyrë

të duhur në gjuhën zyrtare që përdoret nga Gjykata. Gjithashtu, nuk u takon palëve të vendosin se në cilën gjuhë do të zhvillohen procedurat gjyqësore dhe nëse një palë vendos të komunikojë me gjykatën në një gjuhë zyrtare, ai apo ajo nuk mund të pohojnë se ka pasur diskriminim ndaj tyre në bazë të gjuhës. Prandaj, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit konkludoi që nuk kishte pasur shkelje të së drejtës së ankuesit për proces të rregullt gjyqësor sipas të drejtës ndërkombëtare.

## **ANEKSI II: MASAT E PËRKOHSHME**

### **Shitja e mundshme e pronës së përbashkët gjatë procedurave të shkurorëzimit**

Më 28 korrik, Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryetarit të Gjykatës komunale në Prishtinë, me të cilën kërkonte nga ai që të parandalojë, me një masë të përkohshme, transferimin e pronësisë të një prone të përbashkët të znj. B.B.A. dhe ish burrit të saj. B.B.A. pohoi se kishte informata se ish burri i saj kishte planifikuar t'ia transferojë pronën e tyre të përbashkët një pale të tretë dhe se në fakt tashmë i kishte transferuar disa pasuri që ishin pronë e përbashkët. Ajo thashmë kishte parashtruar kërkesë për masë të përkohshme pranë Gjykatës komunale në Prishtinë më 9 dhjetor 2004, Që nga 28 korriku 2005, Gjykata komunale nuk kishte nxjerrë vendim lidhur me kërkesën e saj për masë të përkohshme dhe për pasojë ajo ishte në rrezik që të humbë të drejtën në pjesë e saj të pronës. Prandaj, Ombudspersoni kërkoi nga Gjykata komunale që të ndërmarrë veprime të menjëhershme për të parandaluar dëmin e papërmirësueshëm ndaj B.B.A. dhe t'i sigurojë një kopje të vendimit të gjykatës.

Më **1 gusht 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Kryetari i Gjykatës komunale në Prishtinë, në të cilën theksohej se rekomandimi për masë të përkohshme ishte pranuar dhe se masa ishte vendosur dhe se do të ishte në fuqi deri në vendimin e plotësuqishëm të Gjykatës komunale mbi ndarjen e pronës së përbashkët të ankueses dhe burrit të saj. Pas kësaj, Ombudspersoni e mbylli rastin si të zgjidhur pozitivisht.

### **Largimi me forcë i lokaleve afariste në Gllgovc**

*Më 29 dhjetor 2004, Ombudspersoni pranoi një ankesë lidhur me një vendim të lëshuar nga Drejtoria e Inspeksionit e Komunës së Gllgovcit, në lidhje me përmbarimin e vendimeve për rrënimin dhe largimin e dyqaneve/punëtorive të cilat ndodhen në rrugën "Skënderbeu" në Gllgovc.*

*Më 1 mars 2005, Ombudspersoni i dërgoi Ministres së Shërbimeve Publike një kërkesë urgjente për caktimin e masës së përkohshme, duke kërkuar nga ajo që të sigurojë që komuna e Gllgovcit të suspendojë largimin dhe rrënimin e paraparë të punëtorive/dyqaneve të ankuesve. Ombudspersoni e konsideronte që një veprim i tillë do të ishte në kundërshtim me një aktvendim të mëparshëm të gjykatës që, përmes masës së përkohshme, kishte ndaluar komunën t'i rrënojë pronat në fjalë në pritje të një aktvendimi të plotëfuqishëm të gjykatës në lidhje me pengim posedimin e pohuar mbi pronën e tyre nga ana e komunës e Gllgovcit.*



*Më 2 mars 2005, Ombudspersoni, pasi që nuk kishte pranuar kurrfarë përgjigje nga Ministria e Shërbimeve Publike, i dërgoi një kërkesë të ngjashme PSSP-së. Në letrën e tij, Ombudspersoni shprehu dyshimin që Ministria e Shërbimeve Publike kishte ndërmarrë ndonjë veprim në këtë çështje pasi që dhjetë lokale afariste tashmë ishin shkatërruar kurse pritej të vazhdojë edhe rrënimi i lokaleve tjera afariste. Sipas Ombudspersoni, për këtë arsye ai kishte vendosur që këtë çështje t'ia drejtojë drejtpërdrejt PSSP-së, duke kërkuar nga ai që të shfrytëzojë autorizimet e tij të jashtëzakonshme për të garantuar që mos të vazhdohet me rrënimet e objekteve tjera, së paku derisa Gjykata komunale në Glllogovc të mos nxjerrë një aktvendim të plotfuqishëm. Në letrën e tij, Ombudspersoni gjithashtu theksoi që e konsideronte sjelljen e tillë të komunës së Glllogovcit si të papranueshme dhe si mospërfillje të qartë të parimeve të sundimit të ligjit dhe kërkoi nga PSSP të marrë parasysh ndikimin social të kësaj çështjeje, që do ta dëmtonte në mënyrë të papërmirësueshme emrin e institucioneve të pushtetit lokal po të lejohej vazhdimi i veprime të paligjshme në këtë mënyrë.*

*Më 5 maj 2005, Ombudspersoni i dërgoi përsëri një letër PSSP-së, përmes së cilës kërkoi informata lidhur me veprimet që UNMIK-u apo autoritetet kompetente lokale kishin ndërmarrë apo planifikonin t'i ndërmerrnin lidhur me këtë çështje.*

Më **12 gusht 2005**, Ombudspersoni pranoi një përgjigje nga ZPSSP për Administratë Civile. Në letrën e tij ZPSSP pajtohej me gjetjet e Ombudspersonit se rrënimi dyqaneve në Glllogovc që kishte ndodhur më 2 mars 2005 ishte bërë përkundër faktit se më 7 maj 2001 ishte nxjerrë një vendimit për masë të përkohshme nga Gjykata komunale në Glllogovc që ende ishte në fuqi. Gjithashtu, ZPSSP vërtetoi suspendimin e procesit të rrënimin bazuar në Vendimin Ekzekutiv nr. 2001/6, si dhe shqyrtimin në vazhdim nga gjykatat kompetente dhe Kuvendi Komunal. UNMIK-u e konsideronte këtë si shmangje nga sundimi i ligjit dhe shkelje të Standardit të dytë, sundimit të ligjit, i cili synon krijimin e një kornize të shëndoshë ligjore dhe mënyrave efektive të zbatimit të ligjit në pajtim me standardet evropiane. Veç kësaj, ZPSSP i kishte shkruar Ministrit të Pushtetit Lokal për t'i dhënë atij mundësinë që të veprojë në mënyrë të duhur për këtë rast dhe të parandalojë situata të ngjashme në të ardhmën. Në përmbyllje, ZPSSP nuk desh të shprehte mendimin e tij lidhur me vlerat e rastit civil të paraqitur nga ankuesit duke e drejtuar përgjegjësinë për zgjidhjen e rastit tek Institucionet e Përkohshme të Vetqeverisjes (IPVQ) dhe gjykatave kompetente.

### **Një përpjekje për të eksproprijuar një pronë private afariste në Prizren**

Më 20 prill 2005, Ombudspersoni pranoi një ankesë nga një aplikant të cilit do t'i rrënohej lokali i tij afarist në komunën e Prizrenit në prill 2005. Lokali afarist kontestues ishte ndërtuar nga aplikanti në pronën e tij, që i është eksproprijuar nga ana e Kuvendit Komunal të Prizrenit në vitin 1983. Megjithatë, eksproprijimi nuk ishte kryer kurrë. Megjithatë, më qershor 2001, komuna kishte dhënë urdhër për rrënimin e lokalit. Ky urdhër ishte kundërshtuar menjëher nga ankuesi pranë Gjykatës komunale, e cila urdhëroi suspendimin e të gjitha aktiviteteve lidhur me parcelën në fjalë, në pritje të përfundimit të procedurave civile. Megjithatë, më 14 prill 2005, ankuesi pranoi një njoftim të lëshuar nga Drejtoria e Njësisë së Inspekcioneve pranë Komunës së Prizrenit me të cilin lajmërohej se do të bëhet rrënimi i lokalit të tij afarist.

*Më 20 prill 2005, Ombudspersoni i dërgoi një kërkesë për masë të përkohshme Ministres për Shërbime Publike duke kërkuar nga ajo që të sigurojë suspendimin e vendimin fillestar për rrënim të 11 qershorit 2001, deri në përfundim të hetimeve të Ombudspresonit në këtë rast. Ai theksoi se Njësia për Inspektime kishte caktuar rrenimin e lokalit më 21 prill 2005, pavarësisht nga vendimi i gjykatës që ndalonte qartë një veprim të tillë dhe se rrënimi mund t'i shkaktojë aplikantit dëme të papërmirësueshme*

**Më 19 korrik 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Ministria e Shërbimeve Publike, në të cilën shkruante se Ministria e Shërbimeve Publike nuk kishte kompetenca për të suspenduar vendimin për rrënim të 11 qershorit 2001 dhe se kjo ishte një vendim komunal. Ministria shkroi se në rast se autoritetet komunale kishin nxjerrë vendim të paligjshëm atëherë rasti duhej t'i drejtohej Gjykatës Supreme të Kosovës. Në pajtim me nenin 3 të Rregullorës së UNMIK-ut 2000/45 mbi Vetqeverisjen e Komunave, PSSP mund të vlerësojë çështjen dhe të suspendojë vendimin për rrënim, sepse i takon atij si personi me përgjegjësinë kryesore për të vendosur nëse Drejtoritë e Komunave veprojnë në pajtim me ligjin.

**Më 30 gusht 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga përfaqësuesi i UNMIK-ut pranë Ministrisë së Pushtetit Lokal, me të cilën vërtetonte se UNMIK-u e kishte ngritur çështjen pranë Ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përhershëm në Ministrinë e Pushtetit Lokal, i cili kishte pohuar se do ta shqyrtonte rastin dhe do të tregonte nëse do të ndërmerreshin veprime.

**Më 23 shtator 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Përfaqësuesi i UNMIK-ut pranë Ministrisë së Pushtetit Lokal, me të cilën Përfaqësuesi azhurnonte Ombudspersonin mbi procedurat gjyqësore lidhur me rastin.

### **Problemet në rindërtimin e një fshati të minuar**

*Më 9 shtator 2003, z. H.N. kishte paraqitur ankesë pranë Institucionit të Ombudspersonit në emër të banorëve të fshatit Milaj në komunën e Prizrenit. Ata nuk mund t'i qaseshin fshatit të tyre, që ishte shkatërruar dhe minuar gjatë luftimeve të vitit 1999, duke i lënë 43 familje pa shtëpi. Në shkurt 2004, Drejtori i Rindërtimit në Komunën e Prizrenit e informoi një përfaqësues të Institucionit të Ombudspersonit se rindërtimi në këtë fshat ishte i pamundshëm sepse 80 përqind e fshatit ishte zonë e minuar dhe se komuna nuk kishte para të mjaftueshme për deminuar dhe rindërtuar fshatin. Më 19 korrik 2004, Ombudspersoni i shkroi një letër Kryeministrit të Kosovës, duke kërkuar që të gjindet një zgjidhje e mundshme.*

*Më 28 korrik 2004, Zyrtari i Lartë i Zyrës së Kryeministrit për Çështje Sociale e informoi Institucionin e Ombudspersonit se Zyra e Kryeministrit i kishte përgjegjësi të kufizuara për këtë rast por rasti ishte përcjellë në TMK, e cila do të shqyrtonte çështjen e deminimit.*

*Më 29 prill 2005, shumica e fshatarëve ende ishin duke jetuar në qendra kolektive apo në pronë të huaj, prandaj Ombudspersoni i dërgoi PSSP-së një kërkesë urgjente për masë të përkohshme, duke kërkuar që të suspendojë vendimin e DÇPB-së për të dëbuar fshatarët.*

*Ombudspersoni rekomandoi themelimin e një komisioni të përbashkët të përbërë nga Komuna e Prizrenit, IPVQ-të dhe DÇPB, për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme për fshatarët.*

Më **24 mars 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Kryeministrit duke i bërë thirrje që të ndërmer veprime për të ndihmuar 43 familje të fshatit Milaj që të rindërtojnë shtëpitë e tyre në komunën e Prizrenit. Meqë kishte një numër të madh të fshatarëve të cilën nuk e kishin zgjidhur problemin e banimit dhe nuk kishin marrë ndihmë të mjaftueshme nga komuna e Prizrenit, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit kërkoi nga Kryeministri që, deri sa të gjindet një zgjidhje më e mirë, të gjindet një zgjidhje e përkohshme për fshatarët.

Më **6 prill 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit pranoi një letër nga Zyrtarja e Lartë e Zyrës së Kryeministrit për Çështje Sociale, e cila sqaroi se se Zyra e Kryeministrit kishte përcjellë letrat e Ushtruesit të Ombudspersonit tek TMK dhe PSSP. Zyrtarja e Lartë rekomandoi që, në të ardhmën, Institucioni i Ombudspersonit t'ia adresojë TMK-së, SHPK-së dhe KFOR-it letrat lidhur me minat, sepse ato ishin institucionet përgjegjëse për pastrimin e minave. Më tej, ajo rekomandoi që institucioni të kontaktojë autoritetet komunale në Prizren lishur me çështjen e gjetjes së një vendbanimi për banorët e fshatit Milaj.

### **Eksproprijimi i pronës private për ndërtimin e rrugës Komoran-Carralevë**

Më **26 korrik 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Ministrit për Mjedis dhe Planifikim Hapsinor, me të cilën kërkoi nga Ministri që të ndërmarrë veprime urgjente për të suspenduar projektin për ndërtimin e rrugës Komoran-Caralevë, në komunën e Lipjanit, sepse banorët e fshatrave Rusinoc dhe Pjetërshticë ishin ankuar se projekti kishte filluar pa nisur procedurat për eksproprijimin e tokave të ankuesve.

Më **14 tetor 2005**, Ombudspersoni i dërgoi përsëri një letër Ministrit, duke përsëritur kërkesat dhe brengat e tij.

Më **28 tetor 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Ministri, i cili sqaroi se Ministria që ai udhëhiqte nuk ishte përgjegjëse për këtë projekt dhe se Ombudspersoni duhet t'ia drejtojë kërkesën e tij Ministrit për Transport dhe Postë-Telekomunikacion.

Më **10 nëntor 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Ministrit për Transport dhe Postë-Telekomunikacion, duke ia përcjellur atij kërkesën dhe brengat e lartëpërmendura.

Më **27 shkurt 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersoni i dërgoi përsëri një letër Ministrit të Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka përsëritur kërkesën dhe brengat e tij të theksuara në letrën e Ombudspersonit të 10 nëntorit 2005.

Më **10 mars 2006**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Ministri për Transport dhe Postë-Telekomunikacion, duke sqaruar se Ministria kishte nënshkruar një memorandum të mirëkuptimit me të gjitha komunat e Kosovës lidhur me infrastrukturën

rrugore, sipas të cilit të gjitha komunat obligohen të zgjidhin çfarëdo çështje pronësore-juridike për rrugët që kalojnë në territorin e tyre. Ministri, me tej, theksoi se përgjegjësia i takonte komunave të Gllogovcit, Shtimes dhe Lipjanit, që të zgjidhin çështjet pronësore-juridike në komunat e tyre dhe se Ministria nuk konsideronte se është përgjegjëse për këto çështje.

Sipas informatave të fundit në dispozicion të Institucionit të Ombudspersonit, komuna e Shtimes dhe ajo e Lipjanit kanë themeluar komisione të veçanta për të përcaktuar në mënyrën më të drejtë së kush duhet të marrë kompensim për eksproprijimet.

### **Kontestet në mes fqinjëve në Fushë Kosovë**

Më **1 qershor 2006**, ankuesi z. M.Đ. i dërgoi Inspektionit për Planifikim të Qytetit të Fushë Kosovës një kërkesë dhe të gjitha dokumentet e nevojshme, që fqiu i tij të urdhërohet, me një masë të përkohshme, që të menjëherë të ndërpres punët ndërtimore që pengojnë qasjen e z. M. Đ. në shtëpinë e tij. Punët ndërtimore ishin duke u kryer në pjesë të parcelës ku ankuesi ishte bashkëpronar, por puna kishte filluar pa pëlqim e tij paraprak. Pjesa e kontesuar e parcelës ishte shfrytëzuar më parë si rrugë nga ankuesi dhe fqiu i tij dhe ankuesi nuk kishte rrugë tjetër që t'i qaset shtëpisë së tij. Që nga fillimi i punëve, ankuesi nuk kishte pasur mundësi të hyjë apo t'i qaset shtëpisë dhe prones së tij me automjetet.

Më **19 qershor 2006**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një ankesë nga z. M. Đ., i cili pohonte se nuk kishte pranuar kurrfarë përgjigje në letrën e tij drejtuar Inspektionit për Planifikim të Qytetit të Fushë Kosovës. Sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë, Inspektioni i lartëpërmendur dhe Departamenti Komunal për Planifikim të Qytetit, Gjeodezi dhe Kadastër është dashur të përgjigjen apo të ndërmarrin masa brenda një afati 15 ditësh që nga koha e dorëzimit të kërkesës nga z. M. Đ.

Më **23 qershor 2006**, Ushtuesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Kryetarit të komunës të Fushë Kosovës, duke kërkuar nga ai të ndërmerrë veprime urgjente për të siguruar ndërprerjen e punëve ndërtimore në token në fjalë, në pritje të hetimeve të mëtejshme të Ushtuesit të detyrës së Ombudspersonit.

Më **29 qershor 2006**, Institucioni i Ombudspersonit u njoftua nga ankuesi se komuna e kishte ndaluar ndërtimin e kontestuar si përgjigje ndaj kërkesës për masë të përkohshme.

## **ANEKSI III: PËRMBLEDHJE E LETRAVE TË PËRZGJEDHURA**

### **Diskriminimi i pohuar i UNMIK-ut ndaj gazetarëve serbë**

Më **1 korrik 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër drejtoreshës të Departamentit të UNMIK-ut për Informim Publik (DIP), duke shprehur brengën e tij lidhur me kufizimin nga ana e UNMIK-ut të qajses së gazetarëve serbë në një vend hetimi mjeko-ligjorë në Klinë.

Më **18 korrik 2005**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga drejtoresha e DIP-së, e cila thoshte se DIP-së ndjente keqardhje për faktin se ishte dashur të kufizojë qasjen e gazetarëve të të gjitha etniteteve, por brengat për siguri (vendi ishte një luginë e thellë) dhe ruajtja e vendit të krimit ishin arsytet për të kufizuar numrin e vizitorëve. Në fund, 6 gazetarëve të Kosovës dhe 5 gazetarëve serbë, të cilët ishin zgjedhur sipas kriterëve standarde të zbatuara në shtëpitë e tyre përkatëse botuese – tirazhit dhe shfrytëzimit si burim primar i lajmit. Drejtoresha, më pas sqaroi se kishte ofruar organizimin e vizitave në këtë vend për gazetarë tjerë, në kohëra tjera, por asnjë nuk kishte shfaqur interesim për këtë.

### **Dështimi i komunës së Prishtinës për t’iu përgjigjur Institucionit të Ombudspersonit**

*Më 17 mars 2005, Ombudspersoni i dërgoi një letër Ministrit të Pushtetit Lokal, duke sqaruar se Kryetari i komunës së Prishtinës kishte refuzuar të përgjigjet në të gjitha përpjekjet e Institucionit për të kontaktuar apo për të marrë dokumente ose informacione tjera nga zyra e tij. Ombudspersoni kërkoi nga Ministri të sigurojë që Kryetari i komunës së Prishtinës t’i përgjigjet letrave të institucionit dhe përpjekjeve për të kontaktuar me atë, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/38. Ombudspersoni i dërgoi kopjet e kësaj letrë ZPSSP-së për Administratë Civile dhe Koordinatorit të UNMIK-ut për Standarde.*

Më **4 korrik 2005**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një kopje të një letrë që i ishte drejtuar dy zyrtarëve të lartë të komunës së Prishtinës nga Ushtuesi i detërës së Përfaqësuesit të UNMIK-ut në këtë komunë. Letra i ishte drejtuar kryetarit të Kuvendit Komunal dhe Kryeshefit të Ekzekutivit të komunës. Në letrën e tij, Përfaqësuesi i UNMIK-ut drejtonte vëmendjen e zyrtarëve ndaj faktit që, gjatë gjithë vitit 2005, Institucioni i Ombudspersonit nuk kishte pranuar asnjë përgjigje të vetme nga komuna në kërkesat e ndryshme të saj për informacione. Ai i bënte thirrje komunës që ta përmirësonte nivelin e përgjigjeve dhe që t’i jepte prioritet komunikimit me institucionin, meqë institucioni merret me shumë çështje që lidhen drejtëpërdrejt me zbatimin e standardeve për Kosovën.

Nuk ka pasur përgjigje për këtë letër dhe komuna e Prishtinës ende nuk është përgjigjur në asnjë letrat e dërguara nga Institucioni i Ombudspersonit që nga fillimi i vitit 2005.

### **Mungesa e mjeteve ligjore për anëtarët e Shërbimit Civil të Kosovës dhe kandidatët për këtë shërbim**

I themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës (KPM) ka disa detyra, duke përfshirë këtu shqyrtimin e rasteve të ngritura nga anëtarë dhe kandidat të Shërbimit Civil të Kosovës kundër praktikave qeveritare të rekrutimit dhe punësimit. Megjithëse është themeluar në vitin 2001, KPM nuk ka filluar me shqyrtimin e ankesave deri në mes të vitit 2005, dhe anëtarët e shërbimit civil dhe kandidatët e këtij shërbimi nuk kishin ku të ankoheshin, meqë anjë nga gjykatat e rregullta nuk kishte juridiksion mbi çështje të tilla. Në

periudhën e mëparshme raportuese, Institucioni i Ombudspersonit publikoi një raport lidhur me këtë çështje, duke gjetur se dështimi i KPM-së për të procesuar ankesat lidhur me shërbimin civil të Kosovës kishte shkelur të drejtat e ankuesve për një proces të rregullt gjyqësor sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut.

*Më 17 qershor 2005, Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së duke theksuar se KPM ende nuk ishte operacional, me sa dukej, për shkak të faktit se puna e nevojshme në rregullat e procedurave nuk ishte finalizuar ende. Duke theksuar që numri i personave që drejtoheshin në KPM ishte në ngritje të vazhdueshme, Ombudspersoni kërkoi nga PSSP që ta informonte atë se a janë përfunduar apo kur pritet të përfundohen rregullat procedurale.*

**Më 4 korrik 2005,** Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Ushtuesi i detyrës së ZPSSP për Administratë Civile, e cila sqaronte se KPM tashmë ishte duke kryer dy nga tri funksionet që ka - shqyrtimi i emërimeve të larta në shërbimin civil të Kosovës dhe vlerësimin e pajtueshmërisë të parimeve të punësimit në shërbimin civil. Për sa i përket funksionit të tretë, dëgjimit të ankesave nga shërbyesit civil, rregullat procedurale të KPM-së ishin ende duke u përgatitur por Ushtrësja e detyrës së ZPSSP pohoi se ato do të përfundohen dhe se KPM do të jetë plotësisht funksional deri në fund të gushtit 2005.

#### **Mungesa e ujit të pijshëm në shkollat e Kosovës**

*Më 30 qershor 2005, Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryeministrit të Kosovës lidhur me mungesën e ujit të pijshëm në shkollat në Kosovë. Ombudspersoni theksoi se një hulumtim i bërë në vitin 2002 nga Instituti i Shëndetit Publik në Prishtinë ka treguar se uji i pijshëm ishte i kontaminuar në 83 përqind të shkollave të Kosovës dhe/ose e papërdorshme për pije. Në qershor 2004, Minsitri për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, Ministria për Mjedis dhe Planifikim hapsinor dhe Ministria për Shëndetësi kishin nënshkruar një memorandum mirëkuptimi, duke u pajtuar që t'i koordinojnë përpjekjet për të përmirësuar qasjen e shkollave në ujë të pijshëm. Megjithatë, që nga muaji maj 2005, nuk është bërë ndonjë përmirësim i rëndësishëm. Prandaj, Ombudspersoni kërkoi nga Kryeministri që të ndërmerrë veprime urgjente për të përmirësuar situatën.*

**Më 11 korrik 2005,** Ombudspersoni pranoi një letër nga Sekretari i Përhershëm në Ministrinë për Mjedis dhe Planifikim Hapsinor, i cili sqaroi obligimet e kësaj Ministrie sipas memorandumit ndërministrorë të mirëkuptimit, duke përfshirë trajnimin e mësuesve mbi vetëdijësimin për mjedisin, mësimet lidhur me mjedisin për nxënësit dhe përkrahje për shkollat në planifikimin e tyre hapsinor.

**Më 13 korrik 2005,** Ombudspersoni pranoi një letër nga Ministri për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, i cili tha se Ministria do të respektonte memorandumimin e mirëkuptimit dhe se shpresonte që edhe Ministria për Shëndetësi si dhe ajo e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor do të veprojnë njëloj. Ai, më pas, pohoi se Ministria e tij do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për t'i paralajmëruar shkollat ku nuk ka ujë të pijshëm dhe për t'i kërcënuar me mbyllje nëse ato nuk ndërmarrin masat e nevojshme për këtë.

Më **28 shtator 2005**, Ombudspersoni i dërgoi përsëri letër Kryeministrit, duke e informuar atë për letrat e lartëpërmendura të pranuar por duke sqaruar se, për fat të keq, veprimet e këtyre dy ministrive nuk kanë mjaftuar për të përmirësuar situatën. Ombudspersoni bëri të ditur se ende nuk kishte pranuar përgjigje nga Kryeministri dhe përsëriti kërkesën e tij që ai të shfrytëzojë autorizimet ndaj autoriteteve përkatëse për të përmirësuar situatën.

Më **7 tetor 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga një Zyrtare e Lartë e Zyrës së Kryeministrit, Sekretarisë Koordinuese të Qeverisë, ku sqarohej se Zyra e Kryeministrit kishte kërkuar nga ministrinë e lartëpërmendura që t'i dërgojnë Ombudspersonit letra për të sqaruar se çfarë masash ishin duke ndërmarrë ato. Zyra e Kryeministrit kishte ndërmarrë masa për të krijuar një grup punues për t'i bashkërenduar punët me ato, në mënyrë që të bëhet çdo gjë e mundur dhe sa më shpejtë që është e mundur. Letra shprehte falënderimin e Kryeministrit për interesimin e Ombudspersonit në këtë çështje.

Institucioni i Ombudspersonit ka vazhduar të monitorojë situatën, e cila nuk është përmirësuar ende.

### **Kthimi me forcë i refugjatëve të grupeve të caktuara minoritare**

*Më 4 mars 2005, Ombudspersoni i dërgoi një letër Ministrit të Punëve të Brendshme të Italisë dhe Gjermanisë si dhe Ministres për Migrim dhe Politikë për Azil në Suedi. Ombudspersoni shprehu brengën e tij për informata të pranuar se këto shtete kishin për qëllim që t'i kthejnë refugjatët e etnicitetit romë, ashkali dhe egjiptian në Kosovë. Brengat e tij u përqendruan në rreziqet dhe vështirësitë me të cilat do të ballafaqoheshin të kthyerit, përfshirë krimet në baza etnike dhe qasje të kufizuar në shërbime publike. Ombudspersoni pranoi përgjigje nga Ministri gjerman dhe ai suedez më 24 mars 2005, përkatësisht më 12 prill 2005.*

Më **19 korrik 2005**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Ministri i Punëve të Brendshme të Italisë në atë kohë, i cili pohonte se qeveria e Italisë nuk kishte kthyer dhe nuk planifikonte të kthente asnjë refugjat të tillë në Kosovë. Ai, më tej, theksoi se Ministria kishte udhëzuar shërbimet relevante brenda ministrisë së tij që të zbatojnë me besnikëri Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

### **Mungesa e mjeteve ligjore për anëtarët e Shërbimit Civil të Kosovës dhe kandidatët për këtë shërbim**

*Më 28 qershor 2005, Ombudspersoni publikoi një raport lidhur me rastin e znj. F.B.R, në të cilin gjeti se pamundësia e vazhdueshme e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës (KPM) për të procesuar ankesat e anëtarëve dhe kandidatëve të Shërbimit Civil të Kosovës ka shkelur të drejtën e F.B.R që çështja e saj të dëgjohet drejtësisht nga një gjykatë sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Mes tjerash, Ombudspersoni rekomandoi që PSSP dhe Ministria e Shërbimeve Publike duhet të sigurojnë që të bëhet e mundur që KPM të nisë punën pa vonesë të mëtejshme.*

Më **20 korrik 2005**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Ushtruesja e detyrës së ZPSSP-së për Administratë Civile, e cila vërtetohet përsëri përkushtimin e UNMIK-ut për të punuar me Ministrinë e Shërbimeve Publike në mënyrë që të përgatiten rregullat procedurale të KPM-së dhe që ky institucion të fillojë me punë deri në fund të gushtit 2005.

### **Paqartësia e politikave të UNMIK-ut lidhur me tabelat e regjistrimit të Jugosllavisë**

*Më 29 prill 2005, Institucioni i Ombudspersonit i dërgoi një letër ZPSSP-së për Polici dhe Drejtësi, me të cilën kërkonte sqarime të dispozitave të Ligjit mbi Regjistrimin e Automjeteve lidhur me tabelat e regjistrimit në Kosovë. Për arsye të ankesave të shumta të pranuar nga Institucioni i Ombudspersonit lidhur me këtë çështje, letra nuk theksonte ndonjë ankesë apo ankues të veçantë por në vend të kësaj kërkonte një sqarim të përgjithshëm të politikave të UNMIK-ut dhe përgjegjësi të SHPK-së sipas këtij ligji. Ombudspersoni i kishte dërguar shumë letra të tjera për raste specifike pranë doganave të UNMIK-ut dhe SHPK-së. Në shumë raste, SHPK ua kishte konfiskuar automjetet banorëve të Kosovës, të cilët kishin blerë automjetet e tyre në Serbi (e cila vazhdon të lëshojë tabela regjistrimi sipas sistemit të vjetër të Jugosllavisë, duke shfrytëzuar prefikset PR, PZ dhe të tjera, në vend të tabelave KS), duke pohuar se pronarët e tyre nuk kishin paguar tatimin doganorë.*

Më **28 korrik 2005**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga ZPSSP për Drejtësi dhe Polici, i cili sqaronte në hollësi rregullat e regjistrimit dhe tatimit të automjeteve dhe tabelave të regjistrimit në Kosovë. Sipas tij, Ligji mbi regjistrimin e automjeteve thotë që pronarët e automjeteve të cilët kanë tabela regjistrimi të Jugosllavisë mund t'i ndërrojnë ato me tabela regjistrimi KS por basorët serb mund njëkohësisht t'i mbajnë tabelat e tyre të regjistrimit Jugosllave për të lehtësuar lëvizjen e tyre për hyrje-dalje në Serbi dhe Mal të Zi. Megjithatë, Ligji më tutje thekson se pronarët e automjeteve me tabela regjistrimi të Jugosllavisë nuk duhet të paguajnë tatime doganore (ndonëse duhet të paguajnë akcizën dhe TVSH-në), meqë sipas të drejtës ndërkombëtare ata nuk kanë tabela të një vendi të huaj.

Që nga kjo letër, afati përfundimtar për ndërrimin e tabelave të regjistrimit të Jugosllavisë është shtyer disa herë dhe Institucioni i Ombudspersonit vazhdon të pranojë ankesa rreth zbatimit të këtyre rregulloreve nga ana e SHPK-së. Për momentin, Institucioni ka ende raste të tilla në pritje për tu zgjidhur.

### **Përkujdesja joadekuate institucionale për persona të varur nga droga**

Më **29 korrik 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Minsitrit të Shëndetësisë lidhur me problemin e përkujdesjes joadekuate institucionale për persona të varur nga droga.

Më **4 gusht 2005**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një përgjigje nga Ministri i Shëndetësisë, i cili theksonte se përkujdesja e personave të varur nga droga ishte përgjegjësi e një njësie brenda Repartit Psikiatrik të spitalit të Prishtinës. Ministri theksoi se njësitë nuk ishte në gjendje të sigurojë trajtim adekuat për një numër në ngritje të



personave të varur nga droga në Kosovë, për arsye të buxhetit të kufizuar të Ministrisë së Shëndetësisë.

Më **11 tetor 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryeministrit, z. Bajram Kosumi, lidhur me problemin e përkujdesjes joadekuade institucionale për persona të varur nga droga. Ombudspersoni e nxiti Kryeministrin të ndërmerr veprime kyçe dhe të menjëhershme për të nisur projekte për t'i ndihmuar këta njerëz dhe për të siguruar që këtij problemi në rritje t'i kushtohen vëmendaj e nevojshme.

Më **26 tetor 2005**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga z. Fitim Krasniqi, zyrtar në Zyrën e Kryeministrit. Z. Krasniqi vërtetoi se Zyra e Kryeministrit është e vetëdijshme për këtë problem dhe pohoi përkushtimin e kësaj zyre për gjetjen e një zgjidhjeje të duhur. Z. Krasniqi, më tej, theksoi se Zyra e Kryeministrit kishte filluar përgatitjet për themelimin e një "Këshilli Kosovarë për intervenim kundër Drogës dhe Substancave Psikoaktive"

Më **30 qershor 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Kryeministrit, duke i rikujtuar letërkëmbimin e lartëpërmendur dhe duke i theksuar brengat e lartëpërmendura.

#### **Pohimet për keqtrajtim fizik në një qendër korrektuese**

Më **29 korrik dhe 19 shtator 2005**, një jurist i Institucionit të Ombudspersonit kontaktoi me drejtorin e Qendrës Korrektuese në Lipjan dhe kërkoi informata lidhur me pohimet e ankuesit z.V.K., një i paraburgosur që pohonte se ishte rrahur nga një oficer korrektues në qendrën korrektuese. Në të dy rastet, drejtori i qendrës së lartëpërmendur premtoi se do të siguronte informatat e kërkuara, por më pas kishte dështuar të mbajë premtimin.

Më **27 tetor 2005**, Ombudspersoni i dërgoi në letër drejtorit të qendrës, duke e përsëritur kërkesën e mëparshme për informata lidhur me rastin e z.V.K.

Më **10 nëntor 2005**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një përgjigje nga drejtori, ku ishte bashkëngjitur edhe një raport mjekësor. Raporti mjekësor theksonte se më 26 korrik 2005, z.V.K. i ishte nënshtruar një kontrolli mjekësor, gjatë të cilit mjeku ka vërejtur shenja që sugjeronin lëndime dhe ishte përpjekur që t'i dokumentojë ato, por nuk ka pasur mundësi sepse, në atë kohë, kamera e shërbimeve mjekësore nuk punonte.

Më **5 dhjetor 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Udhëheqësit të Operacioneve të Sektorit të Menaxhimit Penal në kuadër të Departamentit të UNMIK-ut për Drejtësi. Letra theksonte faktet e lartëpërmendura dhe njëkohësisht kërkonte nga Udhëheqësi i Operacioneve që të hetojë incidentin dhe të ndërmerr masa disiplinore nëse është e nevojshme.

Më **4 janar 2006**, Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK, një pjesë e Sektorit të Menaxhimit Penal) e informoi Institucionin e Ombudspersonit se kishin nxjerrë një raport të brendshëm për rastin dhe se kishin vendosur që të zhvendosin oficerët korrektues të akuzuar në një pjesë tjetër të ndërtesës. Në të njëjtën kohë, ata ishin duke miratuar

procedura më fleksibile për të përmirësuar marrëdhëniet në mes të burgosurve dhe punonjësve të SHKK-së. SHKK gjithashtu nxorri një sqarim zyrtar se nuk do të ketë asnjë tolerim të keqpërdorim të autoritetit në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

### **Lirimi i gazrave të rrezikshme nga një depo karburanti**

*Më 24 qershor 2005, Institucioni i Ombudspersonit regjistroi një ankesë të pranuar nga z. M.B., banor i Obiliqit, në lagjen e të cilit ishte ndërtuar një depo karburanti nga kompania “Kastriot Petroll”. M.B. pohoi se vendi ku ishte ndërtuar objekti i kompanisë “Kastriot Petroll” nuk ishte i përshtatshëm sepse gazrat që buronin nga objekti ishin të rrezikshme për shëndetin e banorëve të asaj lagjeje. Për më tepër, ekzistonte një rrezik i madh në rast të ndonjë aksidenti të mundshëm për arsye të afërsisë së madhe të objektit me një trafostacion të energjisë elektrike. Ankuesi dhe fqinjët e tij kishin ngritur këtë çështje pranë komunës së Obiliqit, Minsitrisë për Tregti dhe Industri dhe pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor përmes letrave të datës 6 prill 2004, kopjet e të cilave iu dorëzuan edhe Institucionit të Ombudspersonit, por nuk kishin pranuar kurrfarë përgjigje.*

Më **29 korrik 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Ministrit për Mjedis dhe Planifikim Hapsinor (MMPH) duke kërkuar informata për veprimet e ndërmarra apo të planifikuara lidhur me këtë çështje. Ombudspersoni i dërgoi një kopje të kësaj letre Ministrit të Tregtisë dhe Industrisë si dhe Kryetarit të komunës së Obiliqit.

Më **11 gusht 2005**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga MMPH, në të cilën theksohej se Ministri kishte dërguar një ekip inspektorësh në deponë e karburantit të kompanisë “Kastriot Petroll” menjëherë pas pranimit të letrës së Institucionit. Ekipi inspektues kishte konkluduar se investitori nuk posedonte Pëlqimin Mjedisor ashtu siç kërkohet nga Ligji i Kuvendit për Mbrojtjen e Mjedisit, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 9/2003, dhe e kishte udhëzuar atë që të aplikojë për këtë Pëlqim.

Më **4 tetor 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër MMPH duke kërkuar informata se a ishte ndërmarrë ndonjë veprim tjetër që nga ai i përkthyer në letrën e 11 gushtit 2005. Institucioni i Ombudspersonit nuk ka pranuar përgjigje në këtë letër.

Më **8 mars 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër rikujtuese MMPH-së. Institucioni i Ombudspersonit, as në këtë letër, nuk ka pranuar përgjigje.

Më **4 prill 2006**, një përfaqësues i Institucionit të Ombudspersonit u takua me asistentin ekzekutiv të Sekretarit të Përhershëm të MMPH-së për të diskutuar për rastin. Gjatë takimit, asistenti ekzekutiv theksoi se pas inspektimit të kryer në deponë e karburanteve të kompanisë “Kastriot Petroll” nga ekipi inspektues i MMPH-së, ishte konkluduar se objekti paraqiste rrezik real për banorët në afërsi për arsye të afërsisë së një trafostacioni të energjisë elektrike. Megjithatë, MMPH nuk kishte lëshuar ndonjë vendim mbi pëlqimin mjedisor, duke e lënë të paqartë situatën ligjore. Asistenti ekzekutiv propozoi mbajtjen e një takimi në mes MMPH-së, Institucionit të Ombudspersonit dhe komunës së Obiliqit.

Më **21 prill 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi përsëri një letër MMPH-së duke kërkuar që të përgjigjen me shkrim në letrën e Ombudspersonit të 11 gushtit 2005.

Gjithashtu, më **21 prill 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Kryetarit të komunës së Obiliqit duke kërkuar nga ai sqarim lidhur me statusin ligjor të deposë së “Kastriot Petroll” dhe kompanisë që menaxhonte atë. Një kopje e kësaj letre iu dërgua Kryeministrit, Ministrit për Tregti dhe Industri dhe Ministres të Shërbimeve Publike.

Më **11 maj 2006**, Institucionin i Ombudspersonit pranoi një përgjigje nga MMPH, në të cilën sqarohet se pronari i “Kastriot Petroll” kishte paraqitur kërkesë për pëlqimin mjedisor pranë MMPH-së më 22 qershor 2005.

Më **6 qershor 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër rikujtuese Kryetarit të komunës së Obiliqit, i cili nuk ishte përgjigjur ende në letrën e Ombudspersonit të 11 prillit 2005.

Më **21 qershor 2006**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Kryetari i komunës, i cili paraqiti dokumentet ligjore relevante të “Kastriot Petroll-it” Kryetari gjithashtu kishte bashkëngjitur kopje të dokumenteve vijuese: lejen urbanistike të “Kastriot Petroll-it” (lëshuar nga komuna e Obiliqit, me nr. 351-341/03 të 15 gushtit 2003), lejen për ndërtimin e një depoje karburanti (lëshuar nga Minsitria e Shërbimeve Publike, Departamenti për Menaxhimin e Emergjencave, Sektori për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Zjarri më 5 gusht 2003), si dhe lejen elektro-energjetike nga KEK-u (të 23 korrikut 2003).

Më **30 qershor 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit vendosi të hapë hetime zyrtare për rastin.

### **Arrestimi dhe keqtrajtimi i protestuesve të lëvizjes “Vetvendosje”**

*Më 12 qershor 2005, anëtarët e lëvizjes “Vetvendosje” (lëvizje që kërkon largimin e UNMIK-ut dhe njohjen e menjëhershme ndërkombëtare të Kosovës si shtet i pavarur) mbajtën një protestë të vzhdueshme paqësore, gjatë së cilës ata shkruajtën sloganin ‘Jo negociata – Vetëvendosje’ në muret e ndërtesave publike dhe private. Me sa dukej, sloganet e shkruara në ndërtesat publike ishin bërë me pëlqimin e pronarëve. Disa prej aktivistëve sihin arrestuar dhe gjobitur apo burgosur për shkelje të rendit publik. Pas raportimeve nga mediat, hetimet fillestare të institucionit treguan se disa nga aktivistët ishin keqtrajtuar dhe arrestuar si rezultat i protestës së tyre paqësore.*

Më **1 gusht 2005**, Ombudspersoni hapi hetime ex-officio lidhur me pohimet për keqtrajtim dhe për atë që kjo nënkupton për lirinë e të shprehurit për aktivistët e lëvizjes “Vetëvendosje”. Hetimet u hapën për të shqyrtuar nëse masat e ndërmarra nga pjestarët e SHPK-së dhe Policia e UNMIK-ut, në disa raste ku kishte pasur protesta të organizuara nga këta aktivistë, përbënin ndërhyrje në të drejtën e tyre për t’u shprehur lirshëm sipas nenit 10 të Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut.

Më **12 gusht 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së duke e informuar atë kishte vendosur që të hapë hetime ex-officio. Ombudspersoni tha se protesta paqësore e lëvizjes “Vetëvendosje” përbente një formë të shprehjes që është brenda kufijve të pranueshëm në shoqëritë demokratike dhe prandaj mbrohej nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Dallimi i vetëm mes kësaj dhe formave të tjera të shprehjes publike ishte mundësia për dëmtim të pronës publike, që nuk ishte diskutuar aspak nga gjykatat relevante apo organet e përforsimit të ligjit.

Ombudspersoni kërkoi urgjentisht nga PSSP që të intervenojë në këtë çështje dhe të ndër marrë të gjitha masat e nevojshme për të ndaluar ndërhyrjen e mëtejshme në të drejtën e protestuesve për t’u shprehur në raste të ngjashme në të ardhmen. Për më tepër, Ombudspersoni kërkoi nga PSSP që ta udhëzojë Komesarin e Policisë së UNMIK-ut që të hetojë rastet ku përfshihet keqtrajtimi i protestuesve dhe regimin proporcional nga ana e Policisë. Më tej, Ombudspersoni vuri në pyetje bazat e pohimeve të Policisë se arrestimet ishin të nevojshme për të ndaluar apo parandaluar një prishje të rendit publik.

Më **25 tetor 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Prokurorit Publik për komunën e Prishtinës, me të cilën kërkonte nga ai që të shqyrtojë mundësinë e hapjes së hetimeve penale lidhur me sjelljen e disa pjestarëve të SHPK-së gjatë arrestimeve të bëra gjatë një proteste tjetër paqësore të organizuar nga aktivistë të lëvizjes “Vetëvendosje” më 18 tetor 2005. Gjatë protestës së parë, aktivistët e lëvizjes “Vetëvendosje” kishin shkruar në automjetet e KB-ve (UN) shkronjat F dhe D duke formuar kështu fjalën “FUND”. Sipas deklaratave të personave të arrestuar dhe asaj të një gazetari, protestuesit ishin arrestuar pas përfundimit të protestës së tyre paqësore. Sipas pohimeve, gjatë arrestimeve dhe më pas në një stacion të afërt policorë, ata ishin keqtrajtuar dhe fyer rëndë nga Policë të SHPK-së.

Më **25 nëntor 2005**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga një zyrtare e zyrës së Prokurorit Publik përgjegjëse për rastin, e cila thoshte se kishte ngritur çështjen pranë Njësisë për Standarde Profesionale të SHPK-së dhe se ata kishin hapur hetime për çështjen por ende nuk kishin arritur në përfundime. Zyrtarja tha se ishte e interesuar që të vazhdojë me rastin por se i mungonin informata lidhur me identitetin e palëve të përfshira. Ajo kërkoi nga Institucioni i Ombudspersonit që t’i siguronte çfarëdo informata shtesë dhe premtoi se do ta informonte institucionin mbi rezultatet e hetimeve të Njësisë për Standarde Profesionale si dhe për veprimet e mundshme të Zyrës së Prokurorit.

Institucioni i Ombudspersonit vazhdon të hetojë këto ngjarje dhe reagimin e autoriteteve ndaj lëvizjes Vetvendosje në mënyrë më të përgjithshme.

### **Dështimi për të rindërtuar disa shtëpi të caktuara të dëmtuara gjatë luftimeve të vitit 1999**

Më **4 gusht 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryeministrit lidhur me rindërtimin e shtëpive të dëmtuara apo shkatërruara gjatë luftimeve të vitit 1999. Ombudspersoni tha se ankesat nga Mitrovica dhe komunat tjera kudo në Kosovë tregojnë se shumë shtëpi, për të cilat ishte premtuar se do të rindërtohen – përfshirë këtu edhe ato të cilat ishin shkatërruar plotësisht – ende nuk ishin rindërtuar. Pas fazës fillestare emergjente të përzgjedhjes dhe

rindërtimit prioritar, shumë komuna vazhduan me pohimet e tyre gjatë vitit 2004 dhe 2005 se nuk kishin fonde të mjaftueshme për të përkrahur rindërtimin. Ombudspersoni tha se një ndër shembujt e vetëm pozitiv ishte komuna e Prizrenit. Prandaj, Ombudspersoni kërkoi nga Kryeministri që të shqyrtojë se si IPVQ-të mund të punojnë me komunitetin ndërkombëtar për t'i ndihmuar njerëzit të cilëve nuk u ishin rindërtuar shtëpitë e djegura apo shkatërruara në vitin 1999.

Nuk ka pasur përgjigje në këtë letër dhe Institucioni i Ombudspersonit është në proces të përgatitjes të një raporti për këtë çështje

### **Mungesa e pensioneve për ish-punonjësit e Hekurrudhave të UNMIK-ut**

*Më 29 shkurt 2001, hyn në fuqi Udhëzimi Administrativ 2001/03 i Departamentit të UNMIK-ut për Transport dhe Infrastrukturë, duke i lënë pa punë të gjithë punonjësit e UNMIK-ut që kishin mbushur 60 vjet gjatë vitit 2001 apo të cilët kishin së paku 35 vjet përvojë pune. Udhëzimi Administrativ u jepte të drejtën këtyre punonjësve për të marrë përfitime të caktuara mujore deri sa të fitonin të drejtën për pension të rregullt (zakonisht jo para së të arrinin moshën 65 vjeçare), deri më 31 dhjetor 2003, për aq kohë sa Hekurrudhat e UNMIK-ut të kenë fonde për t'i paguar ata. Pas 31 dhjetorit 2003, ky program ishte vazhduar sepse nuk ishte miratuar asnjë program tjetër për ndihmë sociale. Megjithatë, më 15 dhjetor 2004, pagesat ishin ndërprerë dhe Hekurrudhat e UNMIK-ut pohuan se nuk kishte më para për të vazhduar më këtë program.*

Më 4 gusht 2005, Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së dhe Kryeministrit, duke shprehur brengën e tij për punonjësit e lartëpërmendur dhe duke e bërë të ditur se disa nga ata ishin mbi moshën 60 vjeçare dhe vështirë se do të gjenin punë dhe në të njëjtën kohë nuk kishin moshën e duhur për të dalë në pension. Personat e tillë, si rezultat i kësaj, kishin mbetur pa asnjë të ardhur. Ombudspersoni kërkoi nga PSSP dhe Kryeministri që t'i sigurojnë informata rreth planeve të mundshme të UNMIK-u apo IPVQ-ve fillimin e programeve të mundshme për ndihmë sociale për viktimat e largimit në masë nga puna.

Nuk ka pasur përgjigje në këtë letër.

### **Gjetjet e NjIGj-së në një rast të zvarritjes së procedurës**

*Më 17 dhjetor 2004, Ombudspersoni publikoi një raport lidhur me zvarritjen e procedurës në një rast që kishte të bënte me kthimin në posedim të një pjese të tokës që pohojtë ishte pronë e z. D.M. Ombudspersoni gjeti se dështimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë për të shqyrtuar ankesën e z. D.M. kundër një vendimi të Gjykatës komunale për me tepër se një vit, që pohojtë jetë rezultat i numrit të pamjaftueshëm të gjykatësve që punojnë në Gjykatën e Qarkut dhe për arsye të numrit të madh të rasteve pranë kësaj gjykate, kishte shkelur të drejtën e z. D.M. për proces të rregullt gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme, siç garantohet nga neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*

Më **17 gusht 2005**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një leër nga Drejtori i Departamentit të UNMIK-ut për Drejtësi, i cili thoshte se NjIGj-së pranë Departamentit kishte kryer një hetim të ankesës dhe gjetën se nuk kishte pasur parregullsi në trajtimin e rastit të z. D.M. Drejtori theksoi se vonesat e zgjatura në procedurat civile ishin çështje brengje edhe për Departamentin, i cili kishte nisur një numër iniciativash për të gjetur mënyrën më të mirë për zgjidhjen problemit.

### **Brengat lidhur me politikat e ngritjes së gradave në Shërbimin Korrektues të Kosovës**

Më **24 gusht 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryesuesit të Sektorit të Menaxhimit Penal dhe Komesarit të Shërbimit Korrektues në Kosovë (SHKK), duke kërkuar nga ai që të rishqyrtojë procedurat e SHKK-së lidhur me trajnimet dhe ngritjen në pozitë të punonjësve në pozitat menaxhuese. Ombudspersoni bashkëngjiti në letrën e tij një ankesë zyrtare që kishte pranuar nga oficerë korrektues në Mitrovicë dhe Lipjan që pohonin se trajnimet menaxhuese ishin të hapura vetëm për punonjësit në Institucionet për paraburgim dhe korrektim të SHKK-së dhe se ngritjet në pozita janë bërë ekskluzivisht vetëm për punonjësit nga këto departamente edhe kur kandidatët e zgjedhur nuk kishin shkollimin dhe kualifikimin e duhur.

Më **7 shtator 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Komesari i SHKK-së, i cili konfirmonte se trajnimet dhe ngritjet në pozitat menaxhuese ishin të hapura për të gjithë punonjësit e SHKK-së në pajtim me rregulloret e aplikueshme të UNMIK-ut. Komesari sqaroi se trajnimi për menaxhim u ishte “ofruar të gjithë punonjësve korrektues të cilët kishin shfaqur interesim për t’u bërë mbikëqyrës në kuadër të SHKK-së.” Ai përfundoi letrën duke theksuar se në mënyrë që të bëhet ngritja në pozitë nga Mbikëqyrës në Mbikëqyrës të Lartë dhe pastaj Zëvendës Drejtor, punonjësit duhet të kishin fituar eksperiencë nga trajnimet për menaxhim dhe nga puna në nivele të duhura të organizatës.

### **Konfiskimi i dokumenteve të falsifikuara të udhëtimit**

Më **2 shtator 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Ombudsmanit të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë (IRJM), duke ia referuar një rast në të cilin zyrtarë të doganës në aeroportin e Shkupit ia kishin konfiskuar z. A.H dokumentet udhëtuese të Italisë. Ankuesi pohoi se ishte mbajtur në paraburgim për 24 orë dhe se kishte marrë ndalesë zyrtare për të hyrë në IRJM për dy vite sepse zyrtarët e doganës besonin se dokumentet e tij të udhëtimit ishin të falsifikuara. Ombudspersoni tha se rasti ishte jashtë juridiksionit të tij sepse e gjithë ngjarja kishte ndodhur në IRJM dhe kërkoi nga Ombudsmani i këtij vendi që të hetojë rastin.

Më **11 nëntor 2005**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Ombudsmani i IRJM-së që thoshte se nuk kishte gjetur shkelje të së drejtave të njeriut në rastin e A.H. Letra sqaronte se Ministria e Punëve të Brendshme të IRJM-së kishte vërtetuar se dokumentet e udhëtimit ishin të falsifikuara dhe se z. A.H. ishte njoftuar për konkludimet e hetimeve të tyre.

### **Themelimi i një klase parashkollore në gjuhën boshnjake**

Më **14 shtator 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Ministrit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, duke e drejtuar vëmendjen e tij në një grup prindërisht të etnicitetit boshnjak në Mitrovicë, të cilët kishin vështërsi në themelimin e një klase parashkollore në gjuhën boshnjake.

Më **16 shtator 2005**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Ministri, i cili tha se kishte kënaqësinë ta informoj Ombudspersonin se një klasë parashkollore për nxënësit boshnjak tashmë ishte themeluar në shkollën fillore “Bedri Gjina” më 9 shtator 2005.

### **Pohimet e pabazuara për keqtrajtim në një shkollë fillore**

*Më 20 dhe 21 tetor 2004, gazeta ditore Lajm Ekskluzive publikoi artikuj ku pohoj se disa mësues të shkollës fillore “Selma Riza” në Fushë Kosovë kishin rrahur nxënësit e tyre. Pas publikimit të këtyre artikujve, më 29 tetor 2004, Ombudspersoni i dërgoi një letër Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duke kërkuar informata lidhur me veprimet e ndërmarra nga Ministria si përgjigje në këto pohime. Më 5 nëntor 2004, ai pranoi një letër nga Sekretari i Përhershëm i Ministrisë që konfirmonte se Ministria është duke hetuar situatën.*

Më **28 shtator 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, duke sqaruar se nuk kishte pranuar informacione të mëtejshme lidhur me rastin. Ombudspersoni kërkoi nga Ministri që t'i sigurojë informata të reja mbi zhvillimet në rast si dhe për çfarëdo veprimesh të ndërmarra apo të planifikuara nga ai, apo për rezultatet e ndonjë hetimit të mundshëm.

Më **28 tetor 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Ministri, i cili sqaronte se Ministria kishte përfunduar një hetim lidhur me pohimet për keqtrajtim të publikuara në gazetën Lajm Ekskluzive. Hetimet zbuluan se të gjithë mësuesit dhe nxënësit e intervistuar kishin mohuar pohimet e artikullit të gazetës Lajm, por Ministri tha se do të çmonte nëse do të njoftohej për çfarëdo prove që do të dëshmonte të kundërtën.

### **Largimet nga puna dhe protestat brenda Ministrisë së Shërbimeve Publike**

Më **30 shtator 2005**, Këshilli Organizativ i Punonjësve të Ministrisë së Shërbimeve Publike i dërgoi një letër PSSP-së, Ministres për Shërbime Publike, dhe Institucionit të Ombudspersonit, duke shprehur brengën lidhur me largimet nga puna të një numri punonjësish të Ministrisë për Shërbime Publike.

Më **26 tetor 2005**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga PSSP, i cili thoshte se kompetencat për këtë fushë ishin transferuar tek IPVQ-të. PSSP tha se nxiste të gjithë punonjësit që të shfrytëzojnë të gjitha procedurat ekzistuese të ankimit brenda autoriteve punëdhënëse dhe të drejtohen pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës (KPM) nëse masat e tjera të ndërmarra nga ata dështojnë në adresimin e brengave të tyre.

Më **31 tetor 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Komesarit të Policisë së UNMIK-ut, duke kërkuar nga ai vërtetimin e informatave të pranuar se më 5 tetor 2005, policë të SHPK-së kishin arrestuar punonjës të MSHP-së gjatë një proteste paqësore kundër largimeve të lartëpërmendura si dhe për të sqaruar bazat ligjore për çfarëdo masash që janë ndërmarrë nga policë të SHPK-së në atë rast.

Institucioni i Ombudspersonit ende nuk ka pranuar përgjigje në këtë letër.

### **Mospagimi i pagave në forëm burse i mësuesve në Graçanicë**

Më **30 shtator 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryesuesit të Drejtorisë për Arsim në komunën e Prishtinës lidhur me një ankesë të pranuar nga pesë mësime në Graçanicë, të cilët pohuan se nuk kishin marrë pagat për punën e tyre për më tepër se një vit. Ata kishin vazhduar të punojnë në shkollën muzikore “Stevan Mokranjac” pa pagesë gjatë këtyre 12 muajve, ndonëse nuk kishin marrë kurrfarë njoftimi apo sqarimi për ndalimin e pagave të tyre. Ombudspersoni kërkoi nga Kryesuesi i Drejtorisë që të sigurojë që arsimtarët do të marrin pagat e tyre pa vonesë të mëtejshme.

Më **24 tetor 2005**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një përgjigje nga Kryesuesisi i Drejtorisë, i cili tha se shkolla e muzikës “Sveti Mokranjac” ishte njoftuar paraprakisht me shkrim se do të kishte reduktim të punonjësve të kësaj shkolle.

Më **3 shkurt 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër tjetër Kryesuesit të Drejtorisë, duke i bërë të ditur se hetimet kanë treguar se vetëm dy nga pesë ish punonjësit kishin marrë njoftim para se t’u ndaleshin pagat që mermin nga IPVQ-të dhe duke përsëritur kërkesën e tij që Kryesuesi Drejtorisë të sigurojë që arsimtarëve t’u paguhen pagat pa vonesë të mëtejshme.

Më **28 shkurt 2006**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një përgjigje nga Kryesuesi i Drejtorisë, i cili tha se punonjësit në fjalë nuk kishin nënshkruar ndonjëherë kontratë me Drejtorinë dhe për këtë ata kanë marrë vetëm pagesë në formë burse, jo pagë. Kryesuesi i Drejtorisë, më tej, theksoi se mësuesit ishin hequr nga lista e pagave për shkollën sepse buxheti komunal nuk mund të financonte kaq shumë mësues në këtë shkollë edhe pse shkolla në fjalë kishte vetëm 11 mësues. Ai theksoi se meqë shkolla e muzikës kishte vetëm pak nxënës, ajo nuk kishte nevojë për shumë mësues apo punonjës administrativ.

Më **19 maj 2006**, Drejtori i shkollës së muzikës kërkoi nga Institucioni i Ombudspersonit që të mbyll rastin meqë të gjithë punonjësit e kësaj shkolle kishin refuzuar të marrin paga nga Qeveria e Kosovës. Pas kësaj, rasti u mbyll.

### **Pagesa e faturave të energjisë elektrike për uzurpuesit e paligjshëm**

Më **10 tetor 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Drejtorit Menaxhues të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), lidhur me çështjen e personave që janë kthyer në banesat e tyre pas dëbimit të uzurpuesve të paligjshëm. Disa nga këta të kthyer ishin ngarkuar me fatura të energjisë elektrike të shpenzuar nga uzurpuesit e paligjshëm, ndonëse, sipas



Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2004/04, pronarët pronat e të cilëve kanë qenë të uzurpuara pas luftimeve të vitit 1999 nuk mund të mbaheshin përgjegjës për faturat nga shpenzimet e uzurpuesve të paligjshëm. Ombudspersoni kërkoi nga Drejtori Menaxhues i KEK-ut që të nxjerrë vendim të përgjithshëm për të siguruar që të gjitha njësitë shërbyese të KEK-ut kudo në Kosovë të respektojnë Urdhëresën Administrative të lartëpërmendur. Kjo letër ishte vazhdim i një letre të mëparshme rreth kësaj çështjeje që Ombudspersoni ia kishte dërguar KEK-ut më 4 nëntor 2004.

Nuk ka pasur përgjigje në këtë letër.

### **Arsimimi joadekuat për kryesit e paraburgosur të mitur të veprave kriminale**

Më **10 tetor 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Minsitrit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, duke shprehur brengën e tij lidhur me atë që të miturit që mbaheshin në Qendrën Korrektuese në Lipjan nuk ishin duke u arsimuar si duhet. Një hetim i kryer nga Institucioni i Ombudspersonit zbuloi se kishte vetëm tre mësues për të gjitha grupmoshat në qendrën korrektuese. Autoritetet komunale arsimore të komunës së Lipjanit dhe Drejtori i Shkollës së Lartë Profesionale tha se ishin të gatshëm të përkrahin programin arsimor të qendrës korrektuese por ata gjithashtu thanë se do të ishte më mirë që Ministria të ndërmerre veprime të drejtëpërdrejta. Prandaj, Ombudspersoni kërkoi nga Ministri që të ndërmarrë masa urgjente për të siguruar që të miturit e qendrës korrektuese të përfundojnë arsimimin e tyre në pajtim me ligjin ekzistues.

Nuk ka pasur përgjigje në këtë letër.

### **Një *de facto* eksproprijim i tokës nga KFOR-i**

*Më 16 maj 2005, Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së lidhur me ankesën e z. M.G. kundër komunës së Prizrenit dhe KFOR-it për eksproprijimin e tokës së tij për ndërtimin e një rruge pa ndonjë procedurë ligjore formale apo kompensim paraprak. Ombudspersoni kërkoi që toka e z. M.G të deklarohet e eksproprijuar për interes publik dhe ankuesi të kompensohet në pajtim me ligjin mbi eksproprijim. Kjo letër ishte vazhdim i një letre të cilën Ombudspersoni ia kishte dërguar PSSP-së më 30 dhjetor 2004. Letra e mëparshme bënte të ditur se KFOR-i dhe komuna e Prizrenit kishin refuzuar të njohin kërkesën e z. M.G. për rivendosje të rastit, ku të dy palët pohonin se pala tjetër duhet të mbahet përgjegjëse.*

**Më 11 tetor 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Përfaqësuesi Rajonal i UNMIK-ut për Rajonin Jugperendimor. Përfaqësuesi Rajonal sqaronte se UNMIK-u kishte diskutuar rreth kërkesës së M.G. me Kryeshëfën Ekzekutiv të Komunës së Prizrenit, i cili kishte sqaruar se KFOR-i e kishte bërë rindërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës dhe se komuna nuk ishte e përfshirë në këtë. Përfaqësuesi Rajonal, më tej, sqaroi se pas një kërkesë të bërë nga UNMIK-u, Këshilli i Drejtorëve në Prizren ishte pajtuar që të rishqyrtojë rastin e M.G. dhe të këshillojë se si të vazhdohet më tej, ndërsa Kryeshëfi i Ekzekutivit do ta informonte Ombudspersonin për zhvillimet e reja.

Më **17 tetor 2005**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Përfaqësuesi Rajonal i UNMIK-ut, i cili i referohej një vendimi të komunës të 31 gushtit 2005, me të cilin M.G. këshillohej të paraqesë padi kundër trupave gjermane të KFOR-it, përkundër faktit që gjykatat nuk kanë kompetencë mbi KFOR-in.

Përkundër përpjekjeve të shumta për të kontaktuar me z. Gavazi, Institucioni i Ombudspersonit nuk ka arritur të kontaktojë me ankuesin përsëri.

### **Uzurrpimi dhe përdorimi i paligjshëm i tokës bujqësore**

Më **12 tetor 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së, duke kërkuar nga ai që të takohet me disa përfaqësues të fshatrave serbe nga Kosova qendrore për të diskutuar rreth brengave të tyre lidhur me tokën e tyre bujqësore. Fshatarët ishin të brengosur se uzurpues të paligjshëm po kultivonin tokat e tyre bujqësore. Veç kësaj, ata ishin të shqetësuar se kanalet e tyre për ujitje ishin mbuluar nga punët ndërtimore në një urë të afërt si dhe për atë se një rrugë që lidhte fshatrat me shumicë serbe tani do të zgjeroheshte për përdorim më të gjërë dhe për rrjedhim rruga nuk do të ishte e sigurtë për ata.

Më **25 tetor 2005**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Kryetari i komunës së Fushë Kosovës, i cili thoshte se nuk ishte në dijeni për ankesa të fshatarëve lidhur me urën. Ai tha se ura ishte riparuar dhe shuma për këtë riparim ishte rreth 10.000 Euro dhe se tani ura është e shfrytëzueshme. Kryetari i komunës shprehu shpresën e tij se në të ardhmën, qytetarë të nacionalitetit serbë do të ndiheshin të lirë që të drejtojnë ankesat e tyre drejtëpërdrejt tek institucionet komunale pa i drejtuar paraprakisht pranë Institucionit të Ombudspersonit.

Ankuesit vendosën që mos të vazhdojnë më tej me rastin dhe për rrjedhim rasti u mbyll.

### **Kushtet e jetesës të romëve të zhvendosur brenda vendit në pjesën veriore të Kosovës**

Më **12 tetor 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së, duke përshkruar kushtet e mjerueshme të personave të zhvendosur brenda vendit (PZhBV) të komunitetit rom, të cilët ishin duke jetuar në tre kampe në Kosovën veriore, dhe kërkoi urgjentisht nga ai që UNMIK-u të bëjë çdo gjë që është e mundur për të gjetur një zgjidhje për këtë situatë. Romët ishin duke jetuar në këto kampe të kontaminuara nga plumbi që nga viti 1999.

Duke i theksuar kushtet e mjerueshme të jetesës të PZhBV-ve, Ombudspersoni drejtojë vëmendjen në përhapjen e mbeturinave në të gjitha anët e kampeve, mungesën e ngrohjes dhe mungesën e objekteve të domosdoshme higjieno-sanitare, si dhe praninë e sëmundjeve serioze në mesin e banorëve, përfshirë këtu tuberkulozën, reumatizmin dhe astmën si dhe sëmundje tjera të traktit të frymëmarrjes. Ombudspersoni i dha theks të veçantë kampit të PZhBV-ve në Zhitkovc, ku afërsia e fëmijëve të kampit me vendin ku gjindeshin mbeturinat e minierës së Treçës për përpunimin e plumbit me sa duket kishte shkaktuar helmimin dhe trajtimin e disa prej tyre në spital.

Më **10 shkurt 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi përsëri letër PSSP-së lidhur me situatën e këtyre komuniteteve romë. UNMIK-u ishte duke u përgatitur që të zhvendosë këto komunitete në një bazë të mëparshme ushtarake të trupave franceze të KFOR-it në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës të quajtur Osterode, por shumë romë ishin kundër zhvendosjes. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit sqaroi se shumë romë nuk ishin të gatshëm për tu zhvendosur sepse kishin frikë se po të vendoseshin në një lokacion më të sigurtë, kthimi i tyre në mëhallën e romëve, shtëpia e tyre para se të shkatërrohej në vitin 1999, nuk do të ishte më prioritet i UNMIK-ut dhe i organizatave tjera. Nga këndvështrimi i tyre, duke i marrë parasysh vitet që kanë kaluar në kampet e kontaminuara, disa muaj më shumë nuk do të përbënin kaq shumë rrezik shtesë dhe mund t'u shpaguehet atyre nëse për këtë ata do të ktheheshin më shpejtë në Mëhallë.

Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit tha që megjithëse pajtohej se ishte e rëndësishme që të largohen anëtarët e komunitetit nga vendet e kontaminuara me plumb sa më shpejtë që është e mundur, ai nuk besonte se kjo duhej bërë me çmim të përgatitjes së komunitetve për tu kthyer në Mëhallën e romëve në pjesën jugore të qytetit të Mitrovicës, që ishte djegur gjatë vitit 1999. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit rekomandoi që të bëhen përpjekje për t'i bindur romët që të vendosen në kampin Osterode duke u siguruar atyre garancë me shkrim lidhur me Mëhallën, dhe ofroi shërbimet e mira të Institucionit të Ombudspersonit si ndërmjetësues i mundshëm në ndonjë marrëveshje të tillë.

Më **15 qershor 2006**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Drejtoresha e Departamentit për Administratë Civile pranë UNMIK-ut. Ajo fillimisht kërkoi falje për vonesën në përgjigje dhe njëkohësisht raportoi për përparimin e UNMIK-ut lidhur me këtë çështje. Ajo tha se 62 familje tashmë ishin vendosur në kampin Osterode vullnetarisht ndërsa pritej që atje të vendoseshin edhe 81 familje të tjera. Drejtoresha theksoi se shumë nga të dhënat lidhur me helmimin nga plumbi nuk ekzistonin në vitin 1999 dhe se vendet për tri kampet ishin zgjedhur sepse nuk kishte në dispozicion tokë tjetër komunale për vendosjen e tyre. Ajo gjithashtu theksoi se më 21 prill 2006, UNMIK-u kishte nënshkruar një marrëveshje me udhëheqësit e romëve lidhur me përkushtimin e bashkësisë ndërkombëtare për përmirësimin e shërbimeve në kampin Osterode, duke përfshirë dispozita të veçanta për adresimin e nevojave mjekësore të fëmijëve të cilët ishin të helmuar nga plumbi. Përfundimisht, Drejtoresha tha se përpjekjet për të vendosur familjet e romëve në kampin Osterode ishin dyfishuar.

Para dhe pas kësaj letrë të fundit, Zëvendësi i Ombudspersonit dhe përfqësues të tjerë të Institucionit të Ombudspersonit kishin bërë përpjekje për të vizituar PZhBV-të etnicitetit rom, të cilit ishin zhvendosur në kampin Osterode. Megjithëse vizita e tyre e parë kishte mbetur e përealizuar sepse rojet e sigurisë i kishin urdhëruar ata të largohen dhe u kishin thënë se nuk mund të vizitohet kampin pa leje paraprake nga menaxhmenti i kampit, që nga ajo kohë, të gjitha përpjekjet për të biseduar drejtëpërdrejt me menaxhuesin e kampit kanë qenë të pasukseshme.

### **Greva e Sindikatës së Arsimit, Shkencës dhe Kulturës**

Më **14 tetor 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryeministrit, për t'ia drejtuar vëmendjen ndaj grevës së Sindikatës për Arsim, Shkencë dhe Kulturë. Ombudspersoni

tha se vazhdimi i grevës ishte duke ua pamundësuar fëmijëve kudo në Kosovë realizimin e të drejtës së tyre për arsimim dhe e nxiti Kryeministrin të sigurojë që të gjitha pjesët e qeverisë të përfshira në këtë çështje të bashkëpunojnë në mënyrë efektive për të siguruar një zgjidhje të shpejtë dhe të përshtatshme të situatës.

Më **21 tetor 2005**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Sekretariati Koordinues, Zyrta i Lartë i Zyrës së Kryeministrit, që vërtetonte pranimin e letrës së Ombudspersonit. Letra theksonte se qeveria ishte në dialog me protestuesit dhe kërkonte të gjente një zgjidhje të përshtatshme dhe të pranueshme për të dyja palët. Letra sugjeronte se sindikata do të duhej të mendonte në mënyrë më reale lidhur me burimet në dispozicion të qeverisë. Në fund, Zyra e Kryeministrit falënderoi Ombudspersonin për përkushtimin e tij lidhur me të drejtën e fëmijëve për arsimim.

### **Vështirësitë në urdhërimin e një banke për të ekzekutuar një vendim të gjykatës**

*Më 17 dhjetor 2004, Ombudspersoni i kishte dërguar një letër Koordinatores të Njësisë për Inspektion Gjyqësor pranë Departamentit të UNMIK-ut për Drejtësi, duke ngritur brengën se Gjykata komunale në Rahovec kishte dështuar në përmbartimin e vendimit të saj të 29 nëntorit 2001, me të cilin kompania NBI nga Rahoveci obligohej t'i paguante z. E.K. një gjobë në vlerë prej 1 968 Euro. Ombudspersoni kërkoi që NjIGj ta informojë atë për çfarëdo veprimesh që do të ndërmerre kjo njësi me qëllim të zgjidhjes sa më të shpejtë të çështjes.*

Më **18 tetor 2005**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një përgjigje nga Drejtori i Departamentit për Drejtësi pranë UNMIK-ut. Ai thoshte që NjIGj kishte gjetur se Gjykata komunale në Rahovec kishte urdhëruar bankën përkatëse që të bëjë tërheqjen për pagesë të kompensimit nga xhirollogaria e kompanisë NBI por banka nuk ishte pajtuar. NjIGj kishte gjetur se dështimi i bankës për të vepruar në pajtim me vendimin e gjykatës nuk mund t'i atribuohet gjykatës. NjIGj kishte mbyllur rastin sepse nuk kishte gjetur dëshmi të sjelljes së pahijshme të gjykatësit kryesor të rastit.

### **Kërkesa për të transferuar një të burgosur nga Serbia në Kosovë**

Më **7 nëntor 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Drejtorit të Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut, me të cilën kërkonte që Departamenti i tij të përgjigjej në kërkesën e z. T.B., avokatit mbrojtës të z. A.L., që klienti i tij të transferohej nga një burg në Sërbi në një burg të Kosovës. A.L. ishte i akuzuar për krime të luftës gjatë luftimeve në vitin 1999.

Më **20 mars 2006**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një përgjigje nga Drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut, i cili sqaronte se Departamenti i tij ishte duke shqyrtuar rastin dhe se do ta njoftonte z. T.B. sapo të ndërmerret ndonjë veprim.

Institucioni i Ombudspersonit nuk ka pranuar informata të mëtejshme nga UNMIK-u apo z. T.B. lidhur me rastin.

## **Programi ABC i KEK-ut për shpërndarjen e energjisë elektrike**

Më **8 dhjetor 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Koorporatës Energjetike të Kosovës (KEK) lidhur me zbatimin e programit të tij ABC për shpërndarje të energjisë elektrike, që redukton energjinë elektrike për konsumatorët në Kosovë bazuar në ndryshim të shpërndarjes së energjisë sipas përqindjes të pagesës nga familjet në çdo zonë. Ombudspersoni shprehu brengën se zbatimi i veçantë i programit ABC ishte i barazvlefshëm me një sistem të dënimit kolektiv dhe diskriminues.

Më **6 janar 2006**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Drejtori Menaxhues i KEK-ut, i cili mbronte programin ABC. Ai theksoi se programi ABC zbatonte parimet e ngjashme si planet e mëparshme të distribuimit dhe se kishte përmirësuar shkallën e inkasimit në masë të madhe. Drejtori Menaxhues, më tej, theksoi se trajtimi më i favorshëm i konsumatorëve më të besueshëm ishte praktikë standarde në sektorin privat, dhe nuk është i njëjtë me një regjim të dënimit kolektiv. Ai theksoi se përmirësimi i inkasimit të parave nga KEK-u ishte thelbësor për tërheqjen e investimeve të jashtme, që do të ishte thelbësore në mbajtjen e furnizimit të qendrueshëm me energji elektrike në Kosovë, duke e pasur parasysh riparimet e shpeshta dhe përmirësimet që nevojiten në pajisjet e KEK-ut.

## **Ndërprerja e procedurës së dëbimit të një uzurpuesi të paligjshëm**

Më **14 dhjetor 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Drejtorit të Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut, me të cilën kërkonte informata lidhur me veprimet e ndërmarra apo që planifikoheshin të ndërmerren në rastin e z. B.M., lidhur me ekzekutimin e një vendimi të Gjykatës komunale në Prishtinë për të dëbuar një uzurpator të paligjshëm nga hapsirat afariste të ankuesit. Më 14 nëntor 2005, ashtu si pohoet, ekzekutimi i vendimit ishte ndërprerë nga një sulm ndaj gjykatësit përgjegjës dhe kërcënimeve ndaj ankuesit gjatë përpjekjeve për të zbatuar urdhërin për dëbim.

Më **22 shkurt 2006**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një përgjigje nga Drejtori i Departamentit të Drejtësisë, i cili thoshte se Departamenti i tij kishte ndërmarrë disa veprime në këtë rast, përfshirë këtu edhe caktimin e një prokurori dhe gjykatësi ndërkombëtar. Gjithashtu, ishte bërë një kërkesë pranë Komisarit të Policisë për të hetuar sjelljen e policëve të SHPK-së të përfshirë në rast. Përfundimisht, Drejtori tha se Departamenti do të vazhdonte të monitorojë zhvillimet në këtë rast.

## **Mungesa e njoftimit të viktimave rreth hetimeve penale**

Më **19 dhjetor 2005** dhe **22 mars 2006**, Ombudspersoni dhe Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërguan letrë një Prokurori ndërkombëtar lidhur me ankesën e z. R.R., ku ankuesi ankohej se nuk ishte njoftuar për një vendim të Prokurorit ndërkombëtar z. M.H. për ta mbyllur rastin e tij kundër një polici të SHPK-së, për të cilin pohoj se kishte shtënë me armë zjarri në të birin e R.R.

Më **12 prill 2006**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut, i cili sqaronte se pas mbylljes së rastit nga z. M.H. ishte identifikuar një i dyshimtë tjetër, i cili ishte dënuar me tre vite e gjashtë muaj burg. Drejtori, më tej, theksonte se dosja e rastit zbuloi se z. M.H. i kishte dërguar familjes së të ndjerit vendimin e tij të përkthyer në gjuhën shqipe përmes shërbimit personal nga policia dhe kishte rekomanduar që familjes në fjalë t'i sigurohej shërbim këshillues sipas parimeve udhëheqëse të vendosura nga Njësia për avokim dhe ndihmë të viktimave brenda Departamentit të Drejtësisë. Drejtori tha se besonte që ishin marrë të gjitha masat e nevojshme për këtë rast.

### **Barra e dëshmisë lidhur me diskriminimin e pohuar në procesin e privatizimit**

Më **21 dhjetor 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së lidhur me ankesa të shumta të paraqitura pranë Institucionit të Ombudspersonit lidhur me pengesat që kanë hasur disa ankues, kryesisht të etnicitetit serb, gjatë përpjekjeve të tyre për të marrë pjesë në privatizimin e ndërmarjeve të mëparshme shoqërore. Mes tjerash, Ombudspersoni kërkoi që të ndryshohet legjislacioni për çështjet e privatizimit për të qenë në pajtim me standardet e Evropiane mbi ankesat për diskriminim.

Më **10 shkurt 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi përsëri letër PSSP-së, duke përsëritur brengat e theksuara nga Ombudspersoni i mëparshëm në letërn e tij të 21 dhjetorit 2005.

Më **27 qershor 2006**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga ZPSSP për Shtyllën e UNMIK-ut për rimëkëmbje ekonomike, i cili sqaroi se gjykatësi kryesor i Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës kishte ngritur brenga të ngjashme dhe se këto brenga kishin marrë përgjigje në një sqarim të mënshkruar nga PSSP, më 11 janar 2006. Sipas këtij sqarimi, të cilin ZPSSP e kishte bashkëngjitur në letrën e tij, Ligji kundër diskriminimit (Rregullorja e UNMIK-ut 2004/32) caktonte një standard më të ulët të dëshmisë për të dëshmuar diskriminimin se ligji i mëparshëm për privatizim (Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme shoqërore, të shpallur më 12 maj 2003). Meqë ishte shpallur më vonë, Ligji kundër diskriminimit ka zëvendësuar ligjin për privatizim. Për rrjedhim, individët që kishin pohuar shkelje në procesin e privatizimit duhej të “dëshmonin qartë ... se ishin përjashtuar nga lista e punonjësve me të drejtë për të qenë në listë për shkak të diskriminimit, në bazë të dëshmive statistikore apo duke siguruar dëshmi të tjera.” ZPSSP vërtetoi se Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, pjesë e shtyllës së UNMIK-ut për rimëkëmbje ekonomike dhe entiteti me mandat për të zbatuar procesin e privatizimit, do të vepronte në pajtim me këtë organ të ligjit.

### **Akomodimi për të pastrehët**

Më **11 janar 2006**, ankuesi z. R.S. ka paraqitur një ankesë pranë Institucionit të Ombudspersonit, duke pohuar se komuna e Pejës kishte dështuar në ekzekutimin e vendimit të saj të datës 12 maj 2005, që TMK t'i sigurojë z. R.S një kampshtëpizë për banim. R.S. nuk kishte pasur shtëpi që nga luftimet e vitit 1999.

Më **20 janar 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Kryeshefit të Ekzekutivit të Komunës, duke kërkuar të informohet për shkaqet e mos zbatimit të vendimit.

Më **6 shkurt 2006**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga drejtori i Drejtorisë për Emergjencë dhe Mbrojtje Civile (DEMC) në komunën e Pejës. Drejtori sqaroi se Bordi i Drejtorëve të DEMC-së kishte aprovuar blerjen e një kampshtëpize për z. R.S. dhe se TMK kishte marrë përgjegjësinë për gjetjen e një vendi për vendosjen e kampshtëpizës. Vonesa në zbatimin e vendimit të Bordit të Drejtorëve të DEMC-së ishte shkaktuar si rezultat i disa kontesteve pronësore si dhe vështirësive në gjetjen dhe blerjen e një kampshtëpize të përshtatshme.

Më **21 shkurt 2006**, z. R.S. e informoi Institucionin e Ombudspersonit se komuna kishte ekzekutuar vendimin e saj dhe kishte zgjidhur çështjen. Prandaj, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit mbylli rastin si të zgjidhur pozitivisht.

### **Vonesat në procedurat civile ku njëra palë e përfshirë banon në Serbi**

Rasti në vazhdim pasqyron vështirësitë që shkaktohen nga statusi i pazgjidhur i Kosovës në disa nga çështjet më të rëndomta administrative. Mungesa e bashkëpunimit në mes autoriteteve Kosovare dhe të Serbisë mund të çojë në vështirësi të pakalueshme apo thjesht vonesa të jashtzakonshme, si në këtë rast, që përfshinë procedura civile në Kosovë dhe ku njëra nga palët jeton në Serbi. Problemet e tilla nuk mund të adresohen duke shfrytëzuar të drejtën ndërkombëtare, sepse sipas të drejtës ndërkombëtare Kosova dhe Serbia nuk janë shtete të ndara dhe nuk kanë nënshkruar asnjë marrëveshje dypalëshe për të mbuluar zbrastirën ligjore.

Më **13 janar 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Departamentit të Drejtësisë, duke kërkuar informata mbi veprimet e ndërmarra apo të planifikuara lidhur me procedurën përmbartimore në rastin e z. F.I. kundër Gjykatës komunale në Gjilan. F.I. kishte ngritur padi pranë Gjykatës komunale të Gjilanit për kompensim për dëmet e shkaktuara si rezultat i lëndimeve të marra kur z. B.P kishte shtënë në ankuesin me armë zjarri gjatë luftimeve të vitit 1999.

Më **20 mars 2006**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një përgjigje nga Drejtori i Departamentit të UNMIK-ut për Drejtësi, i cili sqaronte se veprimet e ndërmarra nga Departamenti për të ndjekur rastin, duke përfshirë këtu edhe dërgimin e dokumenteve të gjykatës në Ministrinë e Drejtësisë dhe Pushtetit Lokal në Serbi së bashku me një kërkesë për shërbim. Drejtori tha se, pavarësisht nga kërkesat e vazhdueshme për informata, Departamenti ende nuk kishte pranuar një përgjigje nga Ministria e lartpërmendur.

Më **16 qershor 2006**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Drejtori i Departamentit të UNMIK-ut për Drejtësi. Ai theksonte se Departamenti kishte përcjellë kërkesat e Gjykatës komunale në Gjilan më 22 dhjetor 2004, 5 tetor 2005, dhe 9 mars 2006, tek Ministria për Drejtësi dhe Pushtet Lokal e Serbisë por ende nuk kishte pranuar përgjigje. Departamenti gjithashtu i kishte shkruar Gjykatës komunale më 12 dhjetor 2005, duke e azhurnuar për aktivitetet e saj mbi këtë rast. Ai tha se zyra e tij, për fat të

keq, nuk ishte në gjendje të garantojë se autoriteti përkatës do të procesojë kërkesën për ndihmë të përbashkët ligjore brenda periudhës kohore të kërkuar. Në përmbyllje, ai tha se do të informonte institucionin e Ombudspersonit dhe Gjykatën komunale për zhvillimet e reja në këtë rast.

### **Mungesa e fondeve për plotësimin me punonjës të një qendre mjekësore në Fushë Kosovë**

Më **14 janar 2006**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një ankesë nga punonjësit e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, “Dr. Fatmir Krasniqi” në Fushë Kosovë lidhur me dështimin e Qendrës për të vazhduar kontratat e tyre të punës për arsye të mungesës së fondeve nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për vitin 2006.

Më **18 janar 2006**, Ushtuesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Ministrit të Shëndetësisë, me të cilën kërkonte nga ai që të rishqyrtojë vendimin për mos vazhdim të kontratave të punonjësve shëndetësor dhe të kërkojë fonde për t’i paguar ata, në mënyrë që ata të mund të vazhdonin punën edhe më tej.

Më **19 janar 2006**, Ushtuesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Kryetarit të komunës së Fushë Kosovës, me të cilën kërkonte informata lidhur me atë se ç’ishte duke bërë komuna për të zgjidhur këtë çështje dhe duke i rikujtuar atij rëndësinë e nevojës për të siguruar punonjës të mjaftueshëm në sektorin e shëndetësisë dhe që përbërja e tyre etnike të jetë në pajtim me atë të banorëve të komunës.

Më **9 maj 2006**, Ushtuesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Kryeministrit, ku fliste për letërkëmbimin e lartëpërmendur duke thënë se nuk kishte pranuar kurrfarë përgjigje në letrën e tij të fundit. Më tej, Ushtuesi i detyrës së Ombudspersonit tha se meqë kjo qendër mjekësore ishte institucioni i vetëm multi-etnik shëndetësor në komunën e Fushë Kosovës, ku punonin punonjës të etnicitetit shqiptar dhe serb, situata kishte vënë në pyetje të gjitha përpjekjet nga Komuna për të krijuar një shoqëri multi-etnike funksionale, si dhe përpjekjet e saj për të plotësuar standardet për Kosovën.

Institucioni i Ombudspersonit nuk ka pranuar kurrfarë përgjigje në asnjë nga letrat e lartëpërmendura.

### **Mungesa e përgjigjes në kërkesat për pension bazë dhe invalidor**

Më **19 janar 2006**, Ushtuesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Drejtorit të Administratës Pensionale të Kosovës në kuadër të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me një ankesë të znj. R.T., e cila nuk kishte pranuar përgjigje në kërkesën e saj për pension.

Më **19 janar 2006**, Ushtuesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Drejtorit të Administratës Pensionale të Kosovës në kuadër të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me një ankesë të z. I.B. i cili nuk kishte pranuar përgjigje në kërkesën e tij për pension invalidor.



Më **3 shkurt 2006**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një përgjigje nga Drejtori i Divizionit për Pagesa i Administratës Pensionale të Kosovës, që sqaronte se kërksat e të dy ankuesve, z. I.B. dhe znj. R.T., ishin aprovuar por se pagesa për z. R.T. ishte në pritje deri në hapjen zyrtare të një xhironlogarie bankare nga ankuesi. Drejtori i Divizionit gjithashtu premtoi se pensionet do të paguheshin deri në fund të marsit 2006.

Më **17 mars 2006** dhe **28 mars 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi letra znj. R.T dhe z. I.B përkatësisht, duke i informuar ata se pensionet e tyre do të paguheshin së shpejti dhe se ai i kishte mbyllur rastet e tyre të klasifikuara si të mbyllura pozitivisht.

### **Parregullësitë në procesin e rindërtimit pas marsit 2004**

Gjatë 12 muajve të fundit, Ombudspersoni dhe Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i kanë dërguar disa letra Komisionit Qendror Ndërmëtor për Rindërtim, i cili ka përgjegjësinë për organizimin dhe rindërtimin e shtëpive dhe banesave të shkatërruara gjatë ngjarjeve të marsit 2004. Letrat rekomandonin fillimin e punëve rindërtuese në tre banesa në Prishtinë dhe në një shtëpi në Obiliq, të gjitha këto të shkatërruara në mars 2004. Gjithashtu, letrat rekomandonin që këta ankues të kompensoheshin për dëmet e shkaktuara në pronën e tyre të luajtshme që kishte qenë në këto shtëpi.

Lidhur me këtë çështje, Ombudspersoni dërgoi letra në datat vijuese:

- 1 korrik 2005 (një letër)
- 13 korrik 2005 (një letër)
- 14 tetor 2005 (dy letra)

Lidhur me këtë çështje, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit dërgoi letra në data vijuese:

- 21 prill 2006 (dy letra)
- 19 maj 2006 (dy letra)
- 16 qershor 2006 (një letër)

Më **19 janar 2006**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Komisioni, që thoshte se Komisioni nuk ishte duke nxjerrë vendime lidhur me rindërtimin por thjeshtë duke i zbatuar vendimet e Komunave për sa i përket dy nga rastet e përmendura më lartë.

Institucioni i Ombudspersonit nuk ka pranuar përgjigje në asnjë nga letrat e saj për sa i përket dy rasteve tjera.

Në shkurt 2006, një përfaqësues i Institucionit të Ombudspersonit vizitoi Zyrtarët Lokal të Komuniteteve në komunën e Prishtinës dhe Obiliqit. Këta zyrtarë thanë se i kishin dërguar Komisionit një listë të plotë të shtëpive të shkatërruara në komunat e tyre përkatëse dhe se Komisioni i kishte hequr emrat e ankuesve nga këto lista, duke thënë se shtëpitë nuk ishin shkatërruar gjatë ngjarjeve të marsit por kohë më vonë.

Më **17 shkurt 2006**, Ushtuesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi letër Komisionit duke kërkuar nga ai që të rishqyrtojë rastet dhe duke rekomanduar që të rindërtohen shtëpitë në fjalë dhe të kompensohen pronarët për dëmet e shkatuara në pronën e tyre të paluajtshme.

Më **7 prill 2006** dhe **16 qershor 2006**, Ushtuesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Kryeministrit, duke i drejtuar vënmdjen ndaj këtyre rasteve dhe duke kërkuar nga ai që të shfrytëzojë autorizimet e tij për të siguruar që Komisioni Qendror Ndërministror për Rindërtim të shqyrtojë këto raste dhe t'i përgjigjet rekomandimeve dhe kërkesave për informim nga Institucioni i Ombudspersonit.

### **Mungesa e teksteve mësimore për fëmijët jetim dhe të varfër**

Më **30 janar 2006**, Ushtuesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Ministrit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji lidhur me çështjen e zbatimit të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, i cili kërkon që të shpërndahen falas tekstet mësimore për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme. Ushtuesi i detyrës së Ombudspersonit tha se kishte informata se këtë vit ishin shpërndarë më pak tekste mësimore për fëmijët jetim dhe të varfër dhe se për mungesë të teksteve mësimore më shumë fëmijë e kishin braktisur shkollën. Ushtuesi i detyrës së Ombudspersonit kërkoi nga Ministri që të gjejë zgjidhje për këtë çështje dhe të sigurojë që të gjithë fëmijët në Kosovë të kenë mundësi që të realizojnë të drejtën e tyre për arsimim, pavarësisht nga prapavija e tyre sociale dhe ekonomike. Në letrën e tij, Ushtuesi i detyrës së Ombudspersonit iu referua letërkëmbimit që kishte pasur Ombudspersoni i mëparshëm me Ministrinë gjatë vitit 2004, lidhur me sqarimet për përgjegjësinë e Ministrisë për të siguruar tekste mësimore në pajtim me ligjin.

Më **7 shkurt 2006**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Sekretari i Përhershëm i Ministrisë. Sekretari i Përhershëm tha se Ministria kishte shpenzuar mbi 157.000 Euro për shpërndarjen e teksteve mësimore për nxënësit jetim dhe të varfër por, duke pasur parasyshë burimet e saj financiare, kjo ishte e tëra që Ministria mund të bënte. Ai tha se Ministria kishte bërë çdo gjë në fuqinë e saj për të zbatuar ligjin.

### **Një kërkesë për kthim në vendin e mëparshëm të punës në komunë**

Më **3 shkurt 2006**, Ushtuesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Kryetarit të komunës së Gjilanit, lidhur me kërkesën e z. J.B. për t'u kthyer në vendin e punës në komunë, ku ai kishte punuar para luftimeve të vitit 1999. Ushtuesi i detyrës së Ombudspersonit kërkoi informata për gjendjen aktuale të rastit dhe për veprimet e ndërmarra apo që planifikoheshin nga komuna për këtë rast, në pajtim me sundimin e ligjit.

Më **14 prill 2006**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Kryetari i komunës, i cili thoshte se komuna ishte riorganizuar pas luftimeve dhe se nuk kishte pasur dispozita për të rezervuar pozitat e punonjëve të mëparshëm. Për më tepër, në pajtim me ligjin e aplikueshëm, të gjithë punonjësit e komunës duhej të kalonin një procedurë të veçantë të

aplikimit në mënyrë që të kualifikoheshin për ndonjë pozitë. Sipas Kryetarit të komunës, z. J.B. kishte aplikuar disa herë dhe nuk kishte fituar të drejtën që t'i rekomandohet Komisionit Komunal për Selektim. Në fund, kryetari tha se komuna nuk kishte pozita të hapura në atë kohë dhe se nuk mund të punësonte punonjës të ri.

### **Një kërkesë për të transferuar një të burgosur nga Gjermania në Kosovë**

Më **7 shkurt 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Drejtorit të Departamentit të UNMIK-ut për Drejtësi duke mbështetur kërkesën e znj. S.Ç. për ndihmë në ekstradimin e vëllaut të saj nga një burg në Gjermani në një qendër korrektuese në Kosovë.

Më **23 maj 2006**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Drejtori i Departamentit të Drejtësisë, ku thuhej se vëllau i znj. S.Ç, me sa duket, ishte dënuar edhe nga një gjykatë në Spanjë. Drejtori sqaroi se nëse ai duhet të kthehet në Spanjë pas përfundimit të dënimit në Gjermani, UNMIK-u nuk do të jetë në gjendje të procesojë një kërkesë për transferimin e tij në Kosovë.

### **Ankesa për parregullësi në pranim në një program të studimeve post-diplomike**

Më **21 shkurt 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Rektorit të Universitetit të Prishtinës, me të cilën i drejtonte vëmendjen ndaj një ankese të bërë nga disa studentë që kishin aplikuar për programin e studimeve post-diplomike në Fakultetin e Psikologjisë të Universitetit të Prishtinës. Ankuesit kishin marrë pjesë në një konkurs për regjistrim në programin e studimeve post-diplomike më 13 dhjetor 2005. Ata pohuan se refuzimi i aplikacioneve të tyre nga Fakulteti i kishte shkelur rregullat e brendshme të Universitetit dhe kriteret e regjistrimit për studime post-diplomike.

Më 7 shkurt 2006, studentët kishin paraqitur një ankesë pranë Rektorit të Universitetit dhe Dekanit të Fakultetit të Psikologjisë. Sipas ankuesve, Dekani ishte përgjigjur pozitivisht ndaj ankesës së tyre dhe i kishte rekomanduar Rektorit pranimin e tyre në Fakultetin e Psikologjisë, por Rektori kishte refuzuar.

Në letrën e tij, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit kërkoi nga Rektori që ta informonte atë mbi bazat ligjore të vendimit të tij për refuzimin e rekomandimit të Dekanit.

Veprimet e Institucionit të Ombudspersonit në këtë rast ishin suspenduar në pritje të zgjedhje së Rektorit të ri të Universitetit.

### **Brengat e ngritura pranë UNMIK-ut lidhur me Rregulloren e re të UNMIK-ut mbi Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë**

Më **22 shkurt 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër PSSP-së, për brengat që kishte lidhur me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/06, që ishte shpallur më

16 shkurt 2006. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit shprehu brengën se, duke e pasur parasysh që Rregullorja e re heq juridiksionin e Institucionit mbi UNMIK-un, administrata ndërkombëtare nuk i nënshtrohet më asnjë mekanizmi zyrtarë të mbrojtjes të së drejtave të njeriut. Për më tepër, ky ndryshim në juridiksion vinte në pyetje se çdo të ndodhë me rastet ende të hapura të Institucionit kundër UNMIK-ut si dhe ç'mund të bëhet me ankesat nga pjesa veriore e Mintrovicës, ku IPVQ-të nuk funksionojnë dhe UNMIK-u është i vetmi autoritet publik legjitim. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit gjithashtu theksoi disa paqartësi në tekstin e rregullores, përfshirë këtu dispozitat rreth marrëdhënies së institucionit me qendrat e paraburgimit.

Në fund, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit tha se Rregullorja linte të paqarta çështje të rëndësishme rreth të ardhmes financiare të institucionit. Me sa dukej, Rregullorja e inkorporonte Institucionin e Ombudspersonit në shërbimin civil të IPVQ-ve, duke e bërë buxhetin e tij plotësisht të varur nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Megjithatë, Rregullorja nuk sqaronte disa hollësi të caktuara të procedurave buxhetore, si për shembull a mundet Institucioni i Ombudspersonit të caktojë nivelin e pagave të punonjësve brenda buxhetit të caktuar, siç u lejohet disa Institucioneve të Ombudsmaneve në Evropë.

Pas sqarimit të hollësishëm të brengave të tij, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit kërkoi një takim me PSSP-në për të diskutuar lidhur me dispozitat e rregullores që kishin nevojë për sqarim të mëtejshëm, në veçanti për çështjen e rasteve të pazgjydhura që kishin të bëjnë me UNMIK-un.

Ndonëse janë mbajtur takime me OSBE-në lidhur me këto çështje, PSSP dhe Këshilltari Ligjor i UNMIK-ut ende nuk janë përgjigjur në këtë letër.

### **Brengat e ngritura pranë UNHCHR-së lidhur me Rregulloren e re të UNMIK-ut mbi Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë**

Më **23 shkurt 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Komisionares së Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, për të shprehur brengat e tij rreth paqartësive në gjuhën e përdorur në Rregulloren e UNMIK-ut 2006/06 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë.

Më **21 mars 2006**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Komesarja e Lartë, e cila falënderonte institucionin që e kishte informuar për këto zhvillime. Komisionarja e Lartë konfirmoi se do të ngritë brengat e institucionit lidhur me interpertimin e Rregullores dhe do të nxisë qartësimin e saj përmes kanaleve përkatëse. Më tej, ajo bëri me dije se përfaqësuesi i saj në Prishtinë do të vazhdonte kontaktin me institucionin për këto dhe çështje të ngjashme.

### **Ankesat lidhur me rilokimin e një shkolle fillore**

Më **1 mars 2006**, Ombudspersoni pranoi një ankesë nga fshati Kabash dhe lagjja Morinë e fshatit Kuzhnin, të cilët më parë kishin shfrytëzuar një shkollë të përbashkët në Kabash.

Përfaqësuesit e këtyre bashkësive ankoheshin se në vitin 2005, Drejtoria për Arsim në komunën e Prizrenit kishte ndërtuar një shkollë të re në pjesën e epërme të fshatit Kuzhnin dhe kishte mbyllur shkollën në Kabash, duke i detyruar nxënësit që të ecin një rrugë të gjatë për të arritur në shkollë.

Më **22 mars 2006**, një përfaqësues i Institucionit të Ombudspersonit vizitoi këto dy bashkësi dhe vërtetoi se 215 fëmijë nga fshati Kabash dhe lagjja Morinë nuk ishin duke vijuar mësimin sepse dy bashkësitë ishin të pakënaqura me vendimin e Drejtorisë Komunale. Ata thanë se rruga që duhet të përshkonin nxënësit për të arritur në shkollën e re ishte e paarsyeshme.

Më **24 mars 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Ministrit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, në të cilën rekomandoi që Ministria të gjejë zgjidhje për situatën pa vonesa të mëtutjeshme dhe ofroi shërbimet e Institucionit të Ombudspersonit si ndërmjetësues.

Më **19 prill 2006**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Minsitri për Shkencë, Arsim dhe Teknologji, i cili theksonte se shkolla e vjetër ishte rihapur dhe se ankesa ishte zgjidhur. Tani, 215 fëmijë ishin duke ndjekur mësimë intensive (disa në shkollën e re, disa në atë të vjetrën) për të kompensuar orët e humbura të mësimet. Ai më tutje theksoi se Ministria do të ishte në gjendje të mbështesë kërkesën e prindërve të përfshirë, me të cilën kërkohej që fëmijët e tyre të ndjekin mësimet në një njësi të veçantë të shkollës në fshatin Kabash, nëse ata do të mbulonin 50 përqind të shpenzimeve për shkollën, nëse mësuesi plotëson kriteret profesionale dhe nëse të gjitha klasat kanë më së paku nga 21 nxënës.

Më **27 prill 2006**, një përfaqësues i fshatit Kabash e informoi Institucionin e Ombudspersonit që situata ishte zgjidhur dhe se zgjidhja ishte e kënaqëshme për të dy bashkësitë

### **Redukti i çmimeve të shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara**

Më **24 mars 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Zëvendës Drejtorit Menaxhues i Korporatës Endergjeticke të Kosovës (KEK), duke kërkuar sqarim lidhur me atë se për çfarë arsye nuk ishte zbatuar neni 13.7 i Ligjit 2003/23, që u mundëson njerëzve me aftësi të kufizuara të paguajnë çmim të reduktuar për shpenzim të energjisë elektike. Kopja e kësaj letre iu dërgua edhe Ministrit të Minierave dhe Energjisë si dhe Ministrit për Punë dhe Mirëqenie Sociale si dhe Menxherit të KEK-ut për rajonin e Ferizajt.

Më **21 prill 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi përsëri një letër Zëvendës Drejtorit Menaxhues të KEK-ut, duke i përsëritur brengat e ngritura në letërën e tij të 24 marsit 2006.

Më **4 maj 2006**, Ombudspersoni pranoi një përgjigje nga Zëvendës Drejtorit Menaxhues, i cili theksoi se KEK-u do të zbatonte nenin 13.7 sapo të nxirren udhëzimet e nevojshme administrative nga Ministritë kompetente, ashtu siç thuhet në nenin 13.8 të po këtij ligji.

Më **19 maj 2006**, Ombudspersoni pranoi një përgjigje nga Drejtori i Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës (në kuadër të Minsitrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale), ku theksohej se Ministria për Miniera dhe Energjetikë dhe ajo për Financa dhe Ekonomi ishin informuar kohë më parë se duhet të nxirrnin Udhëzime Administrative për zbatimin e këtij ligji, por Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës nuk kishte pranuar kurrfarë udhëzimesh nga Minsitritë e lartëpërmendura.

Më **12 qershor 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Kryeministrit, duke thënë se mungesa e Udhëzimeve Administrative për Ligjin 2003/23 për Pensionet e Aftësisë së Kufizuar kishte bërë që një kategori qytetarësh t'i mohoen beneficionet e akorduara me këtë Ligj. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit kërkoi nga Kryeministri që të intervenojë pranë ministrive relevante për të siguruar që ato do të nxjerrin, pa vonesë të mëtejshme dhe me efekt retroaktiv, aktet nën-ligjore për zbatimin e të gjitha beneficioneve të renditura sipas nenit 13 të ligjit 2003/23 për Pensionet e Aftësisë së Kufizuar. Ombudspersoni i dërgoi kopje të kësaj letre edhe Kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe Ministrave kompetent për këtë çështje.

### **Ankesat kundër shërbimit komunal për mbledhjen e mbeturinave**

Më **21 prill 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Kryetarit të komunës së Pejës duke ngritur brengat e tij rreth pohimeve të banorëve të fshatit Bellopojë se Shërbimi komunal për mbledhjen e mbeturinave po i hidhte mbeturinat në tokat e tyre, duke i parandaluar në kultivimin e tokave të tyre. Banorët kishin kërkuar që komuna të merrte përgjegjësinë për largimin e mbeturinave nga tokat e tyre dhe t'i kthente ato në gjendje të mirë për lërim. Gjatë një takimi me Ushtruesin e detyrës së Ombudspersonit më 7 mars 2006, Kryetari i komunës kishte propozuar krijimin e një komisioni të veçantë që do të shqyrtonte çështjen dhe që do të rekomandonte një zgjidhje. Në letërën e tij, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit kërkoi informata nga Kryetari se çfarë veprimesh ishin ndërmarrë për rastin që nga takimi i tyre.

Institucioni i Ombudspersonit nuk ka pranuar përgjigje në këtë letër.

### **Dështimi për të siguruar ndihmë sociale për civilët invalid të lënduar gjatë Luftës së Dytë Botërore**

*Më 10 qershor 2005, Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryeministrit të Kosovës duke shprehur brengën e tij në lidhje me situatën e civilëve të lënduar gjatë Luftës së Dytë Botërore, të cilët, që nga fundi i luftimeve më 1999, nuk janë duke marrë pensionet e tyre invalidore apo ndonjë formë tjetër të ndihmës në të cilën kishin të drejtë me ligj. Ombudspersoni e informoi Kryeministrin se ligji Nr. 32 i Krahinës Autonome të Kosovës mbi "Mbrojtjen e civilëve invalid të luftës" i vitit 1976 ishte ende në fuqi në Kosovë. Sipas këtij ligji, civilët të cilët ishin lënduar gjatë Luftës së Dytë Botërore kishin të drejtë në disa beneficione siç janë, përfitimet financiare dhe ndihma mjeksore pa pagesë. Ombudspersoni vërejti se nuk ishin bërë kurrfarë përpjekje për të zgjidhur këtë çështje dhe kërkoi informata për çfardo lloj veprimesh që Kryeministri planifikonte të ndërmerr në këtë drejtim.*

Më **2 maj 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi përsëri një letër Kryeminsitrit, duke përsëritur brengat e tij të theksuara në letrën e Ombudspersonit të mëparshëm, të datës 10 qershor 2005. Ai theksoi se më 24 shkurt 2006, Kuvendi i Kosovës kishte miratuar Ligji për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës por ky ligj kishte dështuar të përfshijë si përfitues edhe invalidët civilë nga Lufta e Dytë Botërore. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit përsëriti kërkesën e Ombudspersonit të mëparshëm që Kryeministri të intervenojë në emër të të drejtave të civilëve të lartpërmendur.

### **Dështimi i vazhdueshëm i DÇPB-së dhe UNMIK-ut për të dëbuar një uzurpues të paligjshëm**

*Më 5 maj 2004, Ombudspersoni publikoi një Raport për rastin e z. S.K ku gjeti që dështimi i vazhdueshëm i DÇPB-së dhe Policisë së UNMIK-ut për ta dëbuar një uzurpatorë të paligjshëm nga prona e z. S.K. kishte shkelur të drejtën e z. S.K. për respektimin e vendbanimit të tij sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*

*Më 11 gusht 2004, ZPSSP për Administratë Civile, u përgjigj në raportin e mësipërm. Duke thënë se DÇPB kishte ekzekutuar dhe ri-ekzekutuar vendimin e saj në mënyrë të efektshme, por që ngjarjet pas dëbimit e kishin parandaluar z. S.K nga qasja në pronën e tij, ZPSSP thoshte se DÇPB nuk mund ta mbante përgjegjësinë e mbrojtjes së pronës pas dëbimit dhe u pajtua me rekomandimin e Ombudspersonit që z. S.K. t'i drejtohet prokurorit publik për rastin e tij.*

*Më 14 shtator 2004, Ombudspersoni i dërgoi një letër ZPSSP-së, duke pohuar se DÇPB kishte një përgjegjësi të caktuar për të siguruar që uzurpimet e përsëritura të hetohen nga policia dhe prokurorët publik, edhe pas ekzekutimit të vendimit të tij. Ombudspersoni theksoi që pozita e pronarëve të pronave, pas vitit 1999, ishte shpesh më e dobët në krahasim me atë të uzurpuesve të paligjshëm dhe e nxiti DÇPB-në që të përkrahë pozitën ligjore të pronarëve të pronave.*

Më **12 maj 2006**, ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Komandanit të Stacionit Policorë nr.3, duke pyetur se a mund të hapë Stacioni i tij hetime penale kundër uzurpuesit të paligjshëm të pronës së S.K. Ankuesi kishte kërkuar paraqitur ankesë pranë Institucionit të Ombudspersonit më 4 prill 2006, duke pohuar se uzurpuesi i paligjshëm ishte dëbuar dhe më pas kthyer në banesën e tij disa herë gjatë muajve të fundit, që nga dëbimi i 8 nëntorit 2005. S.K, më tej, pohoi se SHPK nuk ishte përgjigjur në kërkesat e tij se a kishin hapur hetime penale apo jo.

Më **30 maj 2006**, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Komesari i Policisë së UNMIK-ut, i cili kishte bashkëngjitur një memo që sqaronte veprimet e ndërmarra nga policia në rastin e z. S.K. Më 8 nëntor 2005, një njësi e SHPK-së kishte asistuar një ekzekutimin e urdhërit për dëbim të DÇPB-së dhe Komesari pohonte se, që nga ajo kohë, SHPK nuk kishte pranuar asnjë ankesë nga z. S.K. apo dikush tjetër lidhur për uzurpim të sërishëm apo dëmtim të pronës në fjalë. Megjithatë, me pranimin e letrës së Ushtruesit të

detyrës së Ombudspersonit më 17 maj 2006, SHPK kishte dërguar një njësi të policisë në shtëpinë e z. S.K. për të kuptuar situatën e vërtetë. Atje, ata kishin gjetur se uzurpuesi i paligjshëm ishte kthyer në banesë dhe pohonte se kishte arritur një marrëveshje me S.K. për të blerë shtëpinë e tij. Më 19 maj 2006, një njësi e policisë së SHPK-së kishte shkuar në Graçanicë me ç'rast ishte takuar me ankuesin dhe uzurpuesin e paligjshëm dhe kishte kuptuar se palët kishin arritur vërtetë një marrëveshje lidhur me pronën. Komesari konkludoi se policia i kishte marrë të gjitha masat e nevojshme për sa i përket pronës së poseduar nga z. S.K.

### **Mungesa e përkthimit të të udhëzimeve mbi përdorimin dhe etiketimin e barnave të importuara**

*Më 6 maj 2005, Institucioni i Ombudspersonit regjistroi një rast lidhur me shitjen e prodhimeve të importuara medicinale nëpër barnatoret e Kosovës. Një numër i këtyre prodhimeve medicinale nuk kishin udhëzime mbi përdorim, caktim të dozës dhe/ose etiketë të paketimit të përkthyer në ndonjërin nga gjuhët zyrtare të Kosovës.*

*Më 18 maj 2005, Ombudspersoni i shkroi një lëter Ministrin të Shëndetësisë për të shprehur brengën e tij lidhur me shitjen e prodhimeve medicinale pa ndonjë përkthim të udhëzimeve, dozës, dhe/apo etiketës të paketimit në ndonjërin nga gjuhët zyrtare të Kosovës. Mes tjerash, Ombudspersoni theksoi se individët të cilët kishin blerë medikamentet e lartpërmendura zakonisht nuk e kishin kuptuar gjuhën në të cilën ishin shkruar udhëzimet dhe u kishte mbetur të besonin në udhëzimet gojore të dhëna nga farmacistët apo edhe nga nëpunësit që punojnë nëpër barnatore. Ombudspersoni iu referua Ligjit të Kuvendit të Kosovës për Prodhime Medicinale dhe Pajisje Mjekësore, i shpallur me rregulloren e UNMIK-ut 2004/23, i cili thekson se autorizimi për marketing dhe shitje të prodhimeve mjekësore kërkon, mes tjerash, “një prezantim të saktë dhe të vlefshëm të katalogut, përmbledhjes së cilësive të prodhimit dhe një fletushke të paketimit (fletushkë për informimin e pacientit) të prodhimit medicinal për përdorim në Kosovë”. Ombudspersoni kërkoi nga Ministri që ta informojë atë për veprimet që planifikonte të ndërmerre Minsitria e Shëndetësisë për të zgjidhur këtë problem.*

*Më 7 qershor 2005, Ombudspersoni ka pranuar një përgjegjie nga Ministri i Shëndetësisë, i cili e informonte Ombudspersonin se Ministria ka kërkuar nga kompanitë mjekësore, të cilat kishin aplikuar për regjistrim të prodhimeve medicinale në Kosovë, të bëjnë përkthimin e fletushkave udhëzuese të barnave të tyre. Megjithatë, Ministria gjeti se ishin bërë shumë gabime në përkthimin dhe prandaj nuk kishte lejuar publikimin e tyre. Prandaj, Ministria ishte duke punuar me Agjencinë e Kosovare për Prodhime Mjekësore (që është pjesë e Ministrisë së Shëndetësisë) për të përgatitur një kontratë me një tjetër organizatë që të bëjë redaktimin e këtyre materialeve. Një organizatë e tillë mund të zgjidhej vetëm përmes një procesi të tenderimit, që kërkon vlerësimin e së paku tri ofertave. Në përmbyllje, Ministri theksoi se në rastet kur materialet për përkthim të kompanive që bëjnë shitjen e prodhimeve medicinale nuk ishin përkthyer, kompanive u ishte dhënë autorizim i përkohshëm për marketing dhe shitjen e prodhimeve të tyre medicinale në Kosovë, bazuar në Udhëzimin e saj Administrativ 2003/09.*



Më **15 qershor 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Ministrit të Shëndetësisë, me të cilën kërkonte informata për çfarëdo veprime të mëtijshme të ndërmarra nga Ministria në këtë rast, duke theksuar se, me sa dukej, situata nuk kishte ndryshuar në 12 muajt e kaluara që nga letra e tij e fundit.

Që nga ajo kohë, një përfaqësues i Institucionit të Ombudspersonit ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të kontaktuar Minsitrinë e Shëndetësisë dhe për të shikuar se a ishte zgjedhur ndonjë organizatë për të bërë redaktimin e teksteve të produkteve. Për fat të keq, këto përpjekje kanë qenë të pasuksesshme deri më tani.

### **Zbatimi në të njëjtën kohë i Ligjeve të Jugosllavisë dhe atyre të IPVQ-ve**

Më **15 qershor 2006**, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, me të cilën kishte ngritur brengat lidhur me Ligjin e Kuvendit nr. 2004/32 mbi Familjen. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit theksoi se më parë, fusha e marrëdhënieve familjare rregullohej nga Ligji Jugosllav mbi Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare nr. 10/84, i vitit 1984, por Ligji i ri i Kuvendit nuk përmbante asnjë dispozitë ku thuhet se Ligji Jugosllav do të zëvendësohet nga ligji i ri. Veç kësaj, ligji i ri thekson se gjykatat e Kosovës do të kenë juridiksion mbi rastet lidhur me besimin dhe adoptimin e fëmijëve, mirëpo qendrat për punë sociale dhe organet tjera administrative, që kanë qenë kompetente për këto raste sipas ligjit të Jugosllavisë, kishin vazhduar të vendosin për këto raste dhe anjë rast i kësaj natyre nuk kishte arritur ende pranë gjykatve. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit tha se kjo krijonte një paqartësi të madhe ligjore që dobësonte sundimin e ligjit dhe e nxiti Krytarin e Kuvendit që të ndërmerr masa lidhur me këtë çështje.

### **Zbatimi retroaktiv i legjislacionit për taksa**

Më 30 qershor 2006, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Kryesuesit të Shërbimit Doganor të UNMIK-ut, në të cilën ngriti brengat e tij lidhur rastin katër ankuesve të cilët pohonin se u ishin konfiskuar automjetet e tyre si rezultat i zbatimit retroaktiv të paligjshëm të një Rregulloreje të UNMIK-ut (Rregullorja e UNMIK-ut 2005/32) nga Doganat. Rregullorja në fjalë kishte hyrë në fuqi më 1 korrik 2005 dhe kërkonte nga banorët e Kosovës që të paguajnë akcizë dhe TVSH para regjistrimit të automjeteve të tyre. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit drejtojë vëmendjen ndaj një rasti kur ankuesi kishte bërë përpjekje të paguajë këto taksa por nuk i ishte lejuar të marrë veturën sepse sipas zytarit të doganës, me të cilin kishte biseduar ankuesi, duheshte që së pari të zgjidheshin të gjitha rastet e tyre të konfiskimit të automjeteve. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit kërkoi që t'i sigurohet një analizë e Shërbimit Doganor për aspektin ligjor të këtij rasti.

### **Vonesat në procedura gjyqësore për arsye të mungesës së mendimeve të ekspertëve**


Më 30 qershor 2006, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Drejtorit të Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut, në të cilën kishte ngritur brengat e tij

lidhur me rastin e Q.B. Q.B ishte ankuar se në tre raste Gjykata komunale në Gjakovë kishte kërkuar nga Zyra e UNMIK-ut për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore t'i lehtësojë hetimet e saj në vdekjen e vajzës së Q.B. duke siguruar mendime të ndryshme të ekspertëve, megjithatë Gjykata nuk ka pranuar anjë përgjigje në kërkesën e saj që nga 20 dhjetori 2005. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit kërkoi informata për çfarëdo veprime të ndërmarra nga Zyra e UNMIK-ut për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore për këtë rast.


### **Paqartësitë në Ligjin për pensionet e personave me aftësi të kufizuar**

Më 30 qershor 2006, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Ministrit për Punë dhe Mirëqenie Sociale, duke i drejtuar vëmendjen në gjendjen e vështirë të shumë ankuesve, të cilët kishin pohuar se u është mohuar gabimisht e drejta për të pranuar ndihma sociale për persona me aftësi të kufizuara. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit theksoi se pjesë të ndryshme të Ligjit për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar e kishin lënë të paqartë termin “aftësi plotësisht të kufizuara”. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit rekomandoi që Ministri të gjejë zgjidhje për këtë çështje duke i propozuar Kuvendit të Kosovës ndryshimin e pjesëve të ligjit në fjalë.

Institucioni I Ombudspersonit  
Skema Organizative



Institucioni i Ombudspersonit  
Nën-skema për Zyret në teren



## ANEKSI V: LISTA E PUNONJËSVE

### Punonjësit e Institucionit (më 30 qershor 2006)

Zëvendës i Ombudspersonit/ Ushtues i detyrës së Ombudspersonit	Hilmi Jashari
Zëvendës i Ombudspersonit	Ljubinko Todorović
Drejtor i Hetimeve	Veton Vula
Zëvendëse e Drejtorit të Hetimeve për Projekte Speciale	Violeta Krasniqi-Rexha
Jurist i Lartë, Prishtinë	Avni Hasani
Juriste e Lartë, Prishtinë	Gjylbehare Murati
Juriste e Lartë, Prishtinë	Ilijana Çollaku
Kryesues i Zyrës Rajonale në Gjilan	Goroljub Pavić
Kryesuese e Zyrës në Terren	Aleksandra Dimitrijević
Kryesues i Zyrës Rajonale në Mitrovicë	Naim Krasniqi
Kryesuese e Zyrës Rajonale në Pejë	Hasie Islami
Kryesues i Zyrës Rajonale në Prizren	Murlan Prizreni
Jurist, Prishtinë	Agron Kelmendi
Juriste për GDF	Thëllënza Arifi
Juriste për NjBGj	Luljeta Domaniku
Juriste e Lartë për GMD	Dragana Rodić
Juriste e Lartë për GMD	Merita Syla
Jurist, Gjilan	Isuf Sadiku
Juriste, Mitrovicë veriore	Miljana Scekić
Juriste, Pejë	Shqipe Ibraj-Mala
Juriste, Prizren	Hunaida Pasuli
Jurist, Vidanje	Vlado Prođović
Drejtor i Administratës	Përparim Vula
Zyrtar për Informim dhe Media	Ibrahim Arslan
Përgjegjës për TI	Flamur Gogolli
Zyrtar për prokurim	Gëzim Latifi
Zyrtar i financave	Beqir Musliu
Udhëheqës i Përkthyesve,	Isak Skenderi
Përkthyes i Lartë,	Lirak Hamiti
Përkthyes i Lartë,	Alban Stafai
Përkthyes,	Safete Sadrija
Përkthyes,	Marko Djekić
Përkthyes/Asistent Ligjor, Gjilan	Meliha Brestovci
Asistent Ligjor, Graçanicë	Dušan Dimitrijević
Përkthyes/Asistent Ligjor, Mitrovicë	Merita Gara
Përkthyes/Asistent Ligjor, Pejë	Aida Nela
Përkthyes/Asistent Ligjor, Prizren	Abdullah Kryeziu
Asistente Ekzekutive	Arta Ibrahimimi
Asistente Ekzekutive	Shqipe Paçarada

Asistent Ligjor	Venera Rizvanolli
Asistent Ligjor	Labinot Sheremeti
Udhëheqës i Vozitësve	Shpëtim Reçica
Vozitës	Tamer Gaş
Vozitës	Sami Kuqi
Vozitës	Goran Stević
Udhëheqës i Rojtarëve	Bekim Bunjaku
Rojtar	Hakif Imeri
Rojtar	Muhamet Jahiri
Rojtar	Mentor Myftari
Rojtar	Avni Osmani
Rojtar	Besim Osmani
Pastruese	Nekibe Hoxha
Pastruese	Gëzime Lepaja
Pastruese, Graçanicë	Vesna Cvejić

**Personat që u larguan nga Institucioni i Ombudspersonit gjatë periudhës për të cilën raportohet**

Ombudsperson ndërkombëtar	Marek Antoni Nowicki
Drejtor Ekzekutiv	Naser Krasniqi
Zëvendës i Drejtorit të Hetimeve për Zyrat rajonale	Sefadin Blakaj
Juriste e Lartë	Dragana Ristić
Jurist	Enis Shatri
Jurist, Pejë	Besim Tafa
Jurist, Pejë	Armend Ademaj
Jurist, Prizren	Atdhe Berisha
Përgjegjës për IT	Hekuran Latifi
Asistente e Veçantë e Ombudspersonit	Leonora Visoka
Udhëheqëse e përkthyesve	Branislava Stojilović
Përkthyes/Asistent ligjor, Graçanicë	Milan Prljinić
Asistent ligjor	Xhafer Tahiri
Operator Telefonist	Bedri Kamberi
Rojtar	Arben Plakaj

**Këshilltarët Ndërkombëtar (më 30 qershor 2006)**

Këshilltare e Veçantë e OSBE-së për Ombudspersonin ( Të Drejtat e njeriut)	Antonella Ingravallo
Këshilltar i Veçantë e OSBE-së për Ombudspersonin ( Çështje me publikun)	Richard Medic
Këshilltar i Veçantë i OSBE-së për Ombudspersonin ( Çështje ligjore)	Alice Thomas
Këshilltar i Veçantë i OSBE-së për Ombudspersonin (Çështje me publikun) deri më 15 maj 2006. Këshilltar i OSBE-së për raportin vjetor nga 16 maji 2006	Joshua Wright

**Këshilltarët ndërkombëtar që u larguan nga Institucioni i Ombudspersonit gjatë periudhës për të cilën raportohet**

Këshilltar i Veçantë i OSBE-së për Ombudspersonin (Çështje me publikun)	Jackson Allers
Këshilltare Ndërkomb. për programe speciale	Francesca Marzatico
Këshilltare Ndërkombëtare e Ombudspersonit për media dhe çështje me publikun	Katalin Mester

## ANEKSI VI: LISTA E SHKURTESAVE

GDF	Grupi për të Drejtat e Fëmijëve në Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë
ZPSSP	Zëvendës i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm
IRJM	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
NJBGJ	Njësia për Barazi Gjinore në Institucionin e Ombudspersonit
DÇPB	Drejtoria e KB-ve për Çështje Pronësore dhe Banesore
PZHBV	Personat e zhvendosur brenda vendit
NJIGJ	Njësia e Inspektimit Gjyqësor
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOR	Forcat e NATO-së në Kosovë
KGJPK	Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë( nën IPVQ)
NATO	Organizata e Paktit Veri Atlantike
GMD	Grupi i Mos-diskriminimit në Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë
OJQ	Organizata joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
IPVQ	Institucionet e Përkohshme për Vetëqeverisjes
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
KSZHN	Korporata Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
KLKBR	Komisari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
FKBF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
FKBZHG	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Grave
MKBK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë